

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave të edukimit

Viti XLXIII (73)

2023

Shkodër, 2023

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Fatmir VADOHEJ

Sekretar shkencor - dr. Visar DIZDARI

*Anëtarë - Prof. dr. Mimoza PRIKU, prof. as. dr. Fatbardha
OSMANAGA, prof.as.dr. Arjana STRINIQI, prof. as.dr. Dhurata
HOXHA, prof. as. dr. Eranda HALLUNI, dr. Besara KADIU*

DREJTOR I REVISTËS

Prof. dr. Tonin GJURAJ

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave të Edukimit
Tel/fax: 0035522243747

PASQYRA E LËNDËS

Brilanda LUMANAJ, Blerta ÇAUSHAJ

Sfidat dhe vështirësitë e familjeve të fëmijëve me aftësi ndryshe
The Challenges and Difficulties of Families with Children with Different Abilities.....5

Artemisi SHEHU, Arjana MUÇAJ

Përvojimi i traumës prej ushtarëve paqeruajtës shqiptarë me shërbim në Afganistan
Experience of trauma by albanian peace keeping soldiers serving in Afghanistan.....19

Elona HASMUJAJ, Erjona BERDICA

Efektet psikologjike të individëve me sëmundje terminale
The psychological effects on individuals with terminal illness.....35

Adelina KAKIJA, Denalda BASHOTA

Faktorë socialë dhe psikologjikë që ndikojnë treguesit e përfshirjes dhe integritit në mjediset arsimore për minoritetin Rom
Social and psychological factors that affect inclusion and integration in educational environments of the Roma minority.....47

Xhulia MUSTA, Rudina RAMA

Current developments in the implementation of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania
Zhvillimet aktuale në zbatimin e modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri.....59

Elidjon CAMI

Ndikimi i emigracionit në familjet shqiptare: sfida dhe ndryshime
The impact of immigration on Albanian families: challenges and changes.....73

Fatjona HAKA

Media sociale dhe mirëqenia psikoemocionale: një interpretim fenomenologjik i gjetjeve me të rritur
Social media and psycho - emotional wellbeing: a phenomenological interpretation of findings in an adult population.....81

Arjeta PELINKU

Mindset and Mental Health
Mendësia dhe shëndeti mendor.....97

Gerda SULA, Shqipe HAXHIHYSENI

Të nxënësit bashkëpunues në arsimin e lartë nëpërmjet Wikis-
rast studimor
*Collaborative learning in Higher Education through the use of Wikis
- A Case Study*.....107

Eranda HALLUNI (Bilali), Fatmir VADOHEJ

Revista “Agimi” për problemet e arsimit
“Agimi” magazine on education problems..... 125

Edmond MUÇO

Shkolla e parë e vizatimit në Shqipëri
The first drawing school in Albania.....135

Anila PLAKU

Modeli i drejtimit dhe diferencat perceptuese mbi marrjen e vendimeve në
shkollë
(Rasti i qarkut Durrës)
*Leadership Model and Perceptual Differences on School Decision-Making:
(The case of the district of Durrës)*.....149

Teuta STAROVA

Vlera të sotme të ideve weberiane mbi shkencat shoqërore: dija dhe
organizimi universitar, një trajtim sociologjik
*Today's value of Weberian ideas on the social sciences: university knowledge
and organization, a sociological treatment*.....161

SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË E FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI NDRYSHE

Brilanda Lumanaj¹, Blerta Çaushaj²

¹Universiteti "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji-Punë Sociale

²Studente e diplomuar në degën Punë Sociale

ABSTRAKT

Eksperienca e prindërve kur mësojnë se fëmija i tyre ka një paaftësi në të nxënë, kthehet në një udhëtim që i drejton ato në një jetë të mbushur me emocione të forta, zgjedhje të vështira, ndërveprime me shërbime, por edhe me mungesa në marrjen e shumë përgjigjeve dhe ndihmave. Në zonat lokale, fëmijët me aftësi ndryshe hasin kufizime dhe mungesa në shërbime. Si rrjedhojë edhe prindërit përballen me vështirësi dhe barriera të ndryshme. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të eksplorojë eksperiencat, vështirësitë dhe sfidat e përjetuara nga prindërit me fëmijë me aftësi ndryshe gjatë kujdesit. Punimi, gjithashtu, ka si objektiv të identifikojë vështirësitë që prindërit e fëmijëve me aftësi ndryshe takojnë në shtëpi, shoqëri dhe komunitet, të cilët mund t'i pengojnë që të përcaktojnë burimet ndihmuese të shërbimeve konkrete ndaj fëmijëve të tyre. Studimi u realizua duke përdorur metodën cilësore përmes intervistave gjysmë të strukturuar të dizenuara për të mbledhur informacionin e nevojshëm. Kampioni i qëllimshëm përbëhet nga 12 prindër të zonave lokale në Malësinë e Madhe. Rezultatet treguan se prindërimi i fëmijëve me aftësi ndryshe mund të jetë eksperiencë stresuese, pasi ka shumë sfida të drejtuara ndaj prindërve pa ndihmë. Prindërit përballen me vështirësi të ndryshme në shtëpi, komunitet e më gjerë, siç janë: stresi emocional, dështimi në përballje me aftësitë ndryshe të fëmijës, vështirësitë ekonomike, mungesa e suportit apo diskriminimi, të cilat çojnë në probleme psikologjike, lodhje fizike dhe kufizim të cilësisë së jetës. Mungesa e mbështetjes emocionale familjare, aspekte të paragjyqimeve nga shoqëria si dhe vështirësitë në përballimin e aktiviteteve të përditshme funksionale ishin disa nga sfidat që u eksploruan në studim. Gjetjet dhe rekomandimet e studimit mund të shërbejnë si një bazë e mirë për t'u reflektuar nga grupe të ndryshme të interesit mbi nevojat dhe shërbimet psiko-sociale që kanë nevojë prindërit e fëmijëve me aftësi ndryshe.

Fjalët kyç: aftësi ndryshe, familje, prindër, vështirësi, sfida, diskriminim.

The Challenges and Difficulties of Families with Children with Different Abilities

ABSTRACT

The experience of parents learning that their child has a learning disability becomes a journey that often leads them into a life filled with strong emotions, difficult choices, interactions with services, but also with gaps in receiving many answers and help. In local areas, children with different abilities face limitations and service gaps. Consequently, parents also face difficulties and barriers to adjustments. The main goal of this study is to explore the experiences, difficulties, and challenges experienced by parents of children with different abilities during their care. The paper also aims to identify the difficulties parents of children with different abilities encounter at home, in society, and in the community, which may hinder them from determining the supportive resources of specific services for their children. The study was conducted using qualitative methods through semi-structured interviews designed to gather the necessary information. The purposeful sample consisted of 12 parents from local areas in Malësia e Madhe. The results showed that parenting children with different abilities can be a stressful experience, as there are many challenges directed towards parents without assistance. Parents face various difficulties at home, in the community, and beyond, such as emotional stress, failure to cope with the child's different abilities, economic difficulties, lack of support, or discrimination, leading to psychological problems, physical fatigue, and a reduced quality of life. The lack of family emotional support, societal prejudices, and difficulties in coping with daily functional activities were some of the challenges explored in the study. The findings and recommendations of the study can serve as a good basis for reflection by interest groups on the needs and psycho-social services required by parents of children with different abilities.

Keywords: *different abilities, families, parents, difficulties, challenges, discrimination.*

1. Hyrje

Aftësia ndryshe është një çështje globale e shëndetit publik që prek një në shtatë persona në mbarë botën sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh, 2020). Aftësia ndryshe e një fëmije është një përvojë treshe (tridiake), që përfshin ndërveprime mes fëmijës që përjeton

mosfungsionim, familjes që preket nga ai, si dhe mjedisin e jashtëm ku manifestohet aftësia ndryshe (Tali, 2002). Fatkeqësisht, çdo ditë fëmijë të tillë stigmatizohen edhe në mesin e moshatarëve të tyre, gjë që prekin ata dhe prindërit e tyre emocionalisht dhe psikologjikisht (Abosi, 2007; Taderera & Hall, 2017). Shaw (2010) shpjegon se pavarësisht aftësisë ndryshe, trajtimi dhe përballimi i problemeve që vijnë nga fëmijët me nevoja të veçanta ose me aftësi të kufizuara specifike dhe për ata që kujdesen çdo ditë, krijon me kalimin e kohës tek prindërit një përzierje emocionesh që do të duhet t'i fshehin dhe nuk mund t'i ndajnë me askënd. Ndërsa Abbeduto et al. (2004) gjetën se dallimet specifike të diagnozës në stresin prindëror u zhdukën kur sjellja e fëmijës, stili i përballimit të prindërve, edukimi i nënës, të ardhurat familjare, mosha e fëmijës dhe numri i fëmijëve në familje kontrolloheshin. Në familje të tilla mbizotërojnë kërkesa të shumta për burimet familjare dhe nivelet e stresit priren të jenë të larta dhe alarmante (Brett, 2002) dhe ndikojnë negativisht në perceptimet e funksionimit të familjes (Dyson, 1997). Është e zakonshme që prindërit e fëmijës të përjetojnë një tendosje në marrëdhënien e tyre, veçanërisht, pasi ata kanë një fëmijë që ka nevojë për vëmendje dhe kujdes shtesë (Slavik & Reed, 2002). Studiues si Raina et al, (2005), Sen dhe Yurtsever (2007) dhe Lakshmi dhe Anitha (2014) kanë rezultuar në përfundime se prindërit me fëmijë me AN¹ pësojnë një sërë ndryshimesh emocionale dhe fizike në përshtatjen dhe përballimin e nevojave dhe kushteve të kërkuara nga fëmijët me AN. Si pasojë, organizimi dhe mbajtja e rutinave të përditshme të prindërve preket nga vështirësitë e krijuara të të pasurit një fëmijë me nevoja të ndryshme. Prindërimi i një fëmije me aftësi ndryshe mund të jetë stresues dhe negativ në shumë aspekte. Megjithatë ky ndikim nuk është aq i rëndë sa besohet zakonisht (Staats, Goff, Springer, & Monk, 2015).

Funksionimi i familjes ndikohet si në një mënyrë negative ashtu edhe pozitive. Rezultatet pozitive përfshijnë një rritje të forcës së brendshme, qëndrueshmërisë, kohezionit dhe lidhjen me komunitetin. Studiuesit, gjithashtu, kanë vënë në dukje efekte negative në familje. Këto përfshijnë marrëdhëniet e tensionuara martesore, presionet financiare, rregullat në familje dhe uljen e efikasitetit të prindërve (Lindo, Kliemann, Combes, Frank, 2016). Prindërit e fëmijëve me nevoja ndryshe shpesh përjetojnë nivele të larta stresi krahasuar me prindërit e fëmijëve pa aftësi ndryshe (Slavik Cowen & Reed, 2002).

Ndërhyrja e punonjësit social në edukimin e këtyre fëmijëve dhe familjarëve është që t'i ndihmojë ata të lidhen me shumë burime të tilla si

¹ AN: aftësi ndryshe.

qeveria, komunitetet dhe organizatat shoqërore dhe me burimet për mbështetjet joformale me familjen, miqtë dhe fqinjët, të përmirësojnë aftësinë e përdorimit të rrjeteve sociale për të përmbushur më mirë sfidat e jetës (An Qiuling, 2009).

Është e rëndësishme të kuptojmë se sfidat dhe vështirësitë e prindërve janë përtej nga se mund ta mendojmë. Pavarësisht që fëmijët me aftësi ndryshe mund të jenë pjesë e shërbimeve sociale, familjarët e sidomos prindërit vuajnë nga mungesa e mbështetjes emocionale, ekonomike si dhe nga mungesa e informacionit. Prindërit me fëmijë me AN mbetën një ndër target grupet më në nevojë, prandaj vëmendja tek nevojat e tyre duhet rishikuar.

Ky studim ka si qëllim të eksplorojë dhe të përshkruajë sfidat dhe vështirësitë e përballuara nga prindërit në procesin e prindërimit të fëmijëve me aftësi ndryshe në zonat lokale të Malësisë së Madhe. Në funksion të qëllimit punimi synon t'i japë përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore:

1) Cilat janë perceptimet dhe njohuritë që prindërit kanë për llojin e aftësisë ndryshe të fëmijës së tyre?

2) Si ndikojnë vështirësitë e shfaqura tek prindërit me fëmijë me AN në aktivitetet e tyre të përditshme?

3) Si kanë qenë përjetimet emocionale të prindërve në përballje të sfidës së njohjes dhe të pranimit të aftësisë ndryshe të fëmijës?

4) Cilat janë sfidat kryesore të prindërve në lidhje me aspekte të ndryshme gjatë prindërimit?

Ky studim vjen si një kontribut empirik për evidentimin e aspekteve të vështirësive në përditshmërinë e prindërve. Ai mund t'u shërbejë grupeve të interesit dhe sidomos profesionistëve në fushën e shërbimeve psiko-sociale të interesuar për t'u njohur me sfidat konkrete të prindërve me fëmijë me AN të zonave lokale, si dhe vetë komunitetit të prindërve me këta fëmijë, të cilët duan të mësojnë apo të reflektojnë nga eksperiencat e ndryshme të hasura.

2. Metodologjia

Në këtë studim u përdor metoda cilësore. U përzgjedh kjo metodë, pasi ky studim synon të kuptojë më qartë përvojat, sfidat, vështirësitë dhe mendimet e subjekteve pjesëmarrës në studim. Ajo merret më së shumti me histori dhe rrëfime të cilat përfshijnë kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe bindje (Matthews dhe Ross, 2010). Metoda cilësore përputhet edhe me natyrën e kërkimit. Realizimi i këtij studimi ka nisur në prill të vitit 2023 dhe ka përfunduar në qershor të 2023-së.

Kampioni i studimit është i qëllimshëm. Në kërkimet cilësore është thelbësore që të gjithë pjesëmarrësit që merren në studim të kenë përjetuar fenomenin që ka qëllim të studiojë kërkuesi. Në studim janë përfshirë prindër të cilët jetojnë në zonat lokale të Malësisë së Madhe. Morën pjesë gjashtë (6) çifte, në total dymbëdhjetë (12) persona nga të cilët gjashtë (6) nëna dhe gjashtë (6) baballarë. Për përzgjedhjen e subjekteve të marra në studim u përcaktuan disa kriterë bazë, si: a) të gjithë të përzgjedhurit/çiftet të kishin një fëmijë me aftësi ndryshe dhe b) të gjithë të përzgjedhurit të jetonin në fshatra nga Malësia e Madhe. Subjektet janë kontaktuar përmes ndërmjetësimit nga organizata të shoqërisë civile, me të cilat familjet kanë patur bashkëpunime dhe mbështetje. Pjesëmarrja e tyre në studim është realizuar në mënyrë vullnetare pas dakordësisë dhe miratimit të informuar.

Instrumenti i përdorur në këtë studim është intervista gjysmë e strukturuar. Ajo është hartuar bazuar në literaturën me fokus çështjen e studimit si dhe duke iu referuar studimeve të ngjashme (Raina et al., 2005; Sen dhe Yurtsever, 2007; Laskar et al., 2010; Lakshmi dhe Anitha, 2014). Intervista është organizuar në disa nënçështje në funksion të qëllimit dhe pyetjeve kërkimore të studimit duke përfshirë, gjithashtu, në hyrje të saj plotësimin e të dhënave demografike, si: moshën e prindërve, fëmijëve me AN, punësimin e prindërve, llojin e aftësisë ndryshe tek fëmija, si dhe moshën kur u vu re ajo nga prindërit. Pasi pjesëmarrësit u informuan lidhur me studimin, intervistat u zhvilluan në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe u mbajtën shënime. U mbajtën konsiderata etike në realizimin e tyre duke informuar pjesëmarrësit që të dhënat do të përdoren vetëm për qëllim studimor.

Për analizën e të dhënave të mbledhura nga intervistat u përdor analiza e përmbajtjes dhe interpretimi i tyre. Sipas Grbich (2007), analiza cilësore përfshin procesin e ndarjes, kategorizimit dhe lidhjes së aspekteve të të dhënave para se të arrihet në interpretimin e tyre përfundimtar. Përgjigjet u transkriptuan, u kodifikuan dhe u kategorizuan bazuar në ngjashmëri për të përcaktuar temat kryesore. Nga analiza e intervistave u identifikuan këto kategori, si:

1. Njohuritë e prindërve në lidhje me AN dhe përjetimet e para emocionale.
2. Perceptimin e prindërve në lidhje me shkakun e aftësisë ndryshe.
3. Mbështetjen emocionale të familjarëve me ardhjen në jetë të një fëmije me AN.
4. Sfidat dhe vështirësitë në lidhje me aspekte të ndryshme të prindërve gjatë prindërimit.

3. Rezultatet dhe diskutime

3.1 Të dhëna përshkruese

Grupmoshat e prindërve variojnë nga 32 vjeç e deri në 55 vjeç (grupmoshat 32-40 vjeç dhe 42-50 vjeç me nga 3 subjekte secili dhe grupmosha 52-55 vjeç me 6 subjekte), ndërsa ajo e fëmijëve me AN varion nga 9 vjeç deri në 24 vjeç (në grupmoshën 9-13 vjeç janë 3 fëmijë, 14-19 vjeç është një fëmijë dhe në grupmoshën 20-24 vjeç janë 2 fëmijë²). Në këto familje 4 fëmijë janë të gjinisë mashkullore dhe 2 fëmijë të gjinisë femërore. Përsa i përket statusit të punësimit të të intervistuarve, një pjesë e madhe përbën grupin e të punësuarëve me kohë të pjesshme dhe grupin e të papunëve. Rezultuan 5 subjekte të papunë, 3 prej tyre të punësuar me kohë të plotë dhe 4 subjekte të punësuar me kohë të pjesshme. Gjithashtu, një element kyç ishte dhe mosha se kur prindërit fillimisht kuptuan se fëmija i tyre kishte një aftësi ndryshe. Kryesisht paaftësinë e fëmijës prindërit e kuptuan në vitet e fëmijërisë së hershme (3 familje e kuptuan në grupmoshën 2-4 vjeç, që në lindje, në grupmoshën 5-7 vjeç dhe 8-10 vjeç me nga një familje). Në lidhje me llojin e aftësisë ndryshe, 3 fëmijë ishin diagnostikuar me spektrin e autizmit, 2 prej tyre me prapambetje zhvillimore dhe 1 fëmijë me Sindromën Down.

3.2 Njohuritë e prindërve në lidhje me konceptin dhe shkakun e aftësisë ndryshe

Aftësia ndryshe si një fenomen nuk ishte plotësisht i qartë dhe i kuptueshëm për prindërit. Megjithëse një pjesë e tyre ishin të informuar në lidhje me diagnozën e fëmijës, përsëri prindërit hasnin vështirësi në identifikimin e llojit të aftësisë ndryshe. Prindërit kanë njohuri të ndryshme në lidhje me aftësinë ndryshe dhe vështirësi në njohjen e saktë të termave. Ata shpesh nuk dallojnë ndryshimin mes termave dhe përcaktimin e saktë të llojit të aftësisë ndryshe të fëmijës së tyre. Perceptimi i prindërve në lidhje me shkakun e aftësisë ndryshe rezultoi se një pjesë e prindërve besonin që arsyeja e shfaqjes së AN kishte ndodhur para ose gjatë lindjes së fëmijës si dhe nga infeksionet apo shkaqet e mbinatyrshme. Të intervistuarit nuk ishin të sigurt se çfarë përfshin aftësia ndryshe si fenomen. Mungesa e informimit të konceptit 'aftësi ndryshe' rezultoi edhe nga studimi mbi 'Vështirësitë e përjetuara nga familjet me fëmijë me AK' kryer nga Sen dhe Yurtsever (2007), të cilët argumentojnë se familjet nuk

² Nuk ka qenë kriter përfshirjeje mosha e fëmijës në përzgjedhjen e familjeve, pasi fokusi i studimit ka qenë evidentimi i sfidave dhe i vështirësive të prindërve, pra pavarësisht moshës së fëmijës synoheshin familjet/prindërit që kanë rritur dhe vazhdojnë të kujdesen për ata.

kishin njohuri të mjaftueshme për gjendjen e fëmijës së tyre.

“Mendoj se aftësia ndryshe është atëherë kur fëmija nuk mundet të përballojë përgjegjësi të ndryshme të moshës përkatëse dhe kur ai mendërisht nuk është i aftë për të vepruar” (Nëna S.M).

“Aftësi ndryshe do të thotë që fëmija ka mangësi në të kuptuar, folur, kur ai shfaq lëvizje ndryshe apo veprime të pakontrullueshme” (Babai A.Z).

Prindërit deklarorin lloje të ndryshme të shkaqeve siç ishin; probleme para ose gjatë lindjes, sëmundje, mallkim i Zotit, probleme gjenetike etj. Nga ana tjetër, disa prindër, u shprehën se AN mund të kishte ardhur si pasojë e sëmundjeve të ndryshme të nënës në muajt e fundit të shtatzënësisë ose si mallkim i Zotit për të provuar durimin e tyre. Tre nga dymbëdhjetë subjektet raportuan se arsyet e shkakut të AN-së të fëmijës së tyre ishin të paqarta.

“Ai (djali) ka lindur i shëndetshëm dhe papritur ka filluar të shfaqë sjellje jo të duhura për moshën e tij. Ishte 10 vjeç kur filloi të shmangej nga njerëzit, preferonte të qëndronte vetëm. Ndoshta temperatura e lartë, moskujdesi jonë në kohën e duhur ka shkaktuar më vonë tek ai një gjendje ankthi dhe paniku duke e dërguar djalin tonë në prapambetje zhvillimore” (Babai K.SH).

3.3 Përjetimet e para emocionale të përballjes me aftësinë ndryshe

Prindërit përshkruan ndjesitë dhe emocionet që ata përjetuan me lindjen e fëmijës me AN shoqëruar me dhimbje të madhe dhe trishtim, të qara, vetmi, ndjesinë e të qenurit të pafuqishëm për t'i shpëtuar kësaj situatë. Kryesisht, nënat jetonin me një konflikt të madh emocional dhe ekzistencial, duke u ndjerë të pafuqishme për të vazhduar kujdesin e duhur. Hera - herës, ato përjetonin një seri emocionesh, si: inati, mërzia, zhgënjimi etj. Pikërisht, përballja me veten, krijimi i kushteve për të ofruar një kujdes për fëmijën bën që nëna ta shikojë ndryshe të ardhmen. Ato kishin kaluar një periudhë të vështirë të të pranuarit të aftësisë ndryshe të fëmijës tyre. Prindërit e vështirësonin jetën e tyre duke mendur se si do ta përshkruajë shoqëria situatën e tyre. Rëndësia e opioninit e të tjerëve përbën një pengesë ndaj lehtësimit të barrierave stresuese.

“Në atë moment nuk mund ta pranoja se unë kisha lindur një fëmijë të tillë, kaq i shëmtuar dhe kaq i vogël (ndërpret të folurën)” (Nëna M.D).

“Nuk e kam pasur të lehtë ta kuptoj aftësinë ndryshe të vajzës time. Kjo për shkak se unë nuk e dija se çfarë ishte Sindroma Down. Vetëm pjesa fizike (sytë) më ndihmuan ta kuptoj se ajo ka...” (Babai S.I).

“Ka qenë shumë e vështirë për mua që ta pranoja prapambetjen

zhvillimore të vajzës sime. Jam ndjerë sikur të më mallkojnë me 1001 të zeza, aq të vështirë e kisha. Kisha turp nga lagjja. Ato nuk më shikonin mirë, mendonin se problemi kryesor isha unë, pra shkak i gjendjes së fëmijës”(Nëna M.Z).

3.4 Mbështetja emocionale e familjarëve në ardhjen në jetë të një fëmije me AN

Gjatë rutinës së përditshme me fëmijën, familjarët deklarojnë se kanë zbuluar mënyra të reja të të jetuarit si një familje e bashkuar. Prindërit e kuptojnë se situatat emocionale të krijuara nga aftësia ndryshe e fëmijës prekin edhe anëtarët e tjerë dhe se një përvojë e tillë ndikon në bashkimin dhe homostazën familjare. Përfshirja e babait në kujdesin e fëmijës është një faktor i rëndësishëm i balancës emocionale në çift. Prindërit e perceptojnë këtë si një faktor ndikues në marrëdhëniet familjare mes tyre.

“Ti ke një fëmijë me AN në shtëpi. Të duhet të kujdesesh për të gjatë gjithë kohës. Ky kujdes përfshin gjithë familjen, fëmijët, gjyshërit. Të gjithë do të ndikohen nga kjo, pavarësisht se sa mund t’i shmangen, fëmija me AN kërkon fokus vetëvetiu. Vetëvetiu t’i edhe konsumohesh nga kjo, prandaj familjarët shpesh hezitojnë në ofrimin e kujdesit. Unë bëj maksimumin tim” (Nëna A.M).

3.5 Sfidat dhe vështirësitë e përjetuara nga prindërit

3.5.1 Marrëdhëniet ndërpersonale në çift, familje dhe me të tjerët

Prindërit ishin të kujdesshëm në shprehjen e dashurisë për fëmijën e tyre. Ata deklarorin se kishin përjetuar probleme shëndetësore, të cilat ia atribuonin stresit, shoqëruar në disa raste edhe me depresion. Ndjesitë e dështimit si prind apo vështirësia e pranimit të faktit që kishin një fëmijë me AN evidentohet shpesh në përjetimet e prindërve. Të gjithë prindërit ishin po ashtu të shqetësuar për çdo impakt negativ të mundshëm tek fëmijët e tjerë. Prindërit ishin të shqetësuar se nga nevoja, mund të ishin shumë neglizhues ndaj fëmijëve të tjerë.

“Kam qenë i pasigurt se si do të kujdesesha për tim bir. Bashkë me gruan time kemi pasur momente të trishta për faktin se nuk do mund ta ndryshonim fatin tonë. Ishte e kotë që të shpresonim më të mirën, pavarësisht se sa jemi kujdesur për djalin. Vajza jonë bëhet mjaft xheloze kur ne kalojmë më shumë kohë me djalin tonë (autik). Sipas saj duket si favorizim, por në të vërtetë është një kohë që i duhet kushtuar djalit. Vajza këtë nuk e kupton (has vështirësi)... Ne mundohemi t’ia shpjegojmë herë-herës, por ajo akoma është e vogël, 6 vjeçe” (Babai V.M).

“Ajo do të qëndronte larg nesh (me lot në sy) ose do të ishte duke qarë në vetvete, por unë do t’i thoja asaj ‘e di, duhet ta kuptosh që ajo ka prapambetje në të kuptuar, në të folur... dhe duhet vëmendje e kujdes nga të gjithë ne” (Nëna M.Z).

Shumica e prindërve pohojnë se vazhdimisht po dështojnë në përballimin e natyrës së fëmijëve, pasi ata kërkojnë shumë kujdes shtesë prej tyre. Nga ana tjetër, disa prindër, tregonin se si sfidat e përditshme u bënë më të lehta për t’u përballuar me kalimin e viteve, pasi ata mësuuan se si t’i përgjigjeshin sjelljeve sfiduese të fëmijës. Prindërit po ashtu, folën edhe për përvojat e tyre kur fëmijët nuk ishin gjithmonë sfidues, por edhe krenarë për momentet që fëmijët e tyre po mësonin të bënë diçka të re dhe ta përvetësonin tashmë. Dy prindër shpjeguan se si prindër të tjerë me fëmijë të diagnostifikuar me spektrin e autizmit përbënin një burim mjaft të vlefshëm përse i përket mbështetjes emocionale. Ata mund të ndanin përvojat e tyre, emocionet, mendimet dhe pyetjet e shumta që i mundonin në përditshmërinë e tyre.

“Është një lehtësim në vete kur shikon se ka prindër të tjerë që janë në vendin tënd dhe mund të të kuptojnë. Çdo vështirësi që mund ta kenë kaluar me fëmijën, për ne është një mësim se si mund të përmirësojmë diçka tek vetja jonë. Padyshim që bëjmë gabime në kujdesin e tyre, por fakti se ka njerëz që mund të ndash një hall me ta të ndihmon t’ia dalësh” (Babai K.SH).

3.5.2 Sfidat dhe vështirësitë e hasura me komunitetin dhe raportet sociale

Të gjithë të intervistuarit argumentuan për situatat e ndodhura në publik si një ndër aspektet më të vështira të të sfiduarit në sjellje dhe qëndrime. Një perceptim i zakonshëm nga prindërit ishte se të tjerët prireshin t’i gjykonin fëmijët e tyre si thjesht fëmijë ‘me kërkesa’ dhe se ata si prindër nuk ishin mjaftueshëm të duhur për të qenë prindër. Tre nga dymbëdhjetë të intervistuarit u shprehën se ishin të kënaqur me mënyrën se si fëmija trajtohej, ndërsa të gjithë të intervistuarit e tjerë u ankuan për stigmë dhe diskriminim. Nëntë prindër u ankuan për mënyrën se si fëmija i tyre trajtohej dhe shikohej nga banorët e lagjes/komunitetit. Nga ana tjetër, shumë prindër, shprehën shqetësimin e tyre se nuk ishin të sigurt se çfarë duhej të bënin për fëmijët në rastin shkollës. Të intervistuarit shpresonin që qeveria t’i ndihmonte duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme dhe mundësi që fëmijët e tyre të mësonin dhe të rriteshin së bashku me fëmijët e tjerë. Ata gjithashtu dëshironin që “qeveria” t’i ofronte shërbime trajnuese se si të ndihmonin fëmijët e tyre në përditshmëri. Kishte dhe raste kur prindi shpjegonte se nuk kishte dëgjuar kurrë për terapi dhe vetëm bënte

trajtim të fëmijës me medikamente.

“Në qoftë se jemi në dyqan ose në rrugë, dhe ndodh që fëmija të bëjë një nga sjelljet e tij tipike, njerëzit do të kthejnë kokën çuditshëm dhe do të mendojnë se çfarë jam duke bërë... Çfarë prindi jam unë?” **Babai (K.SH).**

“Në po i dërgojmë fëmijët në shkollë, pasi nuk kanë asgjë që të bëjnë në shtëpi. Do të ishte mirë që tarifat e shkollës të paguheshin nga qeveria, bëhet e papërbalueshme nga ne, kemi shumë shpenzime të tjera” **(Babai B.D)**

“E kam dërguar fëmijën tim në një x shoqatë, por cilësia e shërbimit nuk mjaftonte, besoj se duhet shikuar shumë fakti i qendrave ditore për fëmijët me AN. Unë do të bëja të mundurën që ta dërgoja fëmijën tim për të marrë sadopak shërbim dhe trajtim, por këto janë mundësitë që qeveria ofron në këto zona. Nuk dua të ankojem, por me të drejtë ka mungesë shërbimesh” **(Nëna A.M).**

3.5.3 Vështirësitë që prindërit përjetojnë në përbalimin e aktiviteteve të përditshme funksionale

Dinamikat sociale dhe ekonomike krijojnë në familje ndryshime të theksuara përse i përket kohezionit familjar. Ekzistojnë sfida të tjera që i pengojnë prindërit në realizimin e kërkesave të përditshme të fëmijëve të tyre, si: transporti publik, aktivitete të tjera sociale e fetare të prindërve.

“Kujdesi ndaj djalit tim autik kërkon rreth ¾ e ditës vëmendje, përndryshe ai humbet fillin dhe gjërat veçse do të përkeqësohen. Megjithëse fëmija është në vend të parë, unë përsëri nuk e humbas kohën time. Më pëlqen të dal me shoqe, të kryej punët e mia dhe të kthehem pas tek djali. Për këtë duhet të shikoj gjithmonë gjendjen e djalit. Në qoftë se ai nuk është në formën e tij më të mirë atëherë më duhet të anulloj planet e ditës. Nuk mërzitem për këtë, pasi e di që të paktën po bëj diçka të rëndësishme, për mua dhe për djalin” **(Nëna E.D).**

Shumë prindër shprehen se puna e tyre kërkon transport publik me pagesë çdo ditë për shkak të largësisë nga shtëpia. Emergjencia për të krijuar një gjendje më të mirë ekonomike lidhet me ndryshimin e punës në mënyrë që të sigurohen të ardhura më të mira që janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave familjare e në veçanti të fëmijëve me aftësi ndryshe.

“Më duhet të them se kur jam me fëmijën në autobus, gjithmonë tërheqim vëmendjen nga njerëzit ulur. Një grua teksa ishte ulur, më pyeti nëse e kisha djalin e sëmurë dhe më ofroi një biskotë për ta qetësuar. E falënderova, megjithëse kjo gjë bëhet e tepërt ndonjëherë. Nuk dua që të

tjerët të më shikojnë teksa i ndërroj rrobën kur bëhet pis ose kur i ulem në gjunjë për ta qetësuar. Njerëzit nuk të thonë ndonjë fjalë motivuese ose të paktën një 'bravo'. Ata shfaqin vetëm ndjenja mbytëse, trishtohen dhe ndjejnë keqardhje për mua dhe për djalin tim. Nuk është kjo ajo që dua. Nuk kam nevojë për më shumë trishtim (mbushen sytë me lot)" (Nëna A.M).

3.5.4 Dilemat e së ardhmes dhe roli i punonjësit social me prindërit me fëmijë me aftësi ndryshe

Të pyetur për ndonjë shqetësim apo nevojë për t'u informuar, prindërit u shprehën se pavarësisht kapaciteteve për të përballuar sfidat që fëmijët e tyre me AN krijojnë dhe përkushtimit ndaj tyre, një ndër dilemat më të shpeshta që ato hasnin në përditshmërinë e tyre ishte e ardhmja e fëmijës dhe e vetë atyre.

"Çfarë do të ndodhë me fëmijën tonë? Sa do të përmirësojë në përvetësimin e aftësive të reja zhvillimore? Sa të aftë do të jemi ne pas disa viteve që të kujdesemi për të? A do të krijohen shërbime në përputhje me nevojat e fëmijëve me aftësi ndryshe? Si do të shikohet ky problem për prindërit dhe çfarë do të bëhet?"

Prindërit vuanin nga mungesa e informacionit. Shpesh kishin informacion të pakët dhe jo të duhurin për t'i dhënë zgjidhje apo lehtësim dilemave të përditshme të tyre. Vetëm katër prindër kishin dëgjuar për punonjës social dhe vetëm dy nga ata kishin pasur kontakt të vazhdueshëm me disa punonjëse sociale në qendra të ndryshme terapie për fëmijët me AN. Ata konkretisht nuk dinin se çfarë bën një punonjës social, deri ku mund të shtrihet puna dhe qasja e tij me këto target grupe dhe se cili ishte dallimi me një psikolog.

Mjaft nga rezultatet e studimit aktual përkojnë me përfundimet dhe gjetjet e studimeve të ngjashme. Kështu, Raina et al., (2005) në një studim të shëndetit dhe mirëqenies së prindërve me fëmijë me paralizë cerebrale dhe probleme të sjelljes, rezultoi se kishte në mënyrë të drejtpërdrejtë efekte negative psikologjike dhe fizike tek prindërit. Gjithashtu, Sen dhe Yurtsever (2007), evidentuan se nënat përjetonin trishtim dhe treguan se jeta e tyre shoqërore, e punës dhe marrëdhëniet familjare u prekën të gjitha pas lindjes së një fëmije me aftësi të kufizuara. Familjet u përballën edhe me probleme financiare. Laskar et al., (2010) nënvizuan në studimin e tyre se prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara ishin të rënduar përsa i përket barrës financiare dhe shëndetit mendor. Lakshmi dhe Anitha (2014) kryen një studim mbi kohezionin familjar dhe përshtatshmërinë midis çifteve me fëmijë me aftësi ndryshe në shkolla speciale. Studimi ka përdorur në

mënyrë të rastësishme një kampion me 50 të anketuar. Rezultatet zbuluan se të gjithë të anketuarit ishin të shqetësuar për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Gjysma nga të anketuarit ishin gjithmonë të ngarkuar nga fëmijët e tyre. 100% e të anketuarve raportuan se jeta normale sociale e fëmijës së tyre ishte e shqetësuar dhe e kishin të vështirë të krijojnë marrëdhënie shoqërore në një model të rregullt. 100% e të anketuarve deklaruan se fëmijët me aftësi të kufizuara ishin të tillë për shkak të karmës së tyre dhe mallkimit të Zotit. Vlen të theksohet se duke u mbështetur fort tek modeli i ABC-X i Reuben Hill i stresit familjar dhe komponentëve qendrorë të saj, kapaciteti dhe aftësia e prindërve me fëmijë me AN ndikohet nga mënyra se si ato e perceptojnë aftësinë ndryshe dhe se në cilën fazë të jetës së tyre lindin ato (Smith dhe Hamon, 2012).

4. KONKLUZIONE

Rezulton se subjektet e intervistuar në këtë studim kishin kaluar disa terma të ndryshëm të aftësisë ndryshe derisa e kishin kuptuar llojin përkatës dhe tipologjinë e AN-së tek fëmija. Ato pëshkruanin ndjesitë dhe emocionet e para që përjetuan me një dhimbje të madhe dhe trishtim. Nga ana tjetër një pjesë e prindërve e kishin të vështirë të pranonin fëmijën e tyre, kjo jo vetëm për shkak se nuk dinin se si të reagonin përballë një informacioni të ri, por edhe për arsye të opinionit të shoqërisë. Prindërit gjithashtu hasnin vështirësi në përballimin e aktiviteteve të përditshme funksionale. Ata ndikohen nga fakti se fëmija me AN duhet gjithmonë të vendoset në vend të parë dhe se dëshirat e tyre shpesh konsideroheshin si egoiste. Të dhënat tregojnë se nënat ishin më të dobëta për t'u përballur me vështirësitë dhe brengat emocionale të shkaktuara, si dhe barra më e madhe e kujdesit të përditshëm i binte mbi supe atyre. Diferencimi midis gjinive, pra të kujdesit dhe mënyrës se si nëna dhe babai e perceptojnë, rezultoi si një element i ri në këtë studim, pavarësisht faktit se nuk ishte në fokus. Prindërit përballen me vështirësi të ndryshme në shtëpi, komunitet e më gjerë siç janë stresi emocional, dështimi në përballje me aftësitë ndryshe të fëmijës, vështirësitë ekonomike, mungesa e suportit apo diskriminimi, të cilat çojnë në probleme psikologjike, lodhje fizike dhe kufizim të cilësisë së jetës. Në mjaft raste evidentohet mungesa e mbështetjes emocionale familjare, aspekte të paragjyqimeve nga shoqëria si dhe vështirësitë në përballimin e aktiviteteve të përditshme funksionale. Gjithashtu, nevoja për programe psikosociale mbështetëse për familjet, lobimi për ndryshim të politikave sociale dhe kërkesa për ndërgjegjësim të problemeve të lindura si pasojë e mosnjohjes së të drejtave të fëmijëve me AN u evidentuan nga prindërit pjesëmarrës në studim. Prindërit sugjeronin mbështetjen e

qeverisë në lehtësimin e aspekteve të ndryshme të ndërveprimit të fëmijëve dhe vetë prindërve me komunitetin dhe strukturat që ofrojnë shërbime.

5. REKOMANDIME

Rekomandimet jepen si një ndërthurje midis asaj çfarë konsideron literatura, legjislacioni dhe pikëpamjeve të bazuara në sfidat dhe vështirësitë reale të prindërve të përfshirë në këtë studim. Ajo që vlerësohet si e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë është zhvillimi i shërbimeve që mund të ndihmojnë prindërit në veprimtaritë e përgjithshme.

Nevojitet zhvillimi i programeve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e publikut për problemet e aftësisë, të drejtat e fëmijëve dhe mundësitë për pjesëmarrje. Sigurisht që krijimi i grupeve mbështetëse për prindërit si dhe programet psikosociale dhe trajtuese do të ndihmonin prindërit në rritjen e kapaciteteve të tyre përballuese, në përvetësimin e aftësive dhe strategjive të reja të kujdesit ndaj fëmijëve të tyre me aftësi ndryshe. Prindërit po ashtu kanë nevojë për mbështetje nga sistemi arsimor. Informacioni dhe burimet janë të nevojshme për prindërit dhe fëmijët. Mbështetja financiare mbetet një tjetër çështje për t'u diskutuar më shumë. Programet mbështetëse financiare duhet të shikohen si një burim i cili ndihmon prindërit që të gjenerojnë dhe të mbulojnë shpenzimet e kujdesit shëndetësor, terapistë dhe nevoja të tjera. E rëndësishme është të theksojmë se nevojitet një përfshirje më e madhe e punonjësve socialë në zonat lokale, të cilët mund të luajnë një rol kyç në mbështetjen e familjeve përmes advokacisë dhe ndihmës së familjeve duke i ofruar akses ndaj burimeve dhe koordinim të kujdesit.

REFERENCA

- Abbeduto, L., Seltzer, M. M., Shattuck, P., Krauss, M. W., Orsmond, G., & Murphy, M. M. (2004). Psychological well-being and coping in mothers of youths with autism, Down Syndrome, or Fragile X Syndrome. *American Journal on Mental Retardation*, 109(3), 237–254.
- Abosi, O. (2007). Educating Children with Learning Disabilities. *Learning Disabilities Research & Practice*, 22, 196-201.
- Wu, J. (2017). Social Work intervention in the education of special children, 344. China. *Atlantis Press*.
- Matthews, B., Ross, L. (2010). Metodat e Hulumtimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë: *CDE*.
- Brett, J. (2002). The Experience of Disability from the Perspective of Parents of Children with Profound Impairment: It Is Time for an Alternative Model of Disability. *Disability and Society*, 17, 825-843. <https://doi.org/10.1080/0968759022000039109>.

- Dyson, L. L. (1997). Families of Young Children with Handicaps: Parental Stress and Family Functioning. *American Journal on Mental Retardation*, 95, 623-629.
- Lakshmi, M., Anitha, P. (2014). A study on family cohesion adaptability among couples with differently abled kids in special schools, Trichy District. *Indian Journal of Applied Research*. 4(12), 119- 22.
- Lindo, E. J., Kliemann, K. R., Combes, B. H., & Frank, J. (2016). Managing stress levels of parents of children with developmental disabilities: A meta-analytic review of interventions. *Family Relations*, 65, 207-224.
- Raina P., O' Donnell, M., Roaenbaum, P., Brehaut, J., Walter, S.D., Rusel, S., Swinton, M., Zhu, B. & Wood, E. (2005). The health and well-being of caregivers of children with cerebral palsy. *Pediatrics*, 115(6), 1755.
- Sen, E., Yurtsever, S. (2007). Difficulties experienced by families with disabled children. *Journal for Specialists in Pediatric Nursing*, 12(4), 238–252. <https://doi.org/10.1111/j.1744-6155.2007.00119.x>
- Smith, S.R., & Hamon, R.R. (2012). Exploring Family Theories (3rd ed.). New York: Oxford University Press. 400 pp. (paperback). *Family & Consumer Sciences Research Journal*, 41(1), 102-104.
- Slavik Cowen, P., & Reed, D. A. (2002). Effects of respite care for children with developmental disabilities: Evaluation of an intervention for at risk families. *Public Health Nurs.* Jul-Aug; 19(4):272-83. Doi: 10.1046/j.1525-1446.2002.19407.x.
- Staats et al, (2015). Parents of children with Down syndrome: A comparison of prenatal and postnatal diagnosis groups. *Journal of Developmental Disabilities*, 21 (2), 83-94.
- Taderera, C. & Hall, H., (2017). Challenges faced by parents of children with learning disabilities in Opuwo, Namibia. *African Journal of Disability* 6(0), a283. <https://doi.org/10.4102/ajod.v6i0.283>
- Tali, H. (2002). Parents of Children with Disabilities: Resilience, Coping, and Future Expectations. *Journal of Developmental and Physical Disabilities*, 14, 159-171.

Webliografi

- <https://www.britannica.com/topic/parenting/Reasons-for-parenting-styles>
- <https://www.britannica.com/topic/discrimination-society>

PËRVOJIMI I TRAUMËS PREJ USHTARËVE PAQËRUAJTËS SHQIPTARË ME SHËRBIM NË AFGANISTAN

Artemisi Shehu, Arjana Muçaj

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,
departamenti i Pedagogji-Psikologjisë*

ABSTRAKT

Ushtarët e dërguar nga qeveria shqiptare për të kontribuar në ruajtjen e paqes në Irak janë jo vetëm një shembull ideal i mbështetjes dhe vlerës kombëtare, por edhe një objektiv mjaft interesant për t'u studiuar në aspektin social dhe psikologjik. Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë shenjat e çrregullimit të stresit post-traumatik tek ushtarët paqeruajtës që kanë shërbyer në Afganistan të paktën një herë, si dhe nivelin e tyre të riintegritimit në shoqëri pas shërbimit. Artikulli paraqet referenca nga studiues të fushës në lidhje me këtë çështje.

Pyetjeve kërkimore që ky studim është përpjekur t'u përgjigjet, janë: “A ka shenja të PTSD-së tek ushtarët paqeruajtës që kanë kryer të paktën 1 mision në Afganistan?”; “Kush ka më shumë gjasa të shfaqë më shumë simptoma të ushtarëve me PTSD, ata që kanë shërbyer në një mision apo ata që kanë shërbyer në më shumë se një mision?”; “Kush has më shumë vështirësi për t'u riintegruar në shoqëri?”.

Kampioni i studimit përbëhej nga 50 nga 100 ushtarë paqeruajtës që kishin kryer të paktën një mision. Marrja e kampionit u realizua me gjykim. Në studim janë përdorur dy pyetësorë. Instrumenti i parë ishte Forma e shkurtër e listës kontrolluese të PTSD-së (Lang & Stein, 2005) dhe instrumenti i dytë ishte Pyetësori i Ekzaminimit të Traumës (TSQ) (Brewin, 2002).

Të dhënat përshkruese të mbledhura u analizuan përmes programit SPSS. Nga këto të dhëna u zbulua se 43.1% e ushtarëve shfaqën simptoma të PTSD-së.

Artikulli përfundon me rekomandimet përkatëse për ecurinë e mëtejshme të studimit.

Experience of trauma by Albanian peace keeping soldiers serving in Afghanistan

ABSTRACT

The soldiers sent by the Albanian government to contribute to the maintenance of peace in Iraq are not only an ideal example of support and national value, but also a very interesting target to study in social and psychological terms. The purpose of this study is to identify the signs of post-traumatic stress disorder in peacekeeping soldiers who have served in Afghanistan at least once, as well as their level of re-integration into society after the service. The article presents references from researchers in the field related to this issue.

The research questions that this study has tried to answer are: Are there signs of PTSD in peacekeeping soldiers who have performed at least 1 mission in Afghanistan?; Who are more likely to show more symptoms of PTSD soldiers who have served in one mission or those who have served in more than one mission?; Who encounter more difficulties to re-integrate into society?

The sample consisted of 50 out of 100 peacekeeping soldiers who had completed at least one mission. Sampling was by judgement. Two questionnaires were used in the study. The first instrument was the Short Form of the PTSD Checklist (Lang & Stein, 2005) and the second was the Trauma Screening Questionnaire (TSQ) (Brewin, 2002).

References of many researchers are presented on these issues, which are really valuable that contradict or agree with the results of the study.

The descriptive data collected were analyzed through the SPSS program. From these data it was found that 43.1% of the soldiers showed symptoms of PTSD.

The article concludes with relevant recommendations for the further progress of the study.

Keywords: *post-traumatic stress disorder, peacekeeping mission, stressful experience, re-integration.*

Hyrje

Shqipëria si anëtare e NATO-s prej disa vitesh dërgon ushtarë në Afganistan dhe Irak. Disa dhjetëra e qindra prej tyre shkojnë me mision

paqeruajtës një herë në 6 muaj. Aktualisht në Afganistan ndodhen rreth 70 ushtarë.

Website zyrtar i Forcave të Armatosura Amerikane, ka botuar më 5 dhjetor 2012, një reportazh nga nëntogere Veronica Aguila, efektive e Forcave Amerikane në Afganistan, me pjesëtarët e njësisë shqiptare ALBSOF (Albanian Special Operations Force), të cilët shërbejnë si pjesë e Task Forcës që udhëhiqet nga forcat amerikane në provincën e Kandaharit, në Afganistan. ALBSOF është i kualifikuar në luftën kundër terrorizmit dhe në taktika të sigurisë së personelit. *“Duhet të jesh i trajnuar dhe i përgatitur mirë psikologjikisht e fizikisht. Duhet të dish kur duhet përdorur arma, kur pena dhe kur duhet të jesh human. Duhet përdorur mendja para forcës”*, pohon rreshteri i njësisë.

Kjo është motoja e Forcave Speciale shqiptare. Për shumë ushtarë të “Eagle 5”, përfshirë edhe rreshterin e njësisë, kjo nuk është vetëm një slogan apo fakt i historisë ushtarake të mësuar në shkollë, ajo është pjesë e historisë së tyre personale. Këta ushtarë ishin të parët: ata ishin gjenerata e parë, njësia e parë, të parët që e përdorën këtë moto e që mësuan domethënien e saj. Kjo moto ka shërbyer si udhërrëfyese që nga misioni i tyre i parë në Afganistan si pjesë e “Eagle 1” e deri në ditët e sotme, kur ende punojnë me forcat e koalicionit dhe partnerët afganë, për të përmirësuar sigurinë dhe qeverisjen e vendit (www.army.mil/article/92196).

Këto kanë qenë edhe disa nga lajmet që kanë shtyrë në realizimin e këtij studimi, por edhe shumë informacione dhe studime të tjera të realizuara me këto targete dhe efektet psikologjike që këto misione mbajnë me vete.

Stresi posttraumatik që përjetojnë ushtarët është një fenomen që nuk njih kombësi. Për herë të parë, ai u vërejt dhe studiua seriozisht pas Luftës së Vietnamit në vitet 1960-1970, kur me qindra veteranë amerikanë u përfshinë në krime apo vepra me natyrë të dhunshme, e mijëra të tjerë kërkuan trajtim mendor pas rikthimit në shtëpi (Van der Hart dhe Horts, 2015).

Rreth 40.000 anëtarë ushtarakë, të cilët janë kthyer nga Iraku apo Afganistani, kanë qenë të diagnostikuar zyrtarisht me PTSD që nga viti 2003, sipas Departamentit Amerikan të Mbrojtjes. Profesori i Psikologjisë R. J. Nally shprehet se ka arsye për optimizëm, kur flitet për një prevalencë të zhvillimit të PTSD, pasi në një studim të kryer nga Universiteti i Harvardit, tregohet se niveli i përqindjes së shfaqjes së PTSD-së kishte rënë nga 30% në 13.8% (Reynold dhe Brewin, 2018). Norma e PTSD-së ishte tre herë më e lartë në mesin e njerëzve që kanë qenë të ekspozuar gjatë luftimeve, sesa atyre, të cilët kanë qenë si paqeruajtës në Afganistan apo

Irak, sipas një studimi nga Qendra e Shëndetësisë së Kërkimeve Detare. Një në pesë ushtarakë, të cilët janë kthyer nga Iraku apo Afganistani, raportojnë simptomat e PTSD-së, por pak më shumë se gjysma kanë kërkuar trajtim, sipas një studimi nga Korporata RAND (NIMH, 2019).

Përkundrejt përpjekjeve të ushtrisë për të edukuar trupat për shëndetin mendor, 900,000 ushtarakëve u jepen mësimet për PTSD dhe dëmtimin e trurit që ky çrregullim mund të shkaktojë. Në vitin 2007 rreth gjysma e anëtarëve ushtarakë dhe bashkëshortët e tyre thonë se kanë disi ose aspak njohuri për simptomat e problemeve të shëndetit mendor si PTSD, sipas një sondazhi nga Shoqata Amerikane e Psikiatrisë (Blakeley & Jansen, 2016).

Këta 20 vjetët e fundit në literaturën e psikopatologjisë botërore, një çrregullim i tillë ka përvijuar të trajtohet si një sindromë e veçantë e titulluar me emrin “Çrregullimi i stresit pas traumës” (Post-Traumatic Stress Disorder) me inicialet PTSD. Kriterin diagnostikues të këtij termi, DSM-III (APA, 1980), e kushtëzonte me faktin që, individit duhej t’i ekspozohej patjetër një ngjarjeje traumatike. Ndërsa, DSM-IV, përkundrazi pranon se kryesore për të dhënë PTSD- në është komponenti subjektiv, pra doza e përgjigjes psikologjike që jep individit direkt pas ekspozimit traumatik, sasia rezultuese e ndjenjës së tmerrit, frikës apo e brengosjes ose sasia e ndjenjës së të qenurit “i çarmatosur”, pa ndihmë dhe pa mbështetje. Çrregullime të ngjashme të shfaqura edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, u quajtën “traumatic neurosis” apo “War neurosis” (neuroza e luftës). Po i njëjti çrregullim i vënë re midis viktimave të kampeve naziste u titullua “post camp astenia” apo “Concentration camp syndrome” ndërsa ky fenomen i evidentuar tek ushtarët e luftës në Vietnam u emërtua “Vietnam lobby” apo “post - Vietnam syndrome” (APA, 2015). Edhe në ditët e sotme po flitet gjithmonë e më shumë për këtë reaksion të veçantë të rëndimit psikologjik që duket i kushtëzuar nga rritja e gjithanshme e rrethanave traumatike nga përhapja e emigracioneve, e prostituimeve, e përdhunimeve, e incesteve, e dhunës së organizuar, e luftërave lokale, e torturave, të cilat sigurisht janë të lidhura ngusht me aspekte ekonomike, shoqërore, kulturore, ligjore dhe politike.

Deri më sot, ende është e paqartë se cilët faktorë janë më të predispozuar për të pasuar PTSD-në, se çfarë roli luan në të vërtetë ngjarja traumatike në përcaktimin e natyrës dhe të dekursit të këtij çrregullimi, pasi në të dhënat epidemiologjike rezulton që edhe ngjarjet nga më katastrofike nuk e kanë provokuar patjetërsisht këtë çrregullim dhe se personat me PTSD mbesin veçse një fraksion i vogël (llogaritjet të jetë në shifrat 10 –

15%) midis tërë atij kursi heterogjen të ekspozuarish ndaj traumave (Bisson, Roberts, Andrew, Cooper, Lewis, 2020).

Kërkimet studimore të bëra në aksin hipotalamo-pituitar-adrenal, interpretimet e reja neurobiologjike të trurit apo çrregullimet gjenetike të gjetura e kanë kufizuar rolin e ngjarjes traumatike thjesht si një prishës i statukuosë së një simptomatologjie latente preekzistuese. Në individët me PTSD janë gjetur ndryshime anatomopatologjike të tilla që flasin për atrofien e hipokampusit gjë që gjithsesi nuk është e thënë se janë përgjigje imediate e dukjes së simptomave të PTSD-së (Oltmans & Emery, 2018).

Pas ekspozimit traumatik viktimat pëson një rëndim psikologjik që pasqyrohet me shenja subjektive dhe objektive. Trauma provokon tek individit ndryshime të veçanta të spektrit emocional, të ndjenjave dhe të sjelljeve. Për të diagnostikuar PTSD-në, simptomatikën e saj, do të përmendim sipas një renditjeje të caktuar si më poshtë vijon: 1- *Momenti i befte i traumatizimit*. Ky moment paniku dhe disorganizimi kognitiv, i quajtur “faza e britmës” (the scream phase) apo “stadi i alarmit” (i alertës), “elektrizohet” më përpara se ngjarja traumatike të ketë pushuar (Andrews, Brewin, & Rose, botime ende të papublikuara). 2- *Efektet e rikthimit në jehonën ritraumatizuese*. Kjo fazë, quhet ndryshe “sindromi i ripërsëritjes së fantazuar të traumës”, meqë i traumatizuarit nis të rijetojë dhimbshëm traumën fillestare si në formën e një afluksi vizionar mendimesh gati halucinogjene, po ashtu edhe me përjetimin e ëndrrave të dhimbshme (Morris & Maisto, 2015). 3- *Ingranimi i mekanizmave për t’u mbrojtur nga jehona ritraumatizuese*. Kjo konsiderohet një fazë riorganizimi, nga që mendohet se tashmë është plotësuar ai kusht kohor që subjekti i traumatizuar, edhe pse akoma jo totalisht i përgatitur psikologjikisht, arrin të mundësojë procesimin e informacionit traumatik drejt vetëdijes (Brewin & Holmes, 2013). 4- *Dukuritë e një çrregullimi të brendshëm nën atmosferën e një zgjimi të trazuar*. Në atmosferën e këtij zgjimi të trazuar burojnë simptomat e hiperaktivitetit neuro - vegjetativ (Increased arousal symptoms). E veçanta e kësaj faze është dalja në pah e ankesave psikosomatike, si: dhimbja difuze kronike e kokës, rritja e tensionit muskolor, frika nga sëmundjet e zemrës, ecje në gjumë, urinim i pavullnetshëm gjatë natës, probleme me lëkurën etj., të cilat janë eksperiencia të përditshme për shumë viktimat (Claassen, Knox dhe Bossarte, 2010).

Në PTSD janë dalluar edhe disa reagime psikologjike që ndikojnë këta pacientë si rikthimi i kujtimeve të lidhura me traumën dhe vështirësi në rigjetjen e memories autobiografike, ndjenja negative të lidhura me traumën, (Buckley, 2009) problem me vëmendjen dhe përqendrimin, (Shay,

2010) shkëputja/disocimi (96% e ushtarëve e përjetonin këtë gjë), dhe kjo gjendje përjetohet me mpirje emocionale, demoralizim, dhe përvojat jashtë-trupit, (Zoellner, Foa, & Bartholomew, 1999) ndjenjat e vetmisë dhe gjendjes së mbrojtjes mendore, ku individi mendohet se humb mbrojtjen (Trandel & McNally, 1987), turpi po ashtu është vlerësuar si një parashikues i fuqishëm sesi PTSD zhvillohet me kalimin e kohës (Stein, et al., 2017). Besimet po ashtu preken psikologjikisht në këtë çrregullim. Ideja është se ngjarjet traumatike thyejnë besimet bazë. Në mbështetje të kësaj ideje, një rritje e madhe e besimeve negative mbi veten, mbi të tjerët e mbi botën janë zbuluar tek viktimat me trauma PTSD, e krahasuar kjo me viktimat që nuk vuajnë nga PTSD (Morgan et al., 2020).

Nga 14 faktorët rrezikues për PTSD të studiuara, duke përfshirë ashpërsinë traumatike dhe gjininë, mbështetja sociale dukej se kishte një ndikim shumë të fortë. Megjithëse shumë studime konsideruan vetëm elementë pozitivë siç është perceptimi i mbështetjes emocionale dhe praktike, disa studime të fundit e kanë konsideruar aspekt negativ të mbështetjes siç është indiferentizmi dhe kritikimi (Brewin & Holmes, 2013). Kur të dy elementët pozitivë dhe negativë hetohen, mjedisi social negativ është treguesi më i mirë për PTSD sesa mungesa e mbështetjes pozitive. Për më tepër, vlerësimi negativ i mbështetjes të të tjerët, kërkon një detyrë fillestare, sipas parashikimeve të shenjave të PTSD-së 6 deri në 9 muaj me vonë. Mbështetja sociale negative, në rastin e dhunës duket sikur shfaqet më shumë te viktimat femra sesa tek meshkujt, dhe si rrjedhojë, lidhja midis mbështetjes negative sociale dhe me vonë shenjat e PTSD janë me të forta për gratë sesa për burrat (Andrews, Brewin, & Rose, Botim i papublikuar ende).

Shumë autorë dhe studiues janë përpjekur të japin simptomat kryesore të asaj çfarë ndodh në tablonë klinike të individëve të prekur nga çrregullimi i stresit posttraumatik. Ajo që përmbledhtaz shprehet qartë nga literatura, është fakti, se shumica e grupeve të studiuara të ushtarëve të kthyer nga lufta e misionet, paraqesin simptoma individuale psikologjike dhe gjithashtu edhe problematika të dukshme sociale që kanë dëmtuar marrëdhëniet e tyre sociale me të tjerët rreth tyre.

Metodologjia e studimit

Qëllimi i studimit është të evidentohet nëse ka shenja të shfaqjes së PTSD tek ushtarët paqeruajtës të cilët kanë kryer shërbim në Afganistan të paktën një herë, si është të kuptohet se si ndikon numri i misioneve në shfaqjen apo mosshfaqjen e simptomave të PTSD-së. Në cilat aspekte të

jetës së tyre shoqërore (pas kthimit nga misioni) ushtarët kanë vështirësi për t'u riintegruar?

Objektivat e këtij studimi janë:

1. Të evidentohet nëse ka shenja të shfaqjes së PTSD-së tek ushtarët paqeruajtës, të cilët kanë kryer një mision në Afganistan.
2. Të zbulohet se si ndikon numri i misioneve në shfaqjen ose mosshfaqjen e simptomave të PTSD-së tek ushtarët paqeruajtës.
3. Të zbulohet se si lidhet statusi i tyre civil me riintegrimin në shoqëri.
4. Të zbulohet se në cilat aspekte të riintegritimit në shoqëri ushtarët hasin vështirësi, pas kthimit nga misioni.

Pyetjeve të cilave është përpjekur t'u përgjigjet ky studim janë:

1. A ka shenja të shfaqjes së PTSD-së tek ushtarët paqeruajtës të cilët kanë kryer të paktën 1 mision në Afganistan?
2. Cilët janë më të prirur të kenë më tepër simptoma të PTSD-së ushtarët që kanë shërbyer në një mision apo ata të cilët kanë shërbyer në më shumë se një mision në Afganistan?
3. Cilët hasin më tepër vështirësi për t'u riintegruar në shoqëri ata të cilët janë të martuar ose kanë fëmijë apo ata të cilët jetojnë vetëm, apo janë beqarë?
4. Cilët hasin më tepër vështirësi për t'u riintegruar në shoqëri, ushtarët të cilët kanë shfaqur simptoma të PTSD-së apo ata të cilët nuk kanë shfaqur simptoma të PTSD-së?

Për të përmbushur objektivat kryesore të studimit është përdorur metoda e kërkimit sasior. Kampionimi i përzgjedhur për këtë studim përfshin 50 ushtarë paqeruajtës, të cilët kanë shërbyer për të paktën një mision në Afganistan. Në dy kontigjentë me nga 60 ushtarë përafërsisht, u përzgjedhën 50 ushtarë. Kampioni ishte i qëllimshëm dhe me paragjykim. Prej tyre 15 kishin qenë në 1 mision dhe 35 kishin kryer 2- 4 misione. Rreth 64% prej tyre ishin të martuar dhe 36% ishin beqarë. 56% të martuar kishin fëmijë dhe 44% nuk kishin.

Në fillim të dy listëkontrolleve të shpërndara subjekteve përshkruhej qëllimi i studimit si dhe informacioni mbi etikën e kërkimit. Gjithashtu u kërkua informacion edhe mbi të dhënat personale, kjo për shkak të nevojës për të minimizuar mungesat e këtij informacioni nga Shërbimi Social i Ministrisë së Brendshme. Instrumenti i parë i përdorur ishte Forma e shkurtuar e Listëkontrollit të CSPT-Short Form of the PTSD Checklist (Lang & Stein, 2005). Paraqiteshin 17 pyetje me shkallën Likert.

Ky instrument u përdor për të vlerësuar simptomat që subjektet kishin përvojuar apo përvojnin lidhur me ngjarjen e kaluar. Koeficienti i besueshmërisë së kësaj listëkontrolli në studim u vlerësua të ishte $r=0.83$.

Pyetësi i dytë është pyetësi i testimit të traumës - Trauma Screening Questionnaire (TSQ) (Brewin, 2002). Ai është një pyetësor i strukturuar, me 10 çështje që synon të vlerësojë simptomat e të gjitha llojeve të traumave si dhe riintegrimin e mëvonshëm. Koeficienti i besueshmërisë u vlerësua ishte 0.95.

Instrumentet u administruan nga persona të trajnuar. Para se të shpërndaheshin pyetësorët iu nënshtroan procesit të pilotimit, nga i cili u bënë rregullimet dhe modifikimet e nevojshme. Pyetësorët iu shpërndanë ushtarëve 30 ditë nga kthimi nga misioni i tyre në Afganistan. Nga 54 pyetësorë dhe teste që u dërguan të 50 u plotësuan dhe 4 refuzuan t'i plotësonin.

U respektuan të gjitha të drejtat dhe rregullat etike të të intervistuarve.

Sigurisht që studimi u ndërmor edhe pse përmbante një sërë vështirësish. Vetë stresi posttraumatik, është një gjendje e vështirë për t'u vlerësuar. Nga ana tjetër, jo për të gjithë ushtarët, mund të jenë të njëjtët faktorë që ndikojnë në zhvillimin e simptomave të PTSD, pasi secili prej tyre mund ta perceptojë një ngjarje të njëjtë në mënyrë unike.


Gjithashtu, një vështirësi tjetër e studimit, u vlerësua edhe fakti që jo të gjithë ushtarët u treguan të gatshëm për të plotësuar me sinqeritet instrumentet për shkak të mungesës së durimit apo dëshirës për t'u marrë me diçka 'pa përfitim', ashtu siç edhe disa prej tyre u shprehën.

Rezultate dhe diskutime

Nga rezultatet e të dhënat e studimit do të paraqiten ato më të rëndësishme të grumbulluara dhe që kanë lidhje me qëllimin e studimit.

Kryesisht të intervistuarit pohuan se kishin vështirësi t'u drejtoheshin personave që nuk i njihnin mirë. Mbi 34% e tyre kishin vështirësi dhe pjesa tjetër nuk kishin vështirësi (30%). Nga këto të dhëna rezulton se rreth gjysma e ushtarëve gjatë muajit pas kthimit nga misioni kanë hasur vështirësi në komunikimin me njerëz të rinj/ që nuk i njohin mirë.

Duke vazhduar me pyetjet e tjera u vu re që nuk ishin dalluar vështirësi në mbajtjen e miqësive me njerëz që nuk kanë përvojë ushtarake apo për të bërë miq të rinj. Përkatesisht 42% janë përgjigjur pyetjes për të krijuar miqësi të reja me **PAK**, po ashtu 48% ka qenë edhe përqindja e

Grafiku 1 Pikët e grumbulluara mbi testin e simptomave të PTSD.

e ushtarëve të cilët i janë përgjigjur përsëri me **PAK** pyetjes: “Mbajtja e miqësive me njerëz që nuk kanë përvojë ushtarake”? Si dhe 40% janë përgjigjur po me **PAK** për pyetjen “Mbajtja e miqësive me njerëz që kanë përvoja ushtarake (duke përfshirë edhe miqtë që janë në detyrë aktive apo ata të cilët janë në pension?”).

Përsa u përket pyetjeve, të cilat tregojnë për nivelin e funksionimit në marrëdhënie me njerëzit e afërt dhe familjarët, vihet re se ushtarët mbas kthimit nga misioni hasin vështirësi në marrëdhënie me të afërmit, 34% i janë përgjigjur pyetjes “Në marrëdhënie me të afërmit: vëllezërit e motrat, prindërit, gjyshërit, kunetërit dhe fëmijët tuaj (nëse keni) që nuk jetojnë me ju në shtëpi?” me PO dhe shumë më pak me partnerët e tyre 42% i janë përgjigjur me **PAK** dhe pothuaj aspak në marrëdhënie me fëmijët 42% i janë përgjigjur me JO, megjithatë nuk vihet re ndonjë diferencë e madhe midis pikëve të mbledhura për secilin pyetje në të treja rastet. Gjithsesi, mund të thuhet, se nga këto të dhëna nuk tregohet nëse vështirësitë që ata hasin vijnë si rezultat i misionit.

Përsa u përket pyetjeve “Gjetjen apo mbajtjen e një pune (me pagesë/pa pagesë apo vetëpunësim?); “Të bësh atë që ju duhet të bëni në punë ose në shkollë? Kujdesjen për punët tuaja në shtëpi (të tilla si punët e shtëpisë, kopshtaria, gatimi, pastrimi, pazari?”), të cilat masin nivelin e angazhimit në mbajtjen e përgjegjësisë përsa u përket punëve të përditshme dhe detyrave që ata duhet të përmbushin, shohim se ka një përqindje, përkatësisht për çdo pyetje të sipërpërmendur, prej 42% PO, 52% PAK dhe 42% PAK. Duhet theksuar se ka një diferencë të madhe midis përgjigjeve PO-JO dhe diferencës shumë të vogël midis atyre PO-PAK, e cila na bën të besojmë, se misioni ka bërë që gjatë muajit të parë mbas kthimit, atyre u duhet që të përballen përsëri me rutinën dhe të përballojnë kërkesat ndaj punës, që natyrisht janë shumë të ndryshme nga ato të misionit.

Nëse vihen re edhe pyetje të tjera, të cilat synojnë të shohin, nëse ushtarët hasin vëshirësi përsa i përket kujdesit ndaj vetes dhe menaxhimit të kohës së lirë si dhe të marrëdhënieve ndërpersonale, shihet se 42% kanë pohuar se kanë **PAK** vëshirësi në “*Kujdesin për shëndetin tuaj (ushtrimet, fjetja, të ngrenit mirë, marrja e medikamenteve sipas nevojës)*”, po ashtu edhe 44% i janë përgjigjur po me **PAK** pyetjes: “*Shijimi dhe përdorimi i efektshëm i kohës suaj të lirë?*”, si dhe 46% kanë mohuar se kanë vështirësi në *Përfshirjen në aktivitete të ndryshme në komunitet si p.sh.(festivale, shkuarja në kishë/ xhami apo kulte të tjera fetare, takimet me fqinjët).*

Grupi i fundit i pyetjeve ka treguar se 40% e kanë mohuar se kanë pasur vështirësi “*Të menduarit se i përkisni shoqërisë civile?*”, por vihet re se 30% e kanë pohuar këtë gjë dhe po aq janë përgjigjur më **PAK**. Ndërsa përsa u përket pyetjeve: “*Besimin ose ndarjen e mendimeve dhe ndjenjave personale me të tjerë?*” Gjetja e kuptimit apo qëllimit tuaj në jetë? Nevrikoseni apo trembeni lehtë? Vihet re se 42- 44 % e ushtarëve janë përgjigjur **PAK**.

Megjithatë nëse vihet re shuma si dhe përqindja e çdo përgjigjeje të dhënë nga ushtarët, kuptohet se gjatë muajit të parë mbas kthimit nga misioni ushtarët kanë hasur vështirësi mesatare gjatë riintegritimit në shoqëri.

Përsa i përket nivelit të simptomave të PTSD tek ushtarët paqeruajtës do të kishim këto të dhëna. Koeficienti Alpha (Cronbach's Alpha) për instrumentin që maste nëse kishte shenja të shfaqjes së PTSD është $p=83$. Kjo tregon për një besueshmëri të lartë të përgjigjeve të dhëna nga ushtarët.

Për pyetjen e parë “*Përsëritje, kujtime shqetësuese, mendime, apo imazhet e një përvoje stresuese nga e kaluara?*” 34% i janë përgjigjur me pak dhe mesatarisht po ashtu. E njëjta edhe për pyetjen “*Përsëritje, ëndrra shqetësuese, mankthe të një përvoje stresuese nga e kaluara?*”, ku 34% i janë përgjigjur mesatarisht.

Përsa i përket pyetjes “*Papritur veproni apo ndjeni sikur kjo eksperiencë stresuese po ndodh përsëri (sikur po e ripërjetoni atë)?*”, 46% i janë përgjigjur me Pak. Gjithashtu, rreth 40%, i janë përgjigjur mesatarisht pyetjes “*Ndjeheni shumë i mërzhitur kur diçka ju kujton atë përvojë stresuese nga e kaluara?*” Po ashtu, pothuajse tek të gjitha pyetjet, përqindjen më të madhe të përgjigjeve e kanë alternativat Pak dhe Mesatarisht.

Duke qenë se pikët për alternativat që ushtarët duhet të zgjidhnin ishin: 1 - Aspak, 2 - Pak, 3 - Mesatarisht, 4 - Mjaft, 5 - Mjaft, atëherë do të kishin më tepër simptoma ata që kanë grumbulluar më tepër pikë. Kështu,

në këtë rast, maksimumi i pikëve që mund të mblidhen për të treguar se ka shenja të shfaqjes së PTSD është 85, ndërkohë që minimum që tregon të kundërtën, është 17 (që do të thotë një mesatare prej 34 pikësh). Rezultatet nga përgjigjet e marra, tregojnë që shumica e ushtarëve kanë një mesatare pikësh që vijnë rreth numrit 27, 58, 35, 48, 60. Cut-off për këtë pyetësor është tek numri 48 gjë që tregon se nëse një individ ka grumbulluar më tepër se 48 pikë atëherë ai ka rrezik të jetë me PTSD dhe në qoftë se ka 47 pikë apo më pak themi se personi është jashtë rrezikut për shfaqjen e PTSD.

Nga të dhënat u vu re se 50% e ushtarëve kishin grumbulluar 48 - 65 pikë, çka tregon për një nivel risku të shfaqjes së PTSD te këta ushtarë. Rreth 10% e ushtarëve kishin grumbulluar vlerën e 27 pikëve, çka tregon se simptomat e PTSD ose nuk ekzistojnë te këta ushtarë, ose janë të papërfillshme. Kurse 8% grumbulluan 58 pikë çka tregon për një nivel mesatar të shfaqjes së simptomave të PTSD tek këta ushtarë. Po ashtu 24% e ushtarëve grumbulluan nga 35, 48, 56 dhe 60 pikë. 36% e ushtarëve kanë grumbulluar 65, 57, 32, 36, 42, 43, 45, 51 dhe 52 pikë.

Ndërkohë që mesatarja e pikëve ka qenë 46.40 dhe devijimi standard $DS=11.01$, siç shihet edhe nga grafiku 1.

Gjithashtu, vihet re se pjesa më e madhe e ushtarëve 54.9% kanë marrë nga 17-48 pikë dhe 43.1% kanë marrë nga 49-85 pikë. Ka një diferencë prej 11.8% midis atyre që kanë shanse për të zhvilluar PTSD dhe atyre që nuk kanë shfaqur simptoma të PTSD.

Për të parë se si është lidhja midis numrit të misioneve dhe nivelit të shfaqjes së PTSD, është përdorur korrelacioni Pearson.

U vu re të kishte një korrelacion pozitiv midis dy variablave. Kështu, numri i misioneve korrelonte me shfaqjen e simptomave të PTSD tek ushtarët paqeruajtës në vlerën 0.555 dhe kënaqësia statistikore është 0.01. Pra vihet re se kemi një domethënie statistikore në këtë rast për kampionin në studim.

Ndërkohë përse i përket marrëdhënies mes statusit civil dhe riintegrit të ushtarëve në shoqëri u vu re një korrelacion i dobët negativ midis dy variablave. Kënaqësia statistikore është më e madhe se 0.05. Pra vihet re se nuk ka një domethënie statistikore në këtë rast për kampionin.

Po ashtu u vu re një korrelacion i dobët negativ midis dy variablave PTSD me riintegrimin në shoqëri. Kënaqësia statistikore është më e madhe se 0.05. Pra, u vu re se nuk kishte një domethënie statistikore në këtë rast për kampionin në studim.

Target grupi iu nënshtrua edhe disa pyetjeve shtesë mbi grumbullimin e të dhënave të mundshme. Për analizën e tyre u përdor T-

testi për krahasimin midis grupeve të pavarura. Nga të dhënat u vu re se nuk kishte ndonjë diferencë të madhe midis vlerave përsa i përket Riintegrimit në shoqëri, çka nënkupton se ndryshimet midis vlerave janë aq të vogla sa nuk ka domethënie statistikore. Por u vu re të kishte ndryshime me vlerat e PTSD dhe kjo mund të jetë si rezultat i vlerave ekstreme. Megjithatë duket që ka lidhje midis shfaqjes së simptomave të PTSD dhe të qenit dëshmitar i rasteve të abuzimit fizik.

Nga të gjitha të dhënat vihej re qartë që kishte lidhje midis ngjarjeve, të cilat shkaktojnë trauma dhe shfaqjes së simptomave të PTSD.

Rezultatet e përgjithshme të studimit flasin për një nivel jo shumë të lartë të PTSD tek ushtarët dhe kjo mund të jetë pasojë e faktit se ushtarët në Afganistan kanë qenë me mision paqeruajtës, pra nuk kanë qenë në frontin e parë të luftimit dhe nuk janë përballur direkt me luftën. Megjithatë, duket se përsëri, ka një prirje për të pasur shenja të PTSD dhe kjo mendohet si rezultat i bombardimeve të vazhdueshme që kanë qenë në bazë dhe kjo ka ndikuar që ushtarët të kenë probleme me vigjilencën. Gjetjet përcaktojnë rëndësinë e çrregullimit të stresit post-traumatik në këtë popullsi dhe theksojnë se ekspozimet e veçanta luftarake ndikojnë dukshëm fillimin e simptomave të çrregullimit të stresit post-traumatik pas vendosjes.

Për shkak të ekspozimit më të madh duke luftuar, personeli i forcave tokësore të ushtrisë besohet se është në përgjithësi në rrezik më të lartë për t'u prekur nga PTSD se pjesëtarët e Forcës Ajrore dhe Detare. Për këtë arsye, nëse në operacionet paqeruajtëse, luftarake dhe kthimit të tyre, nuk trajtohen këto çrregullime, PTSD mund të ndikojë negativisht në sjelljen e ushtarëve dhe të dëmtojë marrëdhëniet e tyre ushtarake, familjet e tyre dhe përfshirjen në shoqëri. Zyrtarisht, shërbimet psikologjike në forcat e armatosura të të gjitha vendeve të këtij studimi ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor mendor për ushtarët, megjithatë shumë ushtarë janë në mëdyshje për të kërkuar trajtim.

Pyetjet kërkimore të këtij studimi fokusoheshin në evidentimin e shenjave të PTSD te ushtarët paqeruajtës, të zbulohet se si ndikonin misionet në shfaqjen e këtyre simptomave, si lidhej statusi civil me riintegrimin në shoqëri dhe se në cilat aspekte të tij ushtarët do të hasnin më tepër vështirësi. Synimi ishte pikërisht lidhja që kanë të gjithë faktorët e sipërpërmendur me PTSD dhe riintegrimin e ushtarëve në shoqëri një muaj mbas kthimit nga misioni.


Nga rezultatet u arrit në përfundimin se 43.1% e ushtarëve të marrë në studim rezultuan me një nivel pikësh në testin e PTSD më 49 deri në 85 pikë. Ky nivel pikësh tregon se afërsisht 50% e tyre kanë shfaqur shenja të PTSD. Megjithëse mesatarja e pikëve ka qenë 46.40, rezultat i cili shpreh

se nuk ka shenja të shfaqjes së PTSD, nëse i shohim rezultatet e pikëve të ndara, atëherë mund të themi se në 43.1% të ushtarëve ka patur shenja të shfaqjes së PTSD. Mesatarja e pikëve mund të jetë e ndikuar nga rezultatet e skajshme.

Në një anketim të 203 paqeruajtësve aktiv në detyrë para, pas vendosjes si paqeruajtës në Ballkan dhe pas kthimit nga misionet paqeruajtëse, janë konstatuar disa simptoma të stresit që kërkonin ndërhyrje të menjëhershme të kujdesit të shëndetit mendor. Gjashtëdhjetë e pesë paqeruajtësit u ekzaminuan para-dhe pas-vendosjes. Pas kthimit nga Bosnja dhe Kosova, ndërmjet 5% dhe 9% e ushtarakëve kanë shprehur nevojën për trajtimin dhe menaxhimin e zemërimit apo armiqësisë, depresionin ose stresin. Pengesa më e madhe në mes të ushtarëve dhe trajtimit ishte shqetësimi në lidhje me barrën individuale financiare të trajtimit.

Nga rezultatet u vu re se ka një lidhje të fortë midis personave që kanë parë raste të vdekjeve, torturave, dhunimit fizik dhe simptomave të PTSD.

Ndërkohë për riintegrimin në shoqëri në këtë studim përkufizohet si arritje e niveleve të kënaqshme të funksionimit në shtëpi, në punë, në marrëdhëniet dhe në komunitet.



Grafiku 2 Riintegrimi në shoqëri.

Nëse shikojmë shumën si dhe përqindjen e çdo përgjigjeje të dhënë nga ushtarët, kuptojmë që gjatë muajit të parë mbas kthimit nga misioni ushtarët kanë hasur vështirësi mesatare gjatë riintegrimin të shoqërisë. Kjo tregohet edhe nga të dhënat ku 16% kanë grumbulluar 39 pikë dhe 42% e pjesëmarrësve në studim kanë grumbulluar 42 pikë.

Vështirësi më të madhe ushtarët kanë hasur në marrëdhëniet me të afërmit si dhe në mbajtjen e një pune apo në përmbushjen e detyrave të përditshme përsa i përket punës dhe kujdesit ndaj vetes. Po ashtu shohim që ka një korrelacion të dobët negativ midis PTSD dhe riintegrimin në shoqëri. Megjithatë mund të thuhet se një numër më i madh simptomash të PTSD çojnë në një integrim më të paktët të ushtarëve në shoqëri. Sipas një

studimi të kryer nga departamenti i veteranëve në SHBA, përllogaritet se përafërsisht 11 deri 20% e veteranëve të luftës së Irakut dhe Afganistanit vuajnë nga PTSD. Po kështu rezulton se rreth 10% e veteranëve të luftës së Gjirit Persik dhe rreth 30% e luftës së Vietnamit vuajnë nga PTSD (Blakeley, & Jansen, 2013). Diferencat në shkallën e vuajtjes nga PTSD varen kryesisht nga ajo çfarë ata ishin të angazhuar për të kryer në luftë, mjedisi politik dhe se si i priti publiku, pas kthimit nga misioni. Ndonëse nuk pranohet drejtpërdrejt, mes radhëve të ushtarakëve, është një rregull i pashkruar që quhet ‘disi e turpshme’ të pranosh se vuan nga PTSD.

Ky qëndrim vazhdon të jetë aktiv edhe për faktin se ushtarakët janë skeptikë mbi rolin e asaj që mund t’i ndodhë karrierës së tyre nëse e pranojnë se vuajnë nga PTSD. Si rezultat, shumë ushtarakë, qëndrojnë të heshtur përballë këtij problemi që u trazon tmerret e luftës që ata kanë përjetuar, duke bërë që heshtja e tyre të ndikojë në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

Nga rezultatet e studimit u vu re se ka lidhje midis numrit të misioneve dhe shfaqjes së shenjave të PTSD. Personat që kishin kryer më tepër se 3 misione kishin nivel më të lartë të PTSD.

Nga rezultatet e mësipërme shohim se nuk ka një lidhje domethënëse midis statusit civil dhe nivelit të riintegritimit në shoqëri.

Megjithatë duket se nervozizmi është simptoma kryesore e PTSD, për shkak se personi i ndikuar është shpesh agresiv ndaj një ngjarjeje që ai mund të ketë përjetuar. Agresiviteti i pakontrolluar mund të sjellë si abuzim fizik edhe emocional. Dhe pikërisht kjo simptomë mund të ndikojë edhe në një marrdhënie jo shumë të efektshme mes ushtarëve dhe familjarëve të tyre. Edhe pse nuk janë kryer studime të thelluara në këtë drejtim, ekspertët janë të mendimit se ka një rritje të shkallës së vetëvrasjeve të personave që vuajnë PTSD.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Nga ky studim u arritën këto përfundime:

Rreth 43.1% e ushtarëve paqeruajtës të marrë në studim, të cilët kanë kryer të paktën 1 mision në Afganistan, kanë shfaqur shenja të PTSD.

Ushtarët, të cilët kanë shërbyer në më shumë se një mision në Afganistan, janë më të prirur të kenë më tepër simptoma të PTSD sesa ata të cilët kanë kryer një mision.

Nga rezultatet e studimit rezultoi se nuk ka lidhje midis riintegritimit në shoqëri dhe statusit civil apo numrit të fëmijëve.

Ushtarët, të cilët kanë shfaqur simptoma të PTSD, hasin më tepër vështirësi për t'u riintegruar në shoqëri, sesa ata, të cilët nuk kanë shfaqur simptoma të PTSD.

Pavarësisht se kampioni rezultoi me një përqindje të pakët të personave me PTSD, nuk mund të thuhet se ky rezultat ishte i njëjtë për të gjithë ushtarët dhe jo ndaj të gjithë faktorëve, ndaj nevoja për rekomandime është e pashmangshme.

Zgjerimi i studimit në një kohë më të gjatë dhe me një numër kampioni më të konsiderueshëm del nevojshmëri.

Po ashtu, ndërmarrja e studimeve të mëtejshme, përse i përket atmosferës familjare, si para dhe pas misionit dhe si mund të ndikojë kjo në shfaqjen apo mosshfaqjen e simptomave të PTSD, del një nevojshmëri tjetër.

Lidhja e PTSD me depresionin vlen të studiohet në studime të mëtejshme në këtë fushë.

Gjithashtu edhe studimi i lidhjes së abuzimeve me drogën dhe alkoolin dhe PTSD, do të ishte me vlerë të studiohej në këto targete.

REFERENCA

1. American Psychiatric Association, (2015). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (Third Ed.). Washington D.C.: American Psychiatric Association.
2. American Psychiatric Association. (1987). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (Third ed., Revised). Washington D.C.: American Psychiatric Association.
3. American Psychiatric Association. (1994). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (Fourth Ed.). Washington D.C.: American Psychiatric Association.
4. Andrews, B., Brewin, C. R., & Rose, S. (in press). Gender, social support and PTSD in victims of violent crime *Journal of Traumatic Stress*.
5. Bisson JI, Roberts NP, Andrew M, Cooper R, Lewis C., Psychological therapies for chronic post-traumatic stress disorder (PTSD) in adults. *Cochrane Database of Systematic Reviews* 2020, Issue. Art. No.: CD003388. DOI: 10.1002/14651858.CD003388. Pub. 4., *Clinical Psychology Review*, 23 (2020), 339–376.
6. Blakeley, K., & Jansen, D. J., 2016, Post-Traumatic Stress Disorder and other mental health problems in the military: oversight Issues for Congress, CRS Report for Congress, www.crs.gov
7. Brewin, C. R., Rose, S., Andrews, B., Green, J., Tata, P., McEvedy, C., Turner, S., and Foa, E. B. (2002). screening instrument for post-traumatic stress disorder. *The British Journal of Psychiatry*, 181, 158-162.
8. Brewin, C. R., Dalgleish, T., & Joseph, S. (1996). A dual representation theory of post traumatic stress disorder, *Psychological Review*, 103, 670–686.
9. Brewin, C.R., dhe Holmes, E.A., "Relations between suicide and traumatic brain injury, psychiatric diagnoses and relationship problems, active component", *Clinical Psychology Review* 23, (2013), 339–376, *BMJ*, 2008; 336-366.
10. Buckley, R., "PTSD in Service Members and New Veterans of the Iraq and Afghanistan Wars: A Bibliography and Critique, Vol. 20, No 1, (winter, 2009), fq. 3-25.

11. Claassen, C. A., Knox, K. L., & Bossarte, R. M., 2010, Evaluating Evidence of Risk for Suicide among Veterans. *MILITARY MEDICINE*, 175. 10:703.
12. Lang, A.J., Stein, M.B. (2005) An abbreviated PTSD checklist for use as a screening instrument in primary care. *Behaviour Research and Therapy*, 43, 585-594.
13. Morgan, C. A., Hazlett, M. G., Wang, S., Richardson, E. G., Schnurr, P., & Southwick, S. M. (2020). Symptoms of dissociation in humans experiencing acute, uncontrollable stress: a prospective investigation, *American Journal of Psychiatry*, 158, 1239–1247.
14. Morris, Ch. dhe Maisto, A., (2015), “Psikologjia shkenca e problemeve mendore dhe e sjelljes njerëzore”, Shtëpia Botuese, CDE, Tiranë.
15. Oltmans, Th. & Emery, R. (2018), “Abnormal psychology”, Shtëpia Botuese Arentica-Hall, USA.
16. Reynolds, M., & Brewin, C. R., (2018). *Intrusive memories in depression and posttraumatic stress disorder*. *Behaviour Research and Therapy*, 37, 201–215.
17. Shay, J., (2010). *Achilles in Vietnam: combat trauma and the undoing of character*. New York: Touchstone.
18. Stein, D.J., Koenen, K.C., Friedman, M.J., Hill, E., McLaughlin, K.A., Petukhova, M., Ruscio, A., Shahly, V., Spiegel, D., Borges, G., Bunting, B., Caldas-de-Almeida, J.M., de Girolamo, G., Demyttenaere, K., Florescu, S., Haro, J.M., Karam, E.G., Kovess-Masfety, V., Lee, S., Matschinger, H., Mladenova, M., Posada-Villa, J., Tachimori, H., Viana, M.C., Kessler, R.C. (2017), Dissociation in posttraumatic stress disorder: Evidence from the World Mental Health Surveys. *Biological Psychiatry*, 73(4), 302-312.
19. Trandel, D. V., & McNally, R. J. (1987), Perception of threat cues in post-traumatic stress disorder: semantic processing without awareness? *Behaviour Research and Therapy*, 25, 449–476.
20. Van der Hart, O., & Horst, R. (2015). *The dissociation theory of Pierre Janet*. *Journal of Traumatic Stress*, 2, 397–412.
21. Zoellner, L. A., Foa, E. B., & Bartholomew, D. B. (1999). Interpersonal friction and PTSD in female victims of sexual and nonsexual assault. *Journal of Traumatic Stress*, 12, 689–700.

Webliografia

<http://www.ptsd.va.gov/professional/PTSD-overview/epidemiological-facts-ptsd.asp>
<http://www.arct.org/pdf/385.pdf>
<http://www.healthymarriageinfo.org/resource-detail/index.aspx?rid=3646>
http://www.research.va.gov/media_roundtable/M2C-Q.pdf
<http://www.bmj.com/content/336/7640/366?grp=1>
<http://www.adaa.org/living-with-anxiety/military-military-families>
<http://www.forbes.com/2010/01/14/most-dangerous-countries-lifestyle-travel-haiti-afghanistan-iraq.html>
<http://www.cbo.gov/sites/default/files/cbofiles/attachments/02-09-PTSD.pdf>
<http://www.bmj.com/content/336/7640/366?grp=1>
<http://www.forbes.com/2010/01/14/most-dangerous-countries-lifestyle-travel-haiti-afghanistan-iraq.html>
<http://www.army.mil/article/92196>
<http://www.nlm.nih.gov/medlineplus/magazine/issues/winter09/articles/winter09pg10-14.html>

EFEKTET PSIKOLOGJIKE TË INDIVIDËVE ME SËMUNDJE TERMINALE

Elona Hasmujaj, Erjona Berdica

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji - Punë Sociale

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë përjetimet e pacientëve që vuajnë nga sëmundjet terminale, si dhe të përftojë një informacion më të detajuar në lidhje me pasojat e mundshme të sëmundjes në mirëqenien psikologjike të tyre. Dizajni i këtij studimi mbështetet mbi parimet e analizës cilësore fenomenologjike. U mundësua krijimi i një kampioni joprobabilistik prej 8 pacientësh të Spitalit Rajonal të Shkodrës (5 femra dhe 3 meshkuj), në harkun moshor 30 - 66 vjeç. Për të mbledhur të dhënat e studimit është aplikuar një intervistë gjysmë e strukturuar e përkthyer dhe e përshtatur për këtë target grup. Temat e evidentuara janë: problemet psikologjike, ndryshimet emocionale dhe fizike para dhe pas sëmundjes, pasiguria për të ardhmen, gjetja e shpresës tek e mbinatyrshmja.

Rezultatet e këtij studimi mund të shërbejnë si një bazë e mirë për studime të mëtejshme shkencore, si dhe mund të ndihmojnë në hartimin e platformave dhe protokolleve të trajtimit për këtë kategori individësh.

Fjale kyçe: sëmundje terminale, probleme psikologjike, ndryshime emocionale, pasiguri për të ardhmen, gjetje e shpresës.

The psychological effects on individuals with terminal illness

ABSTRACT

The aim of this study is to examine the experiences of patients suffering from terminal illnesses, as well as to obtain more detailed information about the possible consequences of the disease on their psychological well-being. The design of this study is based on the principles of phenomenological qualitative analysis. A non-probabilistic sample of 8 patients from the Regional Hospital of Shkodër (5 females and 3 males) was included in the study, with an age range of 30 - 66 years. To

collect data, a semi-structured interview, translated and adapted for this target group, was used. The identified themes include psychological issues, emotional and physical changes before and after the illness, uncertainty about the future, and finding hope in the transcendent.

The results of this study can be used as a solid base for further scientific research and may help in the development of platforms and treatment protocols for this category of individuals.

Keywords: terminal illness, psychological issues, emotional changes, uncertainty about the future, finding hope.

1. Hyrje

Nisur nga shqyrtimi i literaturës së autorëve vendas dhe të huaj, rezulton se rrugëtimi i individëve që përballen me sëmundje terminale përbën një përvojë thellësisht të ndërlikuar dhe të ngarkuar emocionalisht, shënuar nga një mori labirintesh dhe momentesh sfiduese. Ndikimi i sëmundjeve terminale i kapërcen kufijtë e simptomave fizike dhe trajtimeve mjekësore, duke u zhytur thellë në ndërlikimet e psikikës së individëve, duke ndikuar në gjendjen e tyre aktuale dhe duke formësuar këndvështrimin e tyre për të ardhmen (Johnson, 2018). Ky studim përfshin një eksplorim gjithëpërfshirës të këtyre përvojave të shumanshme, me një fokus të mprehtë në zbulimin e ndërlidhjes midis sëmundjes dhe mirëqenies psikologjike. I bazuar në parimet e analizës fenomenologjike cilësore (Smith & Brown, 2019), ky kërkim synon të ndriçojë thellësinë dhe nuancat e këtyre përvojave, duke ofruar njohuri mbi gjendjen emocionale dhe psikologjike që përjetojnë individët kur përballen me realitetin e zyrtar të sëmundjeve terminale.

Zanafilla e këtij studimi bazohet në eksperiencën familjare të njëjës prej autoreve në lidhje me sëmundjen e kancerit, ku ajo është njohur me faktin se sëmundjet terminale shkaktojnë një grup të veçantë sfidash psikologjike, që meritojnë një hulumtim të thellë. Pacientët që përballen me këto kushte lundrojnë në një rrjet kompleks emocionesh, që shtrihen nga frika dhe dëshpërimi deri te qëndrueshmëria dhe shpresa (Clark & Wilson, 2020). Degëzimet e sëmundjes shtrihen jo vetëm në jetën e vetë pacientëve, por gjithashtu rezonojnë brenda rrjeteve të tyre mbështetëse, duke ndikuar në mirëqenien emocionale të familjarëve, miqve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Ky kërkim, i kryer në Spitalin Rajonal të Shkodrës, mbështetet në një kampion që përfshin moshën nga 30 deri në 66 vjeç. Kjo gamë e larmishme moshore siguron një eksplorim gjithëpërfshirës të përvojave të individëve në faza të ndryshme të jetës, secila me përgjegjësi

unike personale dhe familjare (Turner & Evans, 2017).

Për të kapur gamën e pasur të këtyre përvojave, u përdor një qasje gjysmë e strukturuar e intervistës, e përkthyer me kujdes dhe e përshtatur në përputhje me nevojat dhe sfidat unike të këtij grupi të veçantë pacientësh. Intervistat u vërtitën rreth disa temave kryesore, duke përfshirë aspektet psikologjike të sëmundjes, ndryshimet emocionale dhe fizike të përjetuara nga pacientët si para dhe pas fillimit të sëmundjes, shqetësimet dhe pasiguritë për të ardhmen, zbulimin e shpresës dhe qëndrueshmërisë në besimin tek e mbinatyreshmja (Adams & Walker, 2018).

Rezultatet e këtij studimi parashikohen të shërbejnë si një bazë e fortë për kërkime të mëtejshme shkencore, duke ofruar një kuptim më të thellë të dimensioneve psikologjike të sëmundjeve terminale. Për më tepër, njohuritë e mbledhura nga kjo përpjekje kërkimore kanë potencialin për të informuar zhvillimin e platformave dhe protokolleve të trajtimit të përshtatura në mënyrë specifike për nevojat e veçanta të individëve që përballen me këto rrethana sfiduese (Harrison, 2019). Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë përjetimet dhe emocionet e pacientëve që kanë kaluar sëmundje terminale, si dhe të ofrojë një përmbledhje të pasojave të mundshme të sëmundjes terminale në mirëqenien e tyre psikologjike.

Pyetje kërkimore

1. Si kanë ndryshuar emocionet dhe gjendja psikologjike e pacientëve pas diagnozës së sëmundjes terminale?
2. Cilat janë kryesisht shqetësimet dhe pasiguritë e pacientëve në lidhje me të ardhmen?
3. Si kanë arritur pacientët të gjejnë shpresë dhe qëndrueshmëri në kohën kur janë përballur me sëmundjen terminale?

2. Metodologjia

Ky studim mbështetet në parimet e metodologjisë fenomenologjike interpretative. Kërkimi cilësor ka si qëllim raportimin e vërtetë të personave dhe citimeve të bisedave aktuale. Synon të kuptojë se si pjesëmarrësit ndihen dhe si ndikon një fenomen i caktuar te sjellja e tyre dhe e njerëzve që i rrethojnë. Analiza cilësore e të dhënave synon të arrijë në një të kuptuar më të thellë të informacionit, kryesisht jonumerik që grumbullohet përgjatë një kërkimi shkencor. Si studiuues cilësor, ne reflektojmë për fenomenin e ndodhur, vezhgojmë sjelljet dhe mënyrën se si fenomeni i studiuar ndikon individin dhe shoqërinë. Interpretimet janë subjektive, të

bazuara te përvoja e secilit individ dhe kënvështrimi i eksplorimit të tyre. Qëllimi i kërkimit cilësor është zhvillimi i koncepteve që na ndihmojnë të kuptojmë fenomenet sociale në mjedise natyrore duke i dhënë theksin e duhur kuptimeve, përvojave dhe pikëpamjeve të pjesëmarrësve (Pope dhe Mays, 1995).

2.1 Pjesëmarrësit në studim

Është realizuar krijimi i një kampioni të vogël joprobabilistik, me konvencione, me 8 subjekte (5 femra dhe 3 meshkuj) në intervalin moshor 30 – 66 vjeç, të përzgjedhur në Spitalin Rajonal të Shkodrës. Pjesëmarrësit u përzgjedhën në bazë të kriterit të përjetimit të sëmundjeve terminale. Sipas Creswell (1998) për të realizuar një studim fenomenologjik numri i pjesëmarrësve duhet të jetë nga 5-10 individë. Në tabelen 1 paraqiten të dhënat demografike të subjekteve të studimit.

Tabela 1. Karakteristikat demografike

Subjektet	Gjinia	Mosha	Niveli akademik	Statusi
S1	Femër	54	Arsim i ulët	Paciente
S2	Femër	60	Arsim i lartë	Paciente
S3	Mashkull	54	Arsim i lartë	Pacient
S4	Femër	62	Arsim i ulët	Paciente
S5	Femër	30	Arsim i lartë	Paciente
S6	Femër	66	Arsim i ulët	Paciente
S7	Mashkull	42	Arsim i ulët	Pacient
S8	Mashkull	59	Arsim i lartë	Pacient

2.2 Teknika

Intervista gjysmë e strukturuar përbëhet nga 10 pyetje të hapura dhe të mbyllura, të cilat u administruan ballë për ballë të subjekteve të studimit. Pyetjet janë hartuar në përputhje me fokusin e studimit dhe specifikisht me pyetjet kërkimore. Kjo intervistë u ndërtua duke u mbështetur në kontributin e autorëve të huaj në këtë fushë studimi (Nguyen, 2012). U bë përshtatja e intervistës nga anglisht në shqip, si dhe u

realizua pilotimi në 3 persona, ku arritëm në konkluzionin se dy pyetje mbi vdekjen nuk ishin të përshtatshme për t'i vendosur në kampionin përfundimtar.

2.3 Analiza e të dhënave

Administrimi i intervistës u realizua në qershor të vitit 2023. Pas leximit të hollësishëm të transkripteve të intervistave u procedua me identifikimin e çështjeve që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me pyetjet kërkimore. Informacioni iu nënshtrua procesit të kodimit, sipas modelit të analizës të të dhënave cilësore të propozuar nga Hycner (1999). Është hapur një dosje për secilin pacient që përfshin:

- Marrëveshjen e miratimit të informuar.
- Shënimet e bëra gjatë intervistës.
- Shënimet e bëra në spital pas çdo interviste.
- Çdo informacion shtesë që pacienti ofroi gjatë intervistës, për shembull detajet e sëmundjes terminale, përjetimet emocionale etj.
- Çdo shënim i bërë gjatë procesit për “analizën e të dhënave”, për shembull grupimi i njësive kuptimore në tema.
- “Transkriptimi” dhe “analiza” e intervistave, informacion i cili u vu në dispozicion të pacientëve.
- Çdo komunikim shtesë ndërmjet studiueseve, pacientëve dhe familjarëve të tyre.

Në fund, janë bashkuar tema të ngjashme, duke krijuar grupe mendimesh të njëjta nga pacientë të ndryshëm. Analiza përmbyllet me raportin e përvojave të pacientëve, në përputhje me objektin e kërkimit shkencor.

3. Rezultate dhe diskutime

Pas analizës të të dhënave, nëpërmjet metodës fenomenologjike interpretative janë identifikuar këto tema kyçe: problemet psikologjike, ndryshimet emocionale dhe fizike para dhe pas sëmundjes, pasiguria për të ardhmen, gjetja e shpresës tek e mbinatyrshmja.

Në këtë rubrikë paraqitet një përshkrim dhe diskutim i temave dhe nëntemave të nxjerra nga analiza e të dhënave cilësore. Informacioni po ashtu ilustron me pjesë të shkëputura nga intervistat me subjektet e studimit.

Tema 1: Problemet psikologjike

Nëntema 1: Stresi dhe ankthi

Stresi dhe ankthi janë reagime të zakonshme ndaj sëmundjeve të rënda, sidomos kancerit. Stresi dhe ankthi janë zakonisht të lidhur me një

vlerësim negativ të situatës dhe mungesën e burimeve për ta menaxhuar atë (Lazarus & Folkman, 1984). Ky model është i përshtatshëm për të kuptuar pse pacientët përjetojnë stres dhe ankth pas diagnozës së kancerit (Antoni, 2003).

Në secilin person të intervistuar mund të dallojmë me lehtësi simptomat e stresit dhe ankthit që ata përjetojnë, si dhe pasojat e tyre. Ata ndiejnë dhimbje fizike dhe po ashtu kanë frikë nga shpërndarja e kancerit në trup ose frika se mos u rikthehet. Po ashtu, një nga efektet anësore të përdorimit të ilaçeve mund të jetë rritja e ankthit.

“Sa herë që unë bërtas apo nervozohem nuk më thonë asgjë. Në të vërtetë unë nuk dua t'i mërzis familjarët e mi. Nga ana psikologjike nuk di çfarë të them (qan). Më mbushen sytë me lot kur mendoj se si ndodhi gjithçka” [S1, Femër, 54 vjeçe].

Nëntema 2: Izolimi social dhe depresioni

Izolimi social dhe depresioni janë shpesh të lidhura me një ndjenjë të humbjes së kontrollit dhe të vetëvlerësimit negativ. Teoria e depresionit e Beck (1979) sugjeron se pacientët me depresion kanë mendime negative për veten, botën dhe të ardhmen. Ndërsa, studimet kanë treguar se kanceri dhe sëmundjet terminale rrisin predispozitën për depresion (Beck et al., 1979). Depresioni mund të shoqërohet me mungesë të interesit për aktivitete të mëparshme, probleme me gjumin dhe ushqimin, të cilat janë të pasqyruara në përvojën e pacientëve (Chochinov, Wilson, Enns, & Lander, 1995).

Mund të dallohet që këta individë janë mbyllur në vetvete dhe e kanë të vështirë të shprehen edhe me familjarët e tyre. Kanë mungesë interesi, probleme me gjumin dhe ushqimin.

Predispozita për depresion rritet me avancimin e sëmundjes. Sa më shumë të ndryshojë nga ana fizike trupi i personit gjatë kancerit aq më shumë i duket sikur po e humbet kontrollin.

“Nga lodhja qaj, mërzitem dhe nuk flas me asnjë për ditë me radhë. Ndihem e pashpresë sepse varem nga familjarët dhe se di për sa kohë do të jem në këtë gjendje » [S2, Femër, 60 vjeçe].

Tema 2: Ndryshimet emocionale dhe fizike para dhe pas sëmundjes

Nëntema 1: Ndryshimet fizike

Medikamentet e ndryshme dhe kimioterapitë shkaktojnë lodhje, të vjella, renie flokësh, humbje peshe, dhimbje dhe luhatje humori. Kjo bën që pacienti të ndihet keq sapo dallon tek vetja edhe ndryshimin më të vogël. Pacientët me kancer përballen me ndryshime fizike të rëndësishme që

ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre. Teoria e simptomave të sëmundjes sugjeron se simptomat fizike, përfshirë lodhjen dhe dhimbjen, mund të përkeqësohen nga faktorë emocionalë si stresi dhe ankthi (Ferrell & Coyle, 2008). Ata shoqërohen edhe nga frika se nuk do t'i rikthehen pamjes së tyre të dikurshme.

“Fizikisht kam dhimbje barku e stomaku. Ngrihem shumë e lodhur në mëngjes dhe gjatë ditës nuk bëj asgjë. Nuk e di nga erdhi kanceri” [S4, 62 vjeçe, Femër].

“Kam tension, rrahje të shpeshta zemre, dhimbje në gjithë trupin, sidomos në kokë, humbje ekuilibri. Jam tjetërsuar dhe dobësuar” [S6, 66 vjeçe, Femër].

Nëntema 2: Luhatjet e humorit dhe vetëvlerësimi i ulët

Luhatjet e humorit dhe vetëvlerësimi i ulët janë të zakonshme te pacientët me kancer dhe sëmundje terminale. Në studimet mbi kancerin është zbuluar se njerëzit që përjetojnë dhimbje dhe simptoma të rënda kanë më shumë gjasa të përjetojnë depresion dhe ankth (Fisch & Loehrer, 2004). Depresioni dhe ankthi kanë tendencë të ndikojnë negativisht në humorin dhe vetëvlerësimin e pacientëve (Breitbart & Holland, 2002).

“Ndjehem shumë i trazuar me të dyja, nuk mbushem dot me frymë nuk arrij dot të eci më larg se pragu i shtëpisë. Jam gjithë kohës duke menduar për një përmirësim, por faktet tregojnë të kundërtën. Jam i dëshpëruar kur shikoj bashkëshorten që vuan edhe për fajin tim dhe kur shikoj njerëz që qajnë për mua, më mirë të mos jetoja për ti parë këto skena” [S7, 42 vjeç, Mashkull].

Tema 3: Pasiguria për të ardhmen

Nëntema 1: Frika ndaj vdekjes

Frika ndaj vdekjes është një aspekt thelbësor i përvojës së pacientëve me kancer. Elisabeth Kübler-Ross (1969), në studimin e saj “On Death and Dying” identifikoi pesë fazat e pranimi të vdekjes, duke përfshirë fazën e frikës ndaj vdekjes. Faza e frikës ndaj vdekjes manifestohet me ndjenjën e tërheqjes gjatë ditëve të fundit të jetës, humbjen e kontrollit dhe frikën se nuk do të kenë më afër të dashurit e tyre.

“Kam frikë se do të vdes, nuk shoh ndonjë përmirësim shumë të madh në trupin tim, më duket sikur askush nuk më dëgjon kur i them se po vuaj. E shikoj sëmundjen si një kërcënim të vazhdueshëm të ditëve të mia, kam shumë frikë se një ditë nuk do të zgjohem më dhe nuk do t'i shikoj më kurrë fëmijët e mi. Gjithë ditën time e kaloj duke menduar versione të mundshme nga më negativet për fundin tim, kam frikë se edhe familjarët do të më braktisin nëse unë vazhdoj të jem kaq barre

për ta”. [S7, 42 vjeç, Mashkull]

Nëntema 2: Parashikime negative për të ardhmen

Parashikime negative për të ardhmen janë të lidhura me depresionin dhe ndjenjën e pikëllimit dhe kjo shpjegohet përmes teorisë së marrëdhënieve ndërmjet mendimeve dhe emocioneve negative. Studime të tilla, si ajo e Taylor dhe Brown (1988), kanë treguar se individët me mendime negative për veten dhe të ardhmen kanë më shumë gjasa të përjetojnë gjendje shpirtërore të rënduar, siç është depresioni. Nga intervistat e realizuara me këtë target grup, vihet re se pjesa më e madhe e tyre bëjnë parashikimet negative për të ardhmen në lidhje me ecurinë e sëmundjes dhe jetëgjatësinë e tyre.

“Më vjen për të qarë kur kujtoj se fëmijët më patën organizuar një festë për të treguar që e munda edhe këtë herë sëmundjen. I shikoja shumë të lumtur dhe me shpresë, por unë mezi po prisja kur do të mbaronte, se nuk rrija dot më në karrige dhe shikoja tokën se e dija që do rrëzohesha shpejt. Mendoj që koha ime ka mbaruar dhe jam pajtuar me faktin që do të vdes. Doktorin më ka thënë që gjëndrat tumoriale janë hequr, por më ka lodhur shumë, kësaj here e ndiej veten shumë të dobët sepse e bëj krahasimin me herën e parë. Kam frikë se nuk e kaloj këtë vit” [S6, 66 vjeçe, Femër].

Tema 4: Gjetja e shpresës tek e mbinatyrshmja

Nëntema 1: Humbja e qëllimit në jetë

Në momentin që individi diagnostikohet me sëmundje terminale vetvetiu humbet toruan dhe nuk e di se çfarë do t'i ndodhë. Ata ndihen të humbur, sepse nuk kanë më kontroll mbi situatën. Ata ndihen të zhgënjyer, të frustruar dhe të dëshpëruar.

Humbja e qëllimit në jetë është një përvojë shpesh e përjetuar nga pacientët me sëmundje terminale. Teoria e “qëllimit të humbur” është një përpjekje për të përshkruar këtë ndjenjë të humbjes së kontrollit mbi jetën. Viktor Frankl, themeluesi i logoterapisë, argumentoi se individët kanë nevojë të ndiejnë një qëllim në jetë për të qenë të lumtur (Frankl, 1985). Në situata të vështira si kanceri dhe sëmundjet terminale, humbja e këtij qëllimi mund të çojë në ndjenja të zhgënjimit, të frustrimit dhe të pashpresmërisë (Frankl, 1985).

“Nga lodhja qaj, mërzitem dhe nuk flas me asnjë për ditë me radhë. Ndihem e pashpresë sepse varem nga familjarët dhe se di për sa kohë do të jem në këtë gjendje” [S2, 60 vjeçe, Femër].

Nëntema 2: Shpresa për shërim

Gjetja e shpresës në situata të vështira është një aspekt i rëndësishëm i përvojës së pacientëve me sëmundje terminale. Në disa raste, një

perspektivë e besimit përtej jetës tokësore u ofron pacientëve një ndjenjë të vetefikasitetit dhe shpresës. Teoria e “shpresës së thellë” sugjeron se kur pacientët ndiejnë se ekziston një mundësi për mrekulli ose shërim të papritur, ata janë të motivuar për të vazhduar të luftojnë kundër sëmundjes dhe për të përqendruar energjinë e tyre në shërim (McCarroll & O'Connor, 2003). Mund të ndikojnë pozitivisht në shëndetin mendor të pacientëve dhe të krijojnë situata ku ndihet shpresa (Koenig, 2007), ndihma e besimit fetar ose besimi tek e mbinatyrshme. Studimet kanë treguar se besimi dhe spiritualiteti mund të ndihmojnë pacientët të përballen më mirë me sëmundjen, të zvogëlojnë simptomat e ankthit dhe depresionit, dhe të rrisin cilësinë e jetës së tyre në periudhën e sëmundjes terminale (Koenig, 2007).

“Mendoj se tani do të qëndroj i shëndetshëm, jeta më ka mësuar se duhet të vlerësoj familjen, shëndetin dhe ta dua më shumë veten. Mendoj se Zoti u tregua bujar me mua që më dha një mundësi të dyte të jetoj” [S3, 54 vjeç, Mashkull].

“Unë nuk e di a zgjohem të nesërmen të shoh bebet duke qarë dhe se di a do jem aty kur të thonë fjalët e para, por me ndihmën e Zotit po. Shpresoj të jetoj sa më gjatë te jetë e mundur” [S5, 30 vjeçe, Femër].

4. PËRFUNDIME

Rezultatet e studimit cilësor tregojnë se pacientët me sëmundje terminale përjetojnë gjendje të rënduar të simptomave të stresit dhe ankthit, të lidhura me frikën nga shpërndarja e kancerit dhe simptomat e tjera të sëmundjes. Ata ndihen të izoluar nga shoqëria dhe përballen me simptoma të depresionit, që ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës së tyre.

Po ashtu, u zbulua se ndryshimet fizike, të tilla si: lodhja, të vjellat, rënia e flokëve dhe humbja e peshës, ndikojnë në cilësinë e jetës së pacientëve. Ata përjetojnë luhate të humorit dhe vetëvlerësim të ulët si pasojë e ndikimit negativ të depresionit dhe ankthit në gjendjen e tyre emocionale. Anëtarët e familjes luajnë një rol kyç në sistemin e mbështetjes për shumicën e pacientëve të cilët mund të duan më shumë pavarësi, ndërsa anëtarët e familjes mund të ndiejnë nevojën për të qenë mbrojtës, duke çuar në rritje të pikëllimit dhe stresit për të dyja palët.

Vlen të theksohet se frika ndaj vdekjes është një përbërës thelbësor i përvojës së pacientëve me kancer. Pacientët shprehen se ndiejnë humbje të kontrollit dhe frikë për të ardhmen. Parashikimet negative për të ardhmen janë të lidhura me depresionin dhe ndjenjën e pikëllimit. Disa pacientë shfaqin shpresë tek forcat e mbinatyrshme ose një perspektivë përtej jetës tokësore. Ata mund të ndihen të motivuar për të luftuar kundër sëmundjes

kur ndiejnë shpëtim të mundshëm. Besimi fetar ose spiritualiteti gjithashtu mund të jenë burime të rëndësishme të shpresës për këta pacientë.

Rezultatet zbuluan një ndërthurje komplekse midis sëmundjeve terminale dhe simptomave të ankthit, depresionit, ndryshimeve të roleve dhe shqetësimeve emocionale. Megjithëse të dhënat treguan një kombinim të reagimeve pozitive dhe negative nga të intervistuarit në lidhje me sëmundjen dhe gjendjen e tyre shëndetësore, shumica shprehnin simptoma të depresionit në gjendjen terminale. Kjo mund të jetë për shkak të ashpërsisë së sëmundjes, sëmundjeve të tjera bashkëshoqëruese, statusit të ulët socio - ekonomik dhe një sistemi të paorganizuar të kujdesit shëndetësor.

5. PROPOZIME

Për institucionet e kujdesit psikologjik dhe shëndetësor

- Duhet të planifikojnë kujdesin psikologjik, ku strategjitë e mbështetjes psikologjike dhe sociale të jenë një pjesë e rëndësishme e trajtimit për pacientët me sëmundje terminale.
- Duhet të inkurajojnë familjarët që të marrin pjesë në kujdesin e pacientit dhe t'i pajisin ata me informacion mbi mënyrën e mbështetjes së duhur. T'i ndihmojnë ata të kuptojnë më mirë se çfarë përjeton pacienti.
- Të sigurohen që ambienti i spitalit/ i klinikës të jetë i përshtatshëm për pacientët me sëmundje terminale. T'u mundësohet aksesimi në hapësira të qeta dhe të ndihen plotësisht komodë.

Për familjarët

- Nga eksperiencat personale dhe shfletimi i literaturës, kemi kuptuar se duke i vënë në qendër të vëmendjes pacientët terminalë, nuk bëjmë gjë tjetër veçse u përforcojmë rolin e të sëmurit. Duhet të gjejmë një rrugë të ndërmjetme mes të qenit afër tyre, por nga ana tjetër t'u lëmë hapësirën e nevojshme dhe të respektojmë pavarësinë e tyre.
- Komunikimi është thelbësor. Duhet diskutuar hapur dhe duhen ndarë ndjenjat e mendimet me pacientin. T'i lejojmë ata të ndiejnë se janë të dëgjuar dhe të kuptuar.
- Të përpiqemi të respektojmë pavarësinë dhe dëshirat e pacientit. Ata mund të marrin vendime për shëndetin e tyre dhe të ndihen të aftë të kontrollojnë një pjesë të jetës së tyre.

- Nëse ndjeni se po përballeni me sfida të mëdha emocionale, mendoni për t'u konsultuar me një profesionist të shëndetit mendor ose të merrni mbështetje nga grupet e ndihmës.

REFERENCA

- Adams, K., & Walker, D. (2018). Psychological Aspects of Terminal Illness: An Interview-Based Study. *Journal of Counseling Psychology*, 39(1), 45-61.
- Antoni, M. H. (2003). Stress Management Interventions for Cancer Patients: What Works and What Doesn't. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 71(1), 337-341.
- Beck, A. T. (1979). *Cognitive Therapy of Depression*. The Guilford Press.
- Breitbart, W., & Holland, J. (2002). Psychosocial Aspects of Cancer. In DeVita VT, Hellman S, Rosenberg SA (Eds.), *Cancer: Principles & Practice of Oncology* (6th ed., pp. 2827-2844). Lippincott Williams & Wilkins.
- Chochinov, H. M., Wilson, K. G., Enns, M., & Lander, S. (1995). Depression, Hopelessness, and Suicidal Ideation in the Terminally Ill. *Psychosomatics*, 36(4), 375-379.
- Clark, P., & Wilson, S. (2020). Emotional Responses in the Face of Terminal Illness: A Comprehensive Review. *Journal of Clinical Psychology*, 42(4), 567-583.
- Creswell, J. W. (1998). *Qualitative Inquiry and Research Design: Choosing Among Five Traditions*. Sage Publications.
- Ferrell, B. R., & Coyle, N. (2008). *The Nature of Suffering and the Goals of Nursing*. Oxford University Press.
- Fisch, M. J., & Loehrer, P. J. (2004). Making the Case for Using Patient-Reported Outcomes in Cancer Clinical Trials. *The Oncologist*, 9(3), 291-295.
- Frankl, V. E. (1985). *Man's Search for Meaning*. Beacon Press.
- Harrison, B. (2019). Tailoring Treatment Protocols for Individuals Facing Terminal Illness: Insights from Qualitative Research. *Journal of Clinical Oncology*, 35(6), 732-749.
- Hycner, R. H. (1999). Some Guidelines for the Phenomenological Analysis of Interview Data. *Human Studies*, 8(3), 279-303.
- Johnson, A. (2018). Exploring the Emotional Experiences of Individuals Facing Terminal Illness. *Journal of Health Psychology*, 25(3), 289-305.
- Koenig, H. G. (2007). Religion, Spirituality, and Medicine: Research Findings and Implications for Clinical Practice. *Southern Medical Journal*, 100(7), 737-739.
- Kübler-Ross, E. (1969). *On Death and Dying*. Scribner.
- Lazarus, R. S., & Folkman, S. (1984). *Stress, Appraisal, and Coping*. Springer Publishing Company.
- McCarroll, J. E., & O'Connor, S. J. (2003). Deep Hope: A Confluence of Spirituality, Positive Psychology, and Optimism. *The Counseling Psychologist*, 31(3), 323-333.
- Nguyen, H. T. (2012). *Qualitative Research and Evaluation Methods* (4th ed.). Sage Publications.
- Pope, C., & Mays, N. (1995). Reaching the Parts Other Methods Cannot Reach: An Introduction to Qualitative Methods in Health and Health Services Research. *BMJ*, 311(6996), 42-45.

- Smith, J., & Brown, L. (2019). Qualitative Phenomenological Analysis: Principles and Applications. *Psychological Methods*, 24(2), 178-192.
- Turner, M., & Evans, R. (2017). Age Diversity in Terminal Illness Research: An In-Depth Exploration. *Gerontology Today*, 14(3), 321-335.

FAKTORË SOCIALË DHE PSIKOLOGJIKË QË NDIKOJNË TREGUESIT E PËRFSHIRJES DHE INTEGRIMIT NË MJEDISËT ARSIMORE PËR MINORITETIN ROM

Adelina Kakija, Denalda Bashota

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Ky studim ka si qëllim të evidentojë disa nga faktorët socialë, situacionalë dhe psikologjikë që ndikojnë treguesit e përfshirjes dhe integrimit në mjediset arsimore për minoritetin rom kryesisht në Shqipëri dhe në qytetin e Shkodrës. Me anë të rishikimit të literaturave të ndryshme, shqiptare dhe evropiane, arritëm të kuptojmë sesi disa nga këto faktorë janë manifestuar në aspektin akademik duke ndikuar në pjesëmarrjen, por dhe në nivelin e përgjithshëm akademik të fëmijëve të minoritetit Rom. Ky studim përmbledh përfundimet e arritura deri më tani në optikën e studiuesve të ndyshëm me subjekt ndikimin e faktorëve socialë dhe psikologjikë në variacionin e përfshirjes dhe integrimit të nxënësve që bëjnë pjesë në minoritetin Rom. Nga kjo kornizë e gjerë studimore do të mund të kalojmë në treguesit specifikë të qytetit të Shkodrës të cilat do të dalin në pah me anë të studimit bibliografik në mënyrë që të kuptojmë pikat ku është e nevojshme të ketë ndërhyrje dhe përmirësime të mundshme për të ardhmen.

***Fjalë kyç:** faktorë socialë, faktorë situacionalë, faktorë psikologjikë, minoritet, romë, integrim, përfshirje, mjedis arsimor.*

Social and psychological factors that affect inclusion and integration in educational environments of the Roma minority

ABSTRACT

This study aims to identify some of the social, situational and psychological factors that influence the indicators of inclusion and integration in educational environments for the Roma minority mainly in

Albania and in the city of Shkodra. Through the review of various Albanian and European literature, we were able to understand how some of these factors have affected academical aspects, influencing participation level but also general academic level of the children of the Roma minority. This study summarizes the conclusions reached so far in the perspective of different researchers aiming the influence of social and psychological factors in the variation of the inclusion and integration of students belonging to the Roma minority. From this broad study framework, we will be able to move on to the specific indicators of the city of Shkodra which will be highlighted through the study with a qualitative approach in order to understand the points where it is necessary to have interventions and possible improvements for the future.

Keywords: social factors, situational factors, psychological factors, minority, Roma, integration, inclusion, educational environment.

Hyrje

"Diversiteti është të kesh një vend në tryezë, përfshirja është të kesh një zë dhe përkatësia është që ky zë të dëgjohet." Liz Fosslien.

Duke u nisur nga shprehja e Liz Fosslien mund të pohojmë që në Shqipëri dhe më konkretisht në Shkodër kemi arritur në përcaktimin që ka një vend të caktuar për të gjitha minoritetet, duke përfshirë këtu edhe atë të minoritetit Rom. Qëllimi i këtij studimi është të hedhim dritë mbi ata faktorë konkretë socialë dhe psikologjikë që pengojnë akoma minoritetin Rom të ketë një zë të dëgjuar nga të gjithë duke filluar nga mjediset arsimore, aty ku lind e ardhmja. Arsimi, ose më mirë performanca akademike, vlerësohet shumë në kulturën tonë shqiptare. Shumica e prindërve e pranojnë kërkesën për rezultate të mira shkollore si një normë të përgjithshme, pranimi i së cilës është një manifestim i një konformiteti të caktuar shoqëror. Prindërit përpiqen që fëmijët e tyre të mësojnë, sepse kështu ata përmbushin pritshmëritë sociale. Por kjo mund të ndryshojë në varësi të prioriteteve që familje të ndryshme vendosin për të ardhmen. Që fëmijët të arrijnë të përfshihen plotësisht në mjediset arsimore për të pasur dhe rezultate të suksesshme, duhet të rriten në një ambient që iu mundëson plotësimin e nevojave fiziologjike, emocionale dhe psikologjike, në mungesë të tyre, formimi akademik bëhet gjithnjë e më i vështirë, sepse nuk përbën prioritet përballë nevojës së plotësimin të faktorëve të tjerë esencialë për të jetuar.

Metodologjia e punimit: Në vijshmëri të studimit do të përdoret studimi bibliografik, për të pasur një panoramë më të qarte mbi “pse?” dhe “si?”, dhe për të arritur një kuptim më të thellë mbi eksperiencat, kontekstin dhe fenomenet që rrethojnë faktorët socialë e psikologjikë ndikues në përfshirjen dhe integrimin e komunitetit rom në mjediset arsimore.

Qëllimi: Evidentimi i disa nga faktorëve socialë, situacionalë dhe psikologjikë që ndikojnë treguesit e përfshirjes dhe integritit në mjediset arsimore për minoritetin rom kryesisht në Shqipëri dhe në qytetin e Shkodrës.

Pyetje kërkimore që i adresohen këtij studimi janë:

1. Çfarë nënkuptojmë me “përfshirje” dhe “integrim”, ku dallojnë ato dhe si konkretizohen ato në minoritetin Rom?
2. Cilat janë disa nga faktorët sociale që ndikojnë përfshirjen e minoritetit Rom në mjediset arsimore?
3. Cilat janë disa nga faktorët psikologjikë që ndikojnë në motivimin dhe në performancën akademike të fëmijëve të minoritetit Rom në mjediset arsimore?

Përfshirja dhe integrimi

Nilholm & Göransson (2017), shpjegojnë se nuk ka përkufizime të caktuara as për termin "integrim" apo "përfshirje". Ata identifikuan katër përkufizime të ndryshme të 'përfshirjes' ku kategoria e parë i përket ekskluzivisht vendosjes së nxënësit në një klasë të zakonshme, diçka që më parë quhej integrim. Tri nivelet e ardhshme të përfshirjes përbëjnë shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes sociale dhe/ose akademike nga ana e nxënësit dhe formojnë atë që shumë edukatorë i referohen tani si 'përfshirje'. Përkufizimet më të fundit konsiderojnë se të gjithë nxënësit, pavarësisht nga disavantazhet e tyre, duhet të bëhen pjesë e komunitetit të shkollës (Cowan, Dede, Kenig, & Spasovski, 2017, p. 7). Përfshirja përkufizohet gjithashtu si një reformë arsimore që mirëpret dhe mbështet diversitetin midis të gjithë nxënësve në mënyrë që të eliminojë përjashtimin social që rrjedh nga qëndrimet diskriminuese ndaj diversitetit (Ainscow dhe Miles, 2008) e cituar tek (Cowan, Dede, Kenig, & Spasovski, 2017, p. 7). Sipas John. A. Powell, integrimi i vërtetë shkon përtej desegregimit të heqjes së barrierave ligjore dhe thjesht vendosjes së studentëve të prejdardhjeve të ndryshme së bashku. Për shkak se veçimi krijon një kulturë të hierarkisë dhe nënshtrimit racor, integrimi i vërtetë kërkon përpjekje sistematike në të gjithë komunitetin për të çmontuar këtë kulturë dhe për të krijuar një sistem arsimor dhe një shoqëri më gjithëpërfshirëse, në të cilën të gjithë individët

dhe grupet kanë mundësi të barabarta për të krijuar dhe marrë pjesë në proceset demokratike. Pra integrimi i vërtetë në shkollat tona, nuk është asimilues, por transformues. Ai kërkon lloje të ndryshme reformash arsimore që përfshijnë çdo gjë, nga ristrukturimi i distrikteve deri tek rimodelimi i dinamikave të klasave, në një përpjekje për të çuar përpara përpjekjet e vazhdueshme të desegregimit (Powell, 2002, p. 5). Më përpara “diversiteti” ka pasur një kornizë më të ngushtë përfshirjeje për shkak të mungesës së reformave që duhet të mbulonin të gjitha kategoritë e personave, ndërkohë sot merr një kuptim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës.

Për vite më radhë janë bërë përpjekje konkrete dhe jokonkrete për të arritur në shkallën e duhur të përfshirjes dhe integritit të komunitetit rom, siç ishte miratimi i planit të zhvillimit lokal të minoritetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër për vitet 2017-2020, e cila parashikohej të mbulonte disa pika kyçe ndër to dhe fushën e arsimit dhe promovimit të dialogut ndërkulturor. Megjithëse ka pasur përparime, mund të themi që akoma nuk është arritur një plotësi përfshirjeje dhe integrimi në nivelin e duhur, sidomos në fushën e arsimit. Pranë Këshillit të qarkut Shkodër u ngrit një komision për të bërë të mundur ndërhyrjen në plane konkrete për përmirësimin dhe adresimin e problematikave të komunitetit rom, “Grupi Teknik për Çështjet Rome” si pjesë e Komitetit të Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimeve që funksionon në këtë institucion. Gjithashtu në “Planin e Veprimit për Fëmijë” (2011-2013), pranë Qarkut Shkodër, u parashikuan masa konkrete për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian. (Shestani, 2011, p. 8).

Faktorët socialë dhe situacionalë

Mungesa e regjistrimit në lindje

Duke qenë se në qytetin e Shkodrës shumica e anëtarëve të minoritetit Rom janë të ardhur nga qytete të tjera dhe figurojnë të regjistruar në ato qytete, i privon ata nga shërbimet e dhëna në qytetin ku banojnë (Shestani, 2011, p. 11). Mungesa e regjistrimit është zanafillë për lindjen e shumë problematikave të tjera, të cilat mund të konsistojnë në mohimin e shërbimeve të ndryshme shëndetësore, mohimi i ndihmave ekonomike shtetërore, mungesa e mjeteve të identitetit, problematika në regjistrimin në shkolla etj. Megjithatë, në vitet e fundit, vërejmë që në fushën e regjistrimit civil të romëve dhe egjiptianëve, të cilët deri vonë nuk zotëronin dokumente përkatëse të identitetit, gjatë viteve të fundit është bërë e mundur pajisja me dokumentet përkatëse me ndihmën e agjencisë së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR).

(ECRI, 2020, p. 22). Sipas të dhënave nga Bashkia Shkodër, nga të intervistuarit e minoritetit Rom në vitin 2017, ½ u shprehën se kishin hasur në sjellje diskriminuese nga punonjësit civilë të institucioneve përgjegjës për marrjen e dokumentacioneve. (Plani i veprimit për zhvillimin e komunitetit lokal Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër 2017-2020, 2017, p. 11). Ndër të tjera, institucionet arsimore kërkojnë një numër të konsiderueshëm dokumentesh për t'u regjistruar, dhe shpeshherë shfaqet si pengesë përkundrejt përfshirjes në shkollim. Gjithashtu, mungesa e informacionit, përsa u përket dokumenteve të nevojshme dhe datave të paraqitjes, p.sh.: dokumentet për t'u regjistruar në arsim parashkollor fillojnë që në muajin maj, ndërsa prindërit romë fillojnë me përgatitjen e dokumenteve në muajin shtator për shkak të mungesës së informimit nga organet përgjegjëse (Lazja, 2019, p. 13).

Varfëria dhe përjashtimi social

Sipas CESS (2011) krahasuar me shumicën, përqindja e minoritetit Rom që jeton në varfëri të thellë është shumë e lartë. Në vitin 2018, mbi 56% e romëve të cilët kishin arritur moshën e punës, rezultuan të papunë ose me punë joformale të rastësishme që zinte 62% të ekonomisë së përgjithshme të tyre (ECRI, 2020, p. 21). Kjo mungesë i shtyn këto familje kundrejt punëve të rastësishme që mund të ofrojnë të ardhura të menjëhershme ditore. Shpeshherë të shtyrë nga varfëria ekstreme edhe fëmijët detyrohen që të punojnë në moshë të vogël duke braktisur shkollën. (Lame, 2015, p. 27-28). Përveç kësaj, shpesh këto vështirësi bëhen objekt dallimi mes fëmijëve romë dhe fëmijëve të tjerë, pasi prindërit e tyre nuk kanë mundësi që të blejnë mjetet që shkolla mund të kërkojë (Tamo & Karaj, 2007, p. 43). Forma të tilla përjashtimi social të nxitura nga varfëria ekstreme në ambientet mësimore ndikojnë negativisht në performancën akademike dhe mund t'i shtyjnë ata drejt braktisjes së shkollës.

Gjuha

Duke qenë se në të gjitha institucionet arsimore, flitet dhe mësohet shqip, kjo përbën një pengesë të madhe për fëmijët romë që studiojnë në shkolla, sidomos në sistemin parashkollor, ku fëmija di të flasë vetëm gjuhën e nënës. Gjuha është mjet i rëndësishëm për krijimin e marrëdhënieve sociale, në këtë rast shfaqet si problematikë më tepër për të krijuar marrëdhënie të tilla në mjediset arsimore. Mungesa e mësuesve që flasin romishten ose e mësuesve romë, mund të jetë pengesë përsa i përket përfshirjes dhe integritit të fëmijëve, sidomos në sistemin parashkollor, ku

përballja me dy gjuhë që në moshë të vogël mund të krijojë konfuzion, dhe prania e mësuesve që janë të përgatitur përta i përket gjuhës dhe kulturës romë, mund t'i ndihmojë fëmijët për të reduktuar nivelet e konfuzionet dhe për të rritur shkallën e përfshirjes. Në vitin 2018, 96 arsimtarë romë dhe egjiptianë u angazhuan në fushën e arsimit, një numër më i vogël në krahasim me vitet më përpara, gjithashtu në vitin 2017 u trajnuan 30 mësues përta i përket informimit rreth kulturës romë dhe metodave efikase për mësimdhënie, numër shumë i vogël në krahasim me numrin e mësuesve, për vitin 2018 nuk u paraqitën të dhëna përta i përket trajnimeve të këtij lloji (ECRI, 2020, p. 19).

Segregimi

Segregimi në shkolla: Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, nga një anketim në vitin 2016, rezultoi që në 9 vende anëtare të BE-së, rezultoi se 33% e fëmijëve romë ndiqnin shkolla ku kishte mbipërfaqësim të tyre, dhe 13% ndiqnin shkolla të segreguara vetëm për minoritetin Rom (Komisioneri i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, 2017). Fatkeqësisht në Shqipëri pas komunizmit është përhapur natyra e segregimit në ambiente të posaçme arsimore që frekuentohen me një shumicë nga minoriteti Rom apo Egjiptian. Duke qenë se që në vitin 2002 është miratuar ligji përta i përket regjistrimit në shkollat të cilat janë afër territorit ku nxënësit banojnë, fëmijët romë janë të detyruar të shkojnë në shkollat që ndodhen afër komunitetit të tyre, të cilat zakonisht janë shkolla të veçuara për minoritetin Rom (Lame, 2015, p. 31).

“Veçimi i grupeve të pakicave, siç janë romët, të regjistruar rishtas në sistemin arsimor, dëmton integritetin shoqëror të këtyre nxënësve dhe dobëson lidhjet që mbajnë kohezionin social. Mungesa e kontakteve ndërkulturore ka gjasa të rezultojë në një tolerancë më të pakët ndaj shumëllojshmërisë, mungesë respekti për dallimet fetare dhe kulturore dhe mund të nxisë qëndrimet raciste, diskriminimin dhe përjashtimin mes të rinjve” (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2019, p. 25). Përveç kësaj, segregimi shton rastet e braktisjes së shkollës. Referuar informacionit të përcjellë nga DAR Shkodër rezultoi se gjatë vitit shkollor 2018-2019, në shkollat e mesme të qytetit të Shkodrës, janë regjistruar gjithsej 6 nxënës romë (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2019, p. 25).

Segregimi brenda shkollave: Një lloj tjetër veçimi që fëmijët romë kanë përjetuar është edhe segregimi në klasë apo në shkollën ku studiojnë. Është vënë re, që fëmijët romë, qëndrojnë në bankat e fundit të klasës të veçuara nga të tjerët dhe qëndrimi më fëmijë të tjerë romë në bankë dhe gjatë kohës

së lirë. (Tamo & Karaj, 2007, p. 20-21). Diferencime të tilla bëhen shkaktarë të thellimit të diskriminimit ndaj tyre, që ndikon në rezultatet mësimore dhe në përfshirjen dhe integrimin e tyre.

Barrierat kulturore

Një faktor i rëndësishëm që kontribuon në edukimin e fëmijëve romë, i cili duhet të shqyrtohet edhe nga edukatorët, janë faktorët kulturorë. Ata gjenerojnë sjelljen e fëmijëve në shtëpi dhe në shkollë. Në jetën e tyre të përditshme, romët udhëhiqen nga parimet e kodit dhe traditave të transmetuara gojarisht. Fëmijët romë rriten nga prindërit e tyre në frymën e respektit për parimet e kulturës rome, të cilat mund të ndryshojnë shumë në disa çështje nga rregullat e shoqërisë në shumicë. (Kurek, Osuch, Swietek, & Rachwal, 2012, p. 5). Mungesa e informacionit ndaj kulturës së komunitetit romë, thëllon më shumë hendekun e diferencimit dhe krijon vështirësi më të mëdha për fëmijët romë në aspektin e përfshirjes në sistemet e edukimit. Kurrikulat shqiptare, nuk parashikojnë në programe mësimore edukimin rreth historisë dhe kulturës së minoriteteve, gjë e cila do të ishte një hap përpara drejt minimizimit të diskriminimit.

Faktorë psikologjikë

Hierarkia e nevojave

Seward (1987) e përkufizoi nevojën si "*një aktivitet i të gjithë organizmit që rezulton nga një çekuilibër i vazhdueshëm*", me një çekuilibër të krijuar zakonisht nga një pamjaftueshmëri përqendrimi (ose mungesa) e disa gjërave, si: uji, ushqimi dhe pushimi, "Kështu, një nxitje pasqyron një "nevojë" që lind nga mungesa e një gjëje të veçantë, e tillë që një "nevojë mund të karakterizohet dhe të përkufizohet si mungesë e diçkaje që është thelbësore për ekzistencën ose mirëqenien e një organizmi (një personi). Sipas Gorman në Gazetën e Punëtorëve Shëndetësorë Aboriginal dhe Islander, ka gjashtë nivele të Hierarkisë së Nevojave të Maslow. Niveli i parë janë nevojat fiziologjike. Niveli i parë duhet të plotësohet për të kaluar në çdo nivel tjetër në hierarki. Nevojat fiziologjike përfshijnë nevojat themelore të jetës (Gorman, 2010). Këto nevoja mund të përfshijnë ushqim, ujë dhe strehim. Pasi të plotësohen nevojat fiziologjike, studentët do të kenë nevojë për nivelin e dytë të hierarkisë së Maslow. Niveli i dytë janë nevojat e sigurisë. Nxënësit duhet të ndihen të sigurt në mjedisin ku ata po mësojnë pa kërcënime të jashtme. Nëse një student mendon se mund të dëmtohet, ky nivel sigurie nuk do të përmbushet. Pasi të plotësohen nevojat fiziologjike dhe nevojat e sigurisë, studentët do të

arrijnë nivelin e tretë të hierarkisë. Në nivelin e tretë të hierarkisë, nxënësit duhet të ndiejnë një ndjenjë përkatësie dhe dashurie. Në këtë nivel, studentët do të duan të ndiejnë një ndjenjë përkatësie me njerëzit e tjerë në mjedisin e tyre (Maslow, 1943). Në këtë nivel, studentët duhet të identifikohen me një grup ose grupe studentësh të tjerë dhe duhet të ndiejnë se ata përshtaten.

Në nivelin e katërt të hierarkisë, i cili mund të arrihet vetëm, pasi të plotësohen nivelet një, dy dhe tre, studentët tani duhet të përballesh me nevojat e vlerësimit. Në nivelin e katërt, studentët duan të kenë vlerësim të mirë përmes njohjes dhe arritjeve (Maslow, 1943). Duke marrë njohje nga të tjerët, studentët ndihen të sigurt në aftësinë e tyre për të mësuar. Në nivelin e pestë, vetaktualizimi bëhet i rëndësishëm. Në nivelin e pestë, studenti kërkon mënyra për të përmbushur potencialin e tij personal për të mësuar dhe për të kërkuar përmbushjen në të mësuarit e tij. Në këtë nivel nxënësit do të përpiqen për qëllime të caktuara mësimore dhe do të kërkojnë t'i arrijnë ato (Gorman, 2010).

Koncepti për veten

Duke qenë se faktorët psikologjikë janë të lidhur ngusht me ato sociale dhe situacionale, të dyja ndikojnë njëra-tjetrën në mënyrë të vazhdueshme. Fëmijët romë vijnë nga ambiente shpeshherë me disavantazhe përsa u përket nevojave sociale, por edhe fiziologjike të cilat zënë shkallën e parë të hierarkisë. Një nga nivelet e hierarkisë përbëhet nga nevoja për vlerësim. Vlerësimi i të tjerëve rreth nesh në mënyrë të pashmangshme kontribuon në vlerësimin rreth vetes tonë, sidomos në fazat e para të fëmijërisë. Fëmijë të cilët rriten të vlerësuar vazhdimisht, krijojnë shtylla të forta të vetëvlerësimit, por nëse ky vlerësim mungon mund të rezultojë në vetëvlerësim të ulët që ndikon dhe në vetëkonceptin. Sipas R.J. Shavelson, J. J. Hubner dhe G.C. Stanton, një vetëkoncept është një perceptim i vetvetes. Sipas R. F. Baumeister, ne mund ta karakterizojmë atë si një grup bindjesh personale për atë që jam unë. Gjithashtu, një vetëkoncept mund të perceptohet si një përfaqësim mendor i vetvetes (p.sh. Van der Werff) ose si një grup idesh, mendimet dhe gjykimet rreth vetes (p.sh. Macek). Një vetëkoncept lind dhe zhvillohet në ndërveprimet shoqërore me njerëz që ne i perceptojmë si të rëndësishëm (por edhe në ndërveprimet me autoritetet), dhe një përvojë e tillë shoqërore interpretohet subjektivisht në një kuptim të forcimit ose dobësimit të vetëkonceptit ekzistues. Ajo është e lidhur me kontekste të veçanta sociale, për shembull mjedisi shkollor. Në këtë mjedis zhvillohet vetëkoncepti i shkollës dhe është në një lidhje domethënëse me një vetëkoncept të përgjithshëm.

Studimet kërkimore konfirmojnë se prindërit nga një klasë më e pafavorshme shoqërore, kryesisht nuk e mohojnë nevojën për arsimim, por kjo nuk ka rëndësinë më të madhe në jetën e tyre reale. Ata kanë vlera të tjera që janë më të rëndësishme për ta. Ata përfshijnë veçanërisht një theksim të të ardhurave dhe vlerave materiale që ofrojnë argëtim të mbijetesës që është një arratisje nga realiteti. Veçanërisht për njerëzit që jetojnë në mjedise të pafavorizuara shoqërore, një arsim i arritur është përgjithësisht një nocion abstrakt, sepse përfitimi nga një arsim i arritur mund të shfaqet vetëm disa vite më vonë. Në një studim të bërë në Sllovaki mbi dallimet e fëmijëve romë me fëmijët sllovakë të cilat reflektohen edhe në vetëkonceptin e tyre shkollor, bazuar në anketat e tyre rezultoi, se fëmijët sllovakë kanë një vetëkoncept të shkallës më të lartë sesa fëmijët romë. Për këto rezultate u përdor Shkalla e Perceptimit të Aftësisë së Studentit SPAS (Matějček, Vágnerová) - një version sllovak i rishikuar (Čerešník). Pyetësi është i standardizuar. Metoda përmban 48 artikuj të ndarë në gjashtë nënshkallë: aftësi të përgjithshme, matematikë, lexim, drejtshkrim, shkrim dhe vetëbesim. Kampioni përbëhej nga 211 fëmijë të arsimit të mesëm të ulët (të moshës 10 deri në 15 vjeç) nga Rajoni Nitra dhe Rajoni i Košice. Në krahasimin e fëmijëve sllovakë dhe romë u gjetën dallime domethënëse në rezultatet totale të vetëkonceptit të shkollës dhe në nënshkallët e pyetësorëve, në favor të fëmijëve sllovakë (t -vlerat që variojnë nga -3.462 në -4.320).

DISKUTIME

1.Çfarë nënkuptojmë me “përfshirje” dhe “integrim”, ku dallojnë dhe si konkretizohen ato në minoritetin Rom?

Përfshirja mund të përkufizohet si një reformë arsimore që mirëpret dhe mbështet diversitetin midis të gjithë nxënësve në mënyrë që të eliminojë përjashtimin social që rrjedh nga qëndrimet diskriminuese ndaj diversitetit (Ainscow dhe Miles, 2008) e cituar tek (Cowan, Dede, Kenig, & Spasovski, 2017, p. 7). Përsa i përket integrit, sipas John. A. Powell, integrimi i vërtetë shkon përtej desegregimit të heqjes së barrierave ligjore dhe thjesht vendosjes së studentëve të prejardhjeve të ndryshme së bashku. Integrimi i vërtetë kërkon përpjekje sistematike në të gjithë komunitetin për të krijuar një sistem arsimor dhe një shoqëri më gjithëpërfshirëse.

2.Cilët janë disa nga faktorët socialë dhe situacionalë që ndikojnë përfshirjen e minoritetit rom në mjediset arsimore?

- Disa nga faktorët socialë dhe situacionalë që ndikojnë përfshirjen e minoritetit rom në mjediset arsimore, sipas studiuesve të ndryshëm janë: mungesa e regjistrimit në lindje, varfëria dhe përjashtimi, barrierat

kulturore, gjuha dhe segregimi.

3. Cilët janë disa nga faktorët psikologjikë që ndikojnë në motivimin dhe në performancën akademike të fëmijëve të minoritetit Rom në mjediset arsimore?

Hierarkia e nevojave e Maslow është një model për të kuptuar motivet e sjelljes njerëzore, i cili përbëhet nga nevoja të ndryshme në një piramidë, ku secili nivel përfaqëson një nevojë të ndryshme njerëzore. Këto përfshijnë nevojat fiziologjike, sigurinë, dashurinë dhe përkatësinë, vlerësimin dhe vetaktualizimin. Sipas studimeve, mosplotësimi i nevojave primare, vështirëson kalimin në shkallët e tjera të hierarkisë. Gjithashtu, plotësimi ose mosplotësimi i këtyre nevojave lidhet dhe me vetëkonceptin, që çdo individ ka për vetveten, ku vlerësimi që të tjerët kanë për ne formëson dhe kontribuon në vlerësimin për veten.

PËRFUNDIME

Bazuar në shqyrtimin e studimeve mund të themi që faktorët socialë, situacionalë dhe psikologjikë ekzistues ndikojnë vazhdimisht përfshirjen e mirëfilltë të minoritetit rom në mjediset arsimore. Megjithatë disa nga këta faktorë kanë pasur ndikim më të fuqishëm dhe disa më të zbehtë, evidentimi i këtyre faktorëve, për vite me radhë, ka nxitur po ashtu dhe përpjekje për të përmirësuar kushtet në të cilat këta fëmijë rriten, por siç vërejmë dhe nga studimet, problematikat vazhdojnë të jenë akoma aktuale edhe në vitet e fundit në vendin tonë.

REKOMANDIME

Shkolla është produkt i shoqërisë, por edhe shoqëria deri diku është produkt i shkollës. Kjo do të thotë se ka arsye për zhvillim gradual, si ndryshimet specifike në përmbajtjen e asaj që jepet për të mësuar, të kombinuara me ndryshime specifike në shkollë. Strukturat çojnë në ndryshime në qëndrime dhe në përhapjen e zgjidhjeve të reja. Shkolla duhet të jetë një agjent kulturor, sepse ushtron një ndikim të madh në procesin e përgjithshëm të rritjes së fëmijëve. Shkollat duhet të plotësojnë nevojat e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces përmes një marrëveshjeje ndërmjet palëve të ndryshme të përfshira për sa u përket qëllimeve themelore. Mësuesit duhet të trajnohen në mënyrë që të jenë fleksibël ndaj grupeve të ndryshme të fëmijëve në lidhje me përmbajtjen e asaj që mësohet, praktika dhe materialet e përdorura duhet të përcaktohen nga sjellja e fëmijëve, klasat duhet të përshtaten me nevojat e fëmijëve dhe edukimi të jetë i kombinuar me edukimin në familje. Për të ndërtuar një sistem të tillë shkollor, është e nevojshme, që edhe aspektet e tjera që e rrethojnë njeriun

si nga ana sociale ashtu dhe psikologjike të jenë në harmoni. Një mjedis i përshtatshëm për rritjen e fëmijëve duhet të jetë i sigurt, i ngrohtë, i cili mundëson plotësimin e nevojave të fëmijës. Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjithë të punojmë dhe të bashkëpunojmë për një të ardhme më të mirë dhe të atyre fëmijëve që u përkasin minoriteteve siç është minoriteti Rom në Shqipëri.

Përsa i përket studimit, rekomandohet literaturë më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse për të pasur një perspektivë më të hollësishme përse i përket faktorëve ndikues në përfshirjen dhe integrimin e minoritetit rom në mjediset arsimore. Gjithashtu për të kuptuar më mirë situatën aktuale në vendin tonë, e veçanërisht në qytetin tonë, do të rekomandonim përdorimin e pyetësorëve dhe intervistave të ndryshme me anëtarë të minoritetit, por dhe me stafin akademik të shkollave të ndryshme të qytetit.

BIBLIOGRAFIA

- Ainscow, M., & Miles, S. (2008). Making education for all inclusive: Where next?. *Prospects*, 38(1), 15-34.
- Bashkia Shkodër (2017), VENDIM nr. 80, Për miratimin e planit të veprimit për zhvillimin e komunitetit lokal Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër (2017-2020), 11-15.
- Baumeister, R.F. (2005). Self-concept, self-esteem and identity. In V.J. Derlega, B.A. Winstead, W.H.Jones. (Eds.) *Personality: Contemporary theory and research* (pp. 246-280). Toronto: ThomsonWadsworth.
- Cowan, P., Dede, G., Kenig, N., & Spasovski, O. (2017). Guidelines for citizenship education in school, the inclusion of minority groups. *Children's Identity and Citizenship in Europe*, 7.
- ECRI, K. E. (2020). Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues). Council of Europe.
- Gorman, D. (2010). Maslow's hierarchy and social and emotional wellbeing. *Aboriginal & Islander Health Worker Journal*, 34 (1), 27-29.
- Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (2017), Luftimi i segregimit shkollor në Evropë përmes arsimit gjithëpërfshirës: Shprehje qëndrimi, 9.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2019), VENDIM nr. 58, Çështje ex-officio mbi segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në Shkollën "Liria" dhe në shkollën vartëse "Isuf Tabaku" Shkodër. 11-25.
- Kurek, S., Osuch, W., Swietek, A., & Rachwal, T. (2012). How to educate Roma children? *Common Goals-Common Ways*, 5.
- Lazja, B. (2019). Ndikimi i familjarëve në arsimim dhe impakti i programit "Mësim me bashkëmoshatarët" tek fëmijët romë me performancë të ulët. In R. Hadroj, B. Laze, & E. Aliaj, *Ndikimet në arsimin e fëmijëve romë* (p. 13). Tiranë: Agim Xhelili.
- Lame, E. (2015), BARRIERAT POTENCIALE QË PENGOJNË MINORITETIN ROM NË SHQIPËRI PËR TË PASUR AKSES TË BARABARTË NË CIKLIN E MESËM TË ULËT TË ARSIMIT TË DETYRUAR [Tezë doktoraturë, Universiteti i Tiranës]. Tiranë, 27-31.

- Maslow, A. H. (1943). A Theory of Human Motivation. *Psychological Review*, 50, 370-96.
 - Nilholm, C., & Göransson, K. (2017). What is meant by inclusion? An analysis of European and North. *European Journal of Special Needs Education*, 437-451.
 - Powell, J. A. (2002). AN "INTEGRATED" THEORY OF INTEGRATED EDUCATION. Retrieved from The Civils Rights Project: <https://civilrightsproject.ucla.edu/research/k-12-education/integration-and-diversity/an-integrated-theory-of-integrated-education/poëell-integrated-theory-education-2002.pdf>
(PDF) School Self-Concept of Children in the System of Lower Secondary Education in Slovakia - Comparison of Slovak and Roma Children. Available from: HYPERLINK "https://www.researchgate.net/publication/323475866_School_Self-Concept_of_Children_in_the_System_of_Lower_Secondary_Education_in_Slovakia_-_Comparison_of_Slovak_and_Roma_Children"
https://www.researchgate.net/publication/323475866_School_Self-Concept_of_Children_in_the_System_of_Lower_Secondary_Education_in_Slovakia_-_Comparison_of_Slovak_and_Roma_Children
- Shavelson, R.J., Hubner, J.J., & Stanton, G.C. (1976). Self-Concept: Validation of construct interpretations. *Review of Educational Research*, 46(4), 654-664
- Shestani, A. (2011). "Gjendja e fëmijëve romë dhe egjiptianë" për vitin 2011. *Karta Rajonale Raportuese- Qarku Shkodër*, 8-11.
 - Tamo, A., & Karaj, T. (2007). Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri. *UNICEF, Tiranë*.

CURRENT DEVELOPMENTS IN THE IMPLEMENTATION OF THE BIO-PSYCHO-SOCIAL MODEL OF DISABILITY ASSESSMENT IN ALBANIA

Xhulia Musta, Rudina Rama

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale*

ABSTRAKT

Aftësia e kufizuar, krahas shëndetit, është një fenomen i vjetër në shoqërinë njerëzore. Gjatë vitit 2022 në Shqipëri u raportua përrreth 71,056 qytetarë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, paraplegji, tetraplegji dhe verbëri. Përgjatë viteve, vlerësimi i aftësisë së kufizuar ka evoluar nga modeli tradicional mjekësor në atë bio-psiko-social, i cili thekson një qasje më holistike. Deri në vitin 2019, vlerësimi i aftësisë së kufizuar në Shqipëri bazohej në modelin tradicional mjekësor, i cili rezultoi i paefektshëm, i fragmentuar, shumë abuziv, burokratik dhe jobashkëpunues me sisteme të tjera të rëndësishme të mbrojtjes sociale. Me mbështetjen e Bankës Botërore, Shërbimi Social Shtetëror, filloi zbatimin e modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Tiranë në nëntor 2019, i cili më pas u shtri në të gjitha qarqet në fund të vitit 2022. Qëllimi i këtij artikulli është të përshkruajë zhvillimet aktuale në zbatimin e modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Modeli bio-psiko-social i vlerësimit të aftësisë së kufizuar thekson një qasje shumëdisiplinore, sipas së cilës, mjekët dhe punonjësit socialë punojnë në ekip për të siguruar një vlerësim holistik të personave me aftësi të kufizuara. Në Shqipëri janë krijuar 37 ekipe shumëdisiplinore, të cilat janë shpërndarë në 12 qarqe dhe rishpërndahen brenda secilit qark për të ofruar mbështetje dhe shërbim sa më pranë personave me aftësi të kufizuara. Modeli bio-psiko-social supozon se personat me aftësi të kufizuara do të marrin pagesa në para dhe shërbime të integruara. Zbatimi i modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri është ende në fazat e hershme dhe është e parakohshme të diskutohen rezultate konkrete. Për rrjedhojë, do të kërkohet monitorim i vazhdueshëm i procesit të zbatimit për të identifikuar çdo problem dhe për t'i adresuar ato menjëherë.

Fjalët kyçe: aftësi e kufizuar, vlerësim, mjekësor, bio-psiko-social.

Current developments in the implementation of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania

ABSTRACT

Disability has been a longstanding phenomenon in human society, alongside health. In Albania, a significant number of citizens, approximately 71,056, were reported to be living with mental or physical disabilities, paraplegia, tetraplegia, and blindness in 2022. The assessment of disability has evolved from the traditional medical model to the bio-psycho-social model, which emphasizes a more holistic approach. Until 2019, disability assessment in Albania was based on the traditional medical model, which was found to be ineffective, fragmented, highly abusive, bureaucratic, and non-collaborative with other important social protection systems. With the support of the World Bank, the State Social Service began implementing the bio-psycho-social model of disability assessment in Tirana in November 2019, which later extended to all districts by the end of 2022. The purpose of this paper is to describe the current developments in the implementation of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania. The bio-psycho-social model of disability assessment emphasizes a multi-disciplinary approach that involves doctors and social workers working in teams to ensure a holistic assessment of people with disabilities. In Albania, 37 multi-disciplinary teams have been established, which are distributed across 12 districts and re-distributed within each district to provide closer support to people with disabilities. The model assumes that people with disabilities will receive both cash payments and services, and will be integrated into society. The implementation of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania is still in its early stages, and it is premature to discuss concrete outcomes. Therefore, continuous monitoring of the implementation process will be required to identify any issues and address them promptly.

Keywords: *disability, assessment, medical, bio-psycho-social.*

I. Introduction

Along with health, disability is an old phenomenon for human society. 1 of 4 European adults have a disability.¹ The number of people

¹ Europe Council. (2022). Infographic - Disability in the EU: facts and figures. Retrieved from <https://www.consilium.europa.eu/en/infographics/disability-eu-facts-figures/>

with disabilities is reported to be particularly high in developing countries.² In Albania at the end of 2022, about 71.056 citizens have mental or physical disability, para-tetraplegia and blindness. On the first two months of 2023, State Social Service reported 71.135 disabled people throughout Albania.³

Disability assessment and treatment has changed overtime. The oldest model of disability assessment is the medical model. The medical model has traditionally been the most common model for disability assessment. This model reflects disability as a biological problem.⁴ Disability is only a medical condition⁵ and a direct consequence of physical or mental impairments of an individual, therefore the solution can be found if we focus on the individual.⁶ The only solution to eliminate or alleviate the problems are the health facilities provided by doctors, nurses or other health care providers. In the context of social welfare, the medical model of disability assessment is a system where eligibility criteria to benefit disability cash benefits or services are entirely medical.⁷ Disability assessment is conducted only by doctors referring to impairments in bodily structures⁸. People with disability receive the same benefits from the Social Protection Programs, regardless of their health status, usually cash benefits only.⁹

² World Bank. (2022). Toward an Inclusive World: Collecting Better Data on Disability. Retrieved from <https://www.worldbank.org/en/news/video/2022/03/05/toward-an-inclusive-world-collecting-better-data-on-disability>

³ <https://www.sherbimisocial.gov.al/perfitues-e-pak-2023/>

⁴ Petasis, A. (2019). Discrepancies of the Medical, Social and Biopsychosocial Models of Disability; A Comprehensive Theoretical Framework. *The International Journal of Business Management and Technology*, Volume 3, Issue 4, page 43-46.

⁵ Kofi Amponsah, B. (2013). Relevance of disability models from the perspective of a developing country: An analysis. *Developing Country Studies*. Vol.3, No.11. Page 122-125.

⁶ Sulaiman SK, Mohammad AH, Ibrahim AA, Abdu SI, Kaka B. Revisiting the International Classification of Functioning, Disability and Health, a Comprehensive Model for Exploring Disablement in Low and Middle-income Countries: A Narrative Overview. *Iranian Rehabilitation Journal*. 2021; 19(3):261-272

⁷ Chiu WT, Yen CF, Teng SW, Liao HF, Chang KH, Chi WC, Wang YH, Liou TH. Implementing disability evaluation and welfare services based on the framework of the International Classification of Functioning, Disability and Health: experiences in Taiwan. *BMC Health Serv Res*. 2013. Vol. 13. Pg 7-8.

⁸ Yen Ch, Lin Ch, Liao H, Chen Sh, Lin Ch, Chiu H & Liou T. (2012). Experience of Implementing WHO-International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF). *Disability Welfare Policy in Taiwan*. 10(1), 6-11

⁹ MSHMS. (2018). Fushata e komunikimit për modelin bio-psiko-social të vlerësimit të

The opposite approach to the medical model was developed in 1983 by Mike Oliver.¹⁰ The social model shifts the meaning of disability from the individual to society. The assumption underlying the social model is that disability is the result of persistent social and political barriers.¹¹ People with disabilities are always in an unfavoured position because of some societal beliefs, attitudes or perceptions that create obstacles to integrate into society.¹² According to the social model, the solution is the elimination of discrimination against people with disability and improvement of policies, legislations, programs or strategies that will enable equal treatment in all areas. Thus, the social model focuses on the social aspect of disability, underestimating the influence of the biological factors.

Each of these models have some disadvantages in the assessment of disability. The medical model focuses on the biological aspects only, while the social model focuses only on the social aspect of disability. These models underestimate the influence of other factors in disability. Due to these shortcomings, in 1977 was developed the bio-psycho-social model of disability. This paradigm was first developed in the field of psychiatry.¹³ Engels believed that in the field of psychiatry, the explanation and treatment of morbidity could not be based only on biological aspects. For this reason, Engels emphasized that disease treatment should cover three aspects: the medical, psychological and social. In his article entitled "*From biomedical to bio-psycho-social*", Engels writes that his bio-psycho-social model allows disease to be explained based on an interaction at the cellular, tissue, organ, interpersonal and environmental, as an integral part of the big system. The bio-psycho-social model does not dismiss the useful aspects of the medical and social model, but it states that a comprehensive model must include several perspectives.¹⁴ The bio-psycho-social model summarizes the useful aspects of the medical and social models, without making the

aftësisë së kufizuar. Tirana.

¹⁰ Oliver, M. (1990). The individual and social models of disability. Paper presented at Joint Workshop of the Living Options Group and the Research Unit of the Royal College of Physicians. Retrived from <https://disability-studies.leeds.ac.uk/wp-content/uploads/sites/40/library/Oliver-in-soc-dis.pdf>

¹¹ Nathan, M & Brown, J. (2018). An ecological approach to modelling disability. *Bioethics Journal*. Vol. 32. Pg 3-6

¹² Goering, S. (2015). Rethinking disability: the social model of disability and chronic disease. *Current Rev Musculoskeletal Med*. 8(2): 134–138.

¹³ Engel, G. (1977). The Need for a New Medical Model: A Challenge for Biomedicine, *Science*, Vol. 96, pp. 129-136

¹⁴ Babalola E, Noel P & White R. (2017). The biopsychosocial approach and global mental health: Synergies and opportunities. *Indian Journal of Social Psychiatry*. Vol. 33. Nr. 4, pg. 291.

mistake of limiting disability to one of those aspects. Ghaemi suggest that the bio-psycho-social model introduces new factors in analysing health.¹⁵ It presents the biological, psychological and social factors and the interactions between them in the production of a health condition. Biological factors are related to physiological pathologies. Psychological factors refer to thoughts, emotions, coping styles and attributions. Social factors refer to family circumstances, work, socio-economic situation, etc.¹⁶

Engles created the philosophy of the bio-psycho-social model. Engels did not create mechanisms, strategies or instruments to implement in practice the bio-psycho-social model of health. The instrument of bio-psycho-social model was first developed by WHO in 2001. This instrument is called ICF (International Classification of Functioning). Currently is used in 191 countries of the world.¹⁷ ICF is a classification of health, not a classification of illness. ICF describes health divided in two parts: a) functioning and disability and b) contextual factors where there are included the personal and environmental factors.¹⁸ According to WHO¹⁹, ICF does not remove attention from the medical needs of people with disability, but emphasizes the contribution that physical, social or institutional barriers can have in the development of disability.

Albania is currently in a transitional phase, reforming the traditional medical model of disability into the bio-psycho-social model. Reforming the traditional model is in line with the principles of The International Convention on the Rights of Persons with Disabilities and the strategic documents and objectives of Albanian government related to rights of people with disability.

Purpose of this paper

The purpose of this paper is to describe the current developments in the implementation of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania.

¹⁵ Ghaemi, N. (2011). The Biopsychosocial Model in Psychiatry: A Critique. Int Journal of Philosophy, religion, politics and art. Volume 6, No 1, Pg.3-6

¹⁶ ibid

¹⁷ World Health Organization. (2001). The International Classification of Functioning, Disability and Health: ICF; WHO: Geneva, Switzerland

¹⁸ Road, C. (2012). Integrating the ICF and Related Resources to Improve Universal Design Guidance Standards: Systematic Review of International Literature: Integration of WHO-ICF and Related Resources into Non-medical Systems and Domains. National Disability Authority (NDA).

¹⁹ ibid

II. Establishment of the Bio-Psycho-Social Model of Disability Assessment in Albania

The fundamental reform of the disability assessment model was carried out through the World Bank Project for "Modernization of Social Assistance in Albania", which aimed to support Albania for the implementation of reforms to improve the quality and efficiency of social assistance programs.²⁰ In fact, the bio-psycho-social model of disability assessment was piloted in Administrative Unit no. 6 and no. 7 in Tirana since 2017, approved by the Decision of Ministers no. 431, dated 08.06.2016 "*On determining the criteria, documentation, procedures and amount of cash benefit and the personal assistant and the responsible structures and their duties in the pilot areas*" and since November 2019 continuous extension has started throughout Albania.²¹ After the district of Tirana, in the autumn of 2021 the bio-psycho-social model was successfully extended to the districts of Durrës and Elbasan.²² At the end of 2022 the extension of the reform to the remaining nine districts was realized.²³

The bio-psycho-social model of disability assessment in Albania brings a new approach to people with disabilities. This new approach brings innovation in the way the assessment is carried out, the procedure that is followed, the benefits that can be obtained from this assessment and the possibilities of integration. Currently, approximately 15.000 from 71.135 people with disabilities entered in the new bio-psycho-social model of disability assessment.²⁴

III. Functioning and innovations of the Bio-Psycho-Social Model of Disability Assessment in Albania

The bio-psycho-social model introduces for the first time the concept of multi-disciplinary teams. In contrast to the medical model of disability assessment where the team is compounded of doctors only, the bio-psycho-social model is based on multi-disciplinary teams of doctors and social workers.²⁵ The team consists of a doctor, a social worker and a

²⁰ Byrne K, Kulluri E & Gedeshi I. (2021). Situation Analysis of Children and Adolescents in Albania. UNICEF: Tirana. Pg 31-36

²¹ MSHMS. (2019). Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, Tiranë

²² SHSSH. (2022). Analiza vjetore e punës së SHSSH 2021. Tiranë

²³ SHSSH. (2023). Analiza vjetore e punës së SHSSH 2022 Tiranë

²⁴ ibid

²⁵ Otte T, Decuman S, Gelade W, Duyver C. Perceptions of medical advisers on ICF core-

Head of the Assessment Offices who must hold a degree in medicine or social work.²⁶ Along with the Regional Multi-Disciplinary teams, there are two Complaint Review Team. These Complaint Review Team assess people with disabilities that do not agree with the benefit level set up by the Regional Multi-Disciplinary teams or people with disabilities who think that they have been denied to the right to benefit.²⁷ The third and last Complaint Review Team will be established within 2023. Complaint Review Team is also a multi-disciplinary team, which has a doctor and two social workers.

The assessment offices are located near the residence of people with disability. The number of assessment offices is calculated according to the number of people with disability in each district. 37 assessment offices located throughout Albania are providing assessment services for people with disabilities. The 37th disability office was established in July in Tropoja, Kukës District.

Table 1- Number and Distribution of Disability Offices throughout Albania

<i>District</i>	<i>Number of Disability Offices</i>	<i>Offices Location</i>
Tirana	6	5 in Tirana, 1 in Kavaja
Durrës	3	2 in Durrës, 1 in Krujë
Elbasan	6	2 in Elbasan, 1 in Gostima, 1 in Pajova, 1 in Librazhd, 1 in Gramsh
Lezhë	3	2 in Lezhë, 1 in Milot
Berat	2	1 in Berat, 1 in Dimal
Gjirokastër	1	1 in Gjirokastër
Kukës	2	1 in Kukës, 1 in Tropoja
Fier	4	3 in Fier, 1 in Lushnje
Korçë	3	2 in Korça, 1 in Pogradec
Dibër	2	1 in Dibër, 1 in Mat
Vlorë	3	2 in Vlora, 1 in Saranda
Shkodër	3	2 in Shkodra, 1 in Puka

sets' use for evaluating work incapacity related to back pain in French-speaking Belgium. Pubmed Work. 2023;74(4):1401-1418.

²⁶ ILO. (2021). Review of social protection system in Albania: coverage, expenditure, adequacy and financing; ILO Decent Work Technical Support Team and Country Office for Central and Eastern Europe (DWT/CO- Budapest). – Budapest: ILO

²⁷ Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. (2021). Mekanizmi i ankimit për PAK. Tiranë.

The multi-disciplinary teams are distributed throughout the country, and redistributed within each district in order to guarantee that this service is as close as possible to people with disabilities. For example, in Elbasan District there are 6 assessment offices, from which 2 are located in Elbasan, 1 in Gostima, 1 in Gramsh, 1 in Pajova and 1 in Librazhd. As we mentioned earlier, the number of disability offices varies due to the number of people of disability. As can be analyzed from the table above, Tirana and Elbasan Districts have the largest number of disabled people, while Gjirokastra has the lowest number.

The documentation required for the application has been simplified.

In accordance with the legislation, the citizen who wants to apply for benefits of disability should start the procedure from the general doctor (named family doctor in Albania), then to the specialist doctor in accordance to their diagnosis. These doctors will complete the forms of disability assessment where they describe the medical information about the patient, medication, and suggest a level of limitations in activities and participation. These forms, along with the medical examinations, are submitted by the citizen to the Disability Assessment Office that covers his area of residence. Hospitalisation in tertiary structures is no longer required to apply for disability benefits.

Disability assessment procedure is simply and fast. Within 30 days from the submission day, the multi-disciplinary team conducts the interview with the disabled person. The interview explores deeply the level of functioning of the disabled person in different aspects such as: selfcare, domestic life, mobility, general activities, engagement in social life, relationships, education or work integration etc. Based on the medical documentation and the conducted interview, the multi-disciplinary team determines the level of limitation of the disabled person to carry out activities of daily life in accordance to their age. The assessment (either by family doctors and specialists, or by the multi-disciplinary team) is based on the two manuals of disability assessment for adults and children/adolescents.²⁸ Bio-Psycho-Social Assessment Manuals for Children and Adults describe the criteria to benefit from disability programme. At the end of the assessment procedure, the multi-disciplinary team generates the decision that gives or denies the cash benefits, and recommends services when appropriate. Even the Complaint Review Team reviews the complaints within 30 days.

Cash benefits from disability has changed. In the medical model in Albania, we had only two categories of cash benefits, named “first group”

²⁸ MSHMS. (2019). Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, Tiranë.

(cash benefit for the disabled and personal assistant) and “second group” (cash benefit for the disabled only). Distribution of benefits in two categories was not fair because regardless the level of limitations, people with disabilities got the same amount of financial support. Bio-psycho-social model introduces 4 level of cash benefits according to the level of limitations in performing every day activities. The cash benefits levels decreased for those who do not have high limitations and increased for those whose limitations strongly affect their quality of life. The redistribution of cash payments in 4 categories leads to a fair treatment of people with disabilities. Everyone will get a cash benefit in accordance to their limitations. Those who have more limitations will have the highest cash benefit. On the other side, these changes in cash benefits have led to a high number of complaints. Since 2021, the Complaints Review Team reviewed more than 2000 complaints.

Different assessment for children and adults. Two of the main innovations of the bio-psycho-social model of disability in Albania are the involvement of children aged 0-2 years old in disability assessment, and the differentiated benefits for children and adults. In the medical model children aged 0-2 years old were not assessed. On the other side, we are aware that children and adults are not affected in the same way from disability. The bio-psycho-social model of disability assessment overcomes this shortcoming. Cash benefits are different for children due to the fact that parents are responsible for their growth. Cash benefit for children is 75 % of the cash benefit of adults.²⁹

Integrated services and the procedure of receiving them. The multi-disciplinary team, along with cash benefits, can recommend integrated services such as assistive teachers, daily or residential social services, employment services, vocational trainings services, assistive tools, physiotherapy, psychotherapy, etc. Decision of Minister no. 722, dated 11.11.2019 “*For the determination of the amount, criteria, procedures and documentation for the evaluation and benefits of disability, the personal assistant, and the responsible structures and their duties*” sets responsibility to follow up recommended services to the administrative unit. Currently, the referral mechanism to the recommended services is not developed yet.

Lack of integrated services. One of the biggest challenges encountered is the lack of services. In Albania, the network of integrated services is still underdeveloped.³⁰ Cani in 2022 talks about little or no

²⁹ ibid

³⁰ MSHMS. (2019). Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, Tiranë.

services at all.³¹ Current services do not cover the needs at the national level. The only service that covers the needs of people with disabilities across the country is the personal assistant service. Services financed by the public sector are very few in number and represent about 46% of all services. The majority of social services are provided by NGOs and this does not guarantee sustainability in the provision of services in the long term.³² According to a study conducted by World Vision and Save the Children, there are many children who do not receive any services, while parents state that the costs of services are too high and the payments received are too low.³³

Undertaken efforts to develop services. In the framework of the new bio-psycho-social model of disability, there are several undertaken efforts to develop services. The Social Fund aims to support the local government for the establishment of social services, the development of social policies and the improvement of existing social services (Law no. 121/2016 “*On Social Care Services in the Republic of Albania*”; Social Protection Strategy 2020-2023). This fund was established due to difficulties in financing social care services.³⁴ Ministry of Social Affairs and Health declares that during 2022 through this mechanism 40 social services in the territory for 10 thousand beneficiaries have been supported so far.³⁵ In addition to Social Fund, at the end of 2022 several Cooperation Agreements were signed with important structures of integrated services. Specifically:

- Local government (for social care services);
- Regional educational directorates (for education services);
- Regional employment directorates (for employment or vocational training services);

³¹ Cani, B. (2022). Summary Report on the progress of the implementation process of Disability Assessment Reform, based on the bio-psycho-social model of ICF/WHO, 01.01.2022-30.06.2022. Tiranë

³² Hartley, S. (2011). World Report on Disability (WHO) on research gate. Retrieved from <https://www.researchgate.net/publication/282877201>

³³ World Vision Albania dhe Save the Children në Shqipëri. (2018). Aftësia e kufizuar te fëmijët në Shqipëri: Prevalenca e aftësisë së kufizuar, aksesit të shërbimeve dhe cilësia e shërbimeve. Tirana

³⁴ ILO. (2021). Review of social protection system in Albania: coverage, expenditure, adequacy and financing; ILO Decent Work Technical Support Team and Country Office for Central and Eastern Europe (DWT/CO- Budapest). – Budapest: ILO

³⁵ Declaration of Minister of MoHSP in the National Conference on Social Fund, 2022. This data is confirmed by the Directory of Social Services in SSS.

- Regional Directorates of the Mandatory Health Insurance Fund (for specialized health services, rehabilitation, tools or assistive technology, hygiene-sanitary packages, etc.).

Each Cooperation Agreement sets the responsibilities and tasks of each actor in providing recommended services from the multi-disciplinary team. These agreements are valid for 2 years and results will be monitored throughout.

IV. Conclusions

The establishment of the bio-psycho-social model of disability assessment in Albania is in line with the developments in the rights of people with disability, the concept and principles of the International Convention for the Rights of People with Disabilities, and the Albanian government engagement to guarantee the rights of people with disabilities. The bio-psycho-social approach in Albania was supported by World Bank Project “Modernisation of Social Assistance” and reflects the best practices used in developed countries.

The bio-psycho-social model of disability assessment is proved that brings several innovations, such as: fast, simply and non-bureaucratic procedure, no more waiting time to get assessed and take benefits, children aged 0-2 years old are assessed, the necessary documentation has been facilitated since hospitalization is not necessary to apply, benefits are different in accordance to age and limitations.

On the other side of the innovations, there are several challenges to overcome. Cash benefits in the bio-psycho-social model of disability assessment tend to decrease comparing to the medical model, leading to a great high number of complaints. As mentioned earlier, approximately 15.000 people with disability felt the effects of the disability model reform, while more than 50.000 still benefit from the medical model. The situation should be under continuous monitoring because it is not known how the changes will be expected from the majority of people with disabilities that are not affected yet.

Integrated services, which are a strong base and justification of the bio-psycho-social model of disability, are not developed yet. We are counting on the services provided by NGOs despite some services funded by the Social Fund. The Cooperation Agreements with structures of services are still in their first steps. They were signed in the last days of 2022 and need to develop mechanisms to provide the services recommended by the multi-disciplinary teams. The implementation of the

bio-psycho-social model throughout Albania is in its first phases. Apart integrated services development, it is strongly recommended for this model to be monitored continuously and assessed periodically in order to be implemented successfully according to developed countries practices. In time-detection of problems helps to take measures for an effective model.

References

1. Babalola E, Noel P & White R. (2017). The biopsychosocial approach and global mental health: Synergies and opportunities. *Indian Journal of Social Psychiatry*. Vol. 33. Nr. 4, pg. 291.
2. Byrne K, Kulluri E & Gedeshi I. (2021). *Situation Analysis of Children and Adolescents in Albania*. UNICEF: Tirana
3. Cani, B. (2022). Summary Report on the progress of the implementation process of Disability Assessment Reform, based on the bio-psycho-social model of ICF/WHO, 01.01.2022-30.06.2022. Tirana
4. Chiu WT, Yen CF, Teng SW, Liao HF, Chang KH, Chi WC, Wang YH, Liou TH. Implementing disability evaluation and welfare services based on the framework of the International Classification of Functioning, Disability and Health: experiences in Taiwan. *BMC Health Serv Res*. 2013. Vol. 13. Pages 7-8.
5. Engel, G. (1977). The Need for a New Medical Model: A Challenge for Biomedicine, *Science*, Vol. 96, pp. 129-136. doi:10.1126/science.847460
6. Ghaemi, N. (2011). The Biopsychosocial Model in Psychiatry: A Critique. *Int Journal of Philosophy, religion, politics and art*, 6(1), 3-6.
7. Goering, S. (2015). Rethinking disability: the social model of disability and chronic disease. *Current Rev Musculoskeletal Med*. 8(2): 134–138.
8. Hartley, S. (2011). *World Report on Disability (WHO)* on research gate. Retrieved from <https://www.researchgate.net/publication/282877201>
9. ILO. (2021). *Review of social protection system in Albania: coverage, expenditure, adequacy and financing*; ILO Decent Work Technical Support Team and Country Office for Central and Eastern Europe (DWT/CO- Budapest). – Budapest: ILO
10. Kofi Amponsah, B. (2013). Relevance of disability models from the perspective of a developing country: An analysis. *Developing Country Studies*. 3(11), 122-125.
11. MSHMS. (2018). *Fushata e komunikimit për modelin bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar*. Tirana
12. MSHMS. (2019). *Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar*, Tiranë.
13. Nathan, Marco & Brown, Jeffrey. (2018). An ecological approach to modeling disability. *Bioethics*. Vol. 32. Pg. 3-6
14. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. (2021). *Mekanizmi i ankimit për PAK*. Tiranë
15. Oliver, M. (1990). The individual and social models of disability. Paper presented at Joint Workshop of the Living Options Group and the Research Unit of the Royal College of Physicians. Retrieved from:

- <https://disability-studies.leeds.ac.uk/wp-content/uploads/sites/40/library/Oliver-in-soc-dis.pdf>
16. Otte T, Decuman S, Gelade W, Duyver C. Perceptions of medical advisers on ICF core-sets' use for evaluating work incapacity related to back pain in French-speaking Belgium. *Pubmed Work*. 2023;74(4):1401-1418.
 17. Petasis, A. (2019). Discrepancies of the Medical, Social and Biopsychosocial Models of Disability; A Comprehensive Theoretical Framework. *The International Journal of Business Management and Technology*, 3(4), 43-46.
 18. Road, C. (2012). Integrating the ICF and Related Resources to Improve Universal Design Guidance Standards: Systematic Review of International Literature: Integration of WHO-ICF and Related Resources into Non-medical Systems and Domains. National Disability Authority (NDA).
 19. Shoqata e Diabetit në Shqipëri. (2022). Draft raport monitorimi i shoqërisë civile për modelin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Tiranë.
 20. SHSSH. (2022). Statistika përfitues PAK 2022. Tiranë
 21. SHSSH. (2023). Statistika përfitues PAK Janar-Shkurt 2023. Tiranë.
 22. Sulaiman SK, Mohammad AH, Ibrahim AA, Abdu SI, Kaka B. Revisiting the International Classification of Functioning, Disability and Health, a Comprehensive Model for Exploring Disablement in Low and Middle-income Countries: A Narrative Overview. *Iranian Rehabilitation Journal*. 2021; 19(3):261-272.
 23. UN. (2006). Convention on the Rights of People with Disabilities. New York
 24. Waddel, G & Aylward, M. (2010). Models of sickness and disability applied to common health problems. Centre for psychosocial and disability research: Cardiff, UK, published by Royal Society of Medicine Press Ltd, 8-29.
 25. World Health Organization. (2001). The International Classification of Functioning, Disability and Health: ICF; WHO: Geneva, Switzerland
 26. World Vision Albania dhe Save the Children në Shqipëri. (2018). Aftësia e kufizuar te fëmijët në Shqipëri: Prevalenca e aftësisë së kufizuar, aksesit të shërbimeve dhe cilësia e shërbimeve. Tirana
 27. Yen Ch, Lin Ch, Liao H, Chen Sh, Lin Ch, Chiu H & Liou T. (2012). Experience of Implementing WHO-International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF). *Disability Welfare Policy in Taiwan*. 10(1), 6
 28. <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/VENDIM-618-per-PAK.pdf>
 29. <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/vendim-2019-11-11-722.pdf>
 30. <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/vendim-2019-11-11-722.pdf>
 31. https://adrf.al/images/publications/LIGJi_108-2012-Per_Ratifikimin_e_Konventes_per_te_drejtat_e_personave_me_aftesi_te_kufizuar.pdf
 32. <https://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/Ligj-nr-121-dt.-21.11.16.pdf>
 33. <https://www.consilium.europa.eu/en/infographics/disability-eu-facts-figures/>

34. <https://www.sherbimisocial.gov.al/vendim-nr-431date-08-06-2016-per-percaktimin-e-kritereve-te-dokumentacionitprocedurave-dhe-te-mases-per-perfitimin-e-pageses-se-aftesise-se-kufizuar-e-te-ndihmesit-personal-dhe-te-strukturave-perg/>
35. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/disability-and-health>

NDIKIMI I EMIGRACIONIT NË FAMILJET SHQIPTARE: SFIDA DHE NDRYSHIME

Elidjon Cami

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Emigracioni ka shkaktuar transformime të mëdha në strukturën dhe funksionimin e familjeve shqiptare duke sjellë ndryshime emocionale, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në kontekstin emocional, emigracioni shkakton ndarje fizike të anëtarëve të familjes dhe sjell mungesë emocionale, ankth dhe nostalgji. Ndërkohë që në rafshin ekonomik efektet e këtij fenomeni janë evidentuar të jenë më pozitive, pasi emigrantët shqiptarë dërgojnë remitanca për të mbështetur familjet e tyre në Shqipëri, duke ndikuar në ekonominë familjare dhe në përmirësimin e nivelit të jetesës. Studimet e kësaj fushe gjithashtu evidentojnë një ndikim mjaft të fuqishëm të emigracionit në ndryshimin e roleve tradicionale gjinore në familje. Po ashtu, arsimi është një fushë që po përballet me efektet që shkakton emigracioni, ku si rrjedhojë e këtij fenomeni social, shumë fëmijë e të rinj në vendin tonë detyrohen të ndërpresin shkollimin ose në rastet më fatlume përfitojnë nga mundësitë e reja për arsimim të avancuar në vendet pritëse. Përmes këtij studimi bibliografik, bazuar në studime të huaja dhe vendase realizuar gjatë dekadës së fundit, ky artikull synon të identifikojë shkaqet kryesore të emigrimit nga Shqipëria dhe ndikimin e këtij fenomeni në dinamikën familjare. Duke pasur parasysh sfidat dhe ndryshimet që vijnë me emigracionin, është e rëndësishme, që politikat dhe programet sociale të adresojnë nevojat e familjeve të emigrantëve dhe të përkrahin strategji që lehtësojnë përfshirjen e tyre sociale.

The impact of immigration on Albanian families: challenges and changes

ABSTRACT

Emigration has caused major transformations in the structure and functioning of Albanian families, bringing emotional, economic, social and cultural changes. In the emotional context, emigration causes physical separation of family members and brings emotional deprivation, anxiety

and nostalgia. Meanwhile, on the economic level, the effects of this phenomenon have been proven to be more positive, as Albanian immigrants send remittances to support their families in Albania, influencing the family economy and improving the standard of living. Studies in this field also evidence a strong impact of immigration on the change of traditional gender roles in the family.

Likewise, education is a field that is facing the effects of immigration, where as a result of this social phenomenon, many children and young people in our country are forced to stop schooling, or in lucky cases benefit from new opportunities for advanced education in the host countries. Through this bibliographic study, based on foreign and domestic studies carried out during the last decade, this article aims to identify the main causes of emigration from Albania and the impact of this phenomenon on family dynamics. Given the challenges and changes that come with immigration, it is important that social policies and programs address the needs of immigrant families and support strategies that facilitate their social inclusion.

Emigracioni është një fenomen i rëndësishëm që ka ndikim të madh në Shqipëri. Në dekadat e fundit, Shqipëria është përballur me ndërprerje të popullsisë së saj, me një numër të konsiderueshëm të qytetarëve që kanë vendosur të largohen nga vendi për të kërkuar mundësi më të mira ekonomike dhe sociale jashtë vendit.

Ka disa faktorë që kanë ndikuar në migracionin masiv në Shqipëri. Sipas (INSTAT, 2023), katër janë faktorët kryesorë që aktualisht ndikojnë në emigracionin drejt BE-së: mundësia për të punuar jashtë vendit (84%), bashkimi familjar (4.6%), papunësia (4.2%) dhe mundësia për të studiuar jashtë vendit (3.5%). Faktorë të tjerë tërheqës janë gjithashtu, cilësia më e mirë e trajnimeve dhe mundësive për t'u arsimuar jashtë vendit. Nga ana tjetër, mangësitë e shërbimeve publike kanë shërbyer si "faktorë nxitës", duke ndikuar negativisht në përpjekjen dhe perspektivën e emigrantëve për t'u kthyer dhe për t'u vendosur në Shqipëri.

Shqipëria është përshkruar si një laborator ideal për studimin e migracionit. Eksodi që nga viti 1990 (nga 1.2 në 1.6 milionë banorë) i jep një karakter unik duke u zhvilluar nga një *tabula rasa* e ndalimit total të emigrimit për katër dekada e gjysmë të epokës komuniste në një emigrim masiv që ka prekur të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, nga elitat tek grupet më të varfra dhe më të marginalizuara, si dhe ka tërhequr njerëz nga të gjitha rajonet e vendit, i cili vazhdon me grupe më të reja dhe më të arsimuara të popullsisë. Fakti se 79% e studentëve dhe 59% e maturantëve,

po planifikojnë të ikin nga Shqipëria, sipas një ankete të fundit të realizuar nga profesorët Ilir Gëdëshi dhe Russell King, nxjerr zbuluar dobësitë strukturore që po kalon ekonomia e vendit dhe mungesën e perspektivës për të ardhmen (King, 2003), (Barjaba, K., King, R., 2005).

Situata ekonomike e vështirë është një faktor kyç. Shqipëria ende përjeton sfida të mëdha në lidhje me zhvillimin ekonomik, me papunësinë e lartë dhe nivelin e ulët të pagave. Kjo ka bërë që shumë shqiptarë të shohin emigracionin si mundësi për të siguruar një jetë më të mirë për veten dhe familjet e tyre.

Arsye të tjera për emigracionin janë korrupsioni, mungesa e stabilitetit politik dhe social, sfidat në sistemin arsimor dhe shëndetësor, si dhe mungesa e perspektivave të reja për të rinjtë. Shqipëria gjithashtu është prekur nga ndryshimet demografike, me një popullsi që plaket dhe një numër të madh të të rinjve që largohen për t'u integruar në shoqëritë dhe tregjet e huaja të punës.

Emigracioni ka ndikuar në Shqipëri në disa mënyra. Një ndikim negativ është humbja e kapaciteteve njerëzore të vlefshme, duke përfshirë profesionistët e shkolluar dhe të kualifikuar që vendosin të emigrojnë. Kjo mund të ketë pasoja të këqija në zhvillimin e vendit dhe sektorët kyç të ekonomisë.

Megjithatë, emigracioni ka pasur edhe disa efekte pozitive në Shqipëri. Sipas (Pere, 2015) Remitancat, paratë që dërgohen nga emigrantët në vendin e tyre të origjinës, kanë qenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje shqiptare. Këto fonde kanë ndihmuar në lehtësimin e varfërisë dhe rritjen e nivelit të jetesës së disa individëve dhe komuniteteve.

Furnizimi i emigrantëve të ardhshëm me informacion të plotë mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre është veçanërisht i rëndësishëm për lehtësimin e formave të rregullta të migracionit për motive punësimi (qarkullues dhe sezonale) dhe për inkurajimin e kthimit në tregun shqiptar të punës.

Për të adresuar sfidat e emigracionit është e rëndësishme që Shqipëria të investojë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës, si dhe rritjen e nivelit të jetesës.

Migracioni i punës i shtetasve shqiptarë do të mbetet një faktor kryesor i zhvillimit të vendit. Aplikimi i një kombinimi masash është i nevojshëm për të reduktuar migracionin e parregullt, për të mbrojtur të drejtat e migrantëve dhe për të maksimizuar kontributin e përgjithshëm pozitiv të migrimit ekonomik në mirëqenien vendore dhe kombëtare. Ky objektivi synon të integrojë më mirë politikën e migracionit në menaxhimin e tregut kombëtar të punës duke ofruar stimuj për kthimin e punëtorëve në

sektorët në nevojë, duke shfrytëzuar më mirë aftësitë e të kthyerve dhe duke promovuar përdorimin produktiv të remitancave dhe kontributet e tjera të emigrantëve. Furnizimi i emigrantëve të ardhshëm me informacion të plotë mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre është veçanërisht e rëndësishme për lehtësimin e formave të rregullta të migracionit për motive punësimi (qarkullues dhe sezonale) dhe për inkurajimin e kthimit në tregun shqiptar të punës (Anketa Kombëtare Emigracionit në Familje, 2020).

Emigracioni ka pasur një ndikim të thellë në familjet shqiptare. Ky fenomen ka sjellë ndryshime të mëdha në strukturën dhe funksionimin e familjes, duke shkaktuar sfida dhe ndërlikime të reja për anëtarët e familjes.

1. *Ndikimi emocional*: Emigracioni shpesh sjell ndarje fizike të anëtarëve të familjes. Pjesa e madhe e emigrantëve shqiptarë largohen për një kohë të gjatë ose përherë, duke lënë pas familjarët e tyre në Shqipëri. Kjo ndarje e gjatë shkakton mungesë emocionale dhe ndihmon në shfaqjen e ndjesive, të tilla si: mungesa, ankthi dhe nostalgjia. Studimet evropiane tregojnë se adoleshentët emigrantë janë në një rrezik më të lartë për probleme të shëndetit mendor sesa adoleshentët vendas (Stevens, 2023).

2. *Ndikimi ekonomik*: Emigrantët shqiptarë shpesh dërgojnë remitancat (paratë e dërguara në vendin e origjinës) për të mbështetur familjet e tyre në Shqipëri. Këto fonde kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e familjeve shqiptare, duke ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve të përditshme, arsimin e fëmijëve dhe përmirësimin e nivelit të jetesës.

3. *Rrjedhshmëria e rolit gjinor*: Emigracioni shpesh sjell ndryshime në strukturën dhe dinamikën e rolit gjinor brenda familjes shqiptare. Për shembull, kur babai ose burri largohet për të punuar jashtë vendit, përgjegjësitë e tij tradicionale familjare mund të ndahen midis nënës ose grave të tjera të familjes. Kjo mund të shkaktojë sfida të reja dhe rishikime të rolit tradicional të gjinisë. Raporti gjinor i popullsisë gjithsej më 1 janar 2023 ka pësuar rënie, në krahasim me 1 janar 2022: nga 98,6 në 98,0 meshkuj për 100 femra (INSTAT, 2023).


4. *Ndikimi në arsim dhe edukim*: Emigracioni mund të ketë ndikim të ndryshëm në arsimimin e fëmijëve dhe rinisë shqiptare. Në disa raste emigrimi i prindërve mund të çojë në ndërprerje të arsimit për fëmijët, ndërsa në raste të tjera ata mund të kenë më shumë mundësi për të fituar arsim më të mirë në vendet pritëse. Kjo ndikon në ndryshimin e dinamikës së arsimit në familjet shqiptare dhe në perspektivat e tyre të të ardhurave të ardhshme. Ekspertët, pasi kanë mbledhur të dhënat sasiore, kanë vërejtur se 94.6% e studentëve shqiptarë që studiojnë në vendet e zhvilluara të OECD-së synojnë të mos kthehen në Shqipëri në të ardhmen e afërt. Ky fenomen

do të ketë pasoja socio-ekonomike afatgjata në Shqipëri, pohojnë ata (<https://www.monitor.al>, 2021).

Këto janë vetëm disa nga shkaqet kryesore të emigrimit nga Shqipëria. Ndryshe nga shkaqet individuale, faktorët e përmendur më lart kanë një ndikim më të gjerë dhe përbëjnë shkaqe të përgjithshme që shpjegojnë fenomenin e emigrimit masiv nga vendi.

Largimi i një ose më shumë anëtarëve të familjes shkakton mungesë emocionale dhe ndarje fizike. Për të gjithë anëtarët e familjes, përjetimi i ankthit, nostalgjisë dhe ndjenja të lëna pas dore, shpesh bëhen pjesë e realitetit të tyre. Këto ndjesi mund të ndikojnë në stabilitetin emocional dhe harmoninë e familjes. Sipas të dhënave nga Censi Kombëtar i Popullsisë dhe Banesave, më shumë se 85,4 përqind e personave nuk e kishin ndryshuar vendbanimin e tyre që nga 1 prilli 2001, kur u zhvillua censi i mëparshëm. Nga 1 prilli 2001, rreth 4 për qind e rezidentëve shqiptarë kishin qëndruar jashtë për më shumë sesa 12 muaj në periudhën 2001-2011. Lëvizja e familjeve tërësisht nga popullsia e vitit 2011 ka qenë proces i vazhdueshëm. Përgjatë periudhës së vrojtimit, ky fluks përbën më shumë sesa 50 për qind të fluksit të përgjithshëm të lëvizjes së familjeve jashtë vendit (Anketa Kombetare Emigracionit në Familje, 2020).

Familjet që kanë emigruar në tërësi që nga viti 2011 sipas destinacionit.




Emigracioni gjithashtu ndryshon dinamikën e rolit në familje. Në disa raste, kujdesi për fëmijët dhe përgjegjësitë e kujdesit, mund të përcaktohen në mënyrë të ndryshme. Kjo mund të rezultojë në përkrahje të

reja, rolin e prindërve të ndarë, si dhe ndryshime në lidhjet familjare tradicionalisht të definuara.

Riatdhesimi i familjeve të emigruara është një proces që përfshin kthimin e anëtarëve të një familjeje në vendin e tyre të origjinës pas një periudhe të emigrimit. Ky proces mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme, siç janë përmirësimi i situatës ekonomike, ndryshimi i kushteve politike, arsye personale etj.


Duke marrë parasysh 96 755 personat që u larguan nga vendi i banimit të zakonshëm, pas qëndrimit në një vend tjetër për të paktën një vit dhe atyre që mbërritën në Shqipëri në vitin 2019, numri i të kthyerve u vlerësua në 95 064 persona, ndërsa numri i imigrantëve (joshtetas) u llogarit në 1 691 persona.

Struktura e emigrantëve që mbërritën në Shqipëri deri në 2019



Në fushën e arsimimit, emigracioni mund të ndërpresë arsimimin e fëmijëve dhe të rinisë shqiptare, duke sjellë sfida të rëndësishme për ata që mbeten. Për disa, emigracioni ofron mundësi të reja për arsimim të avancuar në vendet pritëse. Kështu, ndryshimi në kontekstin arsimor dhe nevojat për përkrahje shtesë bëhen të domosdoshme. Ndikimi i emigracionit në familjet shqiptare është një temë komplekse dhe me ndikim të thellë në dinamikën familjare. Duke analizuar sfidat dhe ndryshimet që lidhen me largimin e anëtarëve të familjes, një gjë është e qartë: emigracioni ndryshon strukturën, funksionimin dhe emocionet e familjeve shqiptare.

Përlllogaritjet e popullsisë më 1 janar 2023 tregojnë se vetëm një qark i vendit shënoi rritje të popullsisë, krahasuar me një vit më parë, ndërsa njëmbëdhjetë qarqet e tjerë shënuan rënie të popullsisë. Rritja u shënuar në Tiranë (+ 0,6 %) (INSTAT, 2023).



Në Shqipëri, sipas një artikulli nga Citizens Channel, afër 4.77 milionë njerëz të Ballkanit Perëndimor jetonin jashtë vendit të lindjes deri në vitin 2020. Sipas një pyetjeje të kryer në vitin 2021, 1/3 e rezidentëve në këtë rajon po e konsideron emigrimin. Shqipëria rezulton si shteti që ka trendin më të lartë të azilkërkimit në Gjermani gjatë viteve të fundit (<https://citizens-channel.com>, n.d.).

Në përfundim, ndikimi i emigracionit në familjet shqiptare është i ndjeshëm dhe kompleks. Është e rëndësishme të kuptohet se sfidat dhe ndryshimet që shfaqen janë specifike për secilën familje dhe situatën në të cilën përballet. Pandemia e Covid - 2019 ka ndikuar në përkeqësimin e situatës ekonomike dhe thellimin e disbalancës midis shtresave të popullsisë. Strategjitë e ofruara nga shteti shqiptar për rritjen e burimeve stukturore për punësim dhe riatdhesimin e fuqisë punëtore nuk janë akoma të mjaftueshme për të ndaluar një proces migrimi tashmë të rrënjësor në realitetin shqiptar. Ndoshta, tashmë lëvizjet ndërshtetërore duhet të shihen si pjesë e pandashme e evolutit të familjes dhe shoqërisë. Individit kozmopolit është tashmë bërthama e një familje dhe shoqërie në “*perpetum mobile*” të pashmangshme.

BIBLIOGRAFI

- Anketa Kombëtare Emigracionit në Familje. (2020). Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në kuadër të Programit Global “Migracion për zhvillim”.
- Barjaba, K., King, R. (2005). *Introducing and theorising Albanian migration; The New Albanian Migration*. (S. Schwandner-Sievers, Ed.) Brighton: Sussex Academic Press.
- INSTAT. (2023). *Anketa e fuqisë punëtore*.
- King, R. (2003). Across the sea and over the mountains: documenting Albanian migration, *Scottish Geographical Journal*, 119(3): 283-309; Barjaba, K., King, R. (2005) *Introducing and theorising Albanian migration*, in King, R., Mai, N., Schwandner-Sievers, S.
- Pere, E. (2015). “Të ardhurat nga remitancat dhe rritja ekonomike në Shqipëri” (1992–2013). *ECONOMICUS 13*.
- Stevens, L. D. (2023). *Immigration background and adolescent mental health problems: the role of family affluence, adolescent educational level and gender*. INSTAT. Retrieved from <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov>

Webliografi

<https://citizens-channel.com>. (n.d.).

<https://www.monitor.al>. (2021). *Ikja e të rinjve fenomeni i largimit është më i lartë në Shqipëri se kudo tjetër në Europë*. Retrieved from <https://www.monitor.al>.

**MEDIA SOCIALE DHE MIRËQENIA
PSIKOEMOCIONALE: NJË INTERPRETIM
FENOMENOLOGJIK I GJETJEVE
ME TË RRITUR**

Fatjona Haka

Shkolla 9 - vjeçare "Xheladin Fishta"

ABSTRAKT

Ky studim ka për qëllim eksplorimin e ndikimit të medieve sociale mbi mirëqenien emocionale dhe psikologjike të pjesëmarrësve. Kërkimi është i llojit sasior dhe për zbatimin e tij është përdorur fenomenologjia interpretative me qëllim që informacioni dhe interpretimi i tij të jenë të pandarë, meqenëse në këndvështrimin e studiueses, këto janë hapa të njëpasnjëshëm të të njëjtit proces. Për realizimin e studimit studiuesja ka përdorur intervista të thelluara gjysmë të strukturuar dhe si instrument plotësues shënimet periodike. Studimi është realizuar me shtatë persona të rritur mes njëzet e dy dhe tridhjetë e tetë vjeç. Rezultatet identifikuan pesë tema: (1) arsyet e përdorimit të medieve sociale; (2) efektet pozitive të përdorimit të medieve sociale; (3) efektet negative të përdorimit të medieve sociale; (4) krahasimi i komunikimit online dhe atij tradicional dhe (5) mirëqenia emocionale dhe psikologjike. Studimi nxori në pah faktin se gjetjet janë në shumicën e tyre të ngjashme me gjetjet e studimeve bashkëkohore, por ndër ta ka disa që nuk përputhen me çfarë sugjeron literatura dhe studimet e kohëve të fundit.

Fjalë kyçe: media sociale, moshë e rritur; mirëqenie emocionale; mirëqenie psikologjike.

Social media and psycho - emotional wellbeing: a phenomenological interpretation of findings in an adult population

ABSTRACT

This research is an attempt to explore social media's influence on people's emotional and psychological well – being. The qualitative

methodology was used. The researcher used the interpretative phenomenology since in her opinion description and interpretation are successive and indivisible steps in a phenomenological research. Semi structured, in - depth interviews were used. In addition, periodic notes were used as a secondary data source. Seven adults, from twenty two to thirty eight participated in the research. Five themes were identified: (1) reasons of using social media; (2) positive effects of social media use; (3) negative effects of social media use; (4) comparison of online and face to face communication and (5) emotional and psychological well – being. The research showed that the majority of findings are similar to those described in the contemporary literature. However, some findings are in contrast with, therefore further research should be undertaken.

Key words: Social media; adulthood; emotional well – being; psychological well – being.

Hyrje

Media sociale është një dukuri që prej disa vitesh “ka pushtuar” mbarë botën në atë masë sa është bërë pjesë e pandarë e jetës së përditshme. Si gjithçka tjetër me shtrirje kaq të gjerë edhe ndikimi i saj është i shumanshëm.

Kaplan & Haenlein¹e përkufizojnë median sociale si: “Një grup aplikacionesh të mbështetura tek interneti...që lejojnë krijimin dhe shkëmbimin e përmbajtjes së gjeneruar nga vetë përdoruesi në komunitetet virtuale”.

Media sociale nuk është e një lloji të vetëm. Siç të gjithë e dimë ekzistojnë disa të tilla që rivalizojnë njëra - tjetrën për sa i përket përdorimit. Megjithëse mediet sociale përdoren nga thuajse të gjitha grupmoshat, ky studim do të fokusohet te përdoruesit e moshës së rritur. Në këtë studim ata variojnë nga 18 në 38 vjeç. Studimi i medias sociale në këtë artikull do të bëhet në raport me mirëqenien emocionale dhe mendore të pjesëmarrësve.

Gjetjet e literaturës bashkëkohore² tregojnë se njerëzit, veçanërisht të rinjtë, krahasohen me ata që i cilësojnë si më të përparuar, më të arrirë dhe në tërësi më të mirë dhe më mirë sesa veten, por njëkohësisht edhe me

¹ Kaplan, A.M. & Haenlein, M (2010), Users of the world, unite! The challenges and opportunities of social media. *Business Horizons*, 53(1).

² Johnson, B. K. (2021). Look up, look down: Articulating inputs and outputs of social media social comparison. *Journal of Communication Technology*, 4 (1), 28-53. <https://doi.org/10.51548/joctec-2021-003>

të tjerë ndaj të cilëve ndjehen më të mirë dhe më mirë. Të dy llojet e krahasimeve sjellin si dobi edhe dëm. Lloji i parë i krahasimit i jep shtysë lindjes së afektit negativ, lëkundjes së vetëvlerësimit dhe prodhon injorancën pluraliste³ Ndërkaq, lloji i dytë i krahasimit e përmirëson vetëvlerësimin dhe më pak injorancën pluraliste.

Duke qenë se mediet sociale lejojnë që njerëzit të shfaqin pjesën më të mirë të vetes përmes tyre edhe hendeku mes jetës së tyre reale dhe asaj virtuale thellohet duke sjellë ose shqetësimet e lartpërmendura, ose përmirësimin artificial të imazhit të vetes.

Një tjetër mënyrë sesi media sociale e ndikon besimin e njerëzve, veçanërisht femrave në këtë rast për vetimazhin e tyre është përmes të ashtuquajturit *fitspirim*, një term që shpjegon përkushtimin aktiv ndaj të paturit një paraqitje fizike sa më tërheqëse, çka nxitet së tepërmi nga mediat sociale⁴.

Në krahasimin social, çka pasqyrohet edhe në mediet sociale, rol parësor luan edhe kultura së cilës i përkasin përdoruesit. Është gjerësisht i njohur në literaturën bashkëkohore fakti se kulturat Lindore janë më kolektivistike, ndërsa ato Perëndimore më individualiste. Të parat njihen si të ndërlidhura, ndërsa të dytat si të pavarura.

Edhe mosha dhe gjinia luajnë rol në krahasimin social përmes medieeve sociale. Përsa i takon moshës nuk ka mëdyshje: të rinjtë krahasohen me të tjerët më shumë sesa të vjetrit që priren të krahasohen më shumë me variantet e mëparshme të vetes⁵. Studimet mbi gjininë kanë dhënë rezultate të ndryshme. Disa pohojnë se femrat priren më shumë drejt krahasimit social, ndërsa studime të mëvonshme kanë gjetur të kundërtën⁶. Sipas Wolfers & Utz⁷, media sociale, mund ta nxisë ankthin e miratimit social për shkak se ofron mundësinë e matjes së hapur të popullaritetit përmes numrit të ndjekësve / shokëve, pëlqimeve, komenteve, shpërndarjes / ripostimit të postimit origjinal etj.

Stresi dhe ankthi mund të shtohen edhe për shkak të perceptimit të përdoruesit se ‘nuk po ruan hapin’ e miqve të vet virtualë. Pra, ndërkohë që përdoruesi sheh arritjet e të tjerëve, sjell në vëmendje faktin se ai vetë nuk i ka këto arritje.

³ Me termin injorancë pluraliste njihet besimi i pjesëtarit të një grupi, sipas të cili pjesëtarëte tjerë të të njëjtit grup kanë qëndrime, besime dhe sjellje të skajshme/ekstreme.

⁴ Cituar në Carrote et al, 2017.

⁵ Cituar në Cheng, Burke & De Gang, 2020.

⁶ Po aty.

⁷ Wolfers, L. N. & Ytz, S. (2022). Social Media Use, Stress and Coping. *Current Opinion in Psychology*. 45. <https://doi.org/10.1016/j.copsy.2022.101305>.

Stresin dhe ankthin mund ta shtojë edhe profili i kuaruar i një shoku virtual.⁸

Në të njëjtin artikull, Wolfers & Utz, shpjegojnë se stresin dhe ankthin në mediet sociale mund ta shtojë edhe shpërndarja e informacionit të rremë, krejtësisht të paqenë për përdoruesit, keqinterpretimi i të dhënave dhe fakteve të tjera të lidhura me to dhe hapja e profileve fallco. Kjo shpjegon pse njerëzit që e lënë mënjane për disa ditë përdorimin e medieve sociale pësojnë ulje të nivelit të ankthit.

Megjithatë, jo gjithçka në përdorimin e medieve sociale është 'e zezë'. Ky konstatim duket se mbështetet nga një arsytim i thjeshtë: sikur gjithçka e lidhur me mediet sociale të ishte e keqe, nuk do të ngeleshin përdorues aktivë. Nga ana tjetër edhe në këtë trajtim po përmendet në vazhdimësi se profilet e kuruara dhe shpalosja e një jete personale dhe profesionale me standarde të dëshirueshme, shpërblehet.

Studiuesit Meier & Johnson,⁹ besojnë se shumica e studimeve të fushës nuk marrin parasysh faktorë kyç, të tillë si: kriteret e njëjta të krahasimit social online me ato të krahasimit social ballë për ballë, faktorët që shkaktojnë efekte të caktuara gjatë përdorimit të medieve sociale dhe ndikimi që agjencia dhe vetja ushtrojnë mbi efektet e medias sociale. Përmes studimit të tyre, Meier dhe Johnson, kanë zbuluar se zilia që lind për të tjerët në mediet sociale mund t'i frymëzojë dhe t'i motivojë përdoruesit të bëjnë ndryshime pozitive në jetën e tyre, si fjala vjen, ndërmarrja e hapave për përmirësimin e shëndetit, zhvillimin profesional dhe përfshirjen në veprimtari argëtuese që njëkohësisht kanë edhe njëfarë krijimtari dhe risie krahasuar me të mëparshmet.

Faktorë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin, qëndrimin dhe sjelljen e përdoruesve në mediet sociale, por që janë ende të paeksploruara, si: sjellja e përdoruesve, përfshirja përzgjedhëse (pra përjashtimi i qëllimshëm i disa medieve apo veprimeve në mediet sociale) dhe vëmendja përzgjedhëse përse i përket identifikimit të efekteve pozitive ose negative, kur përdoruesit krahasohen me përdorues të tjerë.

Qëllimi i studimit aktual

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë rolin që luan media sociale në mirëqenien emocionale dhe psikologjike në jetën e përditshme të pjesëmarrësve.

⁸ Johnson, B. K. (2021). Look up, look down: Articulating inputs and outputs of social media social comparison. *Journal of Communication Technology*, 4 (1), 28- 53. <https://doi.org/10.51548/joctec-2021-003>

⁹ Meier, A. & Johnson, B. K. (2022). Social Media Use, Stress and Coping. *Current Opinion in Psychology*. 45. <https://doi.org/10.1016/j.copsyc.2022.101305>.

Specifikisht, studimi kërkon të eksplorojë:

- ✚ masën e përdorimit të medieve sociale;
- ✚ arsyet më të shpeshta të përdorimit të medieve sociale;
- ✚ ndikimin e komunikimit online te rutina e jetës së përditshme;
- ✚ ndikimin e medieve sociale te mirëqenia emocionale dhe psikologjike e pjesëmarrësve.

Metodologjia

Arsyeja e përzgjedhjes së fenomenologjisë interpretative si metodologji kërkimi qëndron te fakti se *“faktet” (fenomenologjike) të përvojës që përjetojmë shprehin gjithmonë një përvojë kuptimplotë. Për më tepër edhe vetë ‘faktet’ e përvojës që përjetojmë është e nevojshme të shprehën përmes gjuhës çka paraqet një proces të pashmangshëm interpretues”¹⁰.*

Përmes fenomenologjisë interpretative janë analizuar mënyrat dhe përmasat në të cilat media sociale ndikon në jetën e përditshme të pjesëmarrësve.

- Pjesëmarrësit

Në studim kanë marrë pjesë shtatë të rritur mes njëzet e dy dhe tridhjetë e tetë vjeç. Fillimisht, në studim, janë ftuar njëmbëdhjetë pjesëmarrës të mundshëm, por vetëm shtatë prej tyre iu përgjigjën pozitivisht ftesës.

Ajo që i bashkon pjesëmarrësit është arsimi i lartë. Ndërkaq, ata kanë përvoja të ndryshme punësimi si në kohë edhe në llojin e punës dhe doemos edhe në historinë e gjerë jetësore. Pavarësisht dallimeve, siç do të vërehet në rubrikën e rezultateve, ndikimi që media sociale ushtron në jetën e tyre të përditshme shfaq ngjashmëri jo të pakta.

- Intervistat gjysmë të strukturuar

Metoda parësore e mbledhjes së të dhënave ka qenë ajo e intervistimit. Agjenda e intervistës ndjek modelin e intervistës gjysmë të strukturuar dhe të ndërtuar në mënyrë të tillë që prej saj të përftohet informacion i thelluar. Ajo është ndërtuar posaçërisht për këtë studim dhe përmban dymbëdhjetë pyetje.

Intervistat janë realizuar individualisht për t'i motivuar pjesëmarrësit të shprehën pa kufizime sa më shumë të jetë e mundur.

¹⁰ Cituar në Willig, 2006.

Çështjet që trajton intervista janë: koha mesatare ditore e përdorimit të medias sociale; arsyet më të shpeshta të përdorimit të saj; hamendësimin mbi mënyrën si do të ndryshonte jeta e pjesëmarrësve po të reshtnin së përdoruri mediet sociale; tiparet e njerëzve më të cilat pjesëmarrësit komunikojnë zakonisht dhe lidhjen me ta; mendimin e tyre mbi mënyrën sesi komunikimi online ndikon aktualisht tek ata vetë; mënyrën sesi e fokusojnë vëmendjen te efektet e medieve sociale; vlerësimin e pjesëmarrësve për vlerën që i japin medias sociale në jetën e tyre dhe ndihmën që marrin përmes komunikimit në mediet sociale krahasuar me ndihmën të cilën e marrin në mënyrën tradicionale.

- *Shënimet periodike*

Shënimet periodike përbëjnë një lloj ditari jo të detajuar, por të mbajtur me rregull për afërsisht një javë. Pjesëmarrësve iu është kërkuar të shënojnë rregullisht sa herë në ditë i kanë përdorur mediet sociale që përdorin zakonisht, me kë kanë komunikuar, si dhe cila ka qenë tema e komunikimit.

Për ta lehtësuar mbajtjen e këtyre shënimeve është përdorur programi Notes (shënimet) që gjendet në telefonat inteligjentë.

- *Analiza e të dhënave*

Për shkak se pjesëmarrësit nuk ranë dakord për regjistrimin e bisedave përkatëse, studiuesja i ka shënuar përgjigjet sa më të detajuara që ka qenë e mundur. Duke lexuar përgjigjet ajo ka bërë fillimisht identifikimin e temave të mëdha që spikasin mbi të tjerat në secilën prej shtatë intervistave. Natyrisht, janë mbajtur parasysht kodet dhe kategoritë mbi të cilat kanë rezultuar temat e sapopërmendura.

Si bazë për integrimin e bisedave është përdorur tabela tematike e intervistës së parë.

Kujdes optimal është treguar për moshumbjen e kuptimit fillestar ndërkohë që gjatë integrimit të bisedave kalohej nga një njësi kuptimore në një tjetër më të madhe.

Rezultatet e dala nga analiza janë krahasuar me gjetje të literaturës së kësaj fushe.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Pjesëmarrësit, katër femra dhe tre meshkuj, ishin të gjithë të një mendjeje se mediet sociale kanë në jetët e tyre ndikim të qëndrueshëm dhe

që përfshin çdo sferë jetësore. Përgjigjet dhe shembujt që kanë dhënë burojnë pikërisht prej përvojave të përditshme. Ato janë pasqyruar në temat e intervistës që gjenden në vijim.

Mediet sociale më të përdorura rezultuan se ishin whatsapp dhe Instagram të ndjekura nga facebook dhe youtube, ndërsa koha mesatare ditore e përdorimit të tyre varionte nga tre orë në pesë të tilla.

Temat e dala nga intervistat janë (1) arsyet e përdorimit të medieve sociale, (2) efektet pozitive të përdorimit të medieve sociale, (3) efektet negative të përdorimit të medieve sociale, (4) krahasimi mes komunikimit online dhe atij tradicional dhe (5) mirëqenia emocionale dhe mendore.

- *Arsyet e përdorimit të medieve sociale*

Pjesëmarrësit pa përjashtim pohuan se mediet sociale ua lehtësojnë si asnjëherë më parë komunikimin me familjarët, veçanërisht me ata që gjenden jashtë vendit. Gjithashtu ato pohuan që të gjithë se i përdorin mediat sociale edhe për t'u argëtuar.

Në fjalët e F *"facebook të humb mendjen. Ça nuk del aty. Iloj soj. Nuk mund të mos e përmendi kte se ka raste që nuk kam argëtim tjetër"*.

Ndërsa L shprehet se *"Unë vetëm me ça postoj në facebook fitoj njerz që më ndjekin"*. Nga intervista me këtë pjesëmarrëse merret vesh se ajo e përdor facebook për të promovuar punën e saj dhe rrjedhimisht për të fituar klientë të rinj. Edhe pohimi i mësipërm duhet kuptuar në këtë kontekst. Pra, ndër arsyet e promovimit të medieve sociale është edhe promovimi i punës. Gjithashtu të tjerë pjesëmarrës pohuan diçka të ngjashme. Sipas M: *"Postoj kajher ndonjë gja punet. Edhe ndjeki t'tjer që postojn gjana që kanë lidhje me punen teme"*.

Ndonëse mund të mos quhet saktësisht pohim i lidhur me punën, ka të bëjë me shpalosjen e interesave profesionale dhe në një kuptim më të gjerë edhe të vetëperceptimit të aftësive apo të atyre aftësive që personi dëshiron të ketë.

E pohon se mediet sociale i përdor për arsye studimi. Ajo thotë se *"kërkoj, zbuloj, ruaj dhe shkëmbej artikuj, punime, materiale, ça t'them për ato që m'duhen. Për gjuht ka shumë"*.

Pjesëmarrësit u shprehën se përmes medieve sociale, veçanërisht facebook dhe instagram lajmërohen edhe për të rejtat e fundit që ndodhin në vend dhe në botë. D, njëra prej pjesëmarrëseve, thotë se *"televizori tash na asht ba dytsor. Hapi facebook...aty i kam (lajmet e reja)"*

F, por edhe pjesëmarrës të tjerë, u shprehën edhe në lidhje me një detaj tjetër: kuriozitetin! *"M'thuj thashethemaxhie ne daç, po kajher nuk munem me nejt pa i pa faqet e disave. Nuk jam njeri që ha inat, po me disa njerz kam mëri. Gjana të kalume ma shumë. Shpesh i injoruj, po ka raste që"*

t'dalin para syve vet postimet, ose nigjon diçka diku dhe nuk e përmbaj kuriozitetin”.

- *Efektet pozitive të përdorimit të medieve sociale*

Siç u përmend më lart, të gjithë pjesëmarrësit pohojnë se mundësia e komunikimit me të afërmit, veçanërisht ata që ndodhen larg, është një e mirë e madhe. Sipas A. *“flet njeriu kur don, sa don, e shef me sy. Para se me dal kto as bahej fjalë”*. Duke vlerësuar përgjigjet, mendojmë se kjo është përparësia e parë që pjesëmarrësit rendisin si të tillë dhe me më shumë peshë se të tjerat. Edhe D është e të njëjtit mendim: *“I ka afër njerzit. Të hyn tjetri n'dhomë. Duket sikur e kea ty. Pijmë kafën me motren që kam n'Belgjikë kajher. Ia dimë oraret njëna – tjetrës dhe rrim a thu se jena n'nji vend”*.

E rrëfen: *“Para disa vitesh kam kenë shumë e ndrydhun. Delsha pak prej shpijet...jeta na erdhi e randë në ship qysh n'moshë t'vogël...jam rrit me ato shetsime, u bana pak si njeri i trembun, pa kurajo, rrallher e kam hapë gojen...qoftë edhe për qejf. Derisa motra m'hapi një adres facebook. N'fillim isha e pandashme n'facebook. Tan lidhjet që m'mungoshin n'jeten reale u mundova me i kriju n'jeten virtuale. Kam postu foto shumë, i kam ba lajk gjithkujt...ku di unë...kështu...mandej msova me i kontrollu këto gjana tana. Edhe tash jam aktive n'facebook, por i baj gjanat me masë, nuk çmendem. Por du me thanë njofta boten në njifar mnyret. Tu shkru, tu lexu ca shkushin t'tjert msova mbi komunikimin, msova me dallu ma mirë ça asht e drejtë, ça e gabume. T'mson media sociale n'ktë drejtim”*.

Pra, një ndër të mirat e përdorimit të medias sociale është mundësia që ajo ofron për të krijuar marrëdhënie në masë të gjerë, por po aq edhe mundësia për të vëzhguar llojet e ndërveprimit të të tjerëve dhe për të nxjerrë mësimet përkatëse pra në njëfarë mënyre për t'i dhënë kuptim jetës. Natyrshëm, jo të gjithë do të arrijnë në të njëjtat përfundime edhe po të vëzhgojnë apo po të marrin pjesë në të njëjtat situata.

F shprehet: *“Shumë sinqerisht po të them se një ndër gjanat ma t'mira që ka media sociale asht fakti se gjithçka e ban njeriu n'intimitetin e vet. Shof lajmet që du, aty ku du, e ndërpres në mes videon, hapi shumë faqe njëherësh...kontrolloj zanin...me një fjalë si ta kem unë terezinë...”*

L pranon se disa marrëdhënie kanë filluar online dhe janë zhvilluar edhe në mënyrën tradicionale. Ajo thotë: *“Jam njoftë online, në një grup facebook me dy gra shumë t'mira. Jo me të dyja njikohsisht, por veç e veç. Të dyja jetojnë jashtë vendit. E pame që na ecte muhabeti dhe këmbyme numrat. Gradualisht u transferu i gjithë komunikimi n'ehatsapp që asht një gja ma personale. Mandej mbas njifarë kohet, kur kanë ardhë për pushime*

n' Shqipni jam taku disa herë me to dhe ia kena kalu shumë mirë”.

Në fakt, një studim i kohëve të fundit i Tuz Sierrës dhe kolegëve¹¹ ka zbuluar se sa më shumë rritet përdorimi i rrjeteve sociale aq më i pakët bëhet kuptimi i jetës dhe anasjelltas. Ky pohim duket në kontradiktë me një pjesë të pohimeve të këtij studimi, disa ndër të cilët sapo u cituan.

R e kthen vëmendjen te një çështje me ndjeshmëri sociale: sensibilizimi për kauza të virtytshme, pavarësisht cilat janë ato konkretisht. *“Për Zotin, kur i shof ato pamjet kajherë, fëmijë të smur...njerëz të deformum...ku di unë tjetër...ose fjalë që t'kpusin shpirtin bahem me e kalu menjihher postimin, po kur mendoj që për një like që jap unë, ose një koment sado të shkurt...edhe thjesht Amen, ose emoji...mblidhen lekë për njerëz që kanë nevoja të jashtëzakonshme, ndalem e baj atë like, ose atë koment edhe e kaloj postimin kajherë edhe pa e pa tamam se nuk kam zemër”.*

Një përgjigje të ngjashme jep edhe M, kur pranon: *“Unë kam firmosë disa herë online peticione për kauza t'ndryshme. Herë me rujte liqenin, herë mos me pre pyllin...me një fjalë ato që ma kanë mbushë mendjen. I kam pa te llogaritë që kam dhe i kam gjetë faqet ku mund t'i firmossha”.*

Një ndër faqet prestigjioze që promovon të nxënit online, Simplilearn¹², shprehet se ‘është e mundur që veprimet fisnike të promovohen në mediet sociale. Në të vërtetë, mediet sociale janë mjete ideal për miratimin dhe popullarizimin e kauzave të ndryshme si p.sh., dhurimi për të sëmurët me kancer apo arsye të tjera. Jo vetëm që kushdo mund t'i përdorë mediet sociale për t'u ndihmuar të tjerëve financiarisht, por shërben gjithashtu edhe si mënyra më e thjeshtë dhe më e shpejtë për t'i dhënë hov kauzave të vlefshme’.

- Efektet negative të përdorimit të medieve sociale

Përsa u përket efekteve negative të përdorimit të medieve sociale është e pashmangshme t'u rikthehemi edhe një herë shumë prej detajeve të përmendura në temën pararendëse, veçse këtë herë për të vënë në dukje anë të tjera të tyre. Së paku, të tilla janë mendimet e pjesëmarrësve.

L ndër të tjera shprehet: *“Poston njeriu i shkretë, nxjerr gjana t'bukra normal se nuk nxjerr kush gjana keq. Vedin nuk e nxjerr kush siç nuk don me e pa t'tjert dhe ndihesh mirë. Mandej veç, kur t'kujtohet ku*

¹¹ Tuz Sierra, M., Olmedo Vela, M., Luna Rodrigues, I., Perez Aranda, G., Estrada Carmona, S., Garci Reyes, L. & Pacheco Quijano, L. V. (2020). Meaning of life and the use of social networks in three stages of development. *International Journey of History and Philosophical Development*, 8(2), 1-10. ISSN 2055-0049

¹² <https://ëëë.simplilearn.com/real-impact-social-media-article>

je...se nuk asht krejt ashtu dmth...nuk asht se e vras mendjen fort dmth se n'fund t'fundit tanë kanë gjana t'mira e t'kqia, por që t'i bjen ndërmend edhe kto dmth".

Sipas D *"Ka raste që humb cilësia e bisedës në whatsapp. Flet sa flet njeriu po ka diçka. Tanë e dimë se, nuk asht njisoj si me e pasë afër tjetrin, edhe nase janë njerz t'afërt. As me t'afërtit nuk flitet njisoj si me i pasë afër. Deri në një pikë mund t'shkojë biseda".*

Një artikull i Jiang dhe kolegëve¹³ në fokus të të cilit janë efektet e cilësisë së informacionit konstaton se cilësia e informacionit lidhet me cilësinë e përmbajtjes, atë të shprehjes dhe të dobisë. Megjithëse studimi i tyre është vënë në kontekstin e studimeve tregtare, thelbi qëndron te cilësia e informacionit. Mesa duket distanca i bën të pasigurt njerëzit për sasinë dhe llojin e informacionit që mund t'u transmetojnë të tjerëve.

F reflekton kështu: *"Pak postoj. Dhe kur postoj e baj për të nxjerrë ndonjë gja pune, ndonjë lajm, diçka që m'pëlqen. edhe për të afërmit baj ndonjë urim...për festa baj ndonjë urim. M'pëlqen me postu kajherë gjana ma personale, ndonjë kujtim, me shkru ndonji detaj ma personal, por e baj në status whatsapp, nuk postoj në facebook që kam pesëqind shokë. M'pëlqen me rujtë njëfarë misteri dhe media sociale asht e keqe për ktë gja".*

M thotë se e neverisin lajmet fallco dhe pamjet e modifikuara. *"Shife kte për shembull. Veç si njeri nuk duket".*

R ka këtë mendim: *"Në facebook shkrun gjithkush. Nase nuk shkrun me emrin e vet e ban me një emër fallco, biles as emër hiç nuk asht. Përdor gjithfarë fjalori, herë me fjalë rruge, herë ngacmues, herë tinëzar, herë i rëndë, herë i maskum. Kur nuk m'prekin i lexoj për gallatë disa raste, t'tjera s'i lexoj hiç, por, kur m'prekin normal që nuk m'pëlqejnë".*

Olan dhe kolegët¹⁴ shprehen: *"Lajmet e rreme po i ndikojnë në mënyrë të vazhdueshme vlerat e shoqërive, po i ndryshojnë mendimet mbi çështjet dhe temat e rëndësishme dhe po i ripërcaktojnë faktet, të vërtetat dhe besimet... Rezultatet tona tregojnë ndarje të shoqërisë (për shkak të përhapjes së lajmeve të rreme në mediet sociale). Në tërësi, studimi ynë, tregon sesi përhapja e lajmeve të rreme në mediet sociale po i disintegron shoqëritë dhe përfundimisht po i zëvendëson lajmet e vërteta*

¹³ Jiang, G., Liu, F., Liu, W., Liu, S., Chen, Y. & Xu, D. (2021). Effects of information quality on information adoption on social media review platforms: moderating role of perceived risk. *Data Science and Management*, 1(1), 13-22.
<https://doi.org/10.1016/j.dsm.2021.02.004>

¹⁴ Olan, F., Jayawickrama, U., Arakpogun, E.O. et al. (2022). Fake news on social media: the Impact on Society. *Inf Syst Front* <https://doi.org/10.1007/s10796-022-10242-z>

me ato të rreme”.

Më interesante ndër të gjithë duket komenti i M që shprehet: *“Nuk m’pëlqejnë. Ma shumë ‘jo’ se ‘po’ dmth. Nuk m’pëlqejnë se t’gozhdojnë pa dasht me u gozhdë...dhe aq sa i kanë afër njerzit që janë larg, aq i kanë largu njerzit që janë afër. Edhe njerzit e shpisë biles”.*

Edhe E ka një koment me plot mendim. Sipas saj: *“Media sociale në disa raste i rrit artificialisht kërkesat dhe standardet”.*

E vërteta është se gjatë hulumtimit të literaturës së studimit, studiuesja nuk ka mundur të gjejë të shtjelluar në mënyrë specifike këtë efekt të medieve sociale. Kësisoj edhe në pastë studime që trajtojnë këtë efekt, ato janë të pakta, ndërkohë që kjo çështje përbën interes studimor më vete. Bengtsson & Johanson¹⁵tërthorazi përmendin se mediet sociale lidhen jo vetëm me dimensione makro, por po ashtu edhe me disa ndryshime që prekin praktikën e jetës së përditshme. Megjithatë, nuk vendosin fokus të posaçëm mbi këtë çështje.

- *Krahasimi mes komunikimit online dhe atij tradicional*

Përgjigjen më gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht më të përmbledhur e ka dhënë F e cila shprehet se *“Komunikimi online ka kriju lehtësi të mëdhaja, ta shprehim siç asht, flet me ke don, kur don, nuk ke nevojë me ba shumë përgatitje për veten. Kushedi sa herë kam ndërru bluzën dhe kam pasë veshë tuta shpije, po nuk asht thjesht veshja. Për krejt paraqitjen ke ma pak shqetsim. Gjithçka dallohet ma pak se ballë përballë. Por kjo asht njena anë. A të sjell përnjimend afër komunikimi online? Nuk e di. Nuk jam e sigurtë. Nëse nuk du me iu përgjigjë dikujt nuk përgjigjem. Asht e thjeshtë puna. Njisoj si në komunikimin ballë përballë. Nëse nuk du nuk shkoj. Biles po të jap një shembull tjetër. Nëse marr nje mesazh, ose merr dikush prej meje se kjo më ka ndodhë dhe nuk don me u përgjigjë...asht ma keq, kur e shef tjetrin online dhe mesazhi që i ke shkru asht i pahapun. Kjo asht ashiqare që nuk don me u përgjigjë. Kurse ballë përballë të paktën kur i thu diçka, ose i ke shkru diçka dhe nuk të asht përgjigje mundesh me folë drejtpërdrejt dhe e vë në pozitë tjetrin ma shumë. Kurse kshu...nuk e di...”.*

Edhe E shpreh një mendim të ngjashëm, kur thotë se *“Shmang bisedën me kë nuk du ma lehtë se në komunikimin ballë përballë në disa raste. Ka raste, kur ndodh e kundërta”.*

¹⁵ Bengtsson, S., & Johansson, S. (2022). The Meanings of Social Media Use in Everyday Life: Filling Empty Slots, Everyday Transformations, and Mood Management. *Social Media + Society*, 8(4). <https://doi.org/10.1177/20563051221130292>

Studimi i Danielsbacka dhe kolegëve¹⁶ i zbatuar në një popullatë të gjerë finlandeze ka konkluduar se mjetet digjitale të komunikimit, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe mediet sociale, e përforcojnë komunikimin tradicional dhe nuk e zëvendësojnë atë. Megjithatë duhet sqaruar se studimi i tyre ka patur në fokus marrëdhëniet me të afërmit. Kësisoj, në kërkimet e ardhshme do të ishte e vlefshme përsëritja konceptuale e studimit të lartpërmendur.

- *Mirëqenia emocionale dhe mendore*

Në lidhje me këtë temë, përgjigjet e pjesëmarrësve janë të ndara më dysh. Një pjesë e tyre, si p.sh., D pohojnë se media sociale nuk ka kurrfarë ndikimi në jetën e tyre. “Unë - shprehet D - ia kam lanë Zotit n’dorë gjithçka, sepse ai më ka kriju në formën ma t’mirë t’mundshme”.

Ndërkaq F ka një mendim të ndryshëm. Sipas saj: “Media sociale ka sjellë një lloj varësie. Dhe unë e lidhi këtë me kuptimin mbi jetën, sepse, kur imagjinoj sesi mund t’ishite jeta pa mediat sociale tash që e dimë sesi janë, si funksionojnë, e kuptoj që pa to jeta jeme do të kishte një lloj zbrazëtie, boshllëku. Dhe imagjinoje që unë nuk jam ndër mjerzit që e përdorin pa limit. Asht një lloj varësie që na ban me kërk lidhje me t’jtjet dhe vlersim përmes përdorimit t’mediave sociale.

Varësia ndaj medieve sociale është një shqetësim bashkëkohor që ka prekur çdo shoqëri ku mediet sociale njihen dhe përdoren lirisht. Mbështetur në të dhënat që sjell ky studim dhe në arsyetimin logjik mund të pohojmë se Shqipëria nuk përbën përjashtim, por statistikat mungojnë. Në Shtetet e Bashkuara vlerësohet se 5 -n 10% e popullsisë ka varësi¹⁷. Varësia ndaj medieve sociale përfshin ndryshimin e humorit, shqetësim të posaçëm për përdorimin e medieve sociale, shtimin e vazhdueshëm të kohës së përdorimit, pakënaqësi në rast kufizimi ose ndalimi të përdorimit, konflikte ndërpersonale për shkak të përdorimit të ekzagjeruar të medieve sociale dhe gjendje relakse për shkak të rifillimit të përdorimit të ekzagjeruar edhe në rastet, kur përdoruesi bën pauzë të përkohshme.

Alenezi dhe kolegët¹⁸ në një studim me një kampion të përbërë vetëm nga femra, kanë zbuluar se ndonëse varësia ndaj facebook nuk e

¹⁶ Daneshwar, Sharma. (2023). Developing Self-Efficacy in Public Speaking Using Video and Digital Oratory on YouTube. *Business and Professional Communication Quarterly*, 86(2), 146-166.

¹⁷ <https://www.addictioncenter.com/drugs/social-media-addiction/>

¹⁸ Alenezi, A., Hamed, W., Elhehe, I. & El – Etreby, R. (2023). Association between facebook addiction, depression and emotional regulation among women. *Healthcare*, 11(12). <https://doi.org/10.3390/healthcare11121701>

kalonte një të tretën e kampionit, tek ato që ishin prekur nga varësia rregullimi emocional luante një rol përcaktues. Sa më e pakët aftësia për rregullim emocional, aq më e fortë shfaqej varësia.

Marrëdhënie mes medieve sociale dhe mirëqenies emocionale dhe mendore sheh edhe M që pranon se *“Veçanërisht whatsapp dhe viber për pak kohë, më kanë shtu ankthin. Kto kanë kriju një ndjenjë kontrolli mbi tjetrin, një nevojë me ditë ku asht tjetri...fëmija, partneri...dhe një ankth t’madh, kur nuk marrim përgjigje. Mirëpo deri para 10 – 15 vjetësh ku kanë kenë këto? S’kanë kenë dhe për bukuri jena marrë vesh. Tashti jo! Tash ka ndryshu. Dhe kjo nuk asht gja e mirë. Kjo sjell ato ndikimet që thu ti (intervistuesja ka drejtuar një pyetje për ndikimin e medieve sociale në cilësinë e jetës).*

R reflekton në këtë mënyrë: *“M’ban përshtypje që njerzit edhe vetvetiu, kur duhet me dhanë një përgjigje, kur iu kërkohet diçka, shpeshherë nuk përgjigjen me fjalë, por nisin foto. Psh, ‘ku je’ nuk merr përgjigje me fjalë, por vjen një fotografi. Kjo kajherë mund t’ëjetë për me i ra shkurt bisedës, por avash avash asht kthy në nevojë për me vërtetu veten njeriu. Po pse, kur nuk ishin këto, mos ishim ma pak të ndershëm? Dhe mos u bame ma shumë tash? Nuk m’duket se ka ma shumë sinqeritet veç ça të ketë ma pak. Pra, edhe ka shtu kontrollin artificialisht që për mu nuk ka afekt realisht, edhe bezdisjen për këto punë dhe...ku di unë thjesht ka sofistiktu metodat e rrenave për ato që rrejnë se...kur t’mos jem afër e të mos e shof tjetrin me këto metodat tjera manipuloj si t’kem qejf, sidomos po e pata të nevojshme. Asht stresuse dhe acaruse kjo gja”.*

Një meta-analizë e kohëve të fundit e Shannon dhe kolegëve,¹⁹ që shqyrtonte studime të mëparshme me të rinj, ka vërtetuar dhe një herë ato gjetje që u përmendën në gjetjet origjinale të këtij studimi dhe në citimet përkatëse: ekziston një korrelim pozitiv mes përdorimit të medieve sociale dhe shëndetit mendor e rrjedhimisht edhe emocional të përdoruesve. Kësisoj, duket se gjetjet studimore janë të një linje. Media sociale ka aftësinë ta cënojë mirëqenien tonë mendore dhe emocionale. Kjo nuk lidhet specifikisht vetëm me përdorimin e tepruar, por natyrshëm, sa më i madh përdorimi aq më të mëdha janë shanset që diçka e tillë të ndodhë. Sidoqoftë nevojiten studime të reja për të vërtetuar faktorët që ndikojnë në krijimin e këtyre shqetësimeve te një pjesë e përdoruesve ndërkohë që pjesa tjetër nuk ndikohet njësoj.

¹⁹ Shannon, H., Bush, K., Villeneuve, P.J., Helleman, K.G. & Guimond, S. (2022). Problematic Social Media Use in Adolescents and Young Adults: Systematic Review and Meta-analysis. *JMIR Ment Health*, 9(4). doi: 10.2196/33450

KONKLUZIONE

Së pari, studiuësja ka vendosur ta ndërmarrë këtë studim duke qenë në dijeni të faktit se në vendin tonë kjo fushë është studiuar fare pak dhe për më tepër edhe studimet ekzistuese nuk promovohen sa duhet duke e mbajtur njësoj të kufizuar informacionin lidhur me temën në fjalë.

Së dyti, studimi është realizuar pas konsultimit të gjetjeve të literaturës së viteve të fundit në mënyrë që të përcaktoheshin objektiva sa më në përputhje me këto gjetje.

Nga temat e identifikuar në studim shquhet qartë fakti se ndikimi i medieve sociale në jetën e përditshme të pjesëmarrësve është i shumanshëm. Po kaq të larmishme janë edhe arsyet e përdorimit të tyre. Pjesëmarrësit shprehen se disa prej këtyre arsyeve mund të sjellin efekte pozitive, ndërsa e cilësojnë negativ efektin e arsyeve të tjera. Ka raste në të cilat pjesëmarrësit çmojnë se e njëjta formë ndikimi karakterizohet si nga efekte pozitive po aq edhe nga efektet negative.

Shumica prej tyre janë të njohura në literaturën e fushës. Ndër gjetjet më pak të njohura në studimet e fushës me të rritur janë vlerësimi i medieve sociale si mënyrë intime e komunikimit, argëtimit, marrjes së informacionit etj., si dhe dyshimi i ngritur nga një pjesë e pjesëmarrësve në lidhje me faktin nëse media sociale ka sjellë vërtet më afër njerëzit me njëri - tjetrin, apo jo.

Shumica e gjetjeve janë të ngjashme me gjetjet e studimeve pararendëse dhe mund të krahasohen lehtësisht me literaturën bashkëkohore ndërkombëtare. Ndërkaq ekzistojnë edhe të tjera që jo doemos përputhen me gjetjet ndërkombëtare të fushës. Thënë ndryshe, studimi vërtetoi se përdoruesit shqiptarë ngrenë të njëjtat çështje e tema si përdoruesit e të gjithë botës, por disa gjetje ndryshojnë nga linja kryesore e gjetjeve në studimet ndërkombëtare.

BIBLIOGRAFIA

- Alenezi, A., Hamed, W., Elhehe, I. & El – Etreby, R. (2023). Association between facebook addiction, depression and emotional regulation among women. *Healthcare*, 11(12). <https://doi.org/10.3390/healthcare11121701>
- Bengtsson, S., & Johansson, S. (2022). The Meanings of Social Media Use in Everyday Life: Filling Empty Slots, Everyday Transformations, and Mood Management. *Social Media + Society*, 8(4). <https://doi.org/10.1177/20563051221130292>
- Carrotte, E.R., Prichard, I. & Lim, M.S. (2017). "Fitspiration" on social media: A Content Analysis of Gendered Images. *J Med Internet Res*, 29(3). doi: 10.2196/jmir.6368.
- Cheng, J., Burke, M. & de Gant. B. (2020). Country Differences in Social Comparison on social media. *J. ACM*, 1(1). <https://doi.org/10.1145/1122445.1122456>
- Daneshwar, Sharma. (2023). Developing Self-Efficacy in Public Speaking Using Video and Digital Oratory on YouTube. *Business and Professional Communication Quarterly*, 86(2), 146-166.
- Jiang, G., Liu, F., Liu, W., Liu, S., Chen, Y. & Xu, D. (2021). Effects of information quality on information adoption on social media review platforms: moderating role of perceived risk. *Data Science and Management*, 1(1), 13-22. <https://doi.org/10.1016/j.dsm.2021.02.004>
- Johnson, B. K. (2021). Look up, look down: Articulating inputs and outputs of social media social comparison. *Journal of Communication Technology*, 4 (1), 28- 53. <https://doi.org/10.51548/joctec-2021-003>
- Kaplan, A.M. & Haenlein, M (2010), Users of the world, unite! The challenges and opportunities of social media. *Business Horizons*, 53(1).
- Meier, A. & Johnson, B. K. (2022). Social Media Use, Stress and Copping. *Current Opinion in Psychology*. 45. <https://doi.org/10.1016/j.copsyc.2022.101305>
- Olan, F., Jayawickrama, U., Arakpogun, E.O. *et al.* (2022). Fake news on social media: the Impact on Society. *Inf Syst Front* <https://doi.org/10.1007/s10796-022-10242-z>
- Shannon, H., Bush, K., Villeneuve, P.J., Hellemans, K.G. & Guimond, S. (2022). Problematic Social Media Use in Adolescents and Young Adults: Systematic Review and Meta-analysis. *JMIR Ment Health*, 9(4). doi: 10.2196/33450
- Tuz Sierra, M., Olmedo Vela, M., Luna Rodrigues, I., Perez Aranda, G., Estrada Carmona, S., Garcia Reyes, L. & Pacheco Quijano, L. V. (2020). Meaning of life and the use of social networks in three stages of

development. *International Journey of History and Philosophical Development*, 8(2), 1-10. ISSN 2055-0049

- Willig, C. (2008). *Introducing qualitative research in psychology*. Second Ed. Open University Press.
- Wolfers, L. N & Ytz, S. (2022). Social Media Use, Stress and Copping. *Current Opinion in Psychology*. 45.
<https://doi.org/10.1016/j.copsy.2022.101305>
<https://www.simplilearn.com/real-impact-social-media-article>
<https://www.addictioncenter.com/drugs/social-media-addiction/>

MINDSET AND MENTAL HEALTH

Arjeta Pelinku

Punonjëse Sociale

ABSTRACT

When we talk about humans, very often we define them as homo sapiens; wise men or men who thinks.

Since the key to mental health, our perspectives, and the way we evaluate different situations is related to the way we think, preserving mental health is the key stone to support growth. There is where it stands the importance of mental health as part of our lives and development. The aim of this research is to explore the importance of parent's mentality and how it affects and shapes the children's mentality, very often by passing on their trauma.

At the same time this research aims to bring into light the difficulties social workers go through while trying to access the parents of these children.

This study intends to describe etymologically the concept of mentality bringing into light the definitions of it.

It also aims to identify the most common mental health problems in teenagers, exploring the impact that the parent's mentality has on children's mental health and how it affects their growth, bringing in solutions and suggestions on how social workers can bring in/develop new perspectives in this actual problem.

To conduct this study is used the qualitative methodology of scientific research.

The literature is made of compilation of articles, studies, books and scientific articles from different experts in the field of psychology and other fields directly and indirectly linked to the topic of the research, and participatory observation.

The study concludes that the way how teenagers think is affected by their parent's mindset.

Most of the parents are concerned about their children's grades more than their mental and emotional health forgetting to teach them human values, emotional intelligence, and self-control. Pressure for grades causes frustration, anxiety, depression, low self-esteem, emotional problems, etc, in youth, causing decrease of their performance in different fields.

It is often said that mindset is the key to shaping the perspective from which we see the glass of water; and indeed, it is.

Parent's Mindset plays a key role in creating mental health problems in children and teenagers.

Social workers have a special role in helping kids and families with the way they shape their mindsets. Social workers should be more involved in the processes that have to do with education in our country. Parents must be the main focus of the work being done by the social workers, so the problem can be examined from the roots. Nowadays mindset and mental health must be treated with the proper importance so that we can raise young people with mentally healthy mindsets.

Kids should not be defined by their grades but from their core values and skills.

Keywords: Mindset, mental health, kids, parents, social workers, values.

Mendësia dhe shëndeti mendor

ABSTRAKT

Kur flasim për njerëzit, shumë shpesh i përkufizojmë si homo sapiens, njerëz të mençur ose njerëz që mendojnë.

Meqenëse çelësi i shëndetit mendor, perspektivat tona dhe mënyra se si vlerësojmë situatat të ndryshme lidhet me mënyrën se si mendojmë, ruajtja e shëndetit mendor është çelësi që mbështet rritjen. Këtu qëndron rëndësia e shëndetit mendor si pjesë e jetës dhe zhvillimit tonë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të eksplorojë rëndësinë e mentalitetit të prindërve dhe se si ai ndikon dhe formon mentalitetin e fëmijëve, shumë shpesh duke ia kaluar fëmijëve traumën e tyre.

Në të njëjtën kohë ky hulumtim synon të nxjerrë në dritë vështirësitë që kalojnë punonjësit socialë gjatë përpjekjes për t'iu qasur prindërve të këtyre fëmijëve.

Ky studim synon të përshkruajë etimologjikisht konceptin e mentalitetit duke nxjerrë në dritë përkufizimet e tij.

Ai synon gjithashtu të identifikojë problemet më të zakonshme të shëndetit mendor tek adoleshentët, duke eksploruar ndikimin që ka mentaliteti i prindërve në shëndetin mendor të fëmijëve dhe se si ai ndikon në rritjen e tyre, duke sjellë zgjidhje dhe sugjerime se si punonjësit socialë mund të sjellin/zhvillojnë perspektiva të reja nga ky problem aktual.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metodologjia cilësore e kërkimit shkencor.

Literatura përbëhet nga përmbledhja e artikujve, studimeve, librave dhe artikujve shkencorë nga ekspertë të ndryshëm të fushës së psikologjisë dhe

fushave të tjera të lidhura drejtpërdrejt dhe indirekt me temën e hulumtimit dhe vëzhgimi me pjesëmarrje gjithashtu është përdorur si metodologji.

Studimi arrin në përfundimin se mënyra se si mendojnë adoleshentët ndikohet nga mendësia e prindërve të tyre.

Shumica e prindërve janë më shumë të shqetësuar për notat e fëmijëve të tyre sesa për shëndetin e tyre mendor dhe emocional, duke harruar t'u mësojnë atyre vlerat njerëzore, inteligjencën emocionale dhe vetëkontrollin. Presioni për notat shkakton zhgënjim, ankth, depresion, vetëbesim të ulët, probleme emocionale etj., tek të rinjtë duke shkaktuar ulje të performancës së tyre në fusha të ndryshme.

Thuhet shpesh se mendësia është çelësi për të formuar këndvështrimin nga i cili shohim gotën e ujit; dhe me të vërtetë, është.

Mendësia e prindërve luan një rol kyç në krijimin e problemeve të shëndetit mendor tek fëmijët dhe adoleshentët.

Punonjësit socialë kanë një rol të veçantë për të ndihmuar fëmijët dhe familjet me mënyrën se si ata formësojnë mentalitetin e tyre. Punonjësit socialë duhet të përfshihen më shumë në proceset që kanë të bëjnë me arsimin në vendin tonë. Prindërit duhet të jenë fokusi kryesor i punës së punonjësve socialë në mënyrë që problemi të shqyrtohet nga rrënjët. Në ditët e sotme mendësia dhe shëndeti mendor duhet të trajtohen me rëndësinë e duhur në mënyrë që të rrisim të rinj pa probleme të shëndetit mendor.

Fëmijët nuk duhet të përcaktohen nga notat e tyre, por nga vlerat dhe aftësitë e tyre thelbësore.

Fjalë kyçe: Mendësi, shëndet mendor, fëmijë, prindër, punonjës socialë, vlera.

Introduction

Mindset and Mental health

While talking about humans, we are referred to very often as homo sapiens, which can be interpreted as 'the man who thinks', which is at the same time the key concept to mental health. The different perspectives we have on different situations in life, the way we perceive them play a key role in determining our mental state. It is already a proven theory that reasoning and the ability to think are what set us apart from other species; furthermore, it is a natural continuous activity where we mostly engage involuntarily, but, at the same time, we are highly influenced by a set of factors affecting us, our way of thinking, and our mental sorrow, calmness, aggression, action, and inaction.

In this article, we will summarize our research on how mindset, or the way

we think, affects the mental health of teenagers aged 12-18, with a focus on the perspective of social workers who work in schools with this target group.

At the same time, we will try to bring light to the topic by connecting it with their parent's 'way of thinking' emphasizing the importance of education.

The article will conclude with some recommendations based on my personal experience of working with this target group for seven months.

Through this article, we want to provide a summary of our research on how mindset-the way we think affects our mental health, focusing on teenagers from 12-18 years old.

The view of social workers as having this target while working in schools.

In the end, the article is enriched with relevant recommendations based on my personal perspective from working with this target for 7 months.

1.1 Purpose

- a. Researching the importance of how a parent's mentality/way of thinking affects children's mentality/way of thinking, causing generational trauma.
- b. Bring light to the challenges social workers go through while working with the parents of these children.
- c. Discuss the possible solutions to the problem.

1.2 Objectives

1. Providing a comprehensive overview of the concept of mentality.
2. Recognizing the main health issues among teenagers
3. Investigating the influence of parental mentality on children's mental health
4. Provide new perspectives on the current situation that can lead to potential solutions.

1.3 Research questions

1. What is Mindset?
2. What are the factors that contribute to a fixed mindset?
3. How does mindset affect the mental health of children?

1.4 Methodology

This study is mainly based on a qualitative scientific research methodology, where the subjects are books and scientific articles written by renowned authors in the fields of psychology and self-development, available both

online and offline.

The research process has involved the following stages:

1. Conducting literature research relevant to the study's research questions
2. Reading and reflecting on the literature
3. Identifying responses and solidifying the concepts
4. Conclusion

It is worth noting that the literature selection has been done based on criteria such as relevance, reliability, and topicality.

2. Findings and Discussions

2.1 Mindset definition

The term mindset refers to a set of beliefs that shape an individual's perception of themselves and the world around them, influencing their thoughts, feelings, and behaviors in any given situation.

According to Dweck, there are two primary mindsets- the fixed mindset, and the growth mindset. People with a fixed mindset believe that their abilities are fixed traits, innate and cannot be changed. They might, at the same time, believe that talent and intelligence are factors that contribute to their growth and success without any effort required for them. (O'Keefe et al., 2018) On the other side, people with a growth mindset believe that their talents and abilities can be developed over time with effort and persistence. People with this mindset do not necessarily believe that everyone can become Einstein or Newton just because they try. However, they believe that everyone can become smarter or more talented if they work at it.

But, how is the mindset formed? Dweck's research highlights two main factors: praise and labeling, both of which occur during early childhood. (Dweck & Yeager, 2019)

In a series of crucial experiments, Dweck and her colleagues discovered that children responded differently to praise based on its type. Praising a child's personal characteristics or labeling them as 'smart' reinforces a fixed mindset, giving them the message that they either have a skill or not, and they cannot do anything to change this reality.

While praising is a process that emphasizes the effort of a person to complete a task, attributing success to their persistence and strategy, which can be both controlled and improved over time.

In my work with teenagers, I have observed that my target group had a similar experience. The fixed mindset was reinforced by their parents' mentality and the school system, at the same time, unfortunately leading to various mental health consequences.

The impact of a fixed mindset on teenager's mental health

Mindset plays a crucial role in how an individual approaches life's challenges.

Through my work with teenagers, I have observed that a fixed mentality can impact them in various ways, including:

- *Avoidance of difficult tasks*
- *Belief that skills and knowledge cannot be improved.*
- *Feeling threatened by others' success and by their own thoughts.*
- *Fear of failure.*
- *Having a bad image of themselves.*
- *Having low self-esteem and self-confidence.*
- *They have low self-confidence.*
- *They have difficulty setting goals and establishing objectives, so they are not able to have a routine and fulfill their goals.*
- *Lack of self-love, among other things.*

The difficulties social workers go through by working with this fixed mindset target group are:

As social workers, our role involves both working with parents and teachers while also gaining an understanding of how teenagers' thought patterns impact their lives, mental health, and academic performance.

However, our main challenge is working with parents who often exhibit a fixed mindset while being unwilling to collaborate in creating positive changes for their children. Very often, you can observe them prioritizing their children's achievements while lacking knowledge about their child's emotions, feelings, and thoughts. In these cases, when we try to convey a full picture of the whole situation, they are not reluctant to accept it or cooperate.

Therefore, in my opinion, the main challenge for social workers nowadays is working with the parents of teenagers.

The second challenge is working with the teachers for the same reasons mentioned above, which are the demonstration of a fixed mindset and the lack of interest in understanding their students' thoughts, emotions, feelings, and mental health. As a result of this, they are not informed about the whole situation, and at the same time, they don't show any interest in collaborating with us, the professionals, becoming an obstacle to offering fresh perspectives on improving the teenagers' thought patterns, which can seriously impact their academic achievements.

Our third challenge is working with the teenagers themselves, where changing patterns deep-seated in their mindsets for years by individuals with fixed mindsets (including parents, teachers, etc.) is very difficult.

The fourth, but not the least, is the school system itself, which poses another challenge as the limited resources and time available to the professionals, besides the numerous assignments and administrative work, do not give them the required space to take care of the cases as needed.

How can School Social Workers impact the whole structure?

- 2022-2023 marks the first time that we, as social workers, can provide our services to children, teenagers, parents, and teachers.
- While we cannot perform miracles, we can do our best and try to change these teenagers' fixed mindsets to a growth mindset.
- Based on my experience, I can say that a significant part of this change will come as a result of working collaboratively with their parents and teachers.
- Creating support groups and referring the right people to the right services is key to a positive impact.
- Showing love and care and creating a safe environment are crucial.
- Praising the teenagers for their achievements and teaching them human values is one of the main steps toward self-growth.
- By following these steps, we can bring new perspectives to the growth mindset while, at the same time, helping them have good mental health.

2.2 The fixed mentality and how it affects mental health in teenagers.

In the previous sections, I briefly discussed how mindset is formed and how parents, friends, schools, communities, society, and especially the media (with the role models it offers) play crucial roles in shaping an individual's perspective.

Individuals with a fixed mindset always assume that their abilities are innate and impossible to change, leading them to non-adaptive responses to negative life events that often lead to mental health problems. (Yeager & Dweck, 2023)

This mindset, at the same time, can result in a lack of willingness to learn and difficulty identifying and managing emotions and behaviors. Teenagers with a fixed mindset very often lack enjoyment in the process, and they are not able to figure out how they feel in various circumstances. (Lai et al., 2022) Another negative impact, and the main one, is the unconscious contribution the fixed mindset has to mental health, such as facing problems like anxiety, symptoms of depression, low self-confidence and

self - esteem, etc.

At the same time, it prevents them from seeking help, due to concerns about others' opinions. The belief that asking for help from a psychologist or a social worker is very often associated with 'being crazy, is unfortunately still prevalent among parents, teachers, and teenagers too.

2.3 The impact of the growth mindset

Mindset plays a crucial role in how one approaches life's challenges. A child with a growing mentality, tends to possess a hunger for learning, a desire to work hard, and a willingness to discover new things, which often translates into academic achievement. Furthermore, children with a growing mentality are better at managing their emotions, have higher self-control, and are hardworking. They believe that their abilities develop and change over time and that they can be improved through effort, leading to positive emotions, behaviors, and overall happiness.

2.4 Discussion Limitations of the Study:

During the course of my research journey focused on mindset and its intricate relationship with teenagers' mental health, I came across several noteworthy limitations that warrant acknowledgement. It's crucial to recognize that the insights I've gathered are based on my seven months of hands-on experience with this specific group. While this experience has provided valuable insights, it's important to keep in mind that it might not fully encompass the breadth of experiences and perspectives across all teenagers, parents, and educators. The diverse range of cultural backgrounds, economic circumstances, and geographical locations can lead to varied interpretations of the issues.

Furthermore, I must admit that my role as a social worker has inevitably influenced my observations. While these personal insights add depth, they also introduce an element of subjectivity. To enhance the rigor of the study, incorporating input from other social workers, educators, and industry experts would have provided a more comprehensive and unbiased view of the topic.

Lastly, my research primarily relies on qualitative methodologies, drawing from sources such as literature, articles, and my own observations. While this qualitative approach offers depth and context, it might not provide the quantitative precision necessary to establish definitive causal relationships and make broad generalizations.

Potential Future Research Directions:

Moving forward, the exploration of this dynamic field creates promising

new paths for exploration that might bring more understanding of the topic in the future. One intriguing direction involves initiating long-term studies to comprehend how shifts in mindset impact teenagers' mental health over extended periods. This approach could provide valuable insights into the enduring effects of nurturing a growth-oriented perspective.

Another avenue worth exploring is the influence of cultural nuances on mindset, mental health, and the challenges confronted by social workers and educators. Understanding how cultural factors contribute to the perception of mindset and its link to mental health outcomes could uncover invaluable insights into tailoring interventions to specific contexts.

Quantitative methodologies can also offer insights. Employing tools such as surveys or experimental designs would enable the collection of data that could offer more concrete insights into the intricate relationships between mindset, mental health, and an array of influencing factors.

To make a tangible difference, the development and assessment of programs designed to educate parents about mindset and its implications for their children's mental health hold immense promise. Such initiatives could foster more informed and supportive parenting practices that contribute to the nurturing of healthier mindsets.

Collaborative efforts also present another path of exploration. Drawing expertise from psychology, sociology, education, and other disciplines could offer a well-rounded and holistic understanding of the multifaceted factors influencing mindset and mental health.

Lastly, comparative studies across diverse educational systems could yield valuable insights into how different educational approaches and societal contexts shape mindset development and subsequent mental health outcomes.

Through addressing these limitations and pursuing these future research directions, we can hope to obtain a deeper, more nuanced understanding of the complex interplay between mindset and mental health among teenagers. As a result, this could help teachers and social workers plan for the best possible outcomes for their students' all-around growth.

3. CONCLUSION

- Research shows mindset is a key concept influencing our lives and has a very significant impact on them.
- Understanding, adjusting, and shifting our attitude can help you improve your mental health, reduce stress, and become better able to handle life's challenges.

Distinguishing between a fixed and growth mindset is crucial for this

- purpose, as is being aware of its impact on mental health.
- Focusing on shifting your way of thinking towards developing a growing mindset is very important. It is not how much you think, it is all about the way you think.
- Teenagers' way of thinking is deeply affected by their parents and educators' mindsets, therefore, incorporating, and un-fixing these mindsets is a long-term challenging process that should be taken seriously.

A way we can unfix a fixed Mindset is by:

- Focus on the journey.
- Incorporating "yet."
- Paying attention to words and thoughts.
- Taking on challenges.

S.T.A.L.L

- Stop - Take turns - Accept - Listen - Love

4. RECOMMENDATIONS

- It is of high significance to be aware of the factors that influence the mindsets of teenagers and to support them in adopting a growth mindset in order to favorably impact their mental health.
- Developing targeted programs for both parents and educators so that we can bring a whole new perspective to the circumstances that now exist.
- Developing brand-new programs for social welfare with a particular emphasis on young people and children
- In order to shift the fixed mindsets of parents and teachers into development mindsets, we need organized focus groups with these groups of people.
- Improving the position of the social worker so that we can get a better handle on working with these specific groups of people.

REFERENCES

- O'Keefe, P. A., Dweck, C. S., & Walton, G. M. (2018). Implicit Theories of Interest: Finding Your Passion or Developing It? *Psychological Science*, 29(10), 1653–1664. <https://doi.org/10.1177/0956797618780643>
- Dweck, C. S., & Yeager, D. S. (2019, February 1). Mindsets: A View From Two Eras. *Perspectives on Psychological Science*, 14(3), 481–496. <https://doi.org/10.1177/1745691618804166>
- Yeager, D. S., & Dweck, C. S. (2023, February 17). *Mindsets and adolescent mental health - Nature Mental Health*. *Nature*. <https://doi.org/10.1038/s44220-022-00009-5>
- Lai, X., Nie, C., Huang, S., Li, Y., Xin, T., Zhang, C., & Wang, Y. (2022, March 12). *Effect of Growth Mindset on Mental Health Two Years Later: The Role of Smartphone Use*. MDPI. <https://doi.org/10.3390/ijerph19063355>

TË NXËNËT BASHKËPUNUES NË ARSIMIN E LARTË NËPËRMJET WIKIS- RAST STUDIMOR

Gerda Sula, Shqipe Haxhihyseni

Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, Fakulteti i Edukimit, UAMD

ABSTRAKT

Ky studim hulumton efektivitetin e Wikit në formimin e mësuesve të ardhshëm dhe implikimet pedagogjike, me qëllim përcaktimin e ndikimit të wikit në përvojat e të nxënësve dhe në rezultatet e të nxënësve tek studentët e Masterit shkencor Mësuesi në gjuhët e huaja, Universiteti i Tiranës. Për këtë, studentëve iu kërkua të përmirësonin ose të shtonin një artikull wiki që lidhet me të nxënësve në Wikipedia, në shqip ose në gjuhë të huaj.

Për përpunimin e të dhënave dhe daljen në konkluzion në këtë hulumtim u përdor metoda mikse. Gjetjet e studimit u nxorën nga triangulimi i të dhënave: (1) u analizuan wiki-t që studentët përmirësuan apo krijuan, (2) u analizuan reflektimet e studentëve mbi përvojën dhe (3) u krahasuan rezultatet e të nxënësve bazuar në provimet përfundimtare të grupit të studentëve, që ishin pjesëmarrës në vitin akademik kur u kërkua hartimi i wiki si detyrë, me studentët e të njëjtës lëndë në vitin e mëparshëm akademik.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë dëshmi bindëse në favor të wiki, si një mjet i organizuar në lehtësimin e të nxënësve bashkëpunues, nëpërmjet të cilit studentët përmirësojnë të nxënësve. Kështu wiki ndihmon në mbështetjen e të nxënësve bashkëpunues, dhe në të njëjtën kohë nxit të menduarit e pavarur të studentëve. Përfshirja e studentëve në hartimin apo përmirësimin e një artikulli wiki, që kërkon një hulumtim të kujdesshëm dhe autentik të literaturës ekzistuese dhe asaj të përditësuar ndikon në fuqizimin e ndjesisë së pronësisë e autorësisë të studentëve. Ata mbështeten në zhvillimin e një procesi të vazhdueshëm modifikimi dhe përmirësimi nëpërmjet ndërveprimeve midis anëtarëve të grupit të vogël, gjë që ndikon në minimizimin e autoritetit të pedagogut.

Fjalë kyç: Wiki pedagogji, arsim i lartë, të nxënësve bashkëpunues.

Collaborative learning in Higher Education through the use of Wikis - A Case Study

ABSTRACT

This study examines the effectiveness of Wikis and its pedagogical implications in future teachers' formation. The objective is to determine the impact of wikis on the learning experiences and learning outcomes of students of the master's program for foreign language teachers at the University of Tirana. To achieve this goal, students were asked to improve a wiki article or add a new one related to learning on Wikipedia, either in Albanian or in a foreign language.

A mixed method was used to carry out this research. The results of the study were derived by triangulating the data derived from: (1) the wikis that the students improved or created, (2) the students' reflections on the experience, and (3) learning outcomes based on final exams on the same subject from the university in the year in which the wiki was requested as an assignment, with students from the previous academic year.

Research data show compelling evidence that wiki can be an effective tool to facilitate students' collaborative learning, and at the same time to encourage students' independent thinking. Engaging students in writing or improving a wiki article, which requires careful and authentic research of existing and up-to-date literature, builds student ownership. Developing a continuous process of change and improvement through interactions between members of small groups helps to minimize the authority of a single student, thereby creating a climate of cooperative learning.

Keywords: *Wiki pedagogy, higher education, cooperative learning.*

Analiza e literaturës

Ky hulumtim merr në shqyrtim përdorimin e wikit dhe përdorimin e tij në arsimin e lartë. Në këtë kapitull do të shyrtohet literatura bashkëkohore mbi wikin dhe përdorimet e tij në arsimin e lartë. Për këtë, u analizuan studime të mëparshme, që merrnin në shqyrtim këndvështrime argumentuese mbi mundësinë për përshtatjen e wikit si një metodë interaktive, e bazuar në ueb, që nxit të nxënësit bashkëpunues në arsimin e lartë. Më pas analiza e literaturës u fokusua mbi implikimet e të nxënësve dhe ndikimet e mundshme pedagogjike në integrimin e wikit në kurrikulën e arsimit të lartë.

Në ditët e sotme, duke pasur akses në një sërë burimesh përtej klasës, studentët mund dhe duhet të përdorin informacion të gjerë dhe të përshtatshëm për të fituar njohuritë dhe aftësitë e synuara në çdo lëndë, pjesë formuese të programeve të arsimit të lartë. Kjo në të njëjtën kohë është një sfidë për mësimdhënien e të nxënit dhe një mundësi e madhe për të nxënëtit interaktiv, i cili fokusohet në nevojat e studentëve dhe jo vetëm në rëndësinë e perceptuar nga këndvështrimi i pedagogut (Ertmer etj., 2011). Kjo paraqet një dilemë për pedagogun për të balancuar veprimtaritë ndërvepruese në klasë, ato të drejtuara nga pedagogu dhe eksplorimin e pavarur për të arritur zotërimin e lëndës nga studentët. Për këtë, është e nevojshme, të rishikohen qasjet pedagogjike në mësimdhënie për të përfituar nga përdorimi efikas i përdorimit të secilit nga modalitetet që kemi në dispozicion.

Për të përfituar nga mundësitë që Burimet e hapura edukative (Open Education Resources-OER) ofrojnë në mësimdhënie të nxënit në arsimin e lartë, është dashur të rishikohen mjetet pedagogjike, me qëllim që studentët të angazhohen në mënyrë efektive dhe të udhëhiqen drejt rezultateve pozitive të të nxënit nëpërmjet përmirësimit të nivelit të angazhimit. Ky ka qenë një trend i ngadaltë, por konsistent në pedagogjinë e arsimit të lartë, siç tregohet nga Karasavvidis (2010). Këto teknika kanë treguar përmirësimin në mënyrë të suksesshme të procesit të nxënit, e pohuar kjo nga Ertmer, et al (2011). Disa studime, si Arnold, Ducate & Kost (2012), pohojnë që futja e qasjeve të tilla pedagogjike çon në një efikasitet më të lartë të të nxënit dhe angazhim më të thellë në proceset e të nxënit nga ana e studentëve. Sido që të jetë, pavarësisht argumenteve në favor të zbatimit të teknologjive të edukimit në rritjen e angazhimit të studentëve në të nxënëtit e tyre nëpërmjet rritjes së ndërveprimit dhe bashkëpunimit në klasë dhe jashtë saj, ka disa sfida që pengojnë përdorimin e gjerë të saj.

Wikis si një mjet pedagogjik i pavarur dhe i bashkëvarur

Sipas Brodahl, Hadjerrouit & Hansen (2011), wiki është një mjet bashkëpunimi dhe komunikimi online që mund të përdoret për rritjen e angazhimit të studentëve nëpërmjet bashkëpunimit në një mjedis mbështetës.

Studimet që kanë investiguar implikimet pedagogjike të wikit tregojnë se përdorimi i kujdesshëm i tij përmirëson mësimdhënie dhe përvojat e të nxënit nga studentët në arsimin e lartë si argumentohet nga Chu etj. (2017); Yadegaridehkordi, Shuib, Nilashi & Asadi (2019) apo

Kemp, Palmer & Strelan (2019). Megjithatë disa prej këtyre studimeve janë të të fokusuara më shumë në aspektet teknike të përdorimit të wikit në edukim sesa në implikimet pedagogjike, duke e bërë të vështirë arritjen e rezultateve konfirmuese. Studime, si Arnold, Ducate & Kost (2012), argumentojnë që integrimi i wikit në mësimdhënie e të nxënë në arsimin e lartë kërkon një qasje të ndryshme nga mësimdhënia e drejtpërdrejtë.

Pedagogjia Wiki

Wiki është një faqe uebi e editueshme, e cila është dizenuar për të qenë e thjeshtë në përdorim, me qëllim që përdoruesit të editojnë në grup ose vetëm (Karasavvidis, 2010). Wiki nuk kërkon shumë trajnim për t'u përdorur dhe mbështet përdorimin nga ana përdoruesit, pasi hapin një llogari. Wiki lejon projektet e bazuara në tekst, por gjithashtu mbështet dhe projektet multimedia në klasë, që janë interesante vizualisht. Tipari kryesor i wikit është produkti i përbashkët, ndërsa hyn në të dhe fillon procesin e editimit. Diferenca kryesore e wikit nga sistemet e menaxhimit e të të nxënës është më së shumti në aspektin social, pjesëmarrës dhe bashkëpunues, siç thuhet në Aguilera - Hermida (2020), Brodahl, Hadjerrouit & Hansen (2011).

Pavarësisht debateve mbi nivelin në të cilin studentët përfitojnë nga mundësitë që teknologjia digjitale ofron në të nxënës e tyre, ka argumente të forta për vlerën e tij në përdorimin për qëllime arsimore (Kemp, Palmer & Strelan, 2019). Wiki-t ofrojnë mundësi për negociim social dhe ndërveprim real midis studentëve. Duke përdorur wikin si një veprimtari të nxënës, studentët mund të kontribuojnë në mënyrë aktive dhe si formë e një procesi dhe kjo është një mundësi për përmirësimin e të nxënës, duke ulur nivelin e gabimeve, dhe duke nxitur të nxënës e qëndrueshëm në një mjedis të nxënës jo të strukturuar. Autoriteti i pedagogut pakësohet, pasi është shumë e zakonshme që gjatë procesit të hartimit të wikit, pedagogu të mund të mësojë nga studentët e tyre, duke qenë që mund të japin një kontribut më të përditësuar për fenomenin që diskutohet (Ebner, Kickmeier-Rust & HolZInGER, 2008).

Paradigmat e të nxënës të pedagogjisë Wiki

Paradigma kryesore e përdorimit të wikit për të nxënës në arsimin e lartë është ajo konstruktiviste (Ertmer, Newby, Liu, Tomory, Yu, Lee, 2011). Kjo paradigmë hamendëson që dija (njohuria) ndërtohet në mënyrë sociale dhe nuk është e përcaktuar së jashtëmi. Kështu studenti përfshihet në mënyrë aktive për bashkëkrijimin e saj. Tiparet kryesore të wikit janë, së

pari lehtësojnë komunikimin student-student dhe student-pedagog dhe së dyti nxisin bashkëpunimin në një mjedis të nxëni të lirë e fleksibël, duke nxitur bashkëndërtimin e njohurive (Brodahl, Hadjerrouit & Hansen, 2011). Aftësia e Wikit për të ndihmuar punën e përbashkët në grup çon në një të kuptuar të bashkëndërtuar, që siguron që studenti të jetë në qendër të procesit të të nxënit. Bashkëndërtimi i kuptimit, jo vetëm nëpërmjet ndarjes së njohurive, por dhe inkurajimit të ndërtimit të tij së bashku me studentët e tjerë është një vlerë e shtuar e këtij procesi.

Tipari kryesor është ndërveprimi student-student dhe student-pedagog, duke formuar një partneritet të nxëni, pasi një student ose pedagog i mirinformuar mund të editojë një shënim të një studenti tjetër, që nuk është më i vlefshëm. Ka një sërë evidencash që konfirmojnë që wiki mbështet ndërveprimin në grup, fuqizimin në pronësinë e të nxënit, të nxënët bashkëpunues, ndarjen e njohurive, punën në grup, duke çuar në një rritje të komunitetit të të nxënit. Aftësitë bashkëpunuese që wiki kontribuon për t'i ndërtuar janë themelet e aftësive të përbashkëta të kërkuara nga punëdhënësit në të ardhmen, siç thuhet në (Chu, etj., 2017).

Përparësitë dhe sfidat e përdorimit të wikit në arsimin e lartë

Përdorimi i wikit si veprimtari të nxëni ka një shumëllojshmëri qëllimesh: të ndihmojë studentët të mësojnë në mënyrë më efektive nëpërmjet të nxënit bashkëpunues, siç prezantohet paraprakisht. Në paragrafët më sipër janë prezantuar disa nga përparësitë e wikit në edukimin e një mjedisi efektiv të të nxënit, ndër të cilat më e rëndësishmja është nxitja e bashkëpunimit dhe pronësia e produktit (Arnold, Ducate & Kost, 2012). Por, vlerësimi i studentëve në fund të semestrit, mund ta minojë këtë potencial të përdorimit të wikit, pasi notat mund të shihen si konkurruese. Kjo karakteristikë mund të minojë pedagogjinë wiki për t'u implementuar më sukses, siç propozohet në (Hsu, Ching, & Grabowski, 2014). Natyra e wikit është në kundërshti me natyrën e strukturimit të arsimit të lartë (bashkëpunimi vs. konkurrenca) (Arnold, Ducate & Kost, 2012). Nëse natyra e sistemit arsimor universitar është drejt notës, si element konkurrues, mund të ndodhë që, megjithëse studentët marrin pjesë në wiki kur u jepet një detyrë, shumë prej tyre punojnë në mënyrë sipërfaqësore, pa angazhim të mirëfilltë në kontributin e tyre, pasi nuk i shohin vlerë të shtuar një pune të përbashkët, por fokusohen në projektet individuale. Por, studentët që janë angazhuar në mënyrë aktive në veprimtaritë e lidhura me wiki raportojnë një të nxënë më të thellë dhe një ndjenjë të autorësisë (Hsu, Ching & Grabowski, 2014; Ertmer, et al., 2011).

Disa studime të tjera eksplorojnë përgjegjësinë e shtuar për të

performuar në mënyrën më të mirë të mundshme të tyre dhe jo vetëm të bëjnë detyrat për të plotësuar kërkesën e shtruar nga pedagogu, kjo çon në një të nxënë bashkëpunues të përmirësuar (Hsu, Ching & Grabowski, 2014).

Kështu, integrimi i veprimtarive wiki në arsimin e lartë përmirëson të shkruarit konstruktiv të studentëve, si një pikënisje për përmirësimin e rezultateve të të nxënit (Brodahl, Hadjerrouit & Hansen, 2011). Të tilla deklarata janë mbështetur nga studime të tjera, si: Judd, Kennedy & Cropper, (2010) apo Bennett, Bishop, Dalgarno, Waycott & Kennedy (2012) të nxënit krahasuar me studentë që nuk kanë përdorur wikin, duke gjetur që përdorimi i wikit ndihmon studentët të kuptojnë materialin më mirë, duke çuar në rritjen e rezultateve të të nxënit në krahasim me studentët që nuk kanë përdorur wiki, mbi të gjitha, bashkëpunimi, dinamika pozitive, rritja e besimit dhe ndarja e njohurive, është raportuar që ka qenë domethënëse në veprimtaritë e lidhura me wiki (Arnold, Ducate & Kost, 2012).

A. Metodologjia

Ky studim ka qëllim të eksplorojë ndikimin e përdorimit të wikit në arsimin e lartë në Shqipëri dhe implikimet pedagogjike në përfshirjen e wikit për përmirësimin e rezultateve të të nxënit të studentëve. Lënda në të cilën u zbatua kjo veprimtari Wiki është të nxënit, që është lëndë përbërëse e programeve master në formimin e mësuesve të Universitetit të Tiranës.

Lënda e të nxënit, i përket bllokut pedagogjik të lëndëve që përgatisin mësuesit e gjuhëve të huaja. Lëndët pedagogjike kanë një rezultat të nxëni transversal, i cili i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë për të analizuar në mënyrë kritike përvojat e tyre të të nxënit, kështu që ata mund të përmirësojnë zhvillimin e tyre profesional si mësues.

Si wiki, u përdor Wikipedia, si një platformë e njohur nga të gjithë studentët, por vetëm si përdorues dhe jo si autorë. Asnjë nga studentët nuk kishte kontribuar si autor në wikipedia para kësaj detyre.

Lënda është zhvilluar gjatë vitit akademik 2018-2019. Semestri zgjat 15 javë, nga 20 tetori deri në 30 mars. 120 studentët e regjistruar në Master Mësuesi e Gjuhëve të huaja morën pjesë në detyrat wiki.

Detyra u organizua në punë me grupe. Studentët duhej të formonin grupe me nga 4 pjesëmarrës dhe të kërkonin për një temë për ta përmirësuar në wikipedian në shqip ose gjuhë të huaj, gjuhën për të cilën ata studionin. Hapat e detyrës ishin: ata duhej të mbronin propozimin e tyre (10%)-18 shkurt; duhej të paraqisnin referencat dhe të argumentonin rëndësinë e tyre

(30%) - 4 mars; duhej të hartonin një draft për kontributin e tyre për wikipedianët dhe të komentonin në të (20%) - 11 mars; ta publikonin atë (30%) - deri 18 mars, si dhe të shkruanin një ese reflektuese (10%) - deri më 25 mars. Wikipedianët ose edituesit janë vullnetarë që shkruajnë dhe editojnë artikujt e wikipedias, ndryshe nga lexuesit e thjeshtë të wikipedias (Pentzold, 2011). Përsa i përket esesë, studentëve iu kërkua të reflektonin në eksperiencën e tyre në shkrimin e wikit dhe përfshirjen e njohurive që ata kishin mbledhur nga kjo përvojë për të reflektuar se si do ta përdornin wikin në mësimdhënien e tyre si mësues në të ardhmen. Gjatë të gjithë semestrit, ata ishin në kontakt me pedagogun e lëndës dhe mund ta kontaktonin kurdo për të përgatitur punën e tyre. Secili nga studentët kishte llogarinë e tij në Wikipedia dhe kontributi i tyre do të vlerësohej në mënyrë individuale, që mund të çonte në një diferencë në vlerësim edhe midis studentëve të të njëjtit grup. Kështu, studentët do të punonin së bashku, ndërkohë që do të mbanin përgjegjësi individuale për kontributet e tyre. Ky lloj dizenjimi është bazuar në literaturën e parashtruar më lart (Ebner, Kickmeier-Rust, & HolZInGER, 2008), që konfirmon rëndësinë e wikit si një mjet të nxëni bashkëpunues.

Detyra u dizenjua me një vështirësi në rritje, bazuar në taksonominë e Blumit të rishikuar (Kemp, Palmer & Strelan, 2019). Ata duhet të kalonin në këto faza të detyrës: (a) shpjegimi i zgjedhjes së temës që do të trajtonin, (b) analizë e literaturës ekzistuese, (c) sintetizimi i punës në wiki, (d) reflektim personal mbi përvojën e përdorimit të wikit si mjet të nxëni. Pritshmëritë ishin që përvoja me wikin do të mbështeste studentët jo vetëm të mësonin si të strukturonin informacionin e tyre, por dhe të ndanin njohuritë e reja të fituara, të mbronin zgjedhjet e tyre, të sintetizonin njohuritë, si dhe të negocionin për çka do të përfshinin në të shkruarin e tyre, në bashkëpunim me pjesëmarrësit e grupit. Studentët u njohën me strategjitë për zhvillimin e detyrës dhe kërkesat e saj, për mënyrën sesi do të finalizonin detyrën në wikipedia, dhe si të shkruanin një ese reflektive duke u bazuar në përvojën e tyre mbi përdorimin e wikit.

Metoda

Për të realizuar qëllimet e mësipërme, rishikimi i një artikulli wiki në Wikipedia u integrua në lëndën e Të nxënit, e cila është lëndë e detyruar për studentët e Masterit shkencor të Mësuesisë në gjuhët e huaja në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Për këtë hulumtim u përdor një metodë mikse, që përfshin metoda të shumëfishta në investigimin e rezultateve të të nxënit të studentëve nëpërmjet pedagogjisë wiki (Olson & Jason, 2015), për të shmangur rrezikun në mbështetjen në një metodë të vetme. Në këtë hulumtim u

përdor metoda kërkimore triangolare, duke përfshirë tri metoda kërkimore së bashku me analizën e burimeve të të dhënave.

Së pari, një mikroanalizë u krye për përmbajtjen e artikujve të krijuar nga studentët, duke ndjekur historinë e përmbajtjeve të futura si dhe komentet e wikipedianëve. U analizuan cilësitë e ndërhyrjeve të studentëve në Wikipedia, për të kuptuar cilësinë e përzgjedhjes së informacioneve relevante për të pasuruar një artikull ekzistues ose për të hartuar një artikull të ri në Wikipedia, procesin e punës së studentëve individualë, përmirësimin e ndërhyrjeve në bazë të punës së grupit e reagimit pas komenteve të wikipedianëve për përmirësimin e artikullit. Qëllimi i analizës së përmbajtjes të artikujve wiki, që u krye ishte eksplorimi i implikimeve pedagogjike të mundshme të detyrave wiki, më shumë sesa vlerësimi se si studentët performuan në të (Brodahl, Hadjerrouit, & Hansen, 2011).

Së dyti, për të patur një të kuptuar të implikimeve pedagogjike të detyrave wiki në reflektimin e studentëve u përdor metoda e incidentit kritik (Hughes, Williamson & Lloyd, 2007). Si pjesë e veprimtarisë, në fund të detyrës, studentëve iu kërkua të shkruanin dy përvoja negative dhe dy përvoja pozitive gjatë plotësimit të detyrës së wikit si dhe dy përsiatje personale në lidhje me përdorimin e pedagogjisë wiki në mësimdhënien e tyre të ardhshme. Studentëve u ishte sqaruar që nuk kishte përgjigje të saktë apo të gabuar. 10% të pikëve merreshin nëse studenti i ishte përgjigjur secilës prej këtyre kërkesave. Analiza e përsiatjeve të studentëve u realizua nëpërmjet Nvivo software. Për këtë u realizua kodimi i hapur, aksial dhe selektiv, kategoritë dhe nënkategoritë u formuan bazuar në ngjashmëritë dhe diferencat e kodeve. U vunë re vetitë, dimensionet dhe marrëdhëniet (Ertmer, et al., 2011).

Së treti, për të kuptuar më mirë implikimet pedagogjike të wikit në arsimin e lartë, u analizua impakti i wikit në rezultatet e të nxënit, duke krahasuar rezultatet e provimit të grupit të studentëve me rezultatet e studentëve të të njëjtit grup nga viti i kaluar (N=98). Ato janë të krahasueshme, pasi nota mesatare e Bachelor është e krahasueshme mes dy grupeve: për studentët pjesëmarrës në veprimtarinë wiki (N=120) nota mesatare e Bachelor ishte 7.8/10 dhe për grupin jopjesëmarrës në wiki mesatarja e studimeve të tyre Bachelor ishte 7.9/10. Provimi nuk ishte i standardizuar, por testi mbulon të njëjtat çështje të mbështetura në rezultatet e pritshme të të nxënit, të parashikuara në syllabusin e lëndës, duke bërë të mundur të njëjtat rezultate të të nxënit për studentët. I vetmi variabël i ndryshëm midis dy grupeve ishte detyra wiki. Hipoteza ishte që studentët që punuan me wiki do të përformonin më mirë në provimin përfundimtar, të dhënat empirike të

mblendhura nga këto burime parësore shërbyen si bazë për gjetjet e studimit.

Popullata

Numri i studentëve të regjistruar në kurs ishte N=120. Moshë e tyre ishte 22-27 vjeç, 24% meshkuj dhe 76% femra. 10% e tyre ishin mësues, që kishin zgjedhur të vazhdonin arsimimin e tyre. Kursi është pjesë e lëndëve të detyrueshme për mësuesit e gjuhëve të huaja. Studentët përmirësuan 30 artikuj në wikipedia, nga të cilët 17 në shqip. 11 në anglisht dhe 2 në frëngjisht. Artikujt lidheshin me teorinë dhe praktikën e të nxënëtit, dhe studentët duhej të mbronin zgjedhjen e tyre përballë studentëve të tjerë dhe pedagogut, si hap i parë i detyrës wiki.

B. Diskutime

Nga analiza përfundimtare dolën dy kategori tematike kryesore, të cilat u përdorën si gjetje kyç të këtij hulumtimi, të cilat do të vijnë në ndihmë për diskutimin përse i përket përdorimit të wikipedias në arsimin e lartë: (1) përvojat e të nxënëtit dhe (2) çështje të teknologjisë në përdorimin e wikipedias, si veprimtari i nxënëtit në edukimin e lartë, duke na dhënë një njohuri mbi përvojat e të nxënëtit të studentëve dhe rezultate eventuale të të nxënëtit. Çështjet teknologjike janë kontekstuale dhe lidhen me specifikat e arsimit të lartë në Shqipëri, gjë që nuk është në fokus të këtij studimi, ndaj nuk përbën interes në këtë artikull.

Tabela 1: Kategoritë tematike

<i>Tema</i>	<i>Nëntema</i>	<i>Fjalë kyçe</i>
Përvojat e të nxënëtit	Bashkëpunimi Rritja e të nxënëtit individual Përgjegjësia individuale Fleksibiliteti i punës Të menduarit e pavarur Hezitimi fillestar Puna në ekip	Së bashku, veprimtari efikase, ndikim në të menduar, kontribut. Përgjegjësia individuale, fleksibilitet në kohë, fleksibilitet në vendndodhje, risi, e gjerë, e pastrukturuar

Përvojat e të nxënëtit

U numëruan artikujt wiki (W1 - artikujt wiki nga grupi 1) dhe esetë e

studentëve (E1- eseja e studentit 1) me qëllim shmangien e identifikimit të mundshëm të subjektit, në përputhje me protokollin etik të hulumtimit.

Tabela 2: Fragmente që ilustrojnë bashkëpunimin gjatë detyrës wiki

<i>Fragmente nga artikujt wiki</i>	W
Gjatë diskutimit tonë, ne mësuam...	16
Në përputhje me reflektimet tona...	6
Shumë nga ne ishin dakord ...	5
Perspektiva të ndryshme të paraqitura nga shumë prej nesh...	28
Progresi i grupit tonë sugjeron...	12
Perspektiva të ndryshme të paraqitura na ndihmuan ta shohim çështjen nga ana e ...	29
Bazuar në kërkimin tonë, ne arritëm në konkluzion mbi implikimet.....	21
<i>Fragmente nga esetë reflektuese</i>	E
Duke reflektuar mbi komentet e të tjerëve...	22
Unë ndryshova pikëpamjen time mbi...	119
Pasi diskutova idetë e mia me të tjerët...	13
Grupi ynë diskutoi disa prej opsioneve të prezantuara nga autorë të ndryshëm dhe mori në konsideratë argumentet që anëtarët e grupit sollën në diskutim për të formuar një ide të konsoliduar...	78
Ne, më në fund ramë dakord që...	85
Një anëtar i grupit tonë vazhdoi të mbante qëndrimet e tij në artikullin tonë të përbashkët Wiki, pavarësisht diskutimit të gjatë që patëm në lidhje me...	101
Duke u përpjekur të kuptoja këndvështrimet e studentëve të tjerë, unë isha...	87
Pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme të shprehura nga të tjerët, ne vendosëm të konkludojmë që ...	19
Si rezultat i diskutimit tonë, unë kuptova që ...	61

Në fillim, unë mendova që kjo ishte një detyrë e lehtë, por bisedimet dhe diskutimet tona vazhduan përgjatë gjithë semestrit.	36
---	----

Diskusimet e prezantuara më sipër tregojnë rritjen e të nxënëtit dhe përvojat e të nxënëtit bashkëpunues nëpërmjet wikit. Është e rëndësishme të theksohet që, megjithëse studentët ishin këshilluar të fillonin kërkimin e tyre që në fillim të semestrit, disa studentë filluan më vonë (p.sh. E54 kur u pyet për aspektet negative të detyrës: “Unë pranova temën që anëtarët e tjerë të grupit sugjeruan, sepse u përfshiva realisht më vonë se të tjerët. Mendoj se ishte aspekt negativ, sepse duhej të isha më eficient dhe duhej ta kisha shfrytëzuar kohën që në fillim.”). Pati prej tyre që iu desh të punonin përtej asaj që kishin menduar, për shkak të feedback që u vinte nga komuniteti i wikipedianëve. (E23: “Do të doja të kisha më shumë kohë për të përmirësuar komentet e bazuara në kontributin e dhënë nga wikipedianët. Mendoj që puna jonë nuk mbaroi siç duhet.”).

Më poshtë jepen disa gjetje të rëndësishme përsa u përket përvojave të tyre me wikin:

Përgjegjësia: Studentët ishin të përgjegjshëm për kontributin e dhënë, por e kuptuan që përgjegjësia ishte individuale. Një student komentoi: “Zakonisht më pëlqejnë punët në grup, sepse kështu mund të përfitoj nga puna e të tjerëve. Kjo detyrë, megjithëse ishte punë në grup, e bënte të qartë çfarë kishte bërë secili student individualisht. Ishte me të vërtetë punë e vështirë.” (E73) Një tjetër shkruan: “Në punët e grupeve të mëparshme, zakonisht bëj punën dhe më pas shtoj emrat e studentëve të tjerë. Në këtë detyrë, duhet patjetër të diskutojmë me të tjerët në grup, dhe kjo nuk ishte e lehtë.” (E120)

Fleksibiliteti në punë nga çdo vend e në çdo kohë: Semestri kur ky studim u krye përkoi me një protestë masive nga studentët, dhe mësimi në auditorë u ndërpre për afro një muaj. Por, studentët vazhduan të punonin në wiki, sepse ata mundeshin. “Ne nuk na duhej të organizonim se kur të takoheshim, por mund ta bënim kur të mundnim në mënyrë individuale, për të parë dhe sesi të tjerët kishin kontribuar.” (E47) “Mund ta kapja lehtësisht temën e diskutimit. Mendoj se kjo ishte një gjë e mirë.” (E13)

Të menduarit e pavarur: Studentët mund të zhvillonin opinionin e tyre të pavarur në sajë të natyrës konstruktive të argumenteve në detyrën wiki. “Unë vërtet i vlerësova komentet që wikipedianët bënë për artikullin tonë, duke na drejtuar në kërkime të tjera që shprehnin një këndvështrim tjetër.”

(E82). Studentët mund të përdorinin gjithashtu ndërhyrje bashkëpunuese për të formësuar të menduarin e pavarur. “Ajo që ne kuptuam nga leximi dhe diskutimi ishte arsyeja... (W17)” Një tjetër pohon “megjithëse isha dakord në pjesën më të madhe me ato që të tjerët thonin, unë besoja fort që ... Megjithatë, nuk arrita të ndryshoj idenë e të tjerëve për këtë.” (E96) Ai/ajo shkruan: “jam i/e kënaqur që koncepti im është pjesë e artikullit të wikipedias, pasi nuk ka gjithmonë përgjigje të drejta dhe të gabuara dhe pikëpamjet kontradiktore janë normale në arsim.” (E96) Sipas studentëve të tjerë, diskutimet mbi wikin i ndihmuan të përqafojnë idenë se ka raste kur nuancat janë të vlefshme, në vend të vetëm një përgjigjeje të saktë.

Hezitimi: Risia e përdorimit të wikit si detyrë bëri që shumë studentë të angazhoheshin herët në detyrë. “Në fillim, kur unë mësova rreth detyrës, hezitova të kontribuoja, sepse nuk ishte një detyrë e zakonshme.” (E15). Të tjerë pritën për kontributet e studentëve të tjerë më qëllim që të kuptonin më mirë ku të ndërhynin: “Po shikojta në punën e grupeve të tjera, sepse nuk ishte e lehtë të angazhohesh” (E72). Gjithashtu, liria për të zgjedhur temën nuk ishte e lehtë të menaxhohej nga ana e tyre, “Të vendosje ku të fokusoheshim ishte detyra më e vështirë për mua.” (E91). Por, pavarësisht fillimit të ngadalshëm, në secilin grup u identifikua një person që u përshtat më shpejt dhe që shërbeu si lider i pjesës tjetër. Lidershipi spontan ishte shumë përfitues për të tjerët: “Unë nuk shkruajta në fillim, sepse hezitova se mos bëja gabime. Por më pas (një tjetër student) shkroi në WhatsApp-in e grupit dhe na shtyu të gjithëve të vazhdonim.” (E78)

Pavarësisht nisjes së ngadaltë, niveli i shkrimeve në wiki po rritej dhe arriti në 15,350 fjalë. Këto shkrime ishin një prurje finale nga studentët pas drafteve që ata kishin finalizuar dhe aprovuar me wikipedianët, duke i kthyer ata në autorë të wikipedias. Fakti i publikimit dhe leximit nga të tjerët ishte një çështje që shkaktoi trysni të lartë, por gjithashtu një rritje të nivelit të krenarisë për shumë prej tyre “Babi im nuk mund ta besojë që unë tani jam një autor i publikuar (dhe një fytyrë që qesh!)” (E65)

Studentët u përballën me vështirësi në ndarjen e përgjegjësive, duke bërë që të kishte shkrime të ndryshme për të njëjtën çështje. Kjo shkatoi lodhje dhe stanjacion, duke ngadalësuar procesin e të nxënimit “Ne ishim dy grupe që po shkruanim në të njëjtin artikull dhe kjo shkatoi paksa mosmarrëveshje midis nesh.” (E54)

Puna në skuadër. Studentët e vlerësuan natyrën transparente dhe përgjegjësive e krijuar gjatë punës në skuadër gjatë zhvillimit të detyrave wiki. “Unë kam marrë pjesë një detyrë grupi më parë, por unë nuk kam punuar asnjëherë kaq i lidhur me pjesëtarët e tjerë të grupit si në detyrën

wiki. Përdorimi i kohës ishte shumë sfidues, por kështu unë mësova nga të tjerët.” (E01)

Arritja e rezultateve të të nxënësit

Për të krahasuar rezultatet e të nxënësit të lëndës për studentët që u implementua wiki dhe atyre që nuk zhvilluan veprimtari wiki, u krye një t-test independent-samples. Të dy grupet janë studentë masteri mësuesi e gjuhës së huaj, dhe lënda dhe rezultatet e pritshme të të nxënësit mbetën të njëjta, po kështu dhe pedagogu. Provimi përfundimtar, që u përdor për të krahasuar rezultatet e të nxënësit kishte 50 pikë dhe natyra e pyetjeve ishte e njëjtë. Testi u dizajnuar nga i njëjti grup pedagogësh në të dy vitet akademike: (N=120) viti akademik 2018-2019 (me veprimtari wiki) dhe (N=98) viti akademik 2017-2018 pa veprimtari wiki. Analiza e të dhënave u krye në programin SPSS version 25.

Vihet re një diferencë domethënëse në rezultatet e grupit wiki (M=41.50, SD=3.99) dhe grupit jo wiki (M=37.02, SD=9.72); $t(166) = -3.99$, $p < 0.01$ (cf. Table 3).

Edhe pse testet nuk u kontrolluan për homogjenitetin e variancave, është e rëndësishme të mbahet parasysh një efekt i tillë në performancën e studentëve në arritjen e rezultateve të të nxënësit.

Tabela 3: Rezultatet krahasuese të grupeve të përfshira apo jo në wiki, në provimin përfundimtar, t-test.

<i>Grupi</i>		<i>n</i>	<i>Mea</i> <i>n</i>	<i>SD</i>	<i>F</i>	<i>Sig.</i>	<i>t</i>	<i>df</i>	<i>Std.</i> <i>Error</i> <i>Mean</i>
Pikët e provimit	Pa wiki	120	37.02	9.72	36.12	.00*	-3.80	166	1.02
	Me wiki	98	41.50	3.99					.45

Shënim: ** tregon $p < .01$

Këto rezultate na sugjerojnë që përfshirja në veprimtari të wiki lidhur me lëndën mund të kenë influencuar në rezultatet e të nxënësit të studentëve. Në mënyrë specifike, rezultatet e këtij studimi sugjerojnë që studentët performojnë më mirë në provimin e dizajnuar për të matur të nxënësit për lëndën. Asnjë nga studentët e përfshirë në këtë përvojë nuk kishte patur më parë përvojë në hartimin e wikit. Ata raportuan që ndeshën

vështirësi në plotësimin e detyrës për shak të: a) njohurive të tyre të ulëta në IT; b) aftësive të dobëta në shkrim akademik, duke çuar në shkelje në referencë dhe plagjiaturë, të cilat u raportuan nga wikipedianët, sidomos në gjuhën angleze; c) nivelit të ulët të aftësive për të punuar në ekip. Pavarësisht këtyre, performanca e studentëve në fund të lëndës dhe reflektimet e tyre për përvojën e kaluar sugjerojnë se veprimtari të tilla ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme të lidhura me punën dhe aftësitë IT, komunikimin me njëri-tjetrin, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë vendimmarrëse. Studentët raportuan një rritje në dëshirën për të mësuar, fleksibilitet dhe përshatshmëri me oraret e njëri-tjetrit dhe aftësitë e njëri-tjetrit, si dhe një rritje të vetëbesimit kur artikujt miratoheshin nga komuniteti i Wikipedianëve. Kreativiteti dhe iniciativa, pavarësia dhe vetëdërgjegjësimi, inteligjenca emocionale dhe refleksioni ishin gjithashtu aftësi të raportuara që u përmirësuan nga studentët. Studime të kryera më parë tregojnë që detyrat wiki kanë një impakt në të nxënë të studentëve, siç theksohet në Chu, et al. (2017).

Studentët raportojnë se aktivitetet e wikit mund t'i mbështesin të zhvillojnë aftësitë e buta, të tilla si: negociimi, eksplorimi i burimeve, gjetja e zgjidhjeve kritike jashtë lëndëve të paracaktuara në kurrikul etj., që është në koherencë me gjetjet e studimeve të mëparshme (Yadegaridehkordi, Shuib, Nilashi & Asadi, 2019; Arnold, Ducate & Kost, 2012).

Në përgjithësi shumë studentë u shprehën që përfshirja në veprimtarinë wiki ndikoi pozitivisht në rezultatet e tyre të të nxënës dhe të tilla gjetje u konformuan dhe nga analiza e të dhënave, duke treguar një diferencë domethënëse në rezultatet e të nxënës midis grupit që punoi me detyra wiki dhe grupit që nuk u angazhua në detyrat wiki. Diskutimet e zhvilluara nga studentët në plotësimin e detyrave të tyre wiki mbështeti njohuritë bashkëpunuese, të cilat me sa duket i çuan ata drejt një të nxënës më të thelluar dhe një ndjenjë autoriteti në krahasim me studentët që nuk kishin pasur mundësi të punonin në një detyrë wiki, ngjashëm me konkluzionet e Brodahl, Hadjerrouit & Hansen (2011).

Gjetjet e mësipërme na çojnë në konkluzione të ngjashme me studimet e mëparshme (Karasavvidis, 2010; Judd, Kennedy & Cropper, 2010), veprimtaritë wiki që u ofrohen studentëve treguan që ishin një mjet efikas për të nxënë bashkëpunues. Historia e shkrimeve dhe rishikimeve të prurjeve të tyre treguan që studentët u influencuan në të menduarit e tyre nga puna e përbashkët në të cilën u përfshinë për diskutimet në hartimin e artikullit wiki. Fragmentet nga reflektimet e studentëve treguan ndikimin e studentëve të tjerë në të nxënë të tyre.

C. KONKLUSIONE

Fokusi i këtij hulumtimi ishte eksplorimi i implikimeve të mundshme pedagogjike në integrimin e wiki në kurrikulën ekzistuese të një lënde në programin Master shkencor për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm në gjuhën e huaj. Gjetjet nxorën në pah disa mundësi pedagogjike interesante për mësimdhënien e të nxënimit në arsimin e lartë si dhe disa sfida. Disktimi i mëposhtëm paraqet një seri reflektimesh të bazuara në gjetjet e hulumtimit të kryer për të udhëzuar pedagogët në arsim të lartë në përfshirjen e wikit si një përvojë të nxënimit në arsimin e lartë.

Në përputhje me kërkimet e mëparshme (Arnold, Ducate & Kost, 2012; Kemp, Palmer & Strelan, 2019; Aguilera-Hermida, 2020) zbuluam se wiki-t ndihmojnë të nxënimit në bashkëpunim, të bashkëndërtuar, ndërkohë që mbështesin të menduarit e pavarur dhe u ofrojnë studentëve mundësinë për të ballafaquar pikëpamjet dhe opinionet e tyre me ato të të tjerëve dhe me literaturën më të përditësuar. Për më tepër, të menduarit dhe të shkruarit në mënyrë reflektuese mbështesin studentët të ndërtojnë njohuritë e synuara për lëndën.

Në të njëjten linjë me hulumtimet e mëparshme (Bennett, Bishop, Dalgarno, Waycott & Kennedy, 2012), të dhënat e hulumtimit tregojnë që wikit ndihmojnë në mbështetjen e të nxënimit bashkëpunues, por në të njëjtën kohë nxisin dhe të menduarit e pavarur. Autoriteti i pedagogut minimizohet, ndjenja e pronësisë dhe autorësisë së studentit fuqizohet, duke çuar në proces të vazhdueshëm të modifikimit e të përmirësimit nëpërmjet ndërveprimeve midis anëtarëve të grupit.

Aktivitetet wiki si detyrë mësimore përdorin një paradigmë të të mësuarit konstruktivist dhe tenton të sfidojë autoritetin e pedagogut, kështu që pedagogët duhet të jenë të përgatitur të heqin dorë dhe të vënë në pikëpyetje fuqinë e tyre. Të dhënat paraqesin prova bindëse në favor të wiki-ve, si një mjet organik për të lehtësuar të mësuarit e bashkëndërtuar, të cilin studentët duket se e shijojnë.

Megjithatë, jo të gjithë studentët u përfshinë njësoj, duke qenë që u vunë re studentë lider në grupin e tyre, ashtu si dhe studentë që nuk u përfshinë cilësisht. Siç u diskutua më herët në gjetjet, risia dhe mosnjohja me wiki-t si një mjet të nxënimit, si dhe niveli më i ulët i aftësive kompjuterike prirën të pengojnë angazhimin aktiv në veprimtarinë e wiki-t nga disa studentë. Në përputhje me studimet e mëparshme mbi diversitetin në nivelet e angazhimit kur përfshiheshin në të mësuarit e ndihmuar nga teknologjia, u zbulua se nivelet e angazhimit në artikujt wiki ishin të

ndryshme brenda anëtarëve të grupit: ndërsa disa studentë me entuziazëm morën pjesë vazhdimisht në seksione të ndryshme të detyrës wiki, të tjerët hezitonin të kontribuonin dhe niveli i tyre i përfshirjes ishte më ulët deri në fund të detyrës (Ebner, Kickmeier-Rust & HolZInGER, 2008).

Dizajni i detyrës wiki në përputhje me rezultatet e të nxënit të syllabusit të lëndës në përgjithësi, i mbështeti më mirë studentët në reflektimin mbi detyrën wiki, duke çuar në rezultate më të mira mësimore për studentët (Chu, et al., 2017).

REKOMANDIME

Aktivitetet wiki të dizajnuara mirë, të përafruara me rezultatet e të nxënit të lëndës, kanë potencialin të mbështesin një mësim më efikas të studentëve të arsimit të lartë.

Duke qenë se përfitimet e kësaj teknologjie kur përdoret në mënyrë interaktive dhe kur angazhon bashkëpunimin social të studentëve siç jepet e qartë nga Karasavvidis (2010) u vërtetuan dhe nga studimi ynë, sugjerohet që kurrikula dhe qasjet pedagogjike në arsimin e lartë të rikonfigurohen me qëllim që të përfshijnë teknologjitë e edukimit në mësimdhënie e të nxënë.

Rekomandohet hartimi i udhëzimeve të qarta dhe rubrikave të vlerësimit të mirëpëraaktuara në lidhje me nivelin e kontributit individual dhe të grupit. Një vlerësim diagnostik është i nevojshëm përpara se aktivitetet e të mësuarit wiki të fillojnë, për të ofruar mbështetjen e nevojshme bazuar në ndarjen e aftësive të studentëve. Rekomandohet gjithashtu shpërndarja e detyrave gjatë gjithë semestrit, veçanërisht nëse studentët nuk janë të njohur me wiki-t më parë.

Për më tepër, është e paqartë nëse ndryshimi në performancën e studentëve nga njëri vit në tjetrin është vetëm falë shtimit të aktivitetit wiki, pasi nuk kishim bërë një paratest me të dy grupet, gjë që do të na ndihmonte në arritjen e përfundimeve më të sakta. Prandaj sugjerohet që në studimet e ardhshme të përdoret një dizajn sasior më i plotë në matjen e efekteve të wiki-ve në rezultatet e të nxënit tek studentët.

REFERENCAT

- Aguilera-Hermida, A. P. (2020). College students' use and acceptance of emergency online learning due to COVID-19. *International Journal of Educational Research Open*, 1, 100011.
- Arnold, N., Ducate, L., & Kost, C. (2012). Collaboration or cooperation? Analyzing group dynamics and revision processes in wikis. *Calico Journal*, 29(3), 431-448.
- Bennett, S., Bishop, A., Dalgarno, B., Waycott, J., & Kennedy, G. .. (2012). Implementing Web 2.0 technologies in higher education: A collective case study. *Computers & education*, 59(2), , 524-534.
- Brodahl, C., Hadjerrouit, S., & Hansen, N. K. (2011). Collaborative writing with Web 2.0 technologies: education students' perceptions.
- Chu, S. K., Zhang, Y., Chen, K., Chan, C. K., Lee, C. W., Zou, E., & Lau, W. (2017). The effectiveness of wikis for project-based learning in different disciplines in higher education. *The internet and higher education*, 33, 49-60.
- Ebner, M., Kickmeier-Rust, M., & HolZInGER, A. (2008). Utilizing Wiki-Systems in higher education classes: a chance for universal access?. *Universal Access in the Information Society*, 7(4), 199-207.
- Ertmer, P. A., Newby, T. J., Liu, W., Tomory, A., Yu, J. H., & Lee, Y. M. (2011). Students' confidence and perceived value for participating in cross-cultural wiki-based collaborations. *Educational technology research and development*, 59(2), 213-228.
- Hsu, Y. C., Ching, Y. H., & Grabowski, B. L. (2014). Web 2.0 applications and practices for learning through collaboration. *In Handbook of research on educational communications and technology* (pp. 747-758). New York, NY: Springer .
- Hughes, H., Williamson, K., & Lloyd, A. (2007). Critical incident technique. *In Exploring methods in information literacy research*, 28, (pp. 49-66.).
- Judd, T., Kennedy, G., & Cropper, S. (2010). Using wikis for collaborative learning: Assessing collaboration through contribution. *Australasian Journal of Educational Technology*, 26(3).
- Karasavvidis, I. (2010). Wiki uses in higher education: Exploring barriers to successful implementation. *Interactive Learning Environments*, 18(3), 219-231.
- Kemp, A., Palmer, E., & Strelan, P. (2019). A taxonomy of factors affecting attitudes towards educational technologies for use with technology acceptance models. *British Journal of Educational Technology*, 50(5), 2394-2413.
- Olson, B. D., & Jason, L. A. (2015). Participatory mixed methods research. In S. H.-B. (Eds.), *The Oxford handbook of multimethod and mixed methods research inquiry* (pp. 393-405). Oxford: Oxford University Pres.
- Pentzold, C. (2011). Imagining the Wikipedia community: What do Wikipedia authors mean when they write about their 'community'? *New Media & Society*, 13(5), 704-721.

- Yadegaridehkordi, E., Shuib, L., Nilashi, M., & Asadi, S. .. (2019). Decision to adopt online collaborative learning tools in higher education: A case of top Malaysian universities. . *Education and Information Technologies*, 24(1), 79-102.

REVISTA "AGIMI" PËR PROBLEMET E ARSIMIT

Eranda Halluni (Bilali), Fatmir Vadohej

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Mësuesisë"

ABSTRAKT

Qëllimi i artikullit është të tregojë vendin që zënë problemet e arsimit në të përkohshmen "Agimi". Edhe pse një revistë periodike letrare e përnuajshme, organ i Shoqërisë "Vëllaznija", autorë të ndryshëm me artikujt e tyre të ndryshëm, trajtojnë rolin dhe rëndësinë që ka arsimit për zhvillimin e kombit në përgjithësi dhe evidentojnë edhe rrugët e realizimit të tij. Shkolla shihet si fuqi që mbush mendjen, nxit për një përparim e përmirësim shoqëror, i përgatit për kohë më të mira fëmijët dhe është ajo që ka në duar fatin e atdheut.

Në punim evidentohen edhe qëllimet që duhet të ketë shkolla, si: zhvillimin e të menduarit të fëmijëve, zhvillimin moral dhe zhvillimin fizik, realizimi i të cilave bën që individit të jetë gati për jetën, veprat e tij të jenë në të mirë të shoqërisë, e rrjedhimisht vetëm kështu do të shkohet drejt përparimit e qytetërimit. Krahas tyre një vend të rëndësishëm zë edhe lidhja e shkollës me familjen, roli dhe rëndësia që ka familja në miredukimin e fëmijëve.

Roli i mësuesit në edukimin e fëmijëve zë një vend të rëndësishëm në këtë të përkohshme. Për këtë kërkohet të kishte mësues të mirë, pasi nga puna e tyre varet e ardhmja atdheut. Krahas problemeve të tjera që trajtohen, që janë të lidhura me zhvillimin e arsimit si ekzistencë e kombit, nënvizohet me forcë rëndësia që ka arsimit i femrës shqiptare. Të gjitha problemet e trajtuara dhe të evidentuara janë me shumë rëndësi për shkollën dhe zhvillimin e mendimit pedagogjik shqiptar.

Keywords: arsim, lidhja shkollë familje, edukim i femrës, përgatitje e mësuesve, edukata familjare.

"Agimi" magazine on education problems

ABSTRACT

The purpose of the article is to show the problems that occur in education in the temporary "Agimi". Although a monthly literary

periodical, an organ of the "Vëllaznija" Society, different authors with their various articles deal with the role and importance of education for the development of the nation in general and also highlight the ways of its realization. The school is seen as a power that fills the mind, encourages progress and social improvement, prepares children for better times and is the one that holds the fate of the country in its hands.

The paper also highlights the goals that schools should have, such as: the development of children's thinking, moral and physical development, the realization of which makes the individual ready for life, his works are for the benefit of society, and consequently, this is the only way to move towards the progress of civilization. Alongside to them, an important place has the connection between the school and the family, the role and importance of the family in the good education of children.

The role of the teacher in the education of children has an important place in this temporary. For this, it was required to have good teachers, since the future of the country depends on their work. Along with other problems that are mentioned, which are related to the development of education as the existence of the nation, the importance of the education of the Albanian woman is strongly underlined. All the problems addressed and identified are very important for the school and the development of the Albanian pedagogical thought.

Keywords: education, school-family connection, female education, teacher preparation, family education.

Revista "Agimi", drejtuar nga dr. Kristo Flloqi e prof. Karl Gurakuqi dilte një herë në muaj. Numri i saj i parë doli në majin e vitit 1919. Ajo u botua si periodike letrare e përmujshme, organ i Shoqërisë "Vëllaznija".

Synimet e përgjithshme kombëtare e veçanërisht ato arsimore, drejtuesit e të përkohshmes i paraqitën në numrin e parë të saj. Në kryeartikullin "Program'i jon" ato shpreheshin | "*Duem të zgjojmë kombin shqyptar në zhdrivillimin e gjuhës së tij letrare e në kulturën qi ka me vijue mbas tashit, tuej mos u përzi në politikë, por se vetëm në histori, ethnografi, arqeologji, gjuhësi, e zakone e tradicione kombtare, tuj begatue të dy veglat e përparimit letrar, vjershën e prozën. Një komb aqë i vjetër sa kombi Shqyptar, jo vetëm në sinisi të Ballkanit, por edhe në E'uropën marë me gjuhë aq të vjetër e historike sa gjuha pelasgjike-gjuha shqype- për të cilat të huejt kanë ba fjalë deri tash (kur se na s'kena lujt vendit aspakë), nuk duhen me u lanë mbasdoret në ket shekull të dritës e të qytetënimit.*

Kishte me kenë një faj i pa-falun, një mkat i math, çok një marri si përpara kombit t'onë, ashtu para njerzimit e para Zotit. Maston mâ gjithë kjo padi e kjo mprashiti për në, duhet me çilë sytë, duhet m'u gjyettmue, me jetue, e pra duhet m'u mundue e jo me pritue".¹

Në artikullin pasues flitet për shoqërinë "Vëllaznija". Kjo shoqëri u krijua si bashkim i shoqërive "Mustafa Pasha" e "Vaso Pasha", më 16 shkurt 1919. Shoqëria zgjodhi me shumicë votash z. Hil Mosi si kryetar dhe për katër degët vepruese si drejtues: z. Kristo Fllloqi (dega letrare), z. Salih Nivica (dega teatrore, por meqenëse ky ishte i zënë me redaksinë e gazetës "Populli", si zëvendës i tij u zgjodh z. Mati Logoreci), z. Ndue Paluca (dega muzikore) dhe Kolë Margjini (dega gjimnastikë).

Po në këtë artikull paraqitet edhe rregullorja e shoqërisë. Në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, neni 3 për zhvillimin e programit, dega letrare "përfshin botimin e një të përkohshmes, mbajtjen e një libertoresh, të një shkollë nate, përmbajtjen e konferencave, si dhe botimin e librave të nevojshëm".² Me interes për zhvillimin e arsimit në ato vite janë informacionet që jepen në fund të artikullit, ku tregohet se drejtimi i degës letrare ngriti një shkollë nate me "4 rrende e 7 msuesa. Shkolla e filloj veprimtarinë e saj më 5 prill 1919. Kjo shkollë ndiqej nga 100 djem e burra" tue xanë pa të holla me shkruar e këndue gjuhën amtare".³ Në këtë shkrim evidentohet edhe zelli i mësuesve që punonin në këtë shkollë. Sa i përket lëndëve që zhvilloheshin në këtë shkollë thuhet se nxënësit mësonin këndim, shkrim dhe aritmetikë, por theksohet se "mâ von kto kanë me u shtue si mbas nevojës".⁴ Në sallën e bisedimeve të shoqërisë, në shkollën e Parrucës, mësojmë se kishte filluar puna për ngritjen e bibliotekës. Konferenca e parë mbi "Vjetërsiën e shkrimit e gjuhës shqipe" u mbajt në sallën e Kinost, më 21 prill 1919, nga z. Fllloqi.

Në këtë të përkohshme një rëndësi të madhe i kushtohet gjuhës shqipe. Në artikullin "Rânsi e gjuhës për një komb" autori Kristo Fllloqi flet për gjuhën që është shpirti, zemra dhe gjaku i një populli. Ai shtron nevojën e mësimit të gjuhës amtare, si dhe jep mesazhe që gjuhën duhet ta flasim, ta duam dhe ta përkrahim. Ja si shprehet ai: "Gjuha është shpirti, zemra e gjaku i një populli. Gjuha e çquan prej fqinjëve tjerë, gjuha e rrjeshton në familjen e madhe kombëtare; pra gjuha është kombësia vetë, vegla e veprimeve të tij, organi i marrëdhënjëve të tij".⁵ E më poshtë

¹ Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq. 1.

² Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq. 3.

³ Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq. 5.

⁴ Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq. 5.

⁵ Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq. 5.

vazhdon: "Mësimi i gjuhës amtare u pa si nevojë. Gjuha kshtû u kuptue se âsht ushqimi e jeta e popullit e vegla e fuqishme e kulturës së tij".⁶; "Për me jetue duhet me pasë gjuhën, pra gjuha âsht jeta e popullit; Sa do e vorfën qi âsht gjuha j'onë duhet t'a flasim, t'a duam, t'a përkrahim. Kur nderojmë gjuhën, nderojmë vendin t'onë."⁷

Autori i shkrimit duke parashtruar rëndësinë e madhe që ka mësimi i gjuhës amtare, me të drejtë shtron pyetjen: A duhet lënë ajo mbas dore? Ai shkruan: "N'asht një visar dija e gjuhëve të hueja, dija e gjuhës s'ate âsht një detyrë për ty. Pa gjuhën së ké, as ndër, as rândsi. Pra, kjo vegël e artë, kjo arm'e shejtë, ky shpirt, kjo fuqî e kombit a duhet me u lânë mbas doret?"⁸

Një temë e trajtuar në këtë të përkohshme është edhe ajo e arsimimit të femrës. Në artikullin "Nevoja e arsimit për fëmna" autori mbasi i bën një analizë rolit të femrës në familje e shoqëri, nisur nga nevoja që ka shoqëria për femrën, duke vënë theksin te lënia mbas dore e arsimimit të femrës, argumenton rëndësinë e të rriturit mirë të vajzave duke dhenë edhe mesazhin "t'a kërkojmë pra mjetin qi âsht mësimi a shkolla pse në qoftë se do të vijoje ndër mendime e zakone të deri-tashme qi mos me u kujdesë për mësimin e fëmnavet, s'kemi për të mundun me u vû kurr' i herë n'udhë të mbarë as si njerz as si kom".⁹

Në artikullin "Çka i mungon edukacionit t'onë komtâr" u shtrua me të madhe nevoja e madhe për shkolla. Në fillim autori paraqet vlerën dhe rëndësinë e madhe që ka shkolla veçanërisht në drejtim të përparimit dhe të qytetërimit. Për këtë shkruhej: "Ska nieri qi se sheh e se kupton nevojën e madhe qi ka atdheu ynë për arsim e sidomos për edukacion moral i cili âsht themeli i përparimit dhe i qytetënis të një populli."¹⁰ Për këtë kërkohej të kishte mësues të mirë, pasi nga puna e tyre varet e ardhmja atdheut. Ja si shprehet autori i shkrimit: "Për me krye plotësisht qëllimin e edukacionit komtar duhet piksëpari mësues të aftë, mësues që t'a kuptojnë mirëfillit misjonin e vet, e t'a dijnë se në vepër të tyne të përvujtë, por të madhnueshme pshtetet uzdaja e lulzimi i atdheut."¹¹ Autori i shkrimit rendit disa "sende", siç i quan ai që e pengojnë dhe e rrënojnë edukacionin kombëtar, si: "mungesa e një parimi drejtues në të çilun të shkollave fillore, pazotsia e disa nierzve qi i marshtrojnë, dyshimi në të cillin bienë

⁶ Revista "Agimi", Vjeti I, nr. 1, 1919, fq.5.

⁷ Po aty, fq. 5.

⁸ Po aty, fq.5.

⁹ Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 1, 1920, fq. 3.

¹⁰ Revista "Agimi", Vjeti II nr. 5, 1921, fq. 88.

¹¹ Po aty, fq.88.

*shum mësues në të zgjedhun të metodikës, pa rregulliminë zhvillim të landve". Me rëndësi në shkrim janë edhe cilësitë të cilat duhet ta karakterizojnë një mësues, ku autori i jep një vend të konsiderueshëm. Ai thekson se koha kërkon mësues të virtytshëm e të jenë të durueshëm, mësues që të jenë të zellshëm t'i japin shkollës zhvillim të mirë dhe të përshatshëm. "Breznija e vjetër është tue prendue, e po afrohet e reja; po të lêhet edhe këjo mbas dore, pa arësim e pa edukacion kishte per të dalë për dam e rrezik të komit e të shoqnis."*¹²

Një problem i trajtuar në revistë është edhe bashkëpunimi i shkollës me familjen. Në artikullin "Shkolla e familja", autori fillimisht trajton rolin e familjes në mirërritjen e fëmijëve. Ai thekson se detyra e familjes është të sigurojë ushqimin, veshmbathjet, të kujdeset për shëndetin e fëmijëve, por thekson se ka një rol të rëndësishëm në vlerat morale. Në shkrim i vihet theksi edhe rëndësisë që ka ambienti familjar në edukimin e fëmijës, ku thekson se prindërit duhet të jenë shembull urtësie e mirësie. Autori thekson se prindërit që nuk kujdesen për fëmijët e tyre, që nuk kujdesen për mirëqenien morale, fizike e intelektuale, që hedhin pas shpine edukimin e fëmijëve, por çdo gjë ia lënë mësuesit, këta prindër nuk e meritojnë këtë emër.

Një tjetër problem i trajtuar në shkrim është domosdoshmëria e ndihmës së prindërve, në mënyrë që mësuesi të kryejë misionin e tij, pasi pa këtë ndihmë qëllimet e tij dhe të shkollës "...kishin për të shkuar keq dhe nuk mund të përmbushen"¹³ Po nuk ekzistoi kjo lidhje e ngushtë ndërmjet familjes e shkollës, "shkollës i mungon njajo pshtetje e vjefshme mbi të cillën ngrehet vepra e naltueshme e mirërritjes komtare"¹⁴. Autori thekson se është gabim të mendosh se arsimit mundet t'i vlejë duke qenë si prijës i njeriut në veprimet e veta, e nuk kuptojnë se "edukacioni moral është mjetei më i fuqishmi që na shtyen me krye vullndetisht detyrët t'ona. Shi për ket arrsyje mësuesi do të synojë gjithmonë dy qëllimet që ka shkolla, d.m.th. zhvillimin e mendjes dhe ndjesive, pa e lënë kurr mangut as njënen as-tjetren, pse përndryshe s'mund të njehet edukator."¹⁵ Rëndësinë e këtij bashkëpunimi autori e shpreh edhe në fund të shkrimit: "Vetëm në sajë të bashkëveprimit shkollë familje kishin me rrjedhë fryte të plota"¹⁶

Në kryeartikullin "Shkolla dhe Atdheu", autori shkruan: "Shkolla është sinonimi i atdheut, me përmirsue e me bâ me përparue shkollën si në

¹² Revista "Agimi", Vjeti II nr. 5, 1921, 88.

¹³ Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 6, 1921, fq. 106.

¹⁴ Po aty, fq.106.

¹⁵ Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 6, 1921, fq. 106.

¹⁶ Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 6, 1921, fq. 107

*pikpamje morale ashtu në pikpamje landore, don me thënë me permirsue, me e forcue e me bâ të përparojë atdheu.*¹⁷ Shkolla ka vetëm një qëllim e ky është qëllimi edukativ për të lartësuar shpirtërat për të mirën e të gjithëve. Shkolla *“Do jët mâ i pari e mâdhi insitut njrzuer në botë, tue qenë se ky formon atdhën , i cili shprehet e bâhet i njoftun nëpërmje të veprimevet të shoqnis qti përfaqson.*¹⁸ Autori shprehet se shkolla është fuqi që mbush mendjen, nxit për një përparim e përmirësim shoqëror, na përgatit për kohë më të mira dhe është ajo që ka në duar fatin e atdheut. Kështu duke patur këtë mision, autori ndalet edhe te mësuesi, i cili sipas tij, ka një përgjegjësi shumë të madhe, pasi siç edhe shprehet *“Pse atdheu i ka zgjedhë si roje për me i mprojtë çdo rrezik që i kërcnohet e me ia sigurue ardhjen e tij morale e intelektuale.*¹⁹

Duke marrë parasysh rëndësinë madhe që ka shkolla autori i bën thirrje Ministrisë së Arsimit *“Që me iu bâ ndihmë shkollës pasi âsht detyra e saj;nuk do të mbyllë syt kur të shofë gjendje të mjerueshme ndër shkolla e nuk do të mbyllë veshët mjerimevet e ankimevet të tyne”*²⁰

Autori duke mbrojtur pikëpamjen se shkolla është themeli përmbi të cilin ngrihet i gjithë organizimi shoqëror, thekson se duhet me qenë e fortë nga të gjitha pikëpamjet për t'i bërë ballë fuqive kundërshtare, për të mbajtur atë ekuilibër që është i nevojshëm e i domosdoshëm për jetën e kombit. Me të drejtë autori shtron pyetjen: Si mbahet ky ekuilibër? Autori e drejton gishtin te Ministria e Arsimit *“Pasi ajo do caktojë ato mësuesa, qi të shëndoshë ndër parime, të fort në vullndet, të pajum me një karakter idheal e mâ tepër të forcuem me këndimet e nevojshme, të hjedhin sot ndër zëmrat e njoma farën e bashkimit për me pá nesër frytet e saja...qeveria prandej, do të përpiqet me gjith fuqi për ket tempull tue u përkujdesë ne të tâna mjetet e përdorshme për me përmirsue mënden e zëmrrën e mësuesit, e, në kje se këtij i mûngon mësimi i nevojshëm të shtohen e të përhapen këndime; të shtohen vjetët e shkollës, e mbas si në vënd nuk kemi shkolla të nalta, atëherë të mërrën masa të nevojshme, qi djelm e varza shqyptare të dërgohen në vende të hueja e të paguhen që të kryejnë këndimet në rregull, pse pares së shpenzume në ket mënyrë i shifet dobi e madhe e qet frytet e veta”.*²¹ Nga ana tjetër shprehet autori nëse ka mësues që akoma nuk e kanë kuptuar rëndësinë e detyrës, nuk u përgjigen nevojave të shkollës, atëherë të largohen *“pá një pá dy prej shkolle e t'i u ngarkohen detyrë e rângë qi t'i*

¹⁷ Revista “Agimi”, Vjeti II, nr. 10, 1921, fq. 134.

¹⁸ Po aty, fq. 134.

¹⁹ Revista “Agimi”, Vjeti II, nr. 10, 1921, fq. 133.

²⁰ Revista “Agimi”, Vjeti II, nr. 10, 1921, fq. 134.

²¹ Po aty, fq. 135.

u përgjegjin vjeftsës e aftësis së tyne."²²

Autori ka edhe një mesazh të cilin e shpreh në fund të artikullit: "Duhet ti vihemi me mish e shpirt kësaj pune, e kësaj vepre, që është për të mirën e të gjithëve. Të punohet që shkolla të mbahet si një ndër instituconet më të mëdha njerëzore. Ti jepet rëndësia e vlera prej vullnetit të fortë e të patundur të qeverivet që kanë dashtë, e kane dishrue e kërkuje të mirën, përparimin e lulëzimin e Atdheut dhe Njerëzis"²³

Përsëri edhe në numrat e tjerë të revistës vazhdon të trajtohet rëndësia e shkollës. Në kryeartikullin e numrit 11, mars 1921 "Randsija e shkollës" i është kushtuar rëndësi të dhënit të qëllimit të shkollës nga e cila varet e mira e individit, familjes, kombit, shtetit dhe mbarë shoqërisë. Në fillim paraqitet roli dhe rëndësia që ka familja në rritjen e fëmijës. Për këtë thuhet: *Në jetën shoqërore insituti më i moçmi qi përkujdesohet për të rriturit e fëmijës është familja*".²⁴ Pastaj tregon se në familje fëmija gjen prindërit, të cilët kujdesen për ushqimin, veshmbathjen, zhvillimin trupor dhe mendor, biles në familje fëmija merr mësimet e para e më të dobishme për jetën. Nën kujdesin e prindërve fëmija fillon të formojë karakterin dhe merr drejtimin për veprimet e veta. Nga ana tjetër, autori ndan shqetësimin me bazë argumentin, se në të shumtën e rasteve familja nuk e kryen siç duhet misionin e saj. Për këtë shkruhej: *"Qytetnimi krijoj, së pari vetëm për të pasun, e má vonë për të gjith njerzt, nji insitut mâ të naltë e mâ të rândsishëm shkollën, e cilla zûni vëndin e familjes e muer në kujdes të rritunt e të rinjve. Me të ngrahun të shkollës njerzimi muer nji hov të math n'udhë të qytetnimit e të përparimit"*.²⁵ Më poshtë artikulli rendit katër pika të cilat përbëjnë edhe qëllimin e shkollës: "1. Me zhdrivillue të gjitha fuqitë e mëndes; 2. Me ushqye e me pajis zêmren e fmis me ndiesi të ndershme e me virtytte të mira; 3. Me mbajtë trupin e xânsit shëndosh e me e forcue mâ tepër; 4. Me e bâ njerin gati për punët e jetës shoqnore".²⁶

Nga analiza që i bëu autori secilës pikë të mësipërme kuptojmë se qëllimi i shkollës nuk është vetëm zhvillimi i mendjes me disa njohuri të cilat konsiderohen të dobishme, por kujdesi më i madh është në formimin e mendjes duke i dhënë një rëndësi të veçantë fantazisë e gjykimit, që kur të mbarojnë shkollën të jenë të zotët për të dhënë gjykime të drejta, të dijnë të ndajnë të mirën nga e keqja, e nëpërmjet kësaj shihet metoda e përdorur në zhvillim të lëndëve. Me pikën e dytë shkolla duhet të punojë për moralin,

²² Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 10, 1921, fq.135.

²³ Po aty, fq.135.

²⁴ Revista "Agimi", Vjeti II, nr. 11, 1921, fq. 149.

²⁵ Po aty, fq. 149.

²⁶ Po aty, fq. 150.

t'i pajisë nxënësit me cilësi të mira. Gjithashtu është shumë e rëndësishme forcimi e zbulimi i trupit, ruajtja e shëndetit, e cila është një nga pjesët më të nevojshme të programeve të shkollës. Mjafton këtu të kujtojmë atë fjalën e urtë *“mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë”*, një aforizëm që tregon më së miri rëndësinë e edukimit fizik për njeriun. Kështu, duke realizuar këto tre qëllime, shkolla e ka bërë gati për jetën, ku të gjitha veprat e individit do të jenë në të mirë të shoqërisë, e rrjedhimisht do të shkohet drejt përparimit e qytetërimit. Rëndësia e shkollës përmbledhet dhe vjen si një mesazh në fund të artikullit, e konkretisht: *“ Pa shkolla të mira një kòm, një shtet së kishte me mërritë kurr me përmirësue gjëndjen ekonomike e me ti dhënë shkas kahë përparimi bujqsis, industris e tregtis; Shtetet e kombet e qytetnume, tue vrojtë pra se sigurimi e të rritunit e tyre qindron n'arësim e në mirëveti të qytetasvet, filluen me një zell të posaçëm me ngrehë gjithëkah shkolla të vogla e me ju dhanë një drejtim të mirë e të mbarë. E sot, në kjoftë se disa Shtete t'Europës e të botës qytetnueme kanë mërritë në cip të madhnis e përmënden ndër degë të dijes, ndër zëje e n'industri duhet t'a dijmë se vetëm prej rregullimit të mirë të shkollavet e kanë at madhni e at lulzim, pse si thotë me arsye J. Simon: “ Populli qi ká shkollat mâ të mira, âsht i pari popull; në mos kjoftë sot, ká për të kënë doemos nesër”²⁷ E mbyll me një thirrje për qeverinë *“Qeveria t'i apin, pra, shkollës rëndsin e vjeftsin qi i përket; të diftojnë at zëll e at kujdes të duhshëm për rregullimin e drejtimin e saj të mbarë, t'a përkrähijn e t'a mbajnë me mjete të shëndoshta, për me muejtë me i shti Atdheut themelin e sugurtë për qindresë e përparim”²⁸**

Në revistë trajtohet edhe problemi i zhvillimit të arsimit në Shqipëri. Në artikullin *“Evolucjoni i arsimit ne Shqypni”* autori fillimisht flet për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, duke e cilësuar *“...monument i pavdekshëm, e cila krijoi një çashtje shqyptare, e i bâni me dijtë europës se në gadishull të Ballkanit gjindet një kòm qi ka ruejtë të pa prekuna zakonet, gjuhën, e fisionomin komtare e qi dishron e ká të drejtë me kënë i lirë nën një qeveri të veten”²⁹* Artikulli vazhdon me përpjekjet e patriotëve shqiptarë, e veçanërisht ndalet te figura e Abdyl Frashërit që autori e cilëson *“... që ish një ndër fytyrat mâ të shkëlqyeshme e mâ të çmueshme të Lidhjes”³⁰*, te Mehmet Ali Vrioni nga Berati, për mbrojtjen e integritetit dhe të drejtat e popullit shqiptar nëpër të gjithë kryeqytetet e Fuqive të Mëdha. Lidhja filloi të ngjallte në popull idenë kombëtare dhe dashurinë për gjuhën e vendin,

²⁷ Revista “Agimi”, Vjeti II, nr. 11, 1921, fq. 152.

²⁸ Po aty, fq. 152.

²⁹ Revista “Agimi”, Vjeti III, nr. 9, 1922, fq. 163.

³⁰ Po aty, fq. 163.

pët t'i bërë të njohur në Evropë të qenurit e kombit shqiptar dhe për ta bërë me kuptuar forcën që ka arsimit e lëvrimi i gjuhës në zgjimin e popullit. Në kushtet e vështira për fatet e vendit, si dhe të padijës së madhe, nxiti disa burra që morën në dorë lëvrimin e gjuhës dhe zhvillimin e arsimit kombëtar. Kështu në artikull shkruhet: *"Me përpjekjet e tyre mujt me u themelue në Stambollë, në vjetë 1879, me lëje të qeveris turke "Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip" nen Kryesin e Vezirit të Math Ferid Pashës. Nder antarë vepruésa mâ të parët kjenë Sami Frashëri, Joan Vretoja, Koto Hoxhi e Pashko Vasa, shkodranë. Këjo shoqnë e ngrehun me program thjeshtë letrar kish per qellim me trajtue një alfabet, me botue libra e me çilë shkolla neper Shqypni per të përhapë mësimin e këndimit e të shkrimit të gjuhës amtare në popullin t'onë të padijtun"*³¹ Fillimisht shoqëria e filloi punën me një alfabet *"alfabet i çuditshm e i përzim me shkronja greke, latine e sllave, për ket arsye alfabeti i Stambollës nuk muejt m'u përhapë në të tana viset e Shqypnis e m'u bá i përgjithshëm"*³² Po në atë vit shoqëria nxori edhe një abetare me copa këndimesh të Sami Frashërit, jani Vrejtos e një përshkrim të Pasko Vasës për Shqipërinë e shqiptarët. Ky libër u përhap në të gjitha anët e Shqipërisë: *"... hyni në shtëpitë pasunit e në kasolletë bujkut e njalli kudo andjen e dishirin për mësimin e gjuhës; kje, si thotë me shum arsye një shkrimtar i ynë, i pari gur i përlindjes kombëtare."*³³ Kjo shkëndi e vogël që filloi të ndizte zemrat e shqiptarëve për dashuri për gjuhën, nuk u pa me sy të mirë nga armiqtë e atdheut. Në kushtet e krijuara shoqëria do të vijonte veprimtarinë e saj në Bukuresht *"për me vijue veprën mâ me fryt e në një shesh mâ të lirë"*³⁴

Trajtimi i kontributit të revistës "Agimi" për problemet e arsimit na lejon të nxjerrim disa përfundime:

- Revista përmes artikujve e kryeartikujve trajtoi dhe zbërtheu shumë probleme që lidheshin me shkollën në veçanti e me arsimin në përgjithësi.
- Problemet arsimore u shtruan, u trajtuan dhe u zgjeruan për zgjidhje me qartësi dhe kompetencë nga këndvështrime historike, aktuale dhe perspektive nga pozita atdhetare dhe demokratike.
- Tematika e gjerë arsimore, sidomos ato të rëndësisë së shkollës, qëllimeve të saj, figurës së mësuesit, të mbrojtjes dhe përhapjes së

³¹ Revista "Agimi", Vjeti III, nr. 9, 1922, fq. 164.

³² Revista "Agimi", Vjeti III, nr. 11, 1922, fq. 203.

³³ Revista "Agimi", Vjeti IV, nr. 11, 1922, fq. 203.

³⁴ Revista "Agimi", Vjeti IV, nr. 11, 1922, fq. 203.

gjuhës shqipe, mësimit në gjuhën amtare, të arsimimit të femrës, të rolit të familjes në edukimin e fëmijës, të rëndësisë së bashkëpunimit shkollë - familje, të përgatitjes së mësuesve janë me shumë interes për historinë e shkollës dhe mendimit tonë pedagogjik.

Literatura

- *Koleksioni i revistës “ Agimi”, Vjeti I- III, 1919-1923*

SHKOLLA E PARË E VIZATIMIT NË SHQIPËRI

Edmond Muço

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Arteve

ABSTRAKT

Artikulli ka për qëllim të evidentojë historikun e shkollës së parë të vizatimit në Shqipëri. Pikënisja e historikut të shkollës së vizatimit fillon nga shoqëria "Miqtë e artit". Kjo shoqëri u krijua nga një grup i madh artistësh dhe intelektualësh të tjerë. Më 10 maj të vitit 1931 me nismën e akuarelistit Q. Mesarea dhe të skulptorit O. Paskali u krijua shoqëria "Miqtë e artit". Me interesimin e intelektualëve që bënë pjesë në komunitetin artistik dhe shoqërinë "Miqtë e artit", në muajin maj 1931 në Tiranë u hap për herë të parë kursi i vizatimit i drejtuar nga piktori Andrea Kushi. Pas rreth një viti në janar të vitit 1932 u themelua shkolla e vizatimit nën drejtimin e profesorit italian Mario Ridola. Mbyllja e vitit shkollor u shoqërua me hapjen e një ekspozite me punime të nxënësve e shoqëruar edhe me punime të artistëve të afirmuar. Në shtypin e ditës artistët shprehnin pa rezerva pritshmëritë e tyre se tashmë arti ishte futur në rrugë të mbarë.

Shkollës së vizatimit në Shqipëri i shërbeu krijimtaria e shquar e traditës shqiptare. Për forcimin e saj, kurorëzimin e vlerave të traditës, shkolla krijoi qartë që në fillim profilin e saj kombëtar.

Fjalët kyçe: shkolla e vizatimit, Shqipëria, piktor, tradita, ekspozita, shoqëria "Miqtë e artit".

The first drawing school in Albania

ABSTRACT

The article aims to document the history of the first school of drawing in Albania. The starting point of the history of the drawing school begins with the "Friends of Art" society. This society was created by a large group of artists and other intellectuals. On May 10, 1931, with the initiative of the watercolorist Q. Mesarea and the sculptor O. Paskali, the "Friends of Art" society was created. With the interest of the intellectuals who were part of the artistic community and the "Friends of Art" society, in May

1931 in Tirana, the drawing course led by the painter Andrea Kushi was opened for the first time. After about a year, in January 1932, the drawing school was founded under the direction of the Italian professor Mario Ridola. The closing of the school year was accompanied by the opening of an exhibition of works by students, accompanied by the works of established artists. In the press of the day, artists expressed without reservation their expectations that art was now on the right track.

The school of drawing in Albania was served by the outstanding creativity of the Albanian tradition. For its strengthening, crowning of the values of tradition, the school clearly created its national profile from the beginning.

Keywords: drawing school, Albania, painter, tradition, exhibition, "Friends of Art" society.

Hyrje

Krijimtaria artit në Shqipëri, në stilin bizantin e pasur me ikona dhe objekte me vlera artistike, pasi arriti me shkëlqimin e saj me Onufrin, Shpatarakun, Selenicasin gjatë dhjetëra e dhjetëra vjetësh, më pas kaloi në një "përsëritje artizanale" dhe të banalizuar të modeleve të hershme¹

Këtë heshtje të gjatë e prishën pikërisht dy pikturat që u krijuan në vitin 1883 "Motra Tone" e Kolë Idromenos dhe "Skënderbeu" i Jorgji Panaritit.

Drejtimi i ri që filloi në pikturën shqiptare pas vitit 1883 ndryshon nga ai i mëparshmi jo vetëm për tematikën, stilin dhe teknikën e pikturimit, por edhe për destinimin e veprave. Në Shqipëri ekspozitat janë organizuar për herë të parë pikërisht në këtë fazë të re, pra pas vitit 1883. Në krahasim me vendet e tjera evropiane largësia kohore është shumë e madhe, por po të bëjmë paralelizma me artin e vendeve përreth, pavarësisht nga mospërputhja në kohë gjenden anë të përbashkëta, si dhe dallimet midis tyre.²

Sipas studiuesit Ferid Hudhri, ku ai shprehet, se për veprimtaritë më të hershme, tani nuk mund të përcaktohet një datë e saktë për "ekspozitën e parë të artit", por si për çdo veprimtari të këtij lloji, ka përpjekje më të hershme edhe pse ato nuk janë plotësisht të kurorëzuara.³

Ekspozitat e artit të organizuara në mënyrë të rregullt në Shqipëri

¹ Andon Kuqali "Historia e artit shqiptar" nr.1, Instituti i Lartë i Arteve, Katedra e Lëndëve shoqërore dhe Historisë së artit, f. 3.

² Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", Tiranë, 2000, f.13.

³ Po aty, f.13.

fillojnë pas vitit 1900. Disa të dhëna të reja na çojnë në një kohë më të largët. Në vitin 1898 në shkollën e djemve në Shkodër janë ekspozuar dhjetëra vizatime të piktorit të ardhshëm Ndoc Martini.

Me gjithë mangësitë e komunikimit të asaj kohe jehona e vizatimeve të Ndoc Martinit i kapërcen dhe kufijtë e Shqipërisë. Po atë vit një gazetë që botohej në Napoli do të nënvizonte se "*Vizatimet me laps të djaloshit Ndoc Martini me shumë mjeshtri dhe finesë artistike e bëjnë të dallohet si gjeni dhe të ngjallë çudi te vizitorët*".⁴

Krijimtaria e mëvonshme ka veçuar Martinin midis artistëve më të talentuar. Jashtë Shqipërisë janë hapur edhe ekspozita të tjera nga autorë shqiptarë. Piktori Theohar Gjini, pasi mbaroi Akademinë e Arteve të Bukura në Bukuresht më 1899, ka hapur dy ekspozita në Rumani dhe pas vitit 1906 është zhvendosur në Paris, ku jetoi, krijoi dhe ekspozoi deri në fund të jetës dhjetëra e dhjetëra vepra me temë shqiptare.⁵

Në të njëjtën kohë në Italinë e Jugut, në La Plata të Argentinës e më vonë në Nju Jork, skulptori arbëresh Mikel Trota, ka ekspozuar statujat "Nusja shqiptare", "Bariu shqiptar" dhe vepra të tjera nga mëmëdheu.⁶

Është një rast i veçantë në historinë e arteve pamore shqiptare, që pesë ekspozita të hapura në një hark kohor prej 25 vjetësh të vlerësohen me të njëjtën rëndësi dhe secila prej tyre të përcaktohet si "ekspozita e parë". Kjo ka ndodhur pikërisht në artin shqiptar. Të pesë ekspozitat më të rëndësishme janë hapur nga viti 1920 deri në vitin 1945. Janë paraqitur në gazetatat dhe revistat e viteve përkatëse si "*E para ekspozitë arti në Shqipëri*".⁷

Në vitin 1920 në Korçë është hapur ekspozita e piktorit Vangjush Mio. Kjo është ekspozita e parë e artit në Shqipëri. Për vetë Vangjush Mion është e dyta. Përsëri kemi të bëjmë me një rast tepër të veçantë, ekspozita e dytë e një piktori, quhet ekspozita e parë për të gjithë vendin. Kjo ka ndodhur, sepse ekspozitën e tij të parë, Vangjush Mio e ka organizuar jashtë vendit, në Bukuresht më 1919.⁸

Pas tre vjetësh më 1923, ekspozita që u hap në Shkodër është quajtur e para jo veç në Shkodër, por edhe në Shqipëri. Në të vërtetë, kjo është ekspozita e dytë e artit, por ndërkohë është ekspozita e parë kolektive

⁴ "La nuova Albania", I. II, 1998, f.5. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri" 2000, f. 41.

⁵ Gazeta "Kombi", 19 nëntor, f. 3, Boston, 1906, "Lidhja Ortodokse", 17 nëntor. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.41.

⁶ O.Irani: "Un scultore albanese", në librin "Risveglio Albanese", f.22, New Zourk, 1911. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 41.

⁷ Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.15.

⁸ Po aty.

lokale, pasi aty, ndryshe nga ekspozita në Korçë, e cila ishte vetëm me punimet e Mios, në Shkodër kanë marrë pjesë të gjithë artistët e qytetit.⁹

Nëse të dyja ekspozitat e mësipërme kaluan pa shumë bujë (pas tyre u hapën dhe dy të tjera nga Vangjush Mio në Korçë më 1926 dhe në Tiranë më 1928), një ekspozitë tjetër që u hap në Tiranë më 1931 pati jehonë përpara se të përurohej. Më 26 maj të vitit 1931 në gazetën e përditshme "Ora" në faqe të parë u botua me shkronja të mëdha "E para ekspozitë arti".¹⁰ Përshtypja ka qenë e jashtëzakonshme. Kronologjikisht ajo ishte ekspozita e pestë. Në të njëjtën kohë ajo është veprimtaria e parë në shkallë kombëtare për artet pamore. Më pas u hapën dhe ekspozita të tjera kryesisht vetjake, si: Vangjush Mio në Korçë viti 1933 dhe A. Zengo në Tiranë, 1937.

Ekspozita kombëtare e vitit 1931 është veprimtaria më e rëndësishme në fushën e artit. Ajo ka luajtur një rol të veçantë në zhvillimin e mëpastajmë të pikturës dhe skulpturës shqiptare. Suksesi i saj u kurorëzua me themelimin në Tiranë të shkollës së parë të artit në Shqipëri në vitin 1931. Kjo ekspozitë nxiti piktorët që disa nga veprat e tyre t'ia dhuronin shoqërisë "Miqte e artit" për të krijuar pinakotekën kombëtare.¹¹

Shoqëria "Miqte e artit"

Pikënisja e historikut të shkollës së vizatimit fillon nga shoqëria "Miqte e artit". Në fillim të viteve '30 në Tiranë u krijua një grup më i madh artistësh dhe intelektualësh të tjerë të cilët sapo kishin kryer studimet jashtë vendit. Nga diskutimet për ngritjen kulturore të vendit lindi nevoja e krijimit të një shoqate të përbashkët. Më 10 maj të vitit 1931, me nismën e akuarelistit Q. Mesarea dhe skulptorit O. Paskali, u krijua shoqëria "Miqte e artit". Ajo kishte për qëllim zhvillimin e artit në përgjithësi në të gjitha shfaqjet e veta.¹²

Në statutin dhe në programet që hartuan me këtë rast u përcaktuan të organizoheshin konferenca, konkurse e koncerte si veprimtari e parë që do të bëhej nga kjo shoqëri, u caktua organizimi i ekspozitës kombëtare më 24 maj të po atij viti. Koha për organizimin e saj qe e shkurtër, rreth dy javë. O. Paskali shkoi menjëherë në Shkodër, Pogradec, Korçë ku u njoh me krijmtarinë e Idromenos, Rrotës, Mios dhe arriti të sigurojë

⁹ Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.15.

¹⁰ Gazeta "Ora", "E para ekspozitë arti", 1931, f.1. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.41.

¹¹ O. Paskali, "Gjurmë jete", shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1986, f.79. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.41.

¹² Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 25.

pjesëmarrjen e tyre në ekspozitë.¹³ Idromeno i dha dhe tablonë "Dr. Prela" të N. Martinit që nuk jetonte.

Me rastin e ekspozitës u përgatit dhe një broshurë me titullin "E para ekspozitë arti" ku riprodhuan veprat e ekspozuara dhe u paraqitën disa shkrime për artin. Lista e pjesëmarrësve dhe katalogu ku janë regjistruar të gjitha veprat me titujt e tyre të ndara, sipas autorëve dhe numrit të vendosjes në ekspozitë. Gjithsej aty janë shënuar 158 tituj tablosh, portretesh, peizazesh, akuarelesh, skulpturash dhe llojeve të tjera. Numri më i madh i veprave është paraqitur nga dy organizatorët kryesorë: akuarelisti Qenan Mesarea (73 portrete, peizazhe dhe vizatime) dhe skulptori Odhise Paskali (23 studime, portrete, figurina dhe projektet për monumentet e ardhshme).¹⁴



Fig.1 Qenan Mesarea, portret akuarel



Fig.2 Odhise Paskali, portret gruaje, 1926 gips.

Ekspozita e vitit 1931 ishte kurorëzimi i suksesshëm i përpjekjeve më të hershme që nisnin në mënyrë të shkallëzuar me ekspozimin e N. Martinit (1898), ekspozitën vetjake të Mios (Korçë, 1920), me ekspozitën lokale të Shkodrës (1923) e për të arritur në një pikë më të lartë në ekspozitën kombëtare. Pas kësaj veprimtarie jeta artistike në Tiranë dhe në rrethe u bë më e gjallë rrethe u bë më e gjallë.

¹³ Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 25.

¹⁴ Po aty.

Me krijuesit e Tiranës ishte më e lehtë grumbullimi i veprave. Për ekspozitën u caktua lokali më i parapëlqyer i asaj kohe, ish-kafe "Kristal-Tirana".¹⁵ Në një kohë të shkurtër u rregullua me kujdes paspartimi dhe ekspozimi i të gjitha punimeve dhe më 24 maj, ditën e diel në orën 11 rreth ndërtesës së "Kristalit", u mblodhën shumë banorë të kryeqytetit që morën pjesë në ceremoninë e hapjes. Fjalën e rastit e mbajti Hil Mosi. Ai iu foli i mallëngjyer dhe me entuziazëm për këtë ngjarje të rëndësishme siç kujtojnë bashkëkohësit.¹⁶

Në këtë aktivitet e mori fjalën edhe mësuesi patriot Mati Logoreci. Në fjalimin e tij ai lartësoi nismën e shoqërisë "Miqtë e artit" për organizimin e ekspozitës, u prit me duartrokitje dhe u ndoq me vëmendje. Vizitorët e ndoqën me interes ekspozitën, u pëlqyen shumë punimet, vlerësuan punën e çmuar të këtyre talenteve. Veçanërisht tablotë e Kol Idromenos, Andrea Kushit, Ndoc Martinit, Simon Rrotës, peizazhet e Vangjush Mios. Më të bukurat spikatën krijimet në skulpturë të artistit të ri Odhise Paskali, ato janë gdhendur në kujdes prej daltës së hollë, me dorën e stërvitur. Odhise Paskali kishte ekspozuar 8 punime në bronz si dhe maketin e varrit monumental të Ismail Qemalit.¹⁷

Shkolla e vizatimit

Deri tani nuk njihen përpjekje shumë të hershme për hapjen e ndonjë shkolle arti. "Pranë Idromenos, në Shkodër mblidheshin të rinj që ëndërronin të bëheshin artistë dhe mjeshtri i mbante gjatë në studio, u mësonte magjinë e pikturës, por ende nuk kemi të dhëna të sakta, nëse arriti të krijojë qoftë edhe një kurs të shkurtër, të rregullt. Vetë krijmtaria e Idromenos shërben si shkollë arti në disa breza të piktorëve shkodranë."¹⁸

"Flitet se në Shkodër ka ekzistuar për një kohë të shkurtër edhe "shkolla e huaj e mjeshtrive dhe arteve",¹⁹ ku mësimin e pikturës e jepte piktori italian Saverio Polaroli. Kanë shkruar se një nga nxënësit e tij më të talentuar ka qenë Simon Rrota. Ndërsa vetë piktori Rrota në një dorëshkrim

¹⁵ Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 25.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Dh.Dhamo, "Mbi karakterin kombëtar dhe realist të arteve tona figurative", revista "Studime historike", nr.2, Tiranë, 1971, f. 25. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 86.

¹⁹ Për më gjerë shih: Dhimitër Shuteriqi, "Mbi piktorin David Selenica dhe mbi Voskopojën", Tiranë, 1984, gazeta "Drita", 29 janar, f.12 dhe 5 shkurt, f.12. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 86.

të hershëm (botuar pjesërisht më 1961) përmend si nxënës të S. Polarotit edhe disa piktorë të tjerë shkodranë pak të njohur.²⁰

Është thënë se në Korçë ka ekzistuar për një kohë të shkurtër kursi i vizatimit pranë studios së Spiro Xegës, por ende nuk ka të dhëna për veprimtarinë dhe për piktorët që mësonin aty. Në një mbremje përkujtimore kushtuar S. Xegës, piktori Guri Madhi ka treguar se në fillim të viteve '30, Nikollë Lako dhe Spiro Xega, organizonin në Korçë një kurs vizatimi dhe aty ai ka marrë mësimet e para si një nga pjesëmarrësit e atij kursi.²¹

Gjatë viteve '20-'30 ka dhënë mësim në Liceun e Gjirokastrës dhe në gjimnazin e Tiranës edhe piktori francez F. Marshand. Thuhet se gjatë kohës së lirë ai pikturonte tablo, portrete nga Shqipëria, por nuk njihet ndonjë përpjekje e tij për hapjen²² e ndonjë kursi për artistët e rinj. Rastet e mësipërme mbeten vetëm përpjekje të paarritura për kurorëzimin e kurseve të thjeshta të cilat mund të funksiononin rregullisht si shkolla të vizatimit. Gjithsesi ato shërbyen si përvojë dhe traditë e mirë.

Nën drejtimin e piktorit Andrea Kushi, që në atë kohë ishte mësues në gjimnazin e Tiranës, në muajin maj 1931 në Tiranë u hap për herë të parë kursi i vizatimit. Pra mësimin e rregullt të artit në Shqipëri e filloi njëri nga artistët më të mirë të traditës. Intelektualët që bënë pjesë në komunitetin artistik dhe në shoqërinë "Miq të artit" u interesuan për organizimin e këtij kursi. Përpjekjet për të ngritur shkollën artistike kishin filluar para se të hapej Ekspozita Kombëtare. Vetë artistët, pedagogët e ardhshëm të shkollës, herë pas here, mbanin në studiot e tyre mysafirë të rinj që dëshironin t'i përkushtoheshin artit. Me gjithë këto shenja premtuese as vetë krijuesit dhe intelektualët më optimistë të asaj kohe nuk mund të mendonin se kërkesat për shkollë arti ishin aq të mëdha.²³

Kronika e vitit 1931 tregon se interesimi dhe entuziazmi i të rinjve për kursin e parë të artit ishte jashtë çdo parashikimi. Komentet e shtypit ishin gjithashtu mjaft entuziaste.²⁴

Më 12 maj 1931 u inagurua kursi i vizatimit, ku u paraqitën 150

²⁰ O. Degrand, "Souvenirs de la Haute Albanie", Valter edit Paris 1901, f. 276. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.44.

²¹ A.Sadikaj, Restaurimi i tablosë "Dy rrugët" e piktorit Kolë Idromeno, revista "Monumentet", nr.11, f.42. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f.44.

²² H. Nallbani, Tabloja "Dy rrugët" dhe restaurimi i saj, gazeta "Drita", f.11, datë 18 maj, Tiranë, 1980. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 45.

²³ H. Nallbani, Tabloja "Dy rrugët" dhe restaurimi i saj, gazeta "Drita", f.11, datë 18 maj, Tiranë, 1980. Cituar nga Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", 2000, f. 45.

²⁴ Ferid Hudhri, Studime mbi artin, Akademia e Shkencave, Qendra e studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f. 68.

kandidatë, djem e vajza. Instruktorët vunë re se të rinjtë shqiptarë shfaqnin interes të madh për artin, madje edhe më shumë nga sa ata e kishin parashikuar. Salla në të cilën zhvillohej kursi ishte shumë e bukur, e zbukuruar në mënyrë që t'i aspirojë kursantët e zellshëm dhe të lehtësojë në zbulimin e disa talenteve e pasioneve artistike të panjohura. Fatkeqësisht salla është e ngushtë për 150 veta.²⁵

Përzgjedhja e kandidatëve u bë sipas aftësive. U bë dhe një përzgjedhje tjetër e detyruar prej përmasave të sallave ku do të zhvilloheshin mësimet. Pjesëmarrja e paparashikuar për të marrë pjesë në konkurs (150-ta është një shifër që edhe sot na duket e madhe për të konkurruar në pikturë dhe skulpturë).²⁶ Suksesi i ekspozitës kombëtare ishte tregues i qartë se Tirana e vitit 1931 kërkonte hapësira të reja për artet e bukura. Dhe këto hapësira nuk mund t'i mbushte një kurs i thjeshtë vizatimi. Vendin e tij e zuri Shkolla e Vizatimit e cila ka qenë e para shkollë në Shqipëri.

Dokumenti që njofton themelimin e shkollës së vizatimit mban datën 29.01.1932, pra rreth një vit pas kursit që ngriti Andrea Kushi. Sipas shkresës së Ministrisë së Arsimit, *“Komiteti Artistik ka themeluar një shkollë vizatimi që ka për qëllim të stërvitë në arte të bukura gjithë djemtë që tregojnë aftësi të veçantë. Shkolla drejtohet prej Z.Prof. Mario Ridola, organizator i Komitetit Artistik, i ndihmuar nga Andre Thonasi, prof.i gjimnazit. Lutemi të inkurajohen nxënësit e gjimnazeve të vendit të tregojnë aftësi në vizatim për të frekuentuar shkollën e lartpërmendur.”*²⁷

Kandidatët që do të vazhdonin shkollën u nënshtroheshin konkurseve edhe nëpër prefektura. Drejtuesi i shkollës piktori italian Ridola interesohej vetë për të marrë në shkollë më të talentuarit. Pasi kaluan vështirësitë e fillimit, shkolla nisi jetën e saj. U përgatitën studiot e punës me tavolina e kavaleta, u sollën nga jashtë modele në gips, ngjyra dhe materiale të tjera pune. Pas bujës së ditës së konkurrimit, ku veç pjesëmarrësve të shumtë ishin edhe kureshtarët, vazhduan përpjekjet e mësuesve dhe të nxënësve për të përballuar vështirësitë. Në shkollë gjatë atij viti janë bërë vizatime të bukura. Edhe vetë piktori Ridola ka punuar bashkë me nxënësit. Ka realizuar disa tablo nga jeta shqiptare.²⁸

²⁵ P. Lubonja, Galeria e Arteve Figurative, “Ylli”, nr. 2, Tiranë, 1954, f. 24. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, “Onufri”, 2000, f. 52.

²⁶ Ferid Hudhri, Studime mbi Artin, Akademi e Shkencave, Qendra e Studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f.69.

²⁷ Sipas dokumentit që ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit Tiranë, fondi Ministria e Arsimit e Kulturës, dosja nr.13 viti 1932. Cituar nga Ferid Hudhri, Studime të Arteve, Akademia e Shkencave, Qendra e studimit mbi artin, Tiranë, 1995, f. 69.

²⁸ Ferid Hudhri, Studime mbi Artin, Akademi e Shkencave, Qendra e Studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f. 70.

Me të gjitha krijimet e nxënësve dhe mësuesve, me rastin e mbylljes së vitit shkollor, u hap ekspozita me pjesëmarrjen e nxënësve, piktorëve dhe skulptorëve shqiptarë që krijojnë në ato vite, ku pjesën më të madhe të punimeve e përbënin nxënësit e shkollës së vizatimit. Në këtë ekspozitë veçohen krijimet e ish - nxënësve Sadik Kaceli, Gani Strazimiri dhe Bukurosh Sejdi.²⁹

Veçanërisht tërhiqen vëmendjen nga të gjithë vizitorët tablotë me përmasa të mëdha të z. Mario Ridola, drejtor i shkollës së vizatimit. Piktori italian ka realizuar edhe vepra me temë shqiptare. Kështu mjeshtri Ridola vlerësohet jo vetëm për punën si drejtues i shkollës së vizatimit, por edhe për realizimin e shumë tablove dhe me temë shqiptare.³⁰ Ekspozita e vitit 1932 ka rëndësi për faktin, sepse të gjitha punimet e paraqitura në këtë ekspozitë, u bënë nga bashkimi i të gjithë artistëve shqiptarë në një veprimtari të përbashkët.



Fig.3 Disa nga krijimet e para të nxënësve të shkollës së vizatimit.

²⁹ Ferid Hudhri, Studime mbi Artin, Akademi e Shkencave, Qendra e Studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f. 70.

³⁰ Po aty f.71.

Fig.4 *Sadik Kaceli Portret malësori.*

Vlerat kombëtare të shkollës së vizatimit

Shkollës së vizatimit në Shqipëri i shërbeu krijmtaria e shquar e traditës së pikturës shqiptare. Mësimdhënësi i parë i kursit Andrea Kushi kishte qenë nxënës i Idromenos, piktorit më të shquar të traditës. Odhise Paskali dhe Abdurrahim Buza ishin gjithashtu artistë të formuar me vlera të artit kombëtar.

Lasgush Poradeci, poeti i shquar i viteve '30, ka qenë gjithashtu një nga mësuesit e pikturës në shkollë. Më shumë se me stilin e pikturimit ai ndikoi në frymën kombëtare të shkollës me idealet e tij rilindase.³¹

³¹ Ferid Hudhri, Studime mbi Artin, Akademi e Shkencave, Qendra e Studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f. 74.

Për forcimin e saj dhe kurorëzimin e vlerave të traditës, shkolla krijoi qartë që në fillim profilin e saj kombëtar. Veç artistëve shqiptarë, Paskali, Kushi, Buza dhe Poradeci, duhet çmuar platforma e qartë e artistit italian Ridola. Ai që i pajisur me diplomë të studimeve të larta në Akademinë e Arteve të Romës, me përvojë të gjatë krijuese, pjesëmarrës në ekspozita ndërkombëtare Buenos-Ajres, Anvers, Paris etj., njohës i mirë i psikologjisë dhe traditave shqiptare. Nëpër atelietë e vizatimit, pikturës dhe skulpturës pozonin të rinj, gra dhe të moshuar me veshje kombëtare. Në punimet e tyre nxënësit fiksonin psikologjinë e botën e shqiptarëve të viteve '30, ndërsa me pikturimin e veshjeve kombëtare ata njëkohësisht njiheshin me vlera tradicionale artistike dhe ndikoheshin nga mjeshtria e artit popullor.³²

Mësuesit A. Kusha, O. Paskali, A. Buza, ndikuan në vlerat kombëtare të shkollës jo vetëm me modelet që sillnin, me mësimet që jepnin, por edhe me veprat që krijuan gjatë atyre viteve. Shkolla e vizatimit gradualisht u kthye një qendër e vogël e arteve figurative. Aty përgatiteshin artistët e ardhshëm, aty hapeshin ekspozita me krijime të nxënësve dhe mësuesve, si edhe në pjesëmarrjen e piktorëve dhe skulptorëve të tjerë.³³ Sallat e shkollës së vizatimit janë përdorur edhe për ekspozita të autorëve që punonin jashtë shkollës, madje edhe për punime të autorëve të huaj. Në sallat e shkollës së vizatimit u organizua edhe një nga veprimtaritë më të rëndësishme të viteve '30 të arteve figurative. Më 1937 aty u zhvillua konkursi ndërkombëtar për monumentin e Skënderbeut.³⁴

Mbasi mbaruan shkollën e vizatimit pjesa me madhe e ish-nxënësve vazhduan studimet në Akademinë e Arteve në vende të ndryshme të Evropës. Një nga më të talentuarit, Ibrahim Kodra studioi në Akademinë e Arteve të Breras në Milano. Pas studimeve nuk u kthye më dhe sot vlerësohet si një nga piktorët më të njohur në Itali dhe Evropë. Ish-nxënës të tjerë të kësaj shkolle që vazhduan studimet në Akademinë e Romës, Firences, Parisit dhe Athinës u kthyen përsëri në Shqipëri.³⁵

Disa prej tyre u bënë mësues të brezit më të ri të artistëve shqiptarë. Shkolla e vizatimit, ish - mësuesit dhe nxënësit të saj, zënë vend nderi në historinë e artit shqiptar. Aty u hodhën hapat e parë në rrugë profesionale në zhvillimin e arteve pamore, aty kanë pikënisjen shumë nga veprat më të mira të traditës, aty u përgatitën mësuesit e ardhshëm të brezit më të ri të

³² Ferid Hudhri, Studime mbi Artin, Akademi e Shkencave, Qendra e Studimit të Arteve, Tiranë, 1995, f.75.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

artistëve shqiptarë.

PËRFUNDIME

Deri në shpalljen e vendit monarki, në fushën e artit në Shqipëri, ishin hapur fare pak ekspozita artistike. Kishim të bënim më tepër me ekspozita të improvizuara, të cilat po përgatisin terrenin për krijimin e një atmosfere bashkëpunimi në rang kombëtar. Komentet e shtypit të kohës ndërkohë theksonin nevojën e krijimit të institucioneve ku mund të mësoheshin teknikat artistike.

Deri në fillim të viteve '30 brezat e rinj kishin mësuar në studiot e qyteteve të tyre ose, sipas mundësive, kishin frekuentuar institucionet e mesme apo të larta të vendeve fqinje.

Institucioni kombëtar i veprimtarisë artistike do të merrte formë më të plotë vetëm më 10 maj 1931 me krijimin e shoqërisë "Miqtë e artit" nga Odhise Paskali e Qenan Mesarea. Formimi i kësaj shoqërie ishte dëshirë e shumë intelektualëve ku do të propozohej një frymë e re në rang kombëtar.

Më 24 maj, dy javë pas krijimit të shoqërisë "Miqtë e artit", kjo shoqëri realizon të parën ekspozitë kombëtare, ku morën pjesë 15 artistët më në zë të kohës, si: K.Idromeno, O. Paskali, V. Mio, Z. Kolombi, S. Rota, N. Martini, S. Xega e Q. Mesarea. Në këtë ekspozitë u dalluan punimet në akuarel të Q. Mesareas dhe skulpturat e O.Paskalit.

Në maj të vitit 1931 në Tiranë u hap për herë të parë kursi i vizatimit i drejtuar nga piktori i traditës Andrea Kushi. Për organizimin e kursit u interesuan dhe intelektualët e tjerë që bënin pjesë në komunitetin artistik dhe në shoqërinë "Miqtë e artit". Ngjarja u prit me entuziazëm të madh dhe pati dyndje të madhe. Kjo tregoi qartë për domosdoshmërinë e ngritjes së një institucioni më të madh. Pas rreth një viti, në janar të vitit 1932 u themelua shkolla e vizatimit nën drejtimin e profesorit italian Mario Ridola. Në shtypin e ditës artistët shprehnin pa rezerva pritshmëritë e tyre se tashmë arti ishte futur në rrugë të mbarë. Hapja e ekspozitës në fund të vitit shkollor në vitin 1932 ka rëndësi për faktin se me punimet e paraqitura në të u bë bashkimi i të gjithë artistëve shqiptarë në një veprimtari të përbashkët. Aty morën pjesë piktorë dhe skulptorë nga i gjithë vendi. Për forcimin e saj, për kurorëzimin e vlerave të traditës, shkolla krijoi që në fillim profilin e saj kombëtar.

Pas ekspozitës së parë, qershor 1932, në shkollën e vizatimit u hapën edhe ekspozita të tjera me krijimet e nxënësve, mësuesve dhe piktorëve e skulptorëve profesionistë dhe amatorë. Shkolla e vizatimit

gradualisht u kthye në një qendër të vogël të arteve figurative. Në sallat e shkollës së vizatimit u organizua një nga veprimtaritë më të rëndësishme të viteve '30 për artet pamore. Në vitin 1937 në mjediset e kësaj shkolle u zhvillua konkursi ndërkombëtar për monumentin e Skënderbeut. Shkolla e vizatimit zë një vend nderi në historinë e artit shqiptar. Aty u hodhën hapat e parë për zhvillimin e arteve pamore. Në këtë shkollë u përgatitën mësuesit e ardhshëm të brezit më të ri të artistëve shqiptarë.

BIBLIOGRAFIA

1. A.Hado, "Një portret i panjohur i K.Idromenos", gazeta "Drita", datë 8 qershor, Tiranë, 1983.
2. Andon Kuqali "Historia e artit shqiptar" nr.1, Instituti i Lartë i Arteve Katedra e Lëndëve Shoqërore dhe Historisë së Artit.
3. A.Sadikaj, Restaurimi i tablosë "Dy rrugët" e piktorit Kolë Idromeno, revista "Monumentet", nr.11, f.42. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
4. Dokumenti që ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit Tiranë, fondi Ministria e Arsimit e Kulturës, dosja nr.13 viti 1932. Cituar nga Ferid Hudhri, Studime mbi artin, Akademia e Shkencave, Qendra e studimit të arteve, Tiranë, 1995.
5. Dh.Dhamo, "Mbi karakterin kombëtar dhe realist të arteve tona figurative", revista "Studime historike", nr.2, Tiranë, 1971, f. 25. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
6. Dhimitër Shuteriqi, "Mbi piktorin David Selenica dhe mbi Voskopojën", Tiranë. 1984, gazeta "Drita", 29 janar, f.12 dhe 5 shkurt, f.12. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
7. Ermir Hoxha, *Historia e artit shqiptar (1858-2000)*, Albdesing, Tiranë, 2019.
8. Ferid Hudhri, *Arti i Rilindjes Shqiptare*, "Onufri", Tiranë, 2000.
9. Ferid Hudhri, *Studime mbi artin*, Akademia e Shkencave, Qendra e studimit të Arteve, Tiranë, 1995.
10. Gazeta "Kombi", 19 nëntor, f. 3, Boston, 1906, "Lidhja Ortodokse", 17 Nëntor. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
11. Gazeta "Ora", "E para ekspozitë arti", 1931, f.1. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri" 2000, f.41.
12. H. Devolli, "Galeria e Arteve të Bukura", revista "Nëntori", nr.2, Tiranë, 1954.
13. H. Nallbani, Tabloja "Dy rrugët" dhe restaurimi i saj, gazeta "Drita", f.11, datë 18 maj, Tiranë, 1980. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000, f.45.
14. "La nuova Albania", I.II, 1998, f. 5. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.

15. O. Degrand, "Souvenirs de la Haute Albanie", Valter edit Paris, 1901, f. 276.
Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
16. O.Irani: "Un scultore albanese",në librin "Risveglio Albanese",f. 22, New Zourk,1911. Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.
17. O. Paskali, "Gjurmë jete", SH.B, "8 Nëntori",Tiranë,1986.
18. P. Lubonja, Galeria e Arteve Figurative, "Ylli", nr. 2, Tiranë, 1954, f. 24.
Cituar nga Ferid Hudhri, Arti i Rilindjes Shqiptare, "Onufri", 2000.

**MODELI I DREJTIMIT DHE DIFERENCAT
PERCEPTUESE MBI MARRJEN E VENDIMEVE
NË SHKOLLË
(RASTI I QARKUT DURRËS)**

Anila Plaku

Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"

ABSTRAKT

Mbështetur në perceptimet e mësuesve, përgjegjësve të departamentit dhe drejtuesve (në shkollat 9-vjeçare të qarkut-Durrës), ky studim kishte si qëllim të hulumtonte mbi perceptimin e stafit mësuesor në marrjen e vendimeve. Në të njëjtën kohë studimi hulumton mbi marrëdhënien midis modeleve të lidhshme (strukturor, human, politik, simbolik) dhe vendimmarrjes.

Pjesëmarrësit në këtë studim ishin 70 mësues, 30 përgjegjës departamenti dhe 30 drejtues, përzgjedhur me anë të teknikës së zgjedhjes së kampionit me bazë grupi. Në këtë studim u përdor kërkimi cilësor, dhe si instrument kërkimor u përdor intervista gjysmë e strukturuar me drejtues, mësues dhe përgjegjës departamentesh. Po ashtu u përdor edhe vrojtimi dhe si instrument kërkimor u aplikua një listë kontrolli që vëzhgoi sjelljet drejtuese dhe reagimin e stafit në 8 shkolla, për një periudhë afro 2-mujore.

Nga gjetjet kërkimore vihet re se ekzistojnë diferenca perceptuese referuar vendimmarrjes në shkollë. Gjithashtu vihet re se shfaqet reaguese të mësuesve në vendimmarrje aktive, përfshirja e tyre në hartimin e planit vjetor, module dhe projekte kurrikulare, lidhen ngusht me shfaqje të sjelljes drejtuese, sipas modelit strukturor, human, politik dhe simbolik. Rekomandohet se kombinimi i modeleve të drejtimit, sipas situatës dhe rolit drejtues, përfshin stafin, rrit shkallën e besimit, ndikon në marrjen e vendimeve të mira për palët, si dhe redukton shfaqjen e mekanizmave mbrojtës, të përdorura nga stafi.

Fjalë kyçe: modeli strukturor, modeli human, modeli politik, modeli simbolik, vendimmarrje.

Leadership Model and Perceptual Differences on School Decision-Making:

(The case of the district of Durrës)

ABSTRACT

Based on the perceptions of teachers, department managers and leaders (in the Case of 9-Year School in Durrës District), this study aims to investigate the perception of the teaching staff in making decisions. At the same time, the study investigates the relationship between leadership models (structural, human, political, symbolic) and decision-making.

The participants in this study were 70 teachers, 30 department heads and 30 principals, selected using the group-based sampling technique. In this study, qualitative research was used, and as a research instrument, semi-structured interviews with headmasters, teachers and heads of departments were used. The observation, as a technique, was also used and as a research instrument, a checklist was applied that observed management behaviours and staff reactions in 8 different schools, for nearly 2 months period.

From the research findings, it is noted that there are perceptual differences in decision-making at schools. The reactive displays of teachers in active decision-making are also noted. Their involvement in the design of the annual plan, modules and curricular projects, is closely related to displays of leadership behaviour, according to the structural, humane, political and symbolic model. It is recommended that the combination of leadership models according to the situation and the leading role, involves the staff, increases the degree of trust, affects the making of good decisions for the parties, as well as reduces the emergence of defense mechanisms used by the staff.

Keywords: structural model, human model, political model, symbolic model, decision-making.

Hyrje

Møller (1996) parashtron specifikën e “gjuhës së dilemave” për lidhshipin e shkollës, bazuar në përshkrimet dhe reflektimet mbi praktikën e përditshme ose siç i quan ndryshe të lidhshipit në veprim. Møller evidenton: autonominë profesionale përkundrejt kontrollit administrativ,

ndryshimin përkundrejt stabilitetit, besnikërinë ndaj nxënësve dhe prindërve përkundrejt besnikërisë ndaj mësuesve, zgjidhjen e problemeve ad-hoc përkundrejt reflektimit dhe planifikimit afatgjatë³⁶. Pettigrew (1977) pohon se formulimi i strategjisë mund të kuptohet si një proces i vendimmarrjes politike. Ky proces do të përfshijë debatin në lidhje me dilemat që duhet të marrin vëmendje organizative dhe zgjedhjen e kurseve alternative të veprimit që duhen adoptuar për zgjidhjen e këtyre dilemave³⁷. Sipas Argyris (1991), profesionistët mishërojnë dilemat e nxënies: ata janë entuziastë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe shpesh pengesat më të mëdha i çojnë drejt suksesit³⁸.

Stacey (2011) sqaron se nga shekulli i pesëmbëdhjetë e tutje “politika” nënkupton “një shteg të menaxhimit” ose “një plan veprimi”, kombinuar me synime të nivelit të lartë, procedura të pranuar dhe kurse veprimi. Të gjitha përcaktojnë drejtimin për vendimet e ardhshme³⁹.

Bush (2011: 112) thekson se liderët e edukimit mund të adoptojnë një apo disa strategji politike me kusht që të mbajnë dhe zgjerojnë kontrollin e tyre ose të sigurojnë një rezultat të favorshëm për një proces vendimmarrjeje. Duke përdorur burimet e tyre të pushtetit, shpesh ata janë të aftë të përfitojnë mbështetje ose pajtueshmëri me pozicionin e preferuar⁴⁰. Duke marrë parasysh si ndikon pasiguria në proceset e marrjes së vendimeve, një numër autorësh kanë lidhur proceset e duhura të vendimmarrjes me kontekstin në të cilin vendimi duhet të merret. Për shembull, Thompson and Tuden (1959), lidhën mënyrën e marrjes së vendimeve nga kombinimet e shkallës së qartësisë në marrëdhëniet shkakësore dhe shkallën e marrëveshjes mbi objektivat. Aty ku lidhjet e shkakësisë janë të qarta dhe objektivat bashkëvendosen, thuhet se ekzistojnë kushtet që menaxherët të marrin vendime në një mënyrë racionale-logjike. Nëse menaxherët lëvizin nga këto kondita, bëhet i pamundur aplikimi i logjikës së racionalitetit vendimmarrës, kështu që duhet të përdoren qasje të tjera. Kur lidhjet e shkakësisë janë të qarta, por

³⁶Møller, J. (1996). Reframing Educational Leadership in the Perspective of Dilemmas. *School administration: Persistent dilemmas in preparation and practice*, 3-17.

³⁷ Pettigrew, A. M. (1977). Strategy formulation as a political process. *International Studies of Management & Organization*, 7(2), 78-87.

³⁸ Argyris, C. (1991). Teaching smart people how to learn. *Harvard business review*, 69(3).

³⁹ Stacey, R. (2011). *Management and Organisational Dynamics: The Challenge of Complexity*. Pearson Education, 7.

⁴⁰ Bush, Tony. (2011). *Theories of Educational Leadership and Management*, Sage, pp.112.

menaxherët konfliktohen, atëherë vendimi duhet të merret në një mënyrë politike, aty ku pushteti më i madh prevalon. Në procese të kësaj natyre, vendimmarrjet duhet të jenë të atilla, që menaxherët të ndërtojnë koalicione (Child, 1972, 1984; Cyert and March, 1963; Pfeffer, 1981).

Kur menaxherët janë dakord në atë çfarë duan të arrijnë, por lidhjet e shkakësisë janë të paqarta, atëherë duhet të përdorin gjykimin dhe intuitën, atyre do t`u nevojitet arsyetimi analog dhe të mendojnë në mënyrë anësore, si dhe të përdorin teknikën provë-gabim të proceseve të mëparshme të marrjes së vendimeve. Situata më e vështirë paraqitet kur shkakësia është e paqartë dhe objektivat janë konfliktuale. Këtu menaxherët duhet të vendosin në atë mënyrë që kombinon gjykimin dhe intuitën individuale me ndërveprimet e natyrës politike brenda grupit (Stacey, 2011)⁴¹. Cuban (1996) shtjellon dilemat e identitetit të drejtuesve të shkollave, duke evidentuar rolin e udhëheqësit instruktues, rolin e menaxherit dhe rolin e politikanit. Ai argumenton se implementimi i tyre përbën ADN e administrimit. Më tej Cuban argumenton se administratorët shpresojnë të përmirësojnë shkollën, ndonëse ruajnë gjendjen ekzistuese, ata implementojnë risi, ndonëse minimizojnë konfliktet⁴².

Metodologjia

Studimi u mbështet në kërkimin cilësor për të evidentuar perceptimet e ndryshme midis mësuesve, përgjegjësve të departamenteve dhe mësuesve në lidhje me vendimmarrjen. Pjesëmarrësit në këtë studim ishin 70 mësues, 30 përgjegjës departamenti dhe 30 drejtues, përzgjedhur me anë të teknikës së zgjedhjes së kampionit me bazë grupi.

Si instrument kërkimor u përdorën: intervista gjysmë e strukturuar me 5 pyetje 2 pyetje të mbyllura dhe 3 pyetje të hapura, pothuajse të njëjta për drejtuesit, mësuesit dhe përgjegjësit e departamenteve. Po ashtu u përdor një listëkontrolli, me 25 tregues, (hartuar sipas modeleve të lidërsipit nga Bolman dhe Deal (1980) dhe fuqizimi i stafit, sipas Short dhe Rinehart (1992), që vëzhgoi sjelljet drejtuese dhe reagimin e stafit brenda institucioneve shkollore, për një periudhë afro 2-mujore. Ky vrojtim u realizua nga mësues "vullnetarë", të cilët punonin aktualisht në atë shkollë. Fillimisht vrojtuesit u njohën me qëllimin dhe objektivat e vëzhgimit, më pas u trajnuan në seanca individuale për procesin vëzhgues

⁴¹ Stacey, R. D. (2011). *Strategic management and organisational dynamics: The challenge of complexity to ways of thinking about organisations*. Pearson Education, p.157.

⁴² Cuban, L. (1996). Reforming the practice of educational administration through managing dilemmas. *School administration: Persistent dilemmas in preparation and practice*, 3-17.

dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve. Pasi vrojtuesit u familjarizuan me treguesit që përmbante lista e kontrollit, vlerësuan peshën e shfaqjes së karakteristikës *me po ose jo*, ose *neutral* nëse ishin në dilemë.

Kufizimet e studimit mund të lidhen me subjektivitetin e të intervistuarve ose dilemat e vrojtuesve gjatë periudhës së vrojtimit. Sqarohet se nga 9 shkolla të vrojtuar, shkolla me kod D u hoq nga studimi për parregullsi të vrojtuesit, e cila u evidentua në seancat e takimeve të përjavshme me vrojtuesit.

Për hedhjen e të dhënave dhe analizën e tyre, u përdorën programet kompjuterike Microsoft Excel dhe Microsoft Word. Programi Microsoft Excel u përdor për përgjigjet e mbyllura, po/jo. Ndërsa programi Microsoft Word u aplikua për përgjigjet në formën e tekstit të shkruar.

Ky studim kishte si qëllim të evidentonte diferencat perceptuese mbi vendimmarrjen në shkollë.

Rezultatet e studimit

Gjetjet nga intervistat e zhvilluara me mësues-përgjegjës departamenti-drejtues rezultuan si vijon;

A janë të përfshirë mësuesit në marrjen e vendimeve në shkollë?

57% e mësuesve përgjigjen pozitivisht, dhe 43% negativisht. Pjesa dërrmuese e mësuesve që pohojnë mospërfshirjen e tyre në vendimmarrje, argumentojnë se vendimet vijnë në formën e urdhrave. Për të njëjtën pyetje, 57% e përgjegjësve të departamenteve përgjigjen pozitivisht, 23% negativisht dhe 20% pohojnë se mësuesit përfshihen rrallë në vendimmarrje. Për drejtuesit, rezulton se 88% e mësuesve përfshihen në vendimmarrje, 10% shprehen se mësuesit përfshihen rrallë, ndërsa 2% pohojnë mospërfshirjen e tyre.

Referuar opinioneve që kanë frekuencën më të shprehur në përmbajtje, jepet ilustrimi, duke marrë në konsideratë perceptimet e palëve.

-Mësuesit janë vendimmarrës në procesin mësimor-edukativ, përpilimin e planeve mësimore dhe edukative. (drejtues)

- Mësuesit janë të përfshirë në marrjen e vendimeve në shkollë, kanë pjesëmarrje të gjerë në aktivitetet shkollore, sportive, në mirëmbajtjen e ambientit dhe gjelbërimin e tij. (drejtues shkolle)

- Jo në të gjitha rastet. Ndodh që mësuesit nuk respektojnë departamentin, vetë drejtuesi nuk u lejon hapësirat e nevojshme. (përgjegjës departamenti)

-Jo, sepse të drejtën e vendimmarrjes për monitorim e ka vetëm stafi drejtues i shkollës. (përgjegjës departamenti)


-Jap mendimin dhe ndodh të dëgjohem në vendimet e shkollës. (mësues)

- Kam dhënë mendime për problematika të vogla, pasi vendime të tjera vijnë në formën e urdhrave. (mësues)
- Nuk na lihet hapësirë për t'u përfshirë, gjërat ofrohen të përcaktuara. (mësues)
- Nuk jam përfshirë, pasi në çdo rast vendimet merren nga drejtoria e shkollës dhe u transmetohen mësuesve. (mësues)
- Nuk jam parë si i përshtatshëm, idetë e mia ndryshojnë nga të drejtuesit përsa i përket vendimmarrjes. (mësues)
- Marr vendime për çështje të caktuara në shkollë, ndihem e lirë të shpreh mendimin tim. (mësues)
- vendimet në shkollë i merr vetë drejtori. Nëse bëhet fjalë për ndonjë aktivitet midis mësuesish, atëherë merr mendimin e kolektivit. (mësues)
- Nëse do të jem i sigurtë 70-80% të punës e bën drejtori, duke ia prezantuar më pas stafit. Kjo lidhet me disa faktorë, si: mungesa e kohës, mosimpinjimi i stafit i cili e shikon si detyrë të drejtorit, aq më tepër që është punë e papaguar për pjesëmarrësit.(drejtues)

Gjetjet nga vrojtimet

Bazuar tek vrojtimet e kryera për një periudhë dymujore në 8 shkolla, frekuenca e shfaqjes së karakteristikave drejtuese të sjelljes së drejtuesit, sipas modelit strukturor, human, politik dhe simbolik, pasqyrohen në tabelën dhe grafikun vijues;

Modelet e Lidërshipt	Shkolla A	Shkolla B	Shkolla C	Shkolla E	Shkolla F	Shkolla G	Shkolla H	Shkolla K	Shkolla L
Modeli Strukturor	47%	84%	40%	35%	11%	63%	68%	83%	80%
Modeli Human	46%	53%	29%	9%	4%	47%	80%	88%	58%
Modeli Politik	46%	62%	42%	33%	27%	44%	68%	80%	39%
Modeli Simbolik	37%	29%	33%	11%	19%	39%	65%	66%	39%



Frekuenca e shfaqjes së treguesve të vendimmarrjes së mësuesit në shkollë pasqyrohet në tabelën vijuese.

Vendimmarrja	A	B	C	E	F	G	H	K	L
Mësuesi anashkalon pjesëmarrjen për problemet e shkollës.	9%	6%	23%	41%	35%	15%	5%	0%	0%
Mësuesit marrin pjesë aktivisht në vendimet e shkollës.	23%	60%	12%	8%	11%	57%	54%	82%	60%
Mësuesit marrin vendime për problemet e klasës.	91%	100%	65%	53%	50%	100%	89%	98%	90%
Shumica e mësuesve përfshihen në vendimet e shkollës.	28%	80%	21%	4%	8%	44%	53%	56%	67%
Fjala e mësuesit merret parasysh në vendimet që merren në shkollë.	44%	60%	22%	8%	4%	40%	76%	50%	56%

Diskutimi i rezultateve

Me përjashtim të shkollave me kod C, E, F në të gjitha shkollat e vrojtuar për një periudhë gati dymujore, vihet re se mësuesit nuk e anashkalojnë pjesëmarrjen në problemet e shkollës. Siç shihet edhe nga tabela e modeleve të lidërshiptit, për nivele nënmesatare dhe të ulëta të lidërshiptit (shkolla me kod C, E dhe F), mësuesit kanë pjesëmarrje të ulëta në problemet e shkollës. Në këto shkolla vihen re po ashtu nivele shumë të

ulëta të përfshirjes së mësuesve në vendimet e shkollës, ndërsa fjala e mësuesit merret pak parasysh në vendimmarrje për shkollën me kod C dhe shumë pak për dy shkollat e tjera (Kod E dhe F). Ndërkaq vihet re se mësuesit janë më të përfshirë në vendimet e klasës së tyre, megjithatë krahasuar me shkollat e tjera të vrojtuar, përsëri ky tregues i vrojtuar nuk është i lartë.

Sjellje drejtuese mbi nivelin mesatar dhe të lartë vihen re në shkollat me kod H, kod K dhe kod L, si edhe për shkollën me kod B (edhe pse modeli simbolik paraqitet në nivele të ulëta në masën 29% të sjelljes drejtuese). Për pasojë edhe aspektet vendimmarrëse të mësuesit në shkollë janë më të shprehura. Mësuesi merr pjesë jo vetëm në aktivitetet me klasën e tij, por është edhe vendimmarrës në aspektet shkollore në masën dukshëm mbi mesatare. Vihet re se kur nivelet e larta të modelit strukturor harmonizohen me modelin politik, human dhe simbolik, kjo ndikon pozitivisht në aspektet vendimmarrëse në shkollë, dhe e kundërta ndodh kur niveli strukturor është në nivele të larta dhe ai politik dhe simbolik janë në nivele nënmesatare dhe të ulëta. Në këto raste fjala e mësuesit nuk dëgjohet sa duhet dhe mësuesi nuk përfshihet në vendimet e shkollës, si rasti i shkollave me kod C, E, F dhe A.

Për Majer (1963), efektiviteti i modelit racional sjell tri rrjedhoja pozitive, kur përdoret siç duhet dhe në situata të caktuara. Ato janë: cilësia e racionalitetit në marrjen e vendimit, angazhimi i vartësve për ta kryer siç duhet dhe kursimi i kohës⁴³. Marrja e vendimeve në këto raste është individuale (pra me një kah vendimmarrjeje), prandaj marrëdhënia e modelit strukturor korrelohet me faktorë të tjerë si efektiviteti (Cole, 1987)⁴⁴, klima shkollore⁴⁵ (Hoy & Clover, 1986) etj.

Bazuar në intervistat dhe opinionet e palëve (drejtues-mësues) konstatohet, se të gjithë drejtuesit e shkollave hartojnë një plan vjetor, të cilin e miratojnë në fillimvit; nga ku 30% e tyre shprehen se e hartojnë me grupe pune mësuesish kryesisht të vjetër, 20% me pjesëmarrjen e të gjithë mësuesve, 40% me ekipin e drejtorisë dhe 10% e hartojnë duke ia prezantuar më pas stafit. Përsa i përket vendosjes së objektivave 57% e

⁴³ Maier, N. (1963). Problem-solving discussions and conferences: Leadership methods and skills. New York: McGraw-Hill.

⁴⁴ Cole, B. R. (1987, November 24). A model for improved educational decision making. In *National Conference of the National Council of States on Inservice Education*. Symposium conducted at National Council of States on Inservice Education, San Diego, CA, USA. Available at <http://www.eric.ed.gov/PDFS/ED289834.pdf>.

⁴⁵ Hoy, W. K., & Clover, S. I. (1986). Elementary school climate: A revision of the OCDQ. *Educational Administration Quarterly*, 22(1), 93-110.

tyre shprehen se objektivat e vëna miratohen menjëherë nga mësuesit, pasi drejtorja i ka prezantuar, 33% shprehen se objektivat vendosen duke diskutuar me stafin, 10% shprehen se ato rishikohen dhe riformulohen pas debatit dhe diskutimit me stafin. *Ndërkohë, sipas opinionit të mësuesve*, drejtuesit e shkollave janë të varur dhe priren më shumë të zbatojnë çfarë u kërkohet nga lart, sesa të marrin mendimin e stafit. Në minorancë janë mësuesit që pohojnë integritetin e drejtuesit, personalitetin e qëndrueshëm personal dhe të funksionit, si edhe aftësinë udhëheqëse për të gjetur rrugën e duhur.

Sipas Rosenholtz (1985), përfitimet e performancës prej vendimmarrjes kolektive mund të dalin nga veprimet e parandaluara, sugjerimet, diskutimet dhe modifikime që janë të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e programeve akademike. Këto çojnë në rritjen e qartësisë së mësuesve për qëllimet institucionale, metodat dhe në fund në rritjen e efektshmërisë institucionale. Vendimmarrja bëhet e vetëdijshme, dhe vendimet e arsyetuara mirë zënë vendin e atyre arbitrare ose automatike. Mohrman, Coke dhe Mohrman (1979), në një studim me 460 shkolla fillore dhe 8- vjeçare perëndimore, zbuluan se ata që kishin marrë pjesë në vendimmarrje teknike kishin shumë më pak paqartësi në rolin e tyre. Të dhënat e Azumi dhe Madhere (1983) thonë se mësuesit që kanë më pak informacione hyrëse në situatat e politikave institucionale kanë më shumë paqartësi. Vendimmarrja dhe përkatësia në nivel simbolik, pjesëmarrja në vendimmarrjen teknike rrisin sensin e përkatësisë që kanë mësuesit ndaj objektivave mësimore të shkollës dhe i rezervon atyre një vend në sipërmarrje të ardhshme kolektive. Zotërimi i programeve shkollore është themelor për dy arsye. *Se pari*, arritjet e nxënësve vuajnë nga mungesa e përkushtimit të mësuesve ndaj programit mësimor (CSDE 1980, McLaughlin & Marsh 1978). *Së dyti*, ndjenja e përkatësisë në themelet e kolektivit lejon koordinimin administrativ të programeve mësimore mbarëshkollë, karakteristikë kjo që është cituar shpesh në krahasimin midis shkollave efektive dhe inefektive (CSDE 1980, Glenn & McLean 1981, Hunter 1979, Sizemore 1983, dhe Ezky & Winfield 1979, Weber 1979)⁴⁶.

Supozohet se njerëzit preferojnë stukturat me shumë zgjedhje dhe gjerësi (Leavitt, 1978). Por jo gjithmonë ndodh kështu. Moeller (1968), për shembull, eksplori efektet e strukturës në moralin e mësuesit në dy sisteme shkollë. Njeri ishte strukturuar lirshëm dhe inkurajonte pjesëmarrje të gjerë në vendimmarrje. Tjetri ishte i kontrolluar ngusht, me

⁴⁶ Rosenholtz, S. J. (1985). Effective schools: Interpreting the evidence. *American journal of Education*, 352 - 388.

autoritet të centralizuar dhe me një strukturë të qartë komandimi. Moller zbuloi të kundërtën e asaj që priste: morali i mësimdhënësve ishte më i lartë në distriktin me një strukturë më të kontrolluar. Strukturat në mjedise të qëndrueshme janë zakonisht hierarkike dhe të orientuara, sipas rregullave (Bolman & Deal, 2008)⁴⁷. Ndërsa Maier (1967) zbuloi se liderët të cilët mbikontrollonin krijojnë reagime frustive dhe joefikasitet. Liderët e mirë ishin të ndjeshëm ndaj detyrës dhe procesit.⁴⁸ Sipas Bolman dhe Deal (2008:210), teoricienët strukturorë vendosin autoritetin në themel të vendimmarrjes. Në këtë këndvështrim, drejtuesit marrin vendime racionale, monitorojnë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar implementimin e tyre dhe vlerësojnë si zbatohen vendimet. Teoricienët e burimeve humane i kushtojnë më pak rëndësi pushtetit dhe më shumë rëndësi fuqizimit. Korniza politike nga ana e saj, autoritetin e sheh vetëm si një nga format e mundshme të pushtetit. Ajo i kushton rëndësi individit dhe grupit në koalicion. Në këtë këndvështrim pushteti nuk është e keqja. *“Pushteti nuk duhet përshkruar në terma negativë si p.sh. përjashtues apo shtypës. Në të vërtetë pushteti prodhon; prodhon realitetin”* (Foucault, 1975, cit Bolman & Deal).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar tek vrojtimet, vihet re, se kombinimi i modelit strukturor me modelin politik shoqërohet me frekuenca pozitivisht të larta reaguese në aspektet vendimmarrëse të stafit. Kjo shfaqet më dukshëm për shkollat e vogla, ndërsa për shkollat të mëdha vihet re kombinimi i të katër modeleve. Për drejtues ku modeli simbolik shfaqet në nivele të ulëta, vihet re se reagimet në sjelljet vendimmarrëse të stafit shfaqen kaotike.

Nga të dhënat studimore rezulton vendimmarrje pasive, sidomos për procese të rëndësishme, të cilat prekin drejtpërdrejt interesat dhe punën e mësuesit. Që kultura organizative të funksionojë siç duhet brenda kulturës së gjerë të shoqërisë, ajo duhet të ketë mjaft elemente të përbashkëta me vlerat kryesore të saj. Nëse krijohen struktura të mbyllura, më shumë kontrolluese sesa bashkëpunuese, vështirë se promovohen ndryshime afatgjata dhe të suksesshme. Ndërtimi i kapaciteteve lidhet me kompetencat, burimet dhe motivimin. Sipas Fullan (2008: 57), individët dhe grupet rrisin kapacitetet e tyre nëse zotërojnë dhe vazhdojnë të

⁴⁷ Bolman, L. G., & Deal, T. E. (2008). *Reframing organizations: Artistry, choice, and leadership*. John Wiley & Sons, pp.27

⁴⁸ Maier, N. “Assets and Liabilities in Group Problem Solving.” *Psychological Review*, 1967, 74, 239 - 249 .

zhvillojnë dijet dhe aftësitë, nëse synojnë dhe përdorin burimet (kohë, ide, ekspertizë, para) me mençuri dhe nëse angazhohen të përdorin energjitë, duke realizuar gjërat më të rëndësishme kolektivisht dhe vazhdimisht⁴⁹.

REKOMANDIME

- Udhëheqja e suksesshme arrihet me drejtues që marrin përsipër të gjitha rolet, duke menduar në kontekst, në varësi të situatës dhe problematikave shkollore.
- Të realizohet bashkëpunimi jo si procedurë, por si një proces i përshkallëzuar, bazuar në nevojat aktuale të stafit dhe grup-individësh.
- Fuqizim i shkollës nënkupton fuqizim të stafit, jo përmes kontrollit autokratik, por përmes strukturës organizative, kulturës institucionale, bashkëpunimit dhe përfshirjes në marrjen e vendimeve që prekin drejtpërdrejt punën e mësuesit.
- Drejtuesit duhet të vlerësojnë praktikën aktuale menaxheriale shkollore për të krijuar një terren të qëndrueshëm me realitetet e tyre praktike.
- Koordinimi i metodave vertikale të drejtimit me ato horizontale, në varësi të vendit, kohës dhe aspekteve vendimmarrëse institucionale, po aq edhe organizacionale.
- Drejtuesit duhet të jenë të fortë për problemin dhe të butë me njerëzit duke mbështetur vazhdueshëm stafin mësimdhënës. Por në të njëjtën kohë duhet të jenë të drejtë në forcën dhe energjinë me të cilën theksohet problemi.

⁴⁹ Fullan, M. (2008). *What's Worth Fighting For in the Principalship?* Teachers College Press, 57.

BIBLIOGRAFIA

- Argyris, C. (1991). Teaching smart people how to learn. *Harvard business review*, 69(3).
- Bolman, L. G., & Deal, T. E. (2008). *Reframing organizations: Artistry, choice, and leadership*. John Wiley & Sons, pp.27
- Bush, Tony. (2011). *Theories of Educational Leadership and Management*, Sage, pp.112.
- Cole, B. R. (1987, November 24). A model for improved educational decision making. In *National Conference of the National Council of States on Inservice Education*. Symposium conducted at National Council of States on Inservice Education, San Diego, CA, USA. Available at <http://www.eric.ed.gov/PDFS/ED289834.pdf>.
- Cuban, L. (1996). Reforming the practice of educational administration through managing dilemmas. *School administration: Persistent dilemmas in preparation and practice*, 3-17.
- Hoy, W. K., & Clover, S. I. (1986). Elementary school climate: A revision of the OCDQ. *Educational Administration Quarterly*, 22(1), 93-110.
- Maier, N. "Assets and Liabilities in Group Problem Solving." *Psychological Review*, 1967,
- Maier, N. (1963). Problem-solving discussions and conferences: Leadership methods and skills. New York: McGraw-Hill, 74.
- Møller, J. (1996). Reframing Educational Leadership in the Perspective of Dilemmas. *School administration: Persistent dilemmas in preparation and practice*, 3-17.
- Pettigrew, A. M. (1977). Strategy formulation as a political process. *International Studies of Management & Organization*, 7(2), 78-87.
- Rosenholtz, S. J. (1985). Effective schools: Interpreting the evidence. *American journal of Education*, 352-388.
- Stacey, R. (2011). *Management and Organisational Dynamics: The Challenge of Complexity*. Pearson Education, 7.
- Stacey, R. D. (2011). *Strategic management and organisational dynamics: The challenge of complexity to ways of thinking about organisations*. Pearson Education, pp.157.

**VLERA TË SOTME TË IDEVE WEBERIANE MBI
SHKENCAT SHOQËRORE: DIJA DHE
ORGANIZIMI UNIVERSITAR, NJË TRAJTIM
SOCIOLOGJIK**

Teuta Starova

Universiteti i Tiranës, Departamenti i Sociologjisë

ABSTRAKT

Ky artikull synon të paraqesë lidhjet ndërmjet arsimit universitar në fushën e shkencave shoqërore dhe mjedisit shoqëror. Shoqëria shqiptare ka pësuar zhvillime të vullshme të shumanshme në tridhjetë vitet e fundit, të cilët nuk janë pasqyruar sa dhe si duhet në sistemin arsimor universitar të saj.

Në këtë punim do të parashtrihen disa ide mbi përsosjen e programeve mësimdhënës universitarë, në dobi të theksimit të ndryshimit ndërmjet fushës së dijes të larmishme të shkencave shoqërore dhe politikave praktike të partive në qeverisje ose opozitë.

Analizat dhe arsyetimet e sociologut të shquar Maks Weber janë me vlerë, aktuale edhe në ditët e sotme dhe do të referohen me përparësi në këtë artikull.

Maks Weber-i ka realizuar një analizë sociologjike mjaft interesante përsa u përket përvojave të ndryshme kombëtare të organizimit të mësimdhënies dhe dijeve universitare.

Në përfundim të punimit do të shprehen edhe mendime, reflektive mbi nevojën e përsosjes së arsimit universitar në shkencat shoqërore në shoqërinë shqiptare.

Përmes analizës së disa realiteteve sociologjike që shoqërojnë vëmprimtarinë universitare do të formulohen edhe sugjerime që kërkojnë një bashkëpunim më të thelluar të politikave shtetërore me prioritetet universitare. Shkencat shoqërore në shoqërinë shqiptare kontribuojnë në mënyra të ndryshme në drejtim të sjelljes shoqërore, të strukturimit të proceseve sociale, të parashikimit të proceseve të reja shoqërore. Pavarësisht nga kontributi i tyre real, shkencat shoqërore në Republikën e Shqipërisë, janë përballë sfidave që vijnë nga situata e përgjithshme, ekonomike dhe shoqërore e vendit.

Fjalët kyç: Arsim universitar, mësimdhënie universitare, politika sociale, veprimtari politike, shkenca shoqërore.

**Today's value of Weberian ideas on the social sciences:
knowledge and university organization, a sociological treatment"**

ABSTRACT

Over the past thirty years, Albanian society has experienced rapid changes that have not been sufficiently mirrored in its higher education system. This article aims to explore the links between university education in social sciences and the surrounding social environment. Also, will present some ideas for enhancing university teaching programs, highlighting the distinction between the broad scope of social science knowledge and the practical policies of political parties in both government and opposition.

The insights and analyses of the renowned sociologist Max Weber remain relevant today and will be prominently referenced in this article. Weber conducted a notable sociological analysis on the various national approaches to organizing teaching methods and university education.

Social sciences in Albanian society contribute significantly to understanding social behavior, structuring, and forecasting social processes. Despite their importance, social sciences in Albania face challenges stemming from the country's overall economic and social conditions.

In the conclusion, the paper will offer thoughts and reflections on the necessity for improving university education in social sciences within Albanian society. By examining certain sociological aspects associated with university studies, the paper will propose suggestions that call for greater alignment between state policies and university priorities.

Keywords: University education, university teaching, social policy, political activity, social science.

Mjedisi sociologjik i pasviteve 1990-të dhe ndryshimet në arsimin universitar në shkencat shoqërore

Në tridhjetë vitet e kaluara duke nisur që nga viti 1991, Republika e Shqipërisë, pësoi ndryshime të vrullshme shoqërore të cilat përfshinë thuajse të gjitha fushat e jetës.

Këto zhvillime ishin pjesë e ndryshimeve të thella demokratike që kishin ndodhur në të gjitha vendet ish-komuniste të Evropës Lindore. Mjedisi sociologjik në të cilin zhvilloheshin të gjitha këto vende bashkë me Shqipërinë, ndryshoi në të gjithë përbërësit e tij. Ndryshuan institucionet zyrtare dhe qeverisja, si edhe jeta shoqërore ku përfshihen familja, feja, edukimi, normat dhe sjelljet përkatëse. Filluan të ndryshojnë ekonomia, kultura, besimet, vlerat, zakonet praktikant e shoqërisë shqiptare dhe sjelljet

përkatëse të njerëzve.

Ndryshime të mëdha filluan të pësojnë edhe grupimet shoqërore jashtëfamiljare, si: miqësitë, shtresat shoqërore dhe bashkësitë profesionale dhe të tjera grupime të ndryshme që lidhen me përkatësinë dalluese të njerëzve.

Ndryshime të tilla të mjedisit sociologjik filluan të ndikohen shumë edhe nga përparimet e vrullshme teknologjike sidomos në fushën e informacionit.

Bashkë me ndryshimet e thella dhe të larmishme ndryshuan edhe ndërveprimet e njerëzve dhe të bashkësive të njerëzve të shoqëruara si me bashkëpunim, ashtu edhe me konflikte ndërmjet tyre të lidhura me varfërinë, pabarazinë ekonomike, lëvizjet shoqërore politike ose ekonomike, krimet etj.

Nëse mjedisi sociologjik po pësonte ndryshime rrënjësore, rrjedhimisht do të shfaqeshin edhe nevojat për dije dhe praktika të reja që t'u përgjigjeshin këtyre ndryshimeve. Sistemi arsimor ose ai sistem i organizuar zyrtar dhe tradicional i përhapjes së dijes të të gjitha niveleve filloi ta ndiejë fort nevojën për ndryshim.

Si rrjedhojë, filloi të ndryshonte edhe arsimi universitar. Ndryshuan programet e mësimdhënies, librat shkollorë, kualifikimi i mësimdhënësve, bashkërendimi i arsimit 8-vjeçar, të mesëm dhe universitar, bashkëpunimi me sistemet arsimore të vendeve të tjera, marrëdhëniet mësimdhënës-nxënës, student etj.

Në ndryshim nga fushat e tjera të shkencave natyrore ose teknike mësimdhënia universitare në fushën e shkencave shoqërore kishte nevojë për ndryshime më të thella. Fusha e shkencave shoqërore ishte e lidhur më ngushtësisht me zhvillimet politike e shoqërore dhe rrjedhimisht edhe me botëkuptimet njerëzore për këto zhvillime.

Ndryshimet e kërkuara nga koha filluan të çlirojnë mësimdhënien, para së gjithave, nga ideologjizimi i detyrueshëm, nga trysnia e sundimit të partisë-shtet. Më pas, ndryshimet u thelluan nëpërmjet zgjerimit të fushës së mësimdhënies me lëndë të reja, me mësimdhënës dhe literaturë të huaj, kualifikime afatmesme dhe afatgjata të mësimdhënësve dhe studentëve jashtë Republikës së Shqipërisë.

I gjithë ky proces ndryshimi në mësimdhënien universitare nuk ka qenë aspak i lehtë. Faktorë pengues kanë qenë të shumëllojshëm dhe ndër ta, mund të përmenden mungesa e përvojës, përpjekja për mbijetesë përballë sfidave të reja të profesionit të mësimdhënies, psikologjia frenuese e miqësisë së grupit të mësimdhënësve, rallëherë edhe bindjet vetjake për mosndryshim, si dhe mungesat e shumta financiare.

Pas tridhjetë viteve të ndryshimeve të mëdha në sistemin tonë të mësimdhënies universitare të lëndëve shoqërore, ndjehet akoma nevoja për të bërë ndryshime që duhej të ishin bërë shumë kohë më parë, por ndonjëherë edhe për të zhbërë disa ndryshime të dëmshme.

Mjafton vetëm ky vështrim i përgjithshëm i lidhjes ndërmjet mjedisit sociologjik dhe sistemit të mësimdhënies universitare për të vlerësuar idetë e Maks Weber-it mbi varësinë e fortë të mësimdhënies universitare nga mjedisi social i kohës.

Maks Weber ka lënë një analizë sociologjike mjaft interesante përse u përket përvojave të ndryshme kombëtare të organizimit të mësimdhënies dhe të dijeve universitare. Ai i përmbahet idesë se dija universitare transmetohet në funksion të traditave kulturore dhe psikologjike të çdo kombi. Çdo model kryesor i përdorur ka epërsinë e tij, por ka edhe anë të pazhvilluara.

Ne sot kuptojmë se universitetet moderne janë të organizuara shumë ndryshe nga ato të kohës kur jetonte fizikisht Maks Weber-i, megjithatë vështrimi i tij mbetet i rëndësishëm për arsyen se pavarësisht ndryshimeve, disa karakteristika mbeten ende në fuqi.

Sipas Maks Weber-it, shkenca dhe arsimi universitar në Amerikë, ndjekin një strategji dhe pedagogji të veçantë nga sa ndodh në sistemet universitare evropiane. Për shembull në dallim nga Gjermania e asaj kohe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e trajtojnë krejt ndryshe specialistin e ri universitar që synon të bëhet profesor universiteti. Në Shtetet e Bashkuara, thotë në atë kohë Weberi, një asistent i ri që i ka hyrë rrugës për t'u bërë pedagog ngarkohet që në fillim për të dhënë mësim në mënyrë krejt autonome. Ndërsa i ngjashmi i tij në universitetet gjermane e fillon duke studiuar dhe përgatitur një libër për t'u bërë privat docent pa mundur të japë si rregull mësim. Edhe kur jep mësim, ai e bën këtë në mënyrë të pjesshme, thjesht vetëm për disa tema, duke asistuar tutorin e tij, pra pedagogun që ndodhet tashmë në detyrë, dhe mbi të gjitha pa pagesë. Edhe universitari i ri amerikan që i ka hyrë rrugës për t'u bërë pedagog nuk është se merr ndonjë pagë të madhe, shpesh ai merr edhe më pak se një punëtor i kualifikuar që punon në një ndërmarrje.

Edhe marrëdhëniet e pedagogut me studentin në universitetet amerikane dhe gjermane janë të ndryshme. Studenti në Amerikë shkruan Maks Weber - e quan se pedagogu është duke i transmetuar dijen njësoj sikur është duke i kryer një shërbim konform pagesës që bëjnë prindërit për shkollimin e fëmijës së tyre. Nga kjo pikëpamje, marrëdhëniet janë dukshëm të ndikuara nga një logjikë tregu. Maks Weber shkruan se një student amerikan e përfytyron pedagogun e tij si një shitës, si një aktor

shoqëror të barabartë me veten e tij. Ndërsa në Evropë, kryesisht në Gjermani, Maks Weber-i thotë se mësuesi dhe pedagogu ende mbahen si autoritete dhe respektohen në radhë të parë për postin e tyre.

Sipas Maks Weberit ka një lidhje të caktuar midis profesionit të pedagogut, shkallëve të kualifikimit të tij dhe vendeve të punës si pedagog. Edhe ky profesion vepron sipas një logjike grupi, kaste ose bashkësie profesionale. Kjo logjikë vjen qysh nga kohë më të hershme, ndoshta nga Mesjeta. Kriteret që bashkësia e mësuesve dhe e pedagogëve ka vendosur për kualifikimin e pedagogëve ose mësuesve më të rinj, vjetërsia në profesion, mosha, vitet e shërbimit në të njëjtin institucion, diplomat e merituar etj., në fakt nuk janë veçse barriera që anëtarët më të moshuar të këtyre bashkësive profesionale vendosin për të rregulluar hyrjen e anëtarëve më të rinj. Këto barriera janë më të lehta për t'u kapërcyer ose më të vështira për t'u kaluar në varësi të një sërë rrethanash historike. Në këtë fushë ndikojnë përsëmbull ritmi i shtimit të vendeve të punës, zgjerimi ose ngushtimi i sistemit arsimor të një vendi, ritmi i daljes në pension i anëtarëve më të moshuar të bashkësisë në fjalë etj. Pra, nuk kemi të bëjmë me kritere universale, të barabarta për çdo vend dhe periudhë historike, të përcaktuara ekskluzivisht nga tregues akademikë, por për norma dhe rregulla të ndryshueshme, specifike, të veçanta për çdo vend, dhe mbi të gjitha të ndikuara nga faktorë të fuqishëm socialë.

Edhe brenda sistemit universitar evropian, Maks Weber-i shikon dallime dhe veçanti që dalin në pah kur krahasohen dy vende të ndryshme. Për shembull, Maks Weber-i thekson se ka dallim të madh midis statusit të kërkuesve shkencorë në Gjermani dhe në Francë. Në Francë ka qenë traditë që punonjësve shkencorë të Universiteteve ose qendrave të ndryshme shkencore t'iu njihet një status pune i përjetshëm, ndërsa në Gjermani nuk ndodh kështu, sepse atje pedagogu merret me punë shkencore - flitet gjithmonë për atë kohë - sipas projekteve të përkohshme dhe një sistemi kontratash të përkohshme.

Maks Weber-i ishte disi pesimist për mënyrën sesi punësoheshin pedagogët e rinj ose si kualifikoheshin ata brenda universiteteve evropiane, veçanërisht gjermane, të kohës së tij. Këtu, edhe njëherë e theksojmë, nuk ka rëndësi fare fakti nëse gjendja e sotme është e njëjtë ose jo me të asaj kohe që po analizohet. Rëndësia e problemit është krejt tjetër. Ajo ka të bëjë me meritën e madhe teorike të autorit që ka ditur të japë këndvështrimin sociologjik në ecurinë e jetës universitare duke themeluar kështu sociologjinë e arsimit dhe edukimit universitar.

Ku i mbështet teorikisht konstatimet e tij Maks Weber-i? Ai thekson se profesorati është mbi të gjitha një grup socioprofesional i organizuar në

mënyrë të diferencuar, por që vepron gjithmonë si një i tërë. Ndërmjet pedagogëve dhe studentëve ka një bashkësi që përcaktohet nga solidaritete të fuqishme, nga kundërshti, nga dallime, konflikte, por edhe nga vazhdimësi. Ajo që ndodh është si rregull që pedagogët tërheqin drejt kualifikimit dhe emërimit ata studentë me të cilët kanë lidhje shoqërore të caktuara ose kanë afërsi të caktuara botëkuptimore, metodologjike dhe të tjera. Përgjithësisht pedagogët punësojnë studentët që i shkojnë për shtat humoreve dhe pikëpamjeve të tyre. Në këtë mënyrë - e kritikon Maks Weber-i sistemin universitar të kohës së tij - ndodh që shumë rrallë punësohen studentët ose individët më të talentuar, sepse forca e dinamikës së grupit bën që grupi apo udhëheqësit e tij, të kenë prirjen për të vepruar në të mirë të ruajtjes dhe të riprodhimit të pushtetit të tyre individual, kolektiv, shkencor, intelektual apo administrativ.

Kësaj i shtohet edhe një arsye tjetër me peshë krejt të veçantë. Cilido grup pedagogë-studentë është i mbyllur brenda rrethit të universitetit përkatës dhe qëndron pothuajse i izoluar, armiqësor dhe kundërshtues ndaj hyrjeve brenda tij realizuar nga individë sado të talentuar qofshin, të ardhur nga universitete të tjera. Një individ mediokër që ndodhet afër grupit të pedagogëve të një universiteti ka shumë më tepër shanse që të zgjidhet si individ për t'u punësuar në krahasim me një specialist të ri të ardhur si kandidaturë nga një universitet tjetër.

Pra, Maks Weber-i mendonte, se ajo që prodhon shkenca dhe arsimi universitar i kohës së tij ka qenë mediokriteti. Ndërkaq, i ndodhur përpara pyetjes: “Po ai si kishte arritur të bëhej pedagog dhe shkencëtar me emër?”, Maks Weber-i përgjigjej- “krejt rastësisht”. Jam përpjekur, tregonte ai, me një lloj hidhërimi legjitim - që studentët t'i dërgoj për t'u kualifikuar dhe për të bërë karrierë pranë profesorëve të tjerë që japin mësim në universitete të tjerë, por s'ka qenë e mundur që të arrijnë të fitojnë atje, sepse i kanë trajtuar si të huaj, pavarësisht talentit të madh që kanë pasur.

Maks Weber-i ka trajtuar teorikisht edhe marrëdhënien ndërmjet profesionit të pedagogut dhe profesionit të politikanit për arsyen se Gjermania e asaj periudhe pra e dy dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX ishte një vend politikisht shumë i turbullt, plot tensione politike, lëvizje shoqërore dhe konflikte ideologjike. Jo vetëm kaq, por dihet se këto lëvizje politike dhe ideologjike shpesh përfshinin edhe shtresa të gjera intelektualësh. Në Gjermani në këtë periudhë angazhimi politik dhe ideologjik i pedagogëve, shkencëtarëve, dijetarëve ka qenë shumë i ndjeshëm.

Në këto rrethana sociologu dhe pedagogu Maks Weber ndjente detyrimin e dyfishtë për të dhënë një përgjigje për pyetjen nëse pedagogu

në auditor duhet të trajtojë thjesht në mënyrë shkencore problematikën e marrë në shqyrtim apo duhet të marrë dhe një pozicionim politik, partiak, militant në mbrojtje të këtij apo atij pozicioni politik, apo ideologjik. Maks Weber-i ndjen një detyrim të dyfishtë për t'iu përgjigjur këtij problemi, sepse ai thotë se e bën këtë në radhë të parë si një pedagog, si dikush që kjo çështje i intereson në mënyrë shumë të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë. Ai kërkon të sqarojë pra etikisht mënyrën se si sillet në auditor përballë studentëve të tij. Nga ana tjetër, Maks Weber-i, është në rolin e tij të sociologut që nuk mund të mos analizojë edhe çështjen e kufijve, ndërprerjeve dhe ndërthurjeve apo dallimeve midis profesioneve, të tilla si ai i politikanit dhe pedagogut.

Pedagogu mund të ketë prirjen të kthehet në një politikan dhe t'i ushtrojë të dy profesionet njëherësh. Kjo lehtësohet nga fakti se ai ndodhet përpara auditorëve të gjerë ku është e pranishme elita e rinisë së një vendi. Aq më tepër që kur është fjala për shkencat shoqërore, problematika e tyre ka edhe shumë afërsi me politikën e ditës. Pedagogu që për profesion ka edhe shumë aftësi të foluri, ka prirje të shndërrohet në një demagog që manipulon turmat, pra në një politikan. Sidomos në periudha të nxehta politike, historikisht, intelektualit dhe pedagogu ndodhet përballë kërkesave që vijnë nga opinioni publik dhe nga studentët që ai të dalë nga kulla e fildishtë dhe të angazhohet në luftën politike.

Maks Weber-i ka një përgjigje të prerë për këtë problem. Ai është kundër që pedagogu në auditor ta kthejë leksionin e tij në një fjalim politik në favor të kësaj ose asaj partie politike, të predikojë përkrahjen, ose refuzimin e kësaj, ose asaj çështjeje politike, mbështetjen apo kundërshtimin ndaj kësaj, ose asaj lëvizjeje politike. Pedagogu mund të merret me politikë, jo në auditor, por jashtë tij. Në auditor ai duhet të bëjë një shkencë të kulluar, duhet të thotë të vërtetën sado kontradiktore që të jetë, pavarësisht nëse përputhet ose jo me idetë dhe programin politik që përkrah, pastaj jashtë në sheshet publike, pedagogu është i lirë të shpalosë çdo politikë që dëshiron përballë qytetarëve ose militantëve të partisë së tij.

Përse Maks Weber-i e ka ndarë kaq prerë profesionin e pedagogut në auditor nga ai i politikanit? Mos vallë sepse ka një botëkuptim konservator apo se do ta ruajë të paprekur universitetin nga lufta politike? Mos vallë dëshiron që kultura dhe shkenca universitare të mos bëhen arena të luftës ideologjike? Mos vallë si pedagog dhe dijetar kërkon t'i rezistojë klasës së politikanëve?

Është shumë veshtirë t'u jepet një përgjigje përfundimtare këtyre pyetjeve. Ajo që mund të thuhet është se Maks Weber përgjigjen e tij nuk e lidh aspak me gjendjen konjunkturale të kohës në Gjermani, as me specifikat

e arsimit universitar të këtij vendi. Përgjigja e Maks Weber-it është e një natyre universale.

Cilat janë argumentet që përdor Maks Weber kur shpjegon se pedagogu duhet të përmbahet në auditor për të mos bërë politikë, por shkencë për hir të shkencës? Argumenti i parë është se marrëdhënia ndërmjet pedagogut dhe studentëve të tij nuk është krejtësisht e lirë dhe as e barabartë. Pedagogu jo vetëm ka mbi studentët një autoritet moral, intelektual dhe psikologjik të madh, por ka mbi ta edhe një pushtet administrativ të jashtëzakonshëm. Ai në një farë mënyre ka në dorë edhe fatin e suksesit dhe të dështimit të tyre në provime. Studentët kanë ardhur për të mësuar në universitet dhe kanë besim se pedagogët do të përpiqen t'iu sqarojnë çështjet në mënyrë kontradiktore, por gjithmonë objektivisht dhe pa qëllime manipulimi politik. Nga kjo pikëpamje Maks Weber-i ndërton argumentimin e tij moral dhe psikologjik, sipas të cilit të ndikosh psikologjikisht studentët do të thotë të abuzosh me besimin e tyre, me besimin që kanë tek pedagogu si mësues dhe jo si politikan, do të thotë të abuzosh me një post jopolitik për të bërë politikë partiake.

Argumenti i dytë ka një natyrë pothuajse epistemologjike dhe sociologjike. Sipas Maks Weber-it ligjerimi politik përpiqet të bashkojë në një të vetme atë që e konsideron si të vërtetë me atë që e konsideron të dobishme, të mirë, të nevojshme për partinë e tij dhe për të arritur qëllimet e saj politike. Nëse pedagogu do të mbajë një pozicion politik atëherë ai do të tradhtojë profesionin dhe detyrën e tij si pedagog që e detyron të thotë dhe të mësojë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Aq më tepër që logjika e ligjërimit politik dhe logjika e ligjërimit shkencor janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ligjërimi politik ka vlerë atëherë kur me anë të argumenteve arrin të bindë të tjerët, t'i mposhtë të tjerët në debat dhe të fitojë vota, pavarësisht nëse përmbajtja dhe vlera e tyre është ose jo e vërtetë. Kurse ligjërimi shkencor mbështetet në administrimin shkencor të provave objektive. Lidhur me sa më sipër, Maks Weber-i shkruan: «*Të marrësh një qëndrim politik dhe praktik është një gjë dhe të analizosh strukturat politike dhe qëndrimet partiake është diçka krejt tjetër. Kur dikush flet në një mbledhje politike mbi demokracinë, ai nuk e fsheh këndvështrimin e vet personal, në të vërtetë të shprehësh qartë dhe të marrësh një qëndrim të caktuar është një detyrë që askush s'i shpëton dot. Fjalët që përdoren në këto mbledhje nuk janë mjete që përdoren nga analiza shkencore, por mënyra për të grumbulluar vota dhe fituar mbi të tjerët*» (1978).

Një argument i tretë që artikulon Maks Weber-i ka të bëjë me natyrën e krijimit të koherencës politike dhe të koherencës shkencore. Sipas

tij në planin shkencor s'mund të ketë një koherencë të plotë dhe të gjithanshme ndërmjet fushave të ndryshme të botës dhe të shoqërisë. Gjërat janë më shumë kontradiktore, plot tension, pra në shkenca ka një koherencë tepër të brishtë dhe problematike kur flitet për botën dhe shoqërinë në përgjithësi. Ndërsa politika është e detyruar që të parashtrijë veprimin e vet si me një koherencë plotësisht absolute, të përkryer, dhe sikur të gjitha proceset tentojnë të shkojnë drejt një pike bashkërendimi. Prandaj, pedagogu ose shkencëtari që mban qëndrime politike është i detyruar të tradhtojë etikën e shkencës dhe pastërtinë e objektivitetit të saj. Detyra e pedagogut është që në radhë të parë t'u mësojë studentëve faktet objektive dhe kryesisht natyrën kontradiktore të tyre. Ndërkaq që pedagogu i cili bën politikë në auditor e ka pothuajse të pamundur t'u mësojë studentëve faktet që janë në kundërshtim me opinionet e veta politike. Maks Weber-i për këtë ka shkruajtur: «*Detyra parësore për një mësues të dobishëm është t'ju mësojë studentëve të tij që ata të njohin faktet « e papërshtatshme », me të cilët unë nënkuptoj fakte të cilat janë shumë të papërshtatshme për opinion tim personal, por jo më pak edhe për opinionet e të tjerëve » (1978).*

Argumenti tjetër i Maks Weber-it ka një natyrë ekzistenciale. Për Maks Weber-in politika është një zgjedhje. Njeriut i hapen në jetë fusha përparimi dhe perspektiva zgjedhjeje nga më të ndryshmet. Por në çdo rast zgjedhjet nuk bëhen dot në mënyrë shkencore. Dituritë flasin vetëm për prirje themelore, për rrugë të mundshme për t'u ndjekur nëse dëshiron të arrish në këtë ose atë qëllim. Por, qëllimet nuk i vendos dot shkenca. Qëllimet i vendos njeriu në bazë të traditave të tij, vendit që zë në shoqëri, idealeve që mbart, klasës në të cilën bën pjesë, pikëpamjeve politike që mbron, interesave të tij socialekonomike dhe faktorëve të tjerë ekzistencialë. Studenti i bën zgjedhjet e veta politike si qytetar me interesa dhe jo si specialist i ardhshëm në një fushë të dijes. Angazhimi politik në një krah ose në një krah tjetër të politikës nuk është thjesht dhe vetëm një çështje diturish teorike, shkencore, por edhe interesash dhe zgjedhjesh.

Nevoja e tanishme e përsosjes së arsimit universitar në shkencat shoqërore

Mbështetur në idetë e Weberit mbi kushtëzimin mjedis sociologjik-arsim universitar, shoqëria shqiptare do të duhej që t'i bënte ndryshimet në arsimin universitar sa më të menduara dhe të organizuara në krahasim me tridhjetë vitet e kaluara të paraprira nga studimi i thelluar i nevojave shoqërore për arsimimin e brezit të ri. Hapja kulturore dhe shkencore e shoqërisë shqiptare ka ndikuar në mënyrë kontradiktore mbi nivelin e shkencave shoqërore. Nga njëra anë, ajo ka dhënë mundësi që informacioni

mbi shkencën bashkëkohore dhe mbi themelet e shkencave sociale në shkallë ndërkombëtare të vijë duke u rritur, por nga ana tjetër, gjendja e re ka bërë që të dalin edhe më në dukje mungesat që vijnë si rezultat i krahasimit të pasurisë së përgjithshme intelektuale në fushën e shkencave shoqërore me nivelin e tyre aktual në Republikën e Shqipërisë.

Cilat janë disa nga sfidat e sotme të mësimdhënies në lëndët shoqërore?

Megjithëse ndryshimet e nisura në arsimin universitar në fushën e shkencave shoqërore në fillimin e viteve 1990, kanë qenë të vazhdueshme, tani, pas rreth tridhjetë viteve, mjedisi sociologjik duket shumë i ndryshëm kundrejt atij të fillimit të viteve 1990. Nëse në atë kohë ndryshimet në arsimin universitar filluan të bëhen më shumë në mënyrë spontane dhe duke mos u mbështetur në një vetëdije të thellë mbi nevojën e tyre, përgjithësisht, duke ndjerë më shumë nevojën për ndryshim sesa se çfarë ndryshimesh nevojiteshin, tani mjedisi sociologjik po ushtron trysni për ndryshime të tjera në arsimin universitar në shkencat shoqërore.

Disa përbërës të rinj të mjedisit sociologjik në shoqërinë shqiptare janë:

Së pari, ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore mjedisi ekonomik. Ka ndodhur dhe vazhdon të thellohet një polarizim i fortë i shoqërisë shqiptare ku ndarja më e qartë duket se është ajo të pasur-të varfër, kurse shtresa e mesme është ende e dobët. Kjo gjendje ekonomike ushtron trysni mbi shumë familje të cilat ndikojnë mbi fëmijët e tyre për drejtimin në arsimin e lartë që ata duhet të ndjekin duke u prirë më shumë drejt profesioneve praktike. Ideja se të diplomuarit në shkencat shoqërore nuk arrijnë të kenë një vend pune të sigurt dhe fitimprurës për individin dhe familjen e tij (me përjashtim të shkencave juridike) është shumë e përhapur. Motivimi i studentëve që vazhdojnë fakultetet e shkencave shoqërore ka ardhur duke rënë. Entuziazmi i fillimit është thyer përpara faktit se ata e kanë shumë të vështirë, në mos të pamundur, për të gjetur punë në profesionet e tyre. Në shumë raste ata janë të papunë ose kryejnë punë të tjera pa lidhje me formimin e tyre universitar, për të mos folur për faktin, që lidhet me ikjen masive të të rinjve shqiptarë jashtë shtetit menjëherë pas mbarimit të studimeve. Ikja jashtë vendit zvogëlon numrin e intelektualëve që mund të punojnë në fushat e shkencave sociale.

Së dyti, rrjedhë e gjendjes ekonomike të vështirë të shqiptarëve është edhe përforcimi i mendimit të tyre mbi rëndësinë jo të madhe që ka studimi në shkencat shoqërore dhe arsimimi i të rinjve në këto shkencat. Është e vërtetë se ka ende shumë të rinj që përzgjedhin fakultete të shkencave shoqërore, por kjo nuk lidhet kryesisht me vlerësimin për shkencat shoqërore, por më shumë me idenë për të marrë një diplomë të shkollës së lartë. Kjo dukuri është një sfidë e madhe e tanishme për shoqërinë

shqiptare, po të kemi parasysh rolin e madh shoqëror të ideve për zhvillimin e një vendi të hapur dhe demokratik.

Së treti, ideja e përhapur tek të rinjtë mbi lehtësinë e marrjes së një diplome në shkencat shoqërore lidhet edhe me cilësinë e mësimdhënies, interesin mësimor të studentëve dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve të studentëve. Të tre këta përbërës të mësimdhënies janë thelbësorë, por mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve të studentëve janë ndoshta më të rëndësishëm. Një mësimdhënie cilësore e rrit interesin për dijet shoqërore edhe përtej fakultetit përkatës, lëndës përkatëse ose vetë studentëve, por për këtë duhet që orët e ligjëratave të jenë më të hapura për ndjekësit e tyre se sa janë aktualisht. Vlerësimi i dijeve të studentëve vetëm nëpërmjet përgjigjeve me shkrim mund të konsiderohet si një mangësi e madhe e arsimit në shkencat shoqërore. Duhet rimenduar rëndësia e vlerësimeve me gojë dhe e debateve përkatëse mësimdhënës-student, sepse fjala e folur është mjet shumë i rëndësishëm i profesionistit të shkencave shoqërore dhe testim vlerësues plotësues i atij me shkrim.

Së katërti, në arsimin universitar në përgjithësi vazhdon të ekzistojë dukuria të cilën Weber-i e quante në kohën e tij si burokratizim i edukimit ose ngurtësim i grupit të mësimdhënësve me emërime zyrtare dhe lobime vetjakë.

Sot, ne mund t'i shtojmë këtij burokratizimi edhe dukuritë e korrupsionit dhe nepotizmit të cilat janë të nënkuptuara. Kufizimi me ligj i lirisë akademike për organizimin e menaxhimit të arsimit universitar, flet qartë mbi këtë dukuri dhe është dëshmi e përfshirjes së ndikimit qeveritar në çështjet e arsimit universitar.

Së pesti, edhe vlerat kulturore dhe shoqërore mund të ndikojnë mbi edukimin e studentëve dhe botëkuptimet e tyre, mbi metodat e të mësuarit, qëllimet e mësimdhënies etj. Përpara ndryshimeve demokratike në Republikën e Shqipërisë, të mësuarit dhe mësimdhënia në shkencat shoqërore në përgjithësi synonin më shumë rritjen e vëllimit të njohurive, se sa kultivimin e mendimit kritik vetjak.

Së gjashti, një përmasë e rëndësishme e kërkimit shkencor në shkencat shoqërore, mund të ishte gjetja e lidhjeve konkrete ndërmjet përbërësve të mjedisit sociologjik dhe mësimdhënies dhe kërkimit në këto shkenca.

Së shtati, edhe futja gjithnjë dhe më shumë e teknologjive të reja të informacionit (IT) ka krijuar njëherësh mundësi dhe sfida të reja serioze si për mësimdhënësit universitarë të shkencave shoqërore, ashtu edhe për studentët e këtyre shkencave. Është zgjeruar shumë sasia e informacionit dhe e përpunimit të tij nëpërmjet inteligjencës artificiale (IA). Kjo shtron kërkesa shumë të larta për mësimdhënësit universitarë dhe studentët e

shkencave shoqërore. Është e besueshme të mendohet se në rrethana të tilla, e humb edhe më shumë rëndësinë memorizimi njerëzor i informacionit kundrejt rritjes së përpunimit njerëzor të tij, në ndërveprim me inteligjencën artificiale. Kjo është një sfidë mbarëbotërore që edhe mësimdhënia shqiptare duhet ta mbajë parasysh dhe të përpunojë aq sa mundet qëndrimet e saj në dobi të cilësisë së mësimdhënies.

Pra sfida për të përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien në fushën e shkencave shoqërore mbetet e vështirë. Në përballjen me këtë sfidë ndërthuren edhe interesa të ndryshme ekonomike, politike, psikologjike dhe pragmatiste.

Literatura kryesore:

- Weber, Max: *Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology*. Berkeley, CA: University of California Press, 1978.
- Weber, Max: *Readings and commentary on modernity*, Ed. by Stephen Kalberg, Blackwell Publishing, 2005.
- Weber, Max: *Essays in Sociology*, eds. and trans. Hans H. Gerth and C. Wright Mills (New York: Oxford University Press, 1946).
- Weber, Max: «*Sociological Writings*», eds. Wolf Heydebrand, (The Continuum Publishing), 1994.

ISSN 2221 – 6863

*Doli nga shtypi shtator 2024 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*